



**THE AIRE CENTRE**

Advice on Individual Rights in Europe

# **KONFISKIMI I TË ARDHURAVE TË KORRUPSIONIT DHE KRIMEVE TË RËNDA DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

NJË SHIKIM I PËRGJITHSHËM I STANDARDEVE  
NDËRKOMBËTARE DHE EVROPIANE, UDHËRRËFYESIT  
DHE JURISPRUDENCA PËRKATËSE E GJYKATËS  
EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT





# **KONFISKIMI I TË ARDHURAVE TË KORRUPSIONIT DHE KRIMEVE TË RËNDA DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

NJË SHIKIM I PËRGJITHSHËM I  
STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE  
DHE EVROPIANE, UDHËRRËFYESIT  
DHE JURISPRUDENCA PËRKATËSE  
E GJYKATËS EVROPIANE TË  
TË DREJTAVE TË NJERIUT

## **Redaktorë**

Biljana Braithewaite, Drejtoreshë e Programit për Ballkanin Perëndimor, Qendra AIRE  
Catharina Harby, Konsulente e Lartë Ligjore, Qendra AIRE  
Nevena Kostić, Menaxhere e Projektit, Qendra AIRE për Ballkanin Perëndimor

## **Kontribues kryesorë**

Evan Flowers, Clare Barnard, Jennifer Hutchings, Tom Stroud,  
Amandeep Mann, dhe Yan-Shen Tan nga Dechert LLP, Londër

Me mirënjohje të thellë për Krešimir Kamber, Drejtorja e Juriskonsultit,  
Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Bogdan Gecić dhe  
Jovana Veličković, Zyra e Avokatisë Gecić, dhe William Ferris,  
Avokat në Clyde and Co., për kontributin e tyre në këtë publikim.

© 2023 AIRE Centre

## **Version i printuar**

400

Versioni origjinal në gjuhën angleze është përkthyer gjithashtu në gjuhët  
boshnjake/kroate/malazeze/serbe, shqipe dhe maqedonase.

## **Dizajni nga**

Kliker Dizajn

# ▶ PËRMBAJTJA

<b>PARATHËNIE.....</b>	<b>9</b>
<b>SHKURTESAT .....</b>	<b>11</b>
<b>Pjesa I - Hyrje .....</b>	<b>12</b>
HYRJE.....	12
Çfarë është konfiskimi?.....	13
Përse është i rëndësishëm konfiskimi?.....	14
<b>1.1 INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE .....</b>	<b>15</b>
1.1.1 Konventat e Kombeve të Bashkuara.....	15
1.1.2 Konventat e Këshillit të Evropës.....	17
1.1.3 Instrumentet e Bashkimit Evropian.....	20
1.1.4 Instrumente të tjera ndërkombëtare.....	22
<b>1.2 ORGANET DHE GJYKATAT NDËRKOMBËTARE.....</b>	<b>24</b>
1.2.1 Taskforca e Aksionit Financiar .....	24
1.2.2 Organet Monitoruese të Këshillit të Evropës.....	24
1.2.3 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut .....	25
1.2.4 Prokuroria Publike Evropiane .....	26
<b>1.3 PARIMET THEMELORE NGA INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE.....</b>	<b>28</b>
1.3.1 Fushëveprimi i asetëve të cilat mund të jenë objekt i ngrirjes dhe konfiskimit, përfshirë kategori të reja asetesh.....	28
1.3.2 Urdhrat e ngrirjes dhe fuqitë hetimore.....	30
1.3.3 Konfiskimi i zakonshëm (i bazuar në dënim) .....	32
1.3.4 Konfiskimi i vlerës dhe përzierja.....	33
1.3.5 Konfiskimi i instrumentaliteteve.....	34
1.3.6 Konfiskimi i të ardhurave dhe benefiteve të tjera që rrjedhin nga të ardhurat e krimit dhe korrupsionit .....	35
1.3.7 Përmbysja e barrës së provës.....	36

1.3.8 Konfiskimi i palës së tretë .....	37
1.3.9 Konfiskimi jo i bazuar në dënim .....	39
1.3.10 Bashkëpunimi ndërkombëtar .....	42
1.3.11 Mbrojtjet .....	42
1.3.12 Administrimi i pasurisë së konfiskuar .....	43

## 1.4 APLIKIMI I KONVENTËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT..... 45

1.4.1 E drejta për gëzimin paqësor të pasurive:	
Neni 1 i Protokollit Nr. 1 KEDNj.....	46
1.4.2 E drejta për proces të rregullt: Neni 6 KEDNj .....	61
1.4.3 Nuk ka dënim pa ligj: Neni 7 KEDNj.....	65
1.4.4 E drejta për respekt ndaj jetës private dhe familjare: Neni 8 KEDNj .....	68

## Pjesa 2 – Përmbledhjet e çështjeve ..... 72

AL-DULIMI DHE MONTANA MANAGEMENT INC. k. ZVICRËS.....	72
ANDONOSKI k. ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË.....	76
ANDRÉ DHE NJË TJETËR k. FRANCËS.....	79
ARCURI DHE TË TJERË k. ITALISË .....	82
B.K.M. LOJSTIK TASIMACILIK TICARET LIMITED SIRKETI k. SLOVENISË .....	85
BAKLANOV k. RUSISË.....	89
BALSAMO k. SAN MARINOS .....	91
BOSFOR AIRWAYS k. IRLANDËS .....	95
BUTLER k. MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	98
G.I.E.M. S.R.L. DHE TË TJERË k. ITALISË.....	101
GEERINGS k. HOLLANDËS.....	106
GLADYSHEVA k. RUSISË .....	108
GOGITIDZE DHE TË TJERË k. GJEORGJISË .....	112
GRAYSON DHE BARNHAM k. MBRETËRISË SË BASHKUAR .....	115
GRIFHORST k. FRANCËS .....	119
GUTSANOV k. BULLGARISË.....	122
ILIYA STEFANOV k. BULLGARISË .....	127
MARKUS k. LETONISË.....	131
MATANOVIĆ k. KROACISË.....	134
PAULET k. MBRETËRISË SË BASHKUAR .....	138
PHILLIPS k. MBRETËRISË SË BASHKUAR .....	141
RAIMONDO k. ITALISË .....	144

RAVON DHE TË TJERË k. FRANCËS .....	147
SACCOCCIA k. AUSTRIË.....	150
SALABIAKU k. FRANCËS.....	154
SHORAZOVA k. MALTËS.....	157
SILICKIENË k. LITUANISË .....	160
TENDAM k. SPANJËS.....	163
ULEMEK k. SERBISË .....	166
WEBB k. MBRETËRISË SË BASHKUAR .....	170
ZAKLAN k. KROACISË .....	173
C-255/14 ROBERT MICHAL CHMIELEWSKI k. NEMZETI ADÓ- ÉS VÁMHIVATAL DÉL-ALFÖLDI REGIONÁLIS VÁM- ÉS PÉNZÜGYŐRI FŐIGAZGATÓSÁGA .....	176
E BASHKUARA TË PROCEDURAVE PENALE KUNDËR DR (C-845/19) DHE TS (C-863/19).....	179





## ▶ PARATHËNIE

Rimarrja e asetëve është ide e thjeshtë; rikthimi ligjor i përfitimeve të paligjshme. Megjithatë, në praktikë rimarrja e asetëve është një fushë komplekse dhe shumë dimensionale e së drejtës, që shpesh kërkon procedura praktike komplekse ku përfshihen palë dhe juridiksione të shumta. Ky kompleksitet praktik kërkon që gjyqtarët dhe prokurorët të kenë njohuri rreth legjislacionit të tyre vendor në lidhje me ngrirjen, marrjen dhe konfiskimin, si dhe të kuptuar të gjerë rreth standardeve dhe instrumenteve ndërkombëtare që mëtojnë të harmonizojnë praktikën ndërkombëtare dhe të sigurojnë që rimarrja e asetëve me vlerë të përdoret vazhdimisht si mjet për luftimin e krimit në nivel global.

Një nga parimet themelore të së drejtës penale është që askush nuk mund të mbajë përfitimet ilegale të fituara përmes aktiviteteve kriminale. Në vendet evropiane, e sidomos në vendet e Ballkanit Perëndimor, ekzistojnë zgjidhje të ndryshme legjislative të cilat kanë për qëllim përmbushjen e këtij parimi. Reformat legjislative në Evropën Juglindore shkojnë paralelisht me krimin e organizuar dhe korrupsionin e aktorëve që aspirojnë pushtet politik dhe ekonomik në të gjithë rajonin.

Qendra AIRE (shq. Këshillim për të Drejtat Individuale në Evropë, ang. Advice on Individual Rights in Europe) dhe RAI (shq. Iniciativa Rajonale Anti-Korrupsion, ang. Regional Anti-corruption Initiative), zbatojnë projektin rajonal “Luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor përmes fuqizimit të bashkëpunimit rajonal në rimarrjen e asetëve”, i themeluar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Në vitet 2019 dhe 2020 dolën dy publikime, Doracaku për Rimarrjen Efektive të Asetëve në Përputhje me Standardet Evropiane dhe Ndërkombëtare, dhe Doracaku për Bashkëpunim lidhur me Instrumentet dhe Praktikat me të Mira për Rimarrjen Ndërkombëtare të Asetëve. Vlen të përmendet se këto dy publikime ofrojnë një shikim të gjerë mbi standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe ofrojnë praktikat më të mira për realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në rimarrjen e asetëve.

Ky publikim i shtjellon këto çështje me anë të një analize gjithëpërfshirëse të standardeve ndërkombëtare dhe praktikës gjyqësore relevante për temën e konfiskimit, me qëllim që të ndihmojë ushtruesit e profesionit ligjor për të kapërcyer sfidat e konfiskimit efektiv. Këshillimi dhe udhërrëfimi i ofruar është i rrënjësor në standarde ndërkombëtare dhe në precedentë ligjorë. Këto instrumente ndërkombëtare shërbejnë si kompas i vlefshëm për të kuptuar më thellë bashkëpunimin ndërkombëtar në lidhje me konfiskimin e asetëve ilegale.

Një nga sfidat kryesore në trajtimin e konfiskimit qëndron në zbatimin praktik të konfiskimit të zgjeruar, i cili përfshin sekuestrimin e aseteve të cilat jo vetëm që janë të lidhura me veprën penale nën hetime, por njëkohësisht prezumohet se janë të asociuara me aktivitete të tjera kriminale. Përveç kësaj, në lidhje me konfiskimin e zgjeruar dalin në pah pyetje që kanë të bëjnë me konfiskimin e aseteve nga palët e treta. Për të kuptuar efektivisht dhe për ta aplikuar si duhet konfiskimin e zgjeruar si koncept ligjor unik, duhet familjarizim i afërt me konventat ndërkombëtare përkatëse, me direktivat dhe parimet bazë që dalin nga këto instrumente ndërkombëtare. Në situata ku legjislacionit vendas i mungojnë përkufizimet e qarta, gjyqtarët dhe prokurorët mund të mbështeten tek parimet themelore të rrënjësura në konventat ndërkombëtare, dhe ky Udhërrëfyes i pajis ata me veglat esenciale për këtë qëllim.

Më tej, marrja e aseteve në të gjitha format e saj ndikon në mënyrë domethënëse tek respekti për të drejtat themelore që garantohet nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNj). Këtu përfshihen e drejta për gëzimin paqësor të pasurisë (Neni 1 i Protokollit Nr. 1), e drejta për proces të rregullt (Neni 6 KEDNj), parimi i jo krimit ose dënimit pa bazë ligjore (Neni 7 KEDNj), dhe e drejta për respekt të jetës private dhe familjare (Neni 8 KEDNj). Këto konsiderata ngrenë po ashtu pyetje me rëndësi lidhur me zbatimin retroaktiv të ligjit në çështjet e marrjes së aseteve.

Sfidë e madhe vazhdon të jetë marrja dhe konfiskimi civil, meqenëse shumica e procedurave të konfiskimit zhvillohen në kuadër të procedurave penale. Marrja civile është një koncept që është provuar në shumicën e vendeve të rajonit me anë të ligjeve të specializuara për tatime dhe dogana. Megjithatë, deri tani zbatimi efektiv i këtyre ligjeve ka munguar.

Ky Udhërrëfyes ofron analiza të vlefshme të parimeve themelore të dala nga instrumentet ndërkombëtare dhe ekzaminim të praktikës së KEDNj-së, duke sjellë orientime dhe zgjidhje për të adresuar çështjet në praktikë. Me një shikim të thellë të konventave kryesore ndërkombëtare, të direktivave dhe praktikës gjyqësore, ai mëton të ofrojë ndihmesë për gjyqtarët dhe prokurorët, por njëkohësisht edhe praktikantët dhe vendimmarrësit në tërë rajonin. Përballimi i sfidave praktike dhe fuqizimi i procesit të vendimmarrjes lidhur me konfiskimin e aseteve ilegale, si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, pa dyshim që do të rezultojnë me realizimin e drejtësisë dhe forcimin e shtetit të së drejtës.

**Radmila Dragicevic Dacic**

Gjykata Supreme, Republika e Serbisë

Gjyqtare në pension

## ▶ SHKURTESAT

Shkurtesa	Përkufizimi
GJDBE (ang. CJEU)	Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian
KEDNj (ang. ECHR)	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJEDNj (ang. ECtHR)	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
BE (ang. EU)	Bashkimi Evropian
TAFPP (ang. FATF)	Taskforca e Aksionit Financiar për Pastrimin e Parave
GSKK (ang. GRECO)	Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit
MONEYVAL (ang.)	Komisioni i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
OKB (ang. UN)	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNAC (ang.)	Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit
UNTOC (ang.)	Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional

Vini re që në seksionet vijuese të publikimit përdoret gjinia mashkullore për t'iu referuar një ngjarjeje të mëparshme që përcakton një person të cilësdo gjini, përveç rasteve kur publikimi i referohet specifikisht një femre. Të dy autorët e publikimit dhe Qendra AIRE avokojnë për barazinë gjinore dhe në parim mbështesin gjuhën neutrale gjinore.

# ► Pjesa I - Hyrje

## HYRJE

Ky publikim ofron një shikim të përgjithshëm të standardeve ndërkombëtare dhe praktikës gjyqësore relevante në lidhje me konfiskimin e të ardhurave të krimit dhe korrupsionit. Pjesa e parë e këtij publikimi mbulon instrumentet ndërkombëtare kyçe që janë relevante për konfiskimin (përfshirë kornizën ligjore evropiane). Pjesa e dytë ofron një shikim të përgjithshëm mbi organizatat ndërkombëtare kryesore, siç janë organet monitoruese të Këshillit të Evropës, dhe njëkohësisht jep detaje rreth rolit të Prokurorisë Publike Evropiane. Pjesa e tretë ndërmerr një qasje hyrëse tematike në lidhje me instrumentet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të konfiskimit, që nga ngrirja e asetëve dhe llojin e pasurive që mund të konfiskohen, e deri tek aspektet procedurale të konfiskimit. Pjesa e katërt e këtij publikimi shpjegon aplikimin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ("KEDNJ") në procedurat e konfiskimit. Kjo përfshin rastet kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ("GJEDNJ") vlerëson janë shkelur të drejtat relevante sipas KEDNJ-së. Pjesa finale e publikimit përmban përmbledhje të çështjeve të rëndësishme të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJDBE) të përzgjedhura për të ilustruar mënyrën se si këto gjykata i kanë zbatuar parimet lidhur me konfiskimin.

Procedurat e konfiskimit janë posaçërisht të ndjeshme ndaj sfidave sipas KEDNJ-së sepse ato përfshijnë balancimin e të drejtës individuale për gëzimin paqësor të pasurisë dhe të drejtës së Shtetit për ta kontrolluar atë pasuri në rrethana të caktuara, sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së. Ky dhe Nene të tjera të KEDNJ-së kërkojnë shqyrtim të kujdesshëm kur forma e konfiskimit nuk është e bazuar në dënim ose kur ajo përfshin të drejtat e palëve të treta. Vitet e fundit, instrumentet ndërkombëtare dhe ligjet vendase kanë lejuar gjithnjë e më shumë forma më të gjera konfiskimi, në përpjekje për të konsoliduar nivelet historikisht të ulëta të rimarrjes së të ardhurave nga krimi. Si rezultat, kufiri mes të drejtave të të pandehurit dhe të drejtave të Shtetit është bërë edhe më i mjegullt.

Natyra shpesh ndërkufitare e korrupsionit dhe krimit të organizuar gjithashtu nënkupton që e drejta ndërkombëtare dhe normat e saj të zakonshme janë relevante për procedurat e konfiskimit, çka e komplikon situatën për gjykatat vendase që trajtojnë çështjet në përputhje me legjislacionin vendas që aplikohet.

Ky publikim përqendrohet kryesisht në procedurat e gjykatës për konfiskim, megjithëse prek gjithashtu edhe çështje si ngrirja e asetëve me qëllim të konfiskimit dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në çështje të konfiskimit.

## Çfarë është konfiskimi?

Konfiskimi nuk është privimi përfundimtar ose i përhershëm i pasurisë me urdhër të gjykatës.<sup>[1]</sup> Ai gjithashtu mund ta përfshijë një privim të tillë të pasurisë me urdhër të autoritetit kompetent që nuk është gjykatë.<sup>[2]</sup> Konfiskimi zakonisht, edhe pse jo domosdoshmërisht, ka karakter ndëshkues<sup>[3]</sup> dhe nuk kufizohet me pa tjetër nga privimet e pasurisë që rrjedhin nga procedurat penale.<sup>[4]</sup>

Përkufizimi i gjerë i konfiskimit tregon se ai është koncept i lakueshëm. Ka një sërë variablesh që legjislatura mund të marrë parasysh gjatë hartimit të masave të konfiskimit. Këto variabla përfshijnë: shtrirjen e pasurisë që ka gjasa të jetë objekt konfiskimi (përfshirë kategori asetesh që janë duke u shfaqur në përdorim siç janë kryptoasetet); llojet e sjelljes kriminale (ose sjellje të tjera të paligjshme) që kanë gjasa të çojë drejt konfiskimit; dhe standardet dhe barra e provës që duhen aplikuar kur përcaktohet nëse asete të caktuara duhet të jenë objekt konfiskimi. Këto dhe çështje të tjera merren në shqyrtim më poshtë nën dritën e standardeve dhe instrumenteve ndërkombëtare.

- 
- [1] Nenet 1 të Konventës së Strasburgut, Konventës së Varshavës dhe Direktivës së vitit 2014: “Konfiskim do të thotë dënim ose masë e urdhëruar nga gjykata pas procedurave lidhur me një vepër penale ose vepra penale që rezultojnë me privimin final të pasurisë”. Nenet 2 të UNTOC dhe UNCAC: “Konfiskimi, i cili përfshin marrjen kur është e aplikueshme, nënkupton privimin permanent të pasurisë me urdhër të gjykatës ose një autoriteti tjetër kompetent”.
- [2] Kështu zgjerohet në përkufizimin e “konfiskimit” të përdorur në UNTOC ose UNCAC, por jo në atë të përdorur në Konventën e Strasburgut të vitit 1990, në Konventën e Varshavës ose në Direktivën e vitit 2014.
- [3] Përkufizimet e “konfiskimit” në Konventën e Strasburgut të vitit 1990 dhe në Konventën e Varshavës përcaktojnë që konfiskimi mund t’i referohet një “dënimi” ose një “masë”.
- [4] Kështu kufizohet në përkufizimin e tij në Konventën e Strasburgut të vitit 1990, në Konventën e Varshavës dhe në Vendimin Kornizë të vitit 2005, por jo në UNTOC, UNCAC ose në Konventën e Vjenës.

## Përse është i rëndësishëm konfiskimi?

Megjithëse ka pikëpamje të ndryshme rreth formës që duhet të ketë regjimi i konfiskimit, konfiskimi gjithsesi njihet dhe promovohet gjerësisht si armë e fuqishme në luftën kundër krimit të rëndë dhe korrupsionit.<sup>[5]</sup> Ai u shërben disa qëllimeve në këtë aspekt. Kur zbatohet me sukses, ai ka potencialin që:

- › Të privojë personat nga të ardhurat e sjelljes kriminale dhe të veprojnë si pengesë ndaj veprimtarisë kriminale.
- › Të lehtësojë erozionin e bazës tatimore të Shtetit që zhvillon ndjekjen penale.
- › Të ri-orientojë asetet në të mirën publike.
- › Të ndihmojë ruajtjen e shtetit të së drejtës.

---

[5] Shih, p.sh., përfshirjen e konfiskimit në Rekomandimin 4 të Taskforcës për Aksion Financiar të vitit 2012.

## ▶ 1.1 INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE

Ka një sërë traktatesh dhe konventash ndërkombëtare që kriminalizojnë akte të ndryshme të lidhura me korrupsionin dhe që rregullojnë zbatimin e atyre veprave, përfshirë konfiskimin e të ardhurave dhe pasurive të lidhura me to.

### 1.1.1 Konventat e Kombeve të Bashkuara

#### 1. Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional (2000) (ang. "UNTOC")

UNTOC, e cila hyri në fuqi në shtator 2003, është instrumenti kryesor i OKB-së në luftën kundër krimit të organizuar transnacional. Ajo përcakton një sërë veprash që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në grupe të organizuara kriminale, pastrim parash, korrupsion dhe pengim të drejtësisë si dhe "krime të rënda" të tjera. <sup>[6]</sup>

- › Neni 12 i UNTOC kërkon që Shtetet të miratojnë, "sa më shumë që është e mundur brenda sistemeve të tyre ligjore", masa që lejojnë konfiskimin e të ardhurave të krimit dhe pasurisë së përfshirë në vepra penale.
- › Neni 13 përcakton procedurat dhe detyrimet për bashkëpunim ndërkombëtar në procedurat e konfiskimit.
- › Neni 14 ravijëzon se si duhet të hiqet pasuria e konfiskuar.

#### 2. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (2005) (ang. "UNCAC")

UNCAC hyri në fuqi në dhjetor 2005 dhe adreson parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit në sektorin publik dhe privat. <sup>[7]</sup> Ajo vë mbi Shtetet

[6] Materiale shpjeguese të mëtejshme mund të gjenden në Udhërrëfyesin Legjislativ të UNTOC: <https://t.ly/SSnkA>

[7] Materiale shpjeguese të mëtejshme mund të gjenden në Udhërrëfyesin Legjislativ të UNCAC dhe Udhërrëfyesin Teknik: <https://t.ly/oaml> and <https://t.ly/X4sw>

firmëtare detyrimin për të zbatuar masa që kriminalizojnë akte të caktuara dhe për të maksimizuar efektivitetin e masave të marra kundër atyre veprave. Në mënyrë të veçantë:

- › Nenet 15 deri në 25 përcaktojnë aktet e kriminalizuara, përfshirë mitmarrjen (si për zyrtarët publikë vendas dhe të huaj, ashtu edhe për sektorin privat), përvetësimin, tregtimin e ndikimit, abuzimin e funksioneve, pasurimin e paligjshëm, pastrimin e të ardhurave të krimit, fshehjen dhe pengimin e drejtësisë.
- › Neni 13 kërkon që Shteti të miratojë “sa më shumë që është e mundur brenda sistemit të tij ligjor” masat e nevojshme për të mundësuar konfiskimin e të ardhurave të veprave të cekura në Konventë, si dhe pasurinë e përdorur ose e destinuar për t’u përdorur në ato vepra. Ai gjithashtu përcakton procedurat e nevojshme për sekuestrimin dhe ngrirjen e pasurisë së ndërlidhur me ato vepra.
- › Nenet 53, 54 dhe 55 përcaktojnë kriteret për njohjen e urdhrave të konfiskimit mes Shteteve dhe mekanizmat përmes të cilave ato implementohen.
- › Neni 57 parashikon kthimin dhe heqjen e aseteve të konfiskuara.

### 3. Konventa të tjera relevante

Konventat e OKB-së më poshtë gjithashtu kanë ndikim në kornizën ligjore ndërkombëtare që ka të bëjë me konfiskimin:

- › Konventa e Vjenës për Ligjin e Traktateve (1998), në lidhje me operimin e traktateve. Ky traktat është relevant kur ngrihen çështje interpretimi në lidhje me instrumente ndërkombëtare që dakordohen mes Shteteve përshkruar në këtë publikim, përfshirë ndërveprimin mes të drejtës ndërkombëtare dhe asaj kombëtare.
- › Konventa kundër Financimit të Terrorizmit (1999), në lidhje me kriminalizimin dhe ndëshkimin e financimit të terrorizmit. Neni 8 i kësaj konvente kërkon që Shtetet palë të ngrijnë ose të sekuestrojnë fondet e përdorura ose të destinuar për t’u përdorur në kryerjen e veprave të financimit të terrorizmit të përcaktuara në konventë, dhe gjithashtu të marrin masat e duhura për heqjen dorë nga këto fondeve. Neni 8 po ashtu sugjeron që Shtetet palë duhet të marrin në konsideratë ngritjen e mekanizmave që fondet nga të cilat është hequr



dorë të përdoren për të kompensuar viktimat e këtyre veprave. Mekanizmat e konfiskimit të përshkruara në këtë publikim u aplikohen veprave të financimit të terrorizmit si dhe veprave të korrupsionit tek të cilat fokusohet ky publikim.

## 1.1.2 Konventat e Këshillit të Evropës

### 1. Konventa e vitit 1990 për Pastrimin, Bastisjen, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave të Krimit (ETC 141) (“Konventa e Strasburgut e vitit 1990”)

Konventa e Strasburgut e vitit 1990 ka fushëveprim më të gjerë sesa UNTOC dhe UNCAC meqenëse ajo nuk e kufizon konfiskimin me kategori të caktuara të veprave. Megjithatë, Shtetet palë mund ta kufizojnë aplikimin e dispozitave të Konventës së Strasburgut të vitit 1990 me vepra të specifikuar ose me disa kategori të veprave.<sup>[8]</sup>

- › Neni 2 përcakton hapat që duhet të ndërmarrin Shtetet palë për të lejuar konfiskimin e pasurisë së përfshirë, dhe të të ardhurave të, veprave penale, si dhe deklaron që çdo palë në konventë mund të kufizojë kategoritë e veprave për të cilat aplikohen detyrimet e konventës.
- › Neni 13 vendos detyrimin që Shtetet palë të zbatojnë urdhrat e konfiskimit të marra nga palët e tjera në konventë. Neni 14 rendit procedurat përmes të cilave këto urdhra duhet të ekzekutohen.
- › Neni 18 përcakton bazat mbi të cilat Shtetet palë refuzojnë të bashkëpunojnë me palët e tjera.
- › Neni 23 përcakton që palët duhet të njohin vendimet gjyqësore të huaja.
- › Neni 27 përcakton kriteret e kërkesave për bashkëpunim mes Shteteve palë gjatë zhvillimit të hetimeve ose ndjekjes penale.

### 2. Konventa e vitit 1999 për të Drejtën Penale në lidhje me Korrupsionin (ETS 173) (“Konventa e Strasburgut e vitit 1999”)

Konventa e Strasburgut e vitit 1999 u miratua në vijim të Programit të Veprimit kundër Korrupsionit të Komitetit të Ministrave. Ajo hyri në fuqi në korrik 2002 dhe adreson

[8] Materiale shpjeguese të mëtejshme mund të gjenden në Raportin Shpjegues të Konventës: <https://t.ly/ADB5R>

korruptionin si në sektorin publik, ashtu edhe në sektorin privat. Ajo mbulon edhe personin që jep mito (“mito aktive”), edhe personin që merr mito (“mito pasive”).<sup>[9]</sup>

- › Neni 2 përkufizon miton aktive dhe i detyron palët e konventës që ta kriminalizojnë një akt të tillë. Neni 3 bën të njëjtën gjë për miton pasive. Nenet 4 deri në 15 më tej përcaktojnë akte të tjera që palët janë të detyruara t'i kriminalizojnë sipas konventës.
- › Neni 23 përcakton masat që duhen marrë nga palët në konventë me qëllim të mbledhjes së provave për keqpërdorime dhe konfiskimit të të ardhurave nga cilado prej veprave të përcaktuara në konventë.
- › Neni 25 përcakton parimet e bashkëpunimit ndërkombëtar sipas konventës, si dhe masat që duhen marrë për ta garantuar atë bashkëpunim. Ky plotësohet nga Neni 26 i cili përcakton detyrimet e palëve për t'i ofruar ndihmesë të ndërsjellë njëra-tjetrës gjatë hetimeve dhe ndjekjeve penale.

### 3. Konventa e vitit 2005 për Pastrimin, Bastisjen, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi dhe për Financimin e Terrorizmit (ETS 198) (“Konventa e Varshavës”)

Konventa e Varshavës ka të bëjë enkas me konfiskimin e financave të terrorizmit, edhe kur fondet që përdoren për të financuar terrorizmin kanë origjinë legjitime. Ajo gjithashtu aplikohet në masat e konfiskimit më përgjithësisht, edhe pse Shtetet kontraktuese kanë mundësi ta kufizojnë aplikimin e saj.<sup>[10]</sup>

- › Neni 3 përcakton detyrimet e përgjithshme për palët kontraktuese që të zbatojnë masat e konfiskimit, ndërsa Neni 5 deklaron nevojën për t'u siguruar që pasuritë e pastruara të mund t'i nënshtrohen ngrirjes, sekuestrimit dhe konfiskimit.
- › Neni 9 përcakton aktet që përbëjnë vepra të pastrimit sipas Konventës së Varshavës dhe nevojën që palët t'i kriminalizojnë akte të tilla.

[9] Materiale shpjeguese të mëtejshme mund të gjenden në Raportin Shpjegues të Konventës: <https://t.ly/XFqLi>

[10] Materiale shpjeguese të mëtejshme mund të gjenden në Raportin Shpjegues të Konventës: <https://t.ly/vsEL>

- › Neni 15 rendit parimet e përgjithshme të bashkëpunimit ndërkombëtar për zbatimin efektiv të urdhrave të konfiskimit si dhe masat e nevojshme për ta realizuar këtë bashkëpunim.
- › Neni 16 përcakton detyrimet e palëve për të ofruar ndihmë në hetime ndërkombëtare.
- › Neni 28 përcakton bazat mbi të cilat palët mund të refuzojnë të bashkëpunojnë me një urdhër konfiskimi.

#### 4. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Masat dhe veprimet për rimarrjen e të ardhurave të krimit duhet të jenë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kjo parandalon sekuestrimin arbitrar të aseteve dhe mbron të drejtat themelore të individëve. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (“**KEDNJ**” ose “**Konventa**”) përcakton standardet minimale detyruese të të drejtave të njeriut të aplikueshme për anëtarët e Këshillit të Evropës.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (“**GJEDNJ**”) e pranon që fuqitë e konfiskimit që kanë Shtetet janë të justifikuar dhe të nevojshme si mekanizma zbatimi kundër veprave të kriminalizuara nga instrumentet e ndryshme të përmendura në këtë pjesë. Megjithatë, me aplikimin e KEDNJ-së, ajo siguron që pronarëve të këtyre pasurive të konfiskuara t’u vihen në dispozicion nivelet bazë të mbrojtjes.

Procesi i konfiskimit të të ardhurave të krimit mund të angazhojë disa të drejta të Konventës. Kryesisht, ato janë:

- › E drejta për gezimin paqësor të pasurisë (Neni 1 i Protokollit Nr. 1)
- › E drejta për proces të rregullt (Neni 6).
- › *Nullum crimen sine lege dhe nulla poena sine lege*, ose nuk ka krim dhe nuk ka dënim pa ligj (Neni 7), ku çështjet e ligjshmërisë janë pjesë e akuzës ose e procedurave të zbatimit.
- › E drejta për respekt të jetës private dhe familjare (Neni 8), në rrethana të caktuara, si p.sh. kur pasuria që konsiderohet “shtëpi” merret ose bastiset.

### 1.1.3 Instrumentet e Bashkimit Evropian

Korrupsioni renditet si fushë kriminale në Nenin 83(1) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (ang. “**TFEU**”), duke i dhënë BE-së fuqi legjislative për ta rregulluar këtë fushë. Fusha të tjera të krimit të renditura në këtë nen përfshijnë pastrimin e parave, trafikimin e paligjshëm të drogës, falsifikimin e mënyrave të pagesës, krimet kibernetike dhe krimin e organizuar. Komisioni Evropian ka propozuar që në këtë listë të shtohen edhe shkeljet e sanksioneve.<sup>[11]</sup> BE-ja nuk ka fuqi legjislative mbi kategoritë kriminale që nuk janë të renditura në TFEU.

Legjislacioni i BE-së konsiston në: (i) Vendimet Kornizë, të cilat mund të bëhen të papërdorshme pas nënshkrimit të Traktatit të Lisbonës në vitin 2007 (por që mbeten në fuqi për aq sa nuk janë shfuqizuar) dhe të cilat kërkojnë që Shtetet Anëtare të zbatojnë ligje kombëtare për t’u dhënë këtyre efekt; (ii) Direktiva, të cilat gjithashtu kërkojnë zbatim përmes ligjeve të Shteteve Anëtare; dhe (iii) Rregullore, të cilat kanë efekt të drejtpërdrejtë tek Shtetet Anëtare dhe gjykatat e tyre.

Ka instrumente të ndryshme të BE-së që mbulojnë fushat e konfiskimit, krimit dhe korrupsionit. Për shkak të juridiksionit të BE-së mbi këto fusha të krimit dhe mekanizmave formale të zbatimit që janë në dispozicion për Komisionin Evropian kundër Shteteve Anëtare për dështimin në zbatimin e së drejtës së BE-së, këto instrumente mund të arrijnë deri diku një harmonizim më të madh sesa traktatet dhe konventat ndërkombëtare të përshkruara më lart. Instrumentet kryesore janë:

- › Neni 3 i Vendimit Kornizë 2005/212/JHA për Konfiskimin e të Ardhurave të Lidhura me Krimin, Instrumentalitetet dhe të Ardhurat (“**Vendimi Kornizë i vitit 2005**”) parashikon “konfiskimin e zgjeruar” (i njohur edhe si “konfiskim special”). Kjo lejon konfiskimin e asetëve jo direkt të lidhura me veprën që shqyrtohet para një gjykate kombëtare. Ajo aplikohet kur të ardhurat e një individit janë në shproporcion me vlerën e asetëve të tij dhe gjykata bindet që asetet në fjalë kanë rrjedhur nga aktiviteti kriminal i individit.

[11] Propozimi për një Direktivë të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për Rimarrjen dhe Konfiskimin e Asetëve COM/2022/245 final.

- › Direktiva 2014/42/EU për Ngrirjen dhe Konfiskimin e Instrumentaliteteve dhe të Ardhurave të Krimit në Bashkimin Evropian (“**Direktiva e vitit 2014**”) pjesërisht ka zëvendësuar Vendimin Kornizë 2005<sup>[12]</sup> dhe është futur për të inkurajuar uniformitetet më të madh mes Shteteve Anëtare në regjimet e ngrirjes dhe konfiskimit, duke parë dallimet e vazhdueshme mes ligjeve të Shteteve Anëtare. Ajo cakton standardet minimale dhe përfshin dispozita më të plota për harmonizimin e ligjeve të konfiskimit brenda BE-së në lidhje me disa vepra të rënda.
- › Rregullorja 2018/1805/EU për Njohjen e Ndërsjellë të Urdhrave të Ngrirjes dhe Konfiskimit (“**Rregullorja e vitit 2018**”) më pas u fut për të ngritur një sistem njohjesh të ndërsjella të urdhrave për ngrirje dhe konfiskim të lëshuara në kuadër të procedurave penale, duke përcaktuar se kur duhet të njihet dhe ekzekutohet një urdhër konfiskimi dhe situatat në të cilat Shtetet Anëtare mund të refuzojnë njohjen e urdhrave të marrë në vendet e tjera. Rregullorja gjithashtu mbulon menaxhimin dhe heqjen e pasurive të ngrira dhe të konfiskuara; detyrimet e Shteteve Anëtare ndaj personave të prekur; dhe zgjidhjet ligjore në dispozicion të atyre personave.
- › Më 12 dhjetor 2023, u arrit një marrëveshje politike mes Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me rregullat e përditësuara të rimarrjes dhe konfiskimit të asetëve, dhe në këtë kuadër do të miratohet një direktivë e re. Kjo direktivë do të zgjerojë mundësitë për konfiskimin e asetëve nga një listë më e gjatë krimesh, si trafikimi i armëve, mashtrimi dhe trafikimi i mallrave kulturore. Ajo do të lejojë konfiskimin e pasurive të pashpjegjuara lidhur me aktivitete kriminale, dhe do të ngrejë Zyra për Menaxhimin e Aseteve në të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së për të garantuar që pasuritë e ngrira të mos humbasin vlerën e tyre, duke mundësuar shitjen e asetëve të ngrira që rrezikojnë të humbasin vlerën ose që janë të kushtueshme për t'u mirëmbajtur. Në fund, kjo direktivë do të lehtësojë realizimin e të drejtës së viktimave për kompensim, duke lejuar kompensimin përmes pasurisë së konfiskuar nëse ka nevojë.<sup>[13]</sup>

[12] Recitali 9, Direktiva 2014/42/EU për Ngrirjen dhe Konfiskimin e Instrumentaliteteve dhe të Ardhurave të Krimit në Bashkimin Evropian.

[13] Deklaratë për shtyp e Komisionit Evropian, 12 dhjetor 2023 – Komisioni mirëpret marrëveshjen politike për rregullat që fuqizojnë rimarrjen dhe konfiskimin e asetëve në Bashkimin Evropian.

## 1.1.4 Instrumente të tjera ndërkombëtare

### 1. Konventa e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik në Luftën kundër Mitmarrjes për Zyrtarët e Huaj Publikë në Transaksionet Ndërkombëtare të Biznesit (1997) (“Konventa e OECD-së Kundër Mitos”)

E miratuar në vitin 1997, Konventa e OECD-së Kundër Mitos është detyruese për anëtarët e OECD-së dhe për Shtete të tjera firmëtare për kriminalizimin e mitos për zyrtarët e huaj publikë, dhe parashikon që Shtetet firmëtare “të marrin masat e nevojshme për të përcaktuar që mitot dhe të ardhurat nga mito për zyrtarët e huaj publikë, ose pasuri vlera e të cilave korrespondon me vlerën e këtyre të ardhurave, të jenë objekt i sekuestrimit dhe konfiskimit ose që të zbatohen sanksione monetare me efekt të krahasueshëm”.<sup>[14]</sup>

Rekomandimet e vitit 2009 nga Këshilli i OECD-së për Luftën e Mëtejshme kundër Mitos për Zyrtarët e Huaj Publikë në Transaksionet Ndërkombëtare të Biznesit, e cila plotëson Konventën e OECD-së Kundër Mitos, përmbajnë një rekomandim që anëtarët e OECD-së të konsultohen dhe të bashkëpunojnë me autoritetet kompetente në Shtete të tjera, përfshirë gjatë ndarjes së informacioneve dhe zhvillimit të procedurave për konfiskimin dhe rimarrjen e të ardhurave të mitos për zyrtarët e huaj publikë.<sup>[15]</sup>

Shumë vende të Evropës Juglindore nuk janë anëtare të OECD-së dhe nuk e kanë ratifikuar Konventën e OECD-së Anti-Mito.

### 2. Rekomandimet e Taskforcës së Aksionit Financiar për Pastrimin e Parave (“Rekomandimet FATF”)

Të miratuara në vitin 2012 dhe të përditësuara rregullisht që atëherë, rekomandimet e FATF-së përbëjnë një standard ndërkombëtar të njohur për luftimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, dhe financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë. Ndërkohë që vendet e Ballkanit Perëndimor nuk janë vetë Shtete Anëtare të FATF-së, MONEYVAL, një organ monitorues i përhershëm i Këshillit të Evropës kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, është anëtar i asociuar dhe zhvillon vlerësime jashtë vendi mbi bazën e standardeve të FATF-së.<sup>[16]</sup> Rekomandimet e FATF-së përfshijnë:

[14] Neni 3 i Konventës së OECD-së Kundër Mitmarrjes.

[15] Rekomandimi XIII i Rekomandimeve të vitit 2009 të Këshillit të OECD-së për Luftimin e Mëtejshëm të Mitmarrjes nga Zyrtarët e Huaj Publikë në Transaksionet Ndërkombëtare të Biznesit.

[16] Materiale shpjeguese të mëtejshme mund të gjenden në Shkresën e FATF-së mbi Praktikat më të

- › Rekomandimi B (i njohur rëndom si “Rekomandimi 4”), i cili ka të bëjë me pastrimin e parave dhe konfiskimin. Neni 4 përcakton qasjen e Rekomandimeve të FATF-së ndaj masave të konfiskimit. Ai thekson rëndësinë e mundësitë që autoritetet kompetente kombëtare të marrin masa zbatuese siç është konfiskimi pa paragjykuar të drejtat e palëve të treta të mirëbesuara (*bona fide*), dhe deklaron që vendet duhet të konsiderojnë marrjen e masave që lejojnë marrjen civile dhe konfiskimin pa kërkuar prova të origjinës së ligjshme (deri aty sa është në pajtueshmëri me parimet ligjore vendase).
- › Rekomandimi G (i njohur rëndom si “Rekomandimi 38”) përcakton standardet e Rekomandimeve të FATF-së në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar.

## ▶ 1.2 ORGANET DHE GJYKATAT NDËRKOMBËTARE

### 1.2.1 Taskforca e Aksionit Financiar

Taskforca e Aksionit Financiar (“**FATF**”) është një organ politikëbërës ndërqeveritar që ka për qëllim të përcaktojë standardet dhe të promovojë zbatimin efektiv të masave ligjore, rregullative dhe operacionale për luftimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe ato të lidhura me krimet financiare. Përveç politikëbërjes dhe përcaktimit të standardeve, FATF zhvillon një procedurë vlerësimi të ndërsjellë në bashkëveprim me Anëtarët e Asociuar dhe partnerë të tjerë, dhe vendos se cilat juridiksione me rrezikshmëri të lartë bëjnë pjesë në listat gri / të zeza. Këshilli i Evropës është anëtar Vëzhgues i FATF-së.

### 1.2.2 Organet Monitoruese të Këshillit të Evropës

#### 1.2.2.1 GRECO

Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (“**GRECO**”) është ngritur në vitin 1999 nga Këshilli i Evropës për të monitoruar pajtueshmërinë e Shteteve Anëtare të tij me masat anti-korrupsion. Përveç monitorimit të zbatimit të Konventës së Strasburgut të vitit 1999, ai monitoron respektimin e Parimeve Udhëheqëse për Luftën kundër Korrupsionit të miratuara në vitin 1997 nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës (“**Parimet Udhëheqëse**”).

Një nga funksionet e GRECO-s është të vlerësojë pajtueshmërinë dhe të hartojë rekomandime për Shtete të caktuara Anëtare, në procedura të ndara në runde vlerësimi. Implementimi i këtyre rekomandimeve më pas monitorohet. Duke vepruar kështu, GRECO ndihmon të identifikohen mangësitë në politikat kombëtare të anti-korrupsionit, duke nxitur reformat e nevojshme legjislative, institucionale dhe praktike.

Raundet e vlerësimit janë të grupuara sipas tematikave të Parimeve Udhëheqëse. Raundi i vlerësimit për 2003-2006 është i vetmi raund deri tani i cili është fokusuar



tek konfiskimi dhe anti-korrupsioni. Temat e tij ishin identifikimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i të ardhurave të korrupsionit, parandalimi dhe pikasja e korrupsionit në administratën publike, dhe parandalimi i përdorjes së personave ligjorë si mburoja për korrupsion.

GRECO gjithashtu ka fuqi të fillojë procedura ad hoc me marrjen e informacioneve të besueshme se një ndryshim institucional, legjislativ ose procedural në një Shtet Anëtar mund të rezultojë me një shkelje të rëndë të një standardi anti-korrupsion të Këshillit të Evropës i cili ka kaluar nëpër një raund vlerësimi nga GRECO.

GRECO po ashtu ofron një platformë për ndarjen e praktikave më të mira për parandalimin dhe pikasjen e korrupsionit.

### 1.2.2.2 MONEYVAL

Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (“**MONEYVAL**”) është një organ tjetër monitorues i Këshillit të Evropës. Ai është anëtar i asociuar i FATF-së, i besuar me detyrën e vlerësimit të pajtueshmërisë me standardet kryesore ndërkombëtare për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe efektivitetit të zbatimit të tyre, si dhe me detyrën e bërjes së rekomandimeve për autoritetet kombëtare në lidhje me përmirësimet e nevojshme në sistemet e tyre. Këtë e bën përmes një procesi dinamik vlerësimesh të ndërsjella, përmes shqyrtimit mes kolegëve, dhe përmes raporteve të rregullta vijuese.

MONEYVAL i vlerëson 34 anëtarët e tij mbi bazën e standardeve të mësipërme të FATF-së. Kështu, Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës të cilat nuk janë zotuar për zbatimin e standardeve të FATF-së gjithsesi u nënshtrohen indirekt atyre standardeve.

## 1.2.3 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

GjEDNj është institucion gjyqësor i Këshillit të Evropës, i cili ka juridiksion mbi kërkesat individuale ose Shtetërore ku pretendohen shkelje të KEDNj-së, për sa kohë që shkelja supozohet se ka prekur kërkuesin në mënyrë direkte dhe domethënëse. GjEDNj nuk mund të ndërmarrë çështje me iniciativën e vet. Gjithashtu, edhe gjykatat më të larta të Shtetit mund të kërkojnë opinione këshilluese për çështje interpretimi nga GjEDNj-ja në lidhje me çështjet e proceduara para gjykatave të tyre vendase.

GjEDNJ-ja ka kritere të rrepta pranueshmërie, përfshirë shterimi i mjeteve vendase, prekja e drejtpërdrejtë nga masa e ankmuar, dhe pësimi i një dizavantazhi domethënës.<sup>[17]</sup>

Seksioni 1.4 i këtij publikimi shqyrton praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së në lidhje me shkeljet e pretenduara të KEDNJ-së në procedura konfiskimi, dhe Pjesa 2 vazhdon me një përzgjedhje çështjesh të përmbledhura për të ilustruar se si GjEDNJ-ja aplikon KEDNJ-në në çështjet e lidhura me konfiskimin.

## 1.2.4 Prokuroria Publike Evropiane

Prokuroria Publike Evropiane (ang. “EPPO”) është organ prokurorial i pavarur i BE-së i cili nga 1 qershori 2021 operon në 22 vende të BE-së.<sup>[18]</sup> EPPO është krijuar sipas Rregullores së Këshillit (EU) 2017/1939 (“Rregullorja e vitit 2017”) me qëllim që të punojë drejt një sistemi të përbashkët të drejtësisë penale për krimet financiare ndërkufitare të BE-së. Sipas Rregullores së vitit 2017, EPPO ka fuqi për të hetuar dhe ndjekur penalisht krime që kanë të bëjnë me fondet e BE-së ose që shkojnë kundër interesave financiare të BE-së, siç është mashtrimi, korrupsioni, keqpërdorimi i aseteve të BE-së ose mashtrime të mëdha ndërkufitare në lidhje me TVSH. EPPO është dizajnuar për të vepruar shpejt dhe efektivisht në çështje ndërkufitare. Në qendër operon një Kryeprokurore Evropiane, si kreu i EPPO-s, dhe në çdo Shtet Anëtar pjesëmarrës operojnë Prokurorë të Deleguar Evropiane. EPPO gjithashtu shfrytëzon partneritetet me autoritetet ligjore kombëtare dhe me Zyrën Evropiane Anti-Mashtrim (ang. “OLAF”).

Neni 30(1)(d) i Rregullores së vitit 2017 parashikon specifikisht që Prokurorët e Deleguar Evropiane kanë fuqinë që të *“ngrijnë instrumentalitetet ose të ardhurat e krimit, përfshirë asetet, të cilat pritet të konfiskohen nga trupi gjykues, kur ka arsye për të besuar që pronari, poseduesi ose kontrolluesi i atyre instrumentaliteteve ose të ardhurave do të përpiqet të pengojë vendimin që urdhëron konfiskimin”*.

Meqenëse secili prej Prokurorëve të Deleguar Evropiane operon sipas ligjeve të Shtetit Anëtar ku janë të vendosur, konfiskimi i aseteve ndryshon sipas të drejtës penale vendase, përfshirë legjislacionin që zbaton ligjet e BE-së pa efekt të drejtpërdrejtë (siç është Direktiva e vitit 2014).

[17] Për udhërrëfim në lidhje me pranueshmërinë, shih GjEDNJ, Udhërrëfyes Praktik mbi Kriteret e Pranueshmërisë, së fundi i përditësuar më 31 gusht 2022.

[18] Mes vendeve pjesëmarrëse bëjnë pjesë: Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Spanja dhe Sllovenia.

Në shtatë muajt e parë të operimit të tij, EPPO raportoi që kishte filluar 81 aksione rimarrjeje në 8 Shtete Anëtare të ndryshme të BE-së.<sup>[19]</sup> EPPO kërkoi sekuestrimin e asetëve me vlerë totale 154 milionë Euro, dhe prej këtyre sekuestroi me sukses 147 milionë Euro, përfshirë me anë të konfiskimit të zgjeruar dhe të vlerës, pa dënim (shih seksionin 1.3 të këtij publikimi). Megjithatë, dëmet nga aktivitetet penale të asociuara u vlerësuan në shumën 5.4 miliardë Euro në të njëjtën periudhë, duke theksuar vështirësinë e rimarrjes së të ardhurave të krimit. Asetet e sekuestruara përfshinin llogari bankare, patundshmëri, automjete, aksione, para kesh dhe sende luksi.

Neni 28(1) i Draft-Direktivës së BE-së për Rimarrjen e Aseteve mëton të fuqizojë funksionet e EPPO-s duke kërkuar që zyrat e rimarrjes së asetëve të ngrihen në çdo Shtet Anëtar, dhe që këto zyra të “bashkëpunojnë ngusht” me EPPO-n për të identifikuar pasuritë që bëhen ose janë objekt i një urdhri ngrirjeje ose konfiskimi në procedurat penale të EPPO-s.

---

[19] Raporti Vjetor EPPO 2021 mund të gjendet tek: <https://t.ly/C1cc>

## ▶ 1.3 PARIMET THEMELORE NGA INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE

### 1.3.1 Shtrirja e asetëve të cilat mund të jenë objekt i ngrirjes dhe konfiskimit, përfshirë kategori të reja asetesh

Ndërkohë që kategoritë tradicionale të asetëve siç janë paratë kesh, llogaritë bankare, toka dhe asete të tjera të prekshme janë konsideruar për një kohë të gjatë se hyjnë brenda fushëveprimit të aksioneve të ngrirjes dhe konfiskimit, mund të ketë njëfarë ambiguiteti rreth zbatueshmërisë së disa përkufizimeve të caktuara të kategorive të reja të asetëve siç janë kryptoasetet.

Vëllimi i aktivitetit të paligjshëm me kryptoasete është rritur me shpejtësi vitet e fundit, i ndihmuar nga anonimiteti gjithnjë më i madh që sigurohet nga fakti që ai nuk ka kufij dhe llogaritë janë dixhitalisht të decentralizuara – ku shumë prej tyre shfrytëzojnë teknologjinë e blloqeve zinxhirore (ang. blockchain technology). Si reagim ndaj këtij trendi, juridiksione të ndryshme janë duke ndërmarrë qasje të ndryshme në trajtimin dhe rregullimin ligjor të kryptoasetëve, çka krijon vështirësi të shumta gjatë integritimit të këtyre kategorive të asetëve brenda regjimeve ekzistuese të ligjzbatimit dhe rimarrjes.

Më tej, natyra anonime e krypto-tregjeve nënkupton që nuk është gjithmonë e mundur të identifikohen pjesëmarrësit e tregut ose të përcaktohet vendndodhja e kryptoasetëve të tyre. Natyrisht që disa kryptoasete janë më të lehta për t'u identifikuar sesa disa të tjera. Për shembull, ato që quhen 'tallonet e pashkëmbyeshme' (ang. non-fungible tokens, ose "NFT") janë unike e rrjedhimisht lehtë të identifikueshme, ndërsa kriptovalutat janë të shkëmbyeshme, çka i bën ato më të vështira për t'u identifikuar dhe gjurmuar, një proces që përfshin metoda ku personat përpiqen të errësojnë origjinën dhe pronarët e fondeve (si p.sh. përmes krypto-mikseve). Kjo ngre problemin e përzjerjes, që elaborohet më poshtë, i cili po ashtu shfaqet edhe tek kategoritë tradicionale të asetëve. Megjithatë, blloku zinxhiror ofron prova të patjetërsueshme

të transaksioneve dhe kështu, me ndihmën e ekspertëve, zakonisht është e mundur të gjurmohen kriptomonedhat për të arritur tek kuletat (hapësirë e valutave për kriptoasete).

Pavarësisht nga sfidat e paraqitura nga kategoritë jo-tradicionale të aseteve, nga perspektiva e politikave ndërkombëtare po bëhet gjithnjë më e rëndësishme që të goditet përhapja e shpejtë e kripto-kriminalitetit me zbatimin e fuqive ligjzbatuese të reja dhe ekzistuese. Për këtë qëllim, trajtimi ligjor dhe rregullator i kriptoaseteve ka tendencë të përqafojë një përkufizim më të gjerë të “pasurisë” që favorizon viktimat e krimit dhe ata që përpiqen të rimarrin vlerën. Në Mbretërinë e Bashkuar, për shembull, gjykatat angleze kanë deklaruar me vendosmëri që kriptoasetet duhet të trajtohen si pronë, një përbërës i nevojshëm i testit për trajtimin e zgjidhjeve pronësore gjatë rimarrjes së tyre sipas të drejtës vendase angleze. Më gjerësisht, gjykatat angleze kanë përcaktuar që kriptoasetet i kanë të gjithë treguesit e pronës: për shembull, ato kanë kapacitet për pronësi, kanë kapacitet për t’u përkufizuar, dhe duken se janë po aq permanente sa edhe asetet e tjera financiare konvencionale. Madje është sugjeruar që e drejta angleze duhet të njohë në mënyrë eksplicite “objektet e të dhënave” (përfshirë kriptoasetet) si një kategori e tretë e pronës personale. Juridiksione të tjera si Australia janë duke arritur në përfundime të ngjashme.

Deri tani nuk është arritur konsensus në mbarë BE-në, por draft-Tregjet në Rregulloren e Kriptoaseteve shprehimisht parashikojnë ngrirjen dhe sekuestrimin e aseteve në zbatim të objektivit primar të asaj rregulloreje për rregullimin e kriptoaseteve dhe tregjeve të tyre.<sup>[20]</sup> Në lidhje me sanksionet ruse, BE-ja ka publikuar një udhërrëfyes që kriptoasetet duhet të konsiderohet se janë brenda përkufizimit të “fondeve”, “burimeve ekonomike” dhe “letrave me vlerë që janë të transferueshme”.<sup>[21]</sup> Edhe pse nuk është direkt e lidhur me konfiskimin, kjo tregon qasjen proaktive të BE-së në futjen e kriptoaseteve brenda fushëveprimit të legjislacionit ekzistues kur ato nuk përdoren për qëllimet që janë të ngjashme me ato të aseteve tradicionale.

Duke qenë se shumica e instrumenteve ndërkombëtare të diskutuara në këtë publikim nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë por kërkojnë implementim në shkallë vendi, varësisht nga përkufizimet e miratuara në legjislacionin vendas të zbatimit, mund të

[20] Neni 82(2)(f) Propozim për Rregullimin e Tregjeve të Kriptoaseteve dhe ndryshimi i Direktivës (EU) 2019/1937, COM/2020/593.

[21] Komisioni Evropian, “A janë kriptoasetet, dhe veçanërisht kriptoalutat, të mbuluara nga këto sanksione?”, *Pyetje të shpeshta në lidhje me kriptoasetet që kanë të bëjnë me sanksionet e vendosura pas agresionit rus në Ukrainë dhe përfshirjes së Bjellorusisë*, 21 mars 2023.

ekzistojnë pengesa të veçanta kombëtare që kriptoaasetet të konsiderohen prona ose asete që mund të jenë pjesë e procedurave të ngrirjes ose konfiskimit në një juridiksion të dhënë. Megjithatë, në këtë fushë të ligjit që po zhvillohet me shpejtësi po duket gjithnjë e më shumë që Shtetet dhe gjykatat vlerësojnë se këto kategori të reja asetesh jo të prekshme duhet të jetë e mundur të përkufizohen dhe të rimerren, pavarësisht nëse kjo duhet bërë përmes legjislacionit apo përmes precedentit ligjor.<sup>[22]</sup>

### 1.3.2 Urdhrat e ngrirjes dhe fuqitë hetimore

Konfiskimit shpesh i paraprin ngrirja e asetëve gjatë hetimeve, ku pengohet përkohësisht shfrytëzimi i atyre asetëve. Ngrirja e asetëve është hap thelbësor në parandalimin e fshehjes ose zhdukjes së pasurisë që mund të bëhet objekt konfiskimi.

Të gjitha konventat e mëdha ndërkombëtare<sup>[23]</sup> të adresuara në këtë publikim i detyrojnë palët firmëtare që të marrin masa për të lehtësuar hetimin dhe ngrirjen e asetëve. UNTOC dhe UNCAC përcaktojnë fuqi hetimore të gjera me qëllim të hartimit të argumenteve efektive duke sekuestruar asetet dhe duke urdhëruar që dokumente dhe informacione me rëndësi të vihen në dispozicion ose të sekuestrohen. Firmëtarët e UNTOC dhe UNCAC duhet të miratojnë masa për “të mundësuar identifikimin, gjurmimin, ngrirjen ose sekuestrimin” e të ardhurave të krimit ose pronat, pajisjet dhe instrumentalitetet e tjera që mbulohen nga konventat. Këtu përfshihen dispozitat e hartuara për të fuqizuar gjykatat dhe autoritetet për të urdhëruar që të dhënat bankare, financiare ose tregtare të vihen në dispozicion ose të sekuestrohen. Palët janë të ndaluara që të refuzojnë të ofrojnë dokumente për shkak të sekretësisë bankare sipas këtyre dispozitave. Kjo mundëson mbledhjen e informacioneve kyçe për hetime dhe, kur lind nevoja, hartimin e dosjes me argumentet e prokurorisë.<sup>[24]</sup>

Konventa e Strasburgut e vitit 1990 përfshin të njëjtat lloje të fuqive hetimore. Neni 4 specifikon teknikat që palët mund të përdorin për të lehtësuar identifikimin, gjurmimin dhe grumbullimin e provave. Teknikat përfshijnë urdhrat e monitorimit, vëzhgimin, interceptimin e telekomunikimeve, qasjen në sistemet kompjuterike dhe

[22] Shih qasjen përfshirëse të gjykatave angleze, për shembull: *Lavinia Deborah Osbourne k. (1) Personave të Panjohur dhe (2) Ozone Networks Inc trading as Opensea* [2022] EWHC 1021 (Comm); *Ion Science Limited dhe Duncan Johns k. Personave të Panjohur, Binance Holdings Limited dhe Payment Ventures* (e paraportuar, 21 dhjetor 2020); dhe *R k. West* (e paraportuar, 2019).

[23] UNTOC, UNCAC, Konventa e Strasburgut e vitit 1990, Konventa e Strasburgut e vitit 1999, dhe Konventa e Varshavës.

[24] Neni 12 UNTOC dhe Neni 31 UNCAC.

urdhrat për të prodhuar dokumente të caktuara.<sup>[25]</sup> Konventa e Strasburgut e vitit 1999 kërkon bashkëpunimin me dhe mes autoriteteve kombëtare sipas Nenit 21.

Konventa e Varshavës gjithashtu parashikon të njëjtat fuqi hetimore, dhe përfshin dispozita të fuqizuara që në mënyrë të veçantë adresojnë konfiskimin e financave terroriste. Masat e mëposhtme u aplikohen bankave dhe institucioneve të tjera më të gjera financiare. Neni 7(2) kërkon që palët firmëtare të adaptojnë masat në legjislacionin vendas për t'u dhënë autoriteteve përkatëse fuqinë që:

- › Të përcaktojnë nëse një person natyror ose ligjor është mbajtësi ose pronari përfitues i një ose më shumë llogarive në ndonjë bankë në territorin e tyre, dhe nëse po të marrin të gjitha detajet e llogarive të identifikuar.
- › Të marrin detajet e llogarive të caktuara bankare dhe operacioneve bankare të zhvilluara gjatë një periudhe të specifikuar.
- › Të monitorojnë operacionet bankare që zhvillohen përmes një ose më shumë llogarive të identifikuar.
- › Të sigurohen që bankat nuk ia zbulojnë klientit të bankës në fjalë ose palëve të treta faktin që janë kërkuar ose dhënë informacione, ose që janë duke u zhvilluar hetime.<sup>[26]</sup>

Këto fuqi më tej shtjellohen në Direktivën 2014, e cila përfshin mbrojtjet për të siguruar që urdhri i ngrirjes të mos qëndrojnë në fuqi më gjatë sesa është e nevojshme dhe që pronat e ngrira që nuk janë konfiskuar t'i kthehen pronarit legjitim.<sup>[27]</sup> Ky publikim nuk merret me ngrirjen ose sekuestrimin e aseteve në detaje.

[25] Neni 4 i Konventës së Strasburgut të vitit 1990.

[26] Neni 7 i Konventës së Varshavës.

[27] Urdhrat e ngrirjes iu nënshtrohen të njëjtave teste të proporcionalitetit si urdhrat e konfiskimit, por natyra e tyre e përkohshme dhe parandaluese i bën ato me gjasë proporcionale (p.sh. *Raimondo k. Italisë*, vendim i 22 shkurtit 1994, Nr. 12954/87 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim) dhe *Arcuri k. Italisë*, vendim i 5 korrikut 2001, Nr. 52024/99 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim)).

### 1.3.3 Konfiskimi i zakonshëm (i bazuar në dënim)

Konfiskimi i bazuar në dënim është privimi final i një personi nga avantazhet ose përfitimet ekonomike të rrjedhura nga një vepër penale për të cilën ai person është dënuar. Ai mundëson, përmes urdhrit të gjykatës, që një person të privohet nga të ardhurat e një krimi për të cilin ai person është shpallur përfundimisht fajtor.

Të gjitha instrumentet ndërkombëtare të renditura lart i detyrojnë Shtetet palë që të miratojnë çdo masë të nevojshme për të mundësuar konfiskimin e zakonshëm të “të ardhurave” të krimeve brenda fushëveprimit të tyre respektiv.<sup>[28]</sup> Prandaj përkufizimi i “të ardhurave” të krimit ka rëndësi:

- › UNTOC dhe UNCAC i përkufizojnë “të ardhurat” e krimit si çdo pronë/pasuri (përfshirë dokumentet ose instrumentet ligjore që dëshmojnë titull ose interes mbi prona/pasuri të tilla) e cila rrjedh nga ose është përftuar, direkt apo indirekt, përmes kryerjes së një veprë.<sup>[29]</sup>
- › Konventa e Strasburgut e vitit 1990 dhe Konventa e Strasburgut e vitit 1999 i përkufizojnë “të ardhurat” e krimit si çdo avantazh ekonomik nga veprat penale, i cili mund të jetë pronë me çfarëdo përshkrimi dhe gjithashtu mund të përfshijë dokumente ose instrumente ligjore që dëshmojnë titull ose interes në një pronë të tillë.<sup>[30]</sup>
- › Konventa e Varshavës i përkufizon “të ardhurat” e krimit më gjerësisht si *“çdo avantazh ekonomik, i rrjedhur ose i përftuar, direkt ose indirekt, nga veprat penale, i cili mund të jetë pronë me çfarëdo përshkrimi dhe gjithashtu dokumente ose instrumente ligjore që dëshmojnë titull ose interes mbi këtë pronë”*.<sup>[31]</sup> [Theksi i shtuar]

[28] Gjatë nënshkrimit ose ratifikimit të Konventës së Strasburgut të vitit 1990 palët mund të kufizojnë aplikimin e kësaj dispozite në Nenin 2(1) në lidhje me marrjen e masave të konfiskimit për vepra ose kategori të caktuara veprash. Aplikimi i dispozitës ekuivalente në Konventën e Varshavës gjithashtu mund të kufizohet në veprat e dënueshme me maksimumi mbi një vit burgim ose përmes referencës tek një listë veprash të veçanta, për sa kohë që konfiskimi i zakonshëm i aplikohet pastrimit të parave dhe kategorive të veprave të renditura në shtojcën e Konventës.

[29] Neni 2 UNTOC; Neni 2 UNCAC.

[30] Shih Raportin Shpjegues të Konventës Penale për Korrupsionin, prg. 94.

[31] Neni 1 i Konventës së Varshavës.



- › Konventa e Varshavës gjithashtu parashikon konfiskimin e pronave të pastruara.<sup>[32]</sup>
- › Direktiva e vitit 2014 gjithashtu përmban një përkufizim të gjerë: “*çdo avantazh ekonomik i rrjedhur nga një vepër penale; mund të jetë çdo formë prone/pasurie [përfshirë dokumente ose instrumente ligjore që dëshmojnë titull ose interes në një pronë/pasuri të tillë] dhe përfshin çdo riinvestim vijues ose transformim të të ardhurave të drejtpërdrejta nga një i dyshuar ose i akuzuar si dhe çdo përfitim me vlerë*”.<sup>[33]</sup> [Theksi i shtuar]

### 1.3.4 Konfiskimi i vlerës dhe përzierja

Në disa situata mund të mos jetë i mundur sekuestrimi direkt i të ardhurave të krimit, çka mund ta bëjë konfirmimin e zakonshëm të vështirë ose të pamundur. Kjo situatë mund të shfaqet kur të ardhurat e krimit janë transformuar ose konvertuar në një formë tjetër pasurie. Në raste të tilla, një masë që mundëson konfiskimin e një shume parash që korrespondon me vlerën e të ardhurave të një krimi mund të jetë vegël efektive. Kjo formë konfiskimi njihet si konfiskim sipas vlerës.

Një situatë tjetër në të cilën mund të mos jetë i mundur sekuestrimi i të ardhurave direkte nga krimi është kur këto të ardhura janë përzier me pasuri të përfutuara nga burime legjitime. Kjo njihet si përzierje. Çështja e përzierjes mund të trajtohet përmes futjes së masave specifike që lejojnë konfiskimin e një shume të pasurisë së përzier e cila konsiderohet afërsisht e njëjtë me vlerën e llogaritur të të ardhurave origjinale nga krimi.

Lloji i pasurisë që mund t’i nënshtrohet konfiskimit të vlerës mund të ndryshojë nga vendi në vend. Instrumentet ndërkombëtare të cekura në seksionin 1.1 nuk përcaktojnë një përkufizim standard. Disa Shtete bëjnë dallimin mes fondeve të vlerës ekuivalente me të ardhurat e krimit, dhe pasurive jo-monetare të vlerës ekuivalente me to (siç janë pronat e patundshme dhe automjetet). Për shembull, në Kodet Penale të Malit të Zi dhe Kroacisë,<sup>[34]</sup> një kryes është i detyruar të paguajë vlerën monetare ekuivalente me të ardhurat kriminale por nuk mund të detyrohet të dorëzojë pasuri në vlerë ekuivalente jo-monetare për të përmbushur një urdhër konfiskimi.<sup>[35]</sup>

[32] Neni 1 i Konventës së Varshavës.

[33] Neni 2 i Direktivës 2014/42/EU për Ngrirjen dhe Konfiskimin e Instrumentaliteteve dhe të Ardhurave të Krimit në Bashkimin Evropian.

[34] Neni 113 i Kodit Penal të Malit të Zi dhe Neni 77 i Kodit Penal të Kroacisë.

[35] Rrjeti Anti-Korrupsion i OECD-së për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, “Konfiskimi i

UNTOC, UNCAC, dhe Konventa e Varshavës të gjitha i detyrojnë palët që (i) të marrin masa për konfiskimin e vlerës; (ii) të mundësojnë konfiskimin e pasurive në të cilat janë transformuar apo konvertuar të ardhurat e krimit; dhe (iii) të mundësojnë konfiskimin e asetëve të përziera deri në vlerën e të ardhurave të krimit të cilat janë përzier. Në BE, të gjitha vendet (përveç Qipros dhe Maltës) kanë vënë në zbatim konfiskimin e vlerës.<sup>[36]</sup>

Konventat e Strasburgut të vitit 1990 dhe të vitit 1999 përmbajnë shprehimisht detyrimin për të marrë masa për konfiskimin e vlerës por nuk adresojnë direkt çështjet që kanë të bëjnë me transformimin, konvertimin ose përzierjen e asetëve. Këto çështje mbase duhet të adresohen me anë të përkufizimit të gjerë të “të ardhurave”, ku përfshihet çdo avantazh ekonomik nga një vepër penale. Mund të konsiderohet se një aset i transformuar, i konvertuar ose i përzier që ka rrjedhur përfundimisht nga një vepër mund të konfiskohet, pa ndonjë dispozitë eksplicite shtesë, mbi bazën se ai vazhdon të jetë avantazh ekonomik pavarësisht nëse ka ndryshuar formë.

### 1.3.5 Konfiskimi i instrumentaliteteve

Instrumentalitetet janë çdo pasuri që përdoret ose synohet të përdoret në çfarëdo mënyre, plotësisht apo pjesërisht, për të kryer një vepër penale ose vepra penale. Ato mund të përfshijnë, për shembull, automjete që janë përdorur për të fshehur mallra në situata trafikimi ose pajisje të synuara për t'u përdorur në kryerjen e një krimi. Instrumentalitetet e konfiskimit nuk janë të kufizuara brenda këtyre pasurive në posedimin e pronësisë së kriminelit. Këto gjithashtu mund të konfiskohen edhe nga palët e treta.<sup>[37]</sup>

UNTOC dhe UNCAC të dy i detyrojnë palët të marrin masa për të mundësuar konfiskimin e pasurisë, pajisjeve ose instrumentaliteteve të tjera<sup>[38]</sup> të destinuara për t'u përdorur në veprat e mbuluara nga këto konventa. Ngjashëm, Konventat e

---

Instrumentalitetet dhe të Ardhurave nga Krimit e Korrupsionit në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore”, 2018.

[36] B Vettori, T Kolarov dhe A Rusev, “Heqja e Aseteve të Konfiskuara në Shtetet Anëtare të BE-së: Ligje dhe Praktika”, Qendra për Studimin e Demokracisë, 2014; Rrjeti Anti-Korrupsion i OECD-së për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, “Konfiskimi i Instrumentalitetetve dhe të Ardhurave të Krimeve të Korrupsionit për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore”, 2018.

[37] Rrjeti Anti-Korrupsion i OECD-së për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, “Konfiskimi i Instrumentalitetetve dhe të Ardhurave të Krimeve të Korrupsionit për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore”, 2018.

[38] “Instrumentalitetet” nuk janë të përkufizuara në UNTOC as në UNCAC.

Strasburgut të viteve 1990 dhe 1999, Konventa e Varshavës dhe Direktiva e vitit 2014 të gjitha përcaktojnë që secili Shtet palë duhet të fusë masa për të mundësuar që Shteti të konfiskojë çdo pasuri që përdoret ose synohet të përdoret, në çfarëdo forme, plotësisht apo pjesërisht, për të kryer një vepër penale ose disa vepra penale.

### 1.3.6 Konfiskimi i të ardhurave dhe benefiteve të tjera që rrjedhin nga të ardhurat e krimit dhe korrupsionit

Të ardhurat e krimit dhe korrupsionit, ose pasuria në të cilën këto të ardhura janë transformuar apo konvertuar, mund t'i japin shkas të ardhurave të tjera ose benefiteve të tjera me vlerë. Secili prej instrumenteve kryesore ndërkombëtare parashikojnë konfiskimin e këtyre benefiteve, megjithëse këtë e bëjnë në mënyra të ndryshme. Politikat që mundësojnë konfiskimin e të ardhurave dhe benefiteve të tjera të rrjedhura nga të ardhurat e krimit synojnë të sigurojnë që kryesit të mos shpërblehen për sjellje të paligjshme.

UNTOC, UNCAC dhe Konventa e Varshavës të gjitha përcaktojnë shprehimisht konfiskimin e të ardhurave dhe benefiteve në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën shkallë si të ardhurat direkte të krimit. Konventa e Strasburgut e vitit 1990 e adreson këtë çështje ndryshe përmes përkufizimit të “të ardhurave” të krimit që përfshijnë çdo avantazh ekonomik nga një vepër penale. Më së pakti, kjo mbulon avantazhet në formën e të hyrave të rrjedhura nga të ardhurat e krimit.

Direktiva e vitit 2014 e zgjeron përkufizimin e “të ardhurave” duke mbuluar “çdo benefit me vlerë”. Megjithatë, Direktiva 2014 nuk lejon konfiskimin e parave mbi këtë bazë nëqoftëse përfitimi ekonomik nuk ka rrjedhur nga vetë krimi. Për shembull, në Çështjet e Bashkuara C-845/19 dhe C-863/19 – *Të ardhurat kriminale kundër DR dhe TS*,<sup>[39]</sup> GjEDNj vendosi që, meqenëse posedimi kriminal i narkotikëve në vetvete nuk gjeneron përfitim ekonomik, paratë që qenë objekt i procedurës së konfiskimit pas dënimit për një posedim të tillë, pa dënim për shitje, nuk mund të kishin dalë nga një vepër penale brenda fushëveprimit të Direktivës 2014 dhe prandaj nuk mund të konfiskoheshin sipas asaj Direktive.

Konfiskimi i zgjeruar, i cili parashikohet nga Neni 5 i Direktivës 2014, shkon përtej konfiskimit të të ardhurave dhe benefiteve të rrjedhura nga të ardhurat e krimit për të cilin një person është dënuar. Momenti i konfiskimit të pasurisë që i përket një personi

[39] Çështjet e Bashkuara C-845/19 dhe C-863/19 – *Procedurat penale kundër DR dhe TS*, vendimi i 21 tetorit 2021 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

të dënuar për një vepër është momenti kur gjykata bindet që pasuria ka rrjedhur nga “sjellja kriminale” (d.m.th. jo domosdoshmërisht nga vepra e dënuar). Direktiva 2014 e përshkruan vlerën e pasurisë si joproportionale me të ardhurat legjitime të kryesit si shembull i një rrethane e cila mund të mos e bindë gjykatën që pasuria ka ardhur nga sjellja kriminale. Draft Direktiva e BE-së për Rimarrjen e Aseteve i përmban këto dispozita.

### 1.3.7 Përmbysja e barrës së provës

Një element i rëndësishëm i një regjimi konfiskimi është mënyra se si ai e përcakton se cilat asete duhet t'i nënshtrohen konfiskimit. Mund të jetë e vështirë të vërtetohet që asetet kanë origjinë të paligjshme pa ndihmën e pronarit, kështu që mund të konsiderohet e udhës që masat e konfiskimit ta vendosin mbi të pandehurin barrën e vërtetimit që asetet kanë origjinë të ligjshme. UNTOC, UNCAC dhe Rekomandimet e FATFs-ë me gjasë sugjerojnë që kjo qasje që parashikon që secili Shtet palë mund të konsiderojë mundësinë e kërkimit që i pandehuri të demonstrojë origjinën e ligjshme të të ardhurave ose pronave të tjera nga krimi/korrupsioni që mund të konfiskohen, për sa kohë që një kërkesë e tillë është në përputhje me parimet<sup>[40]</sup> e të drejtës së vet vendase, dhe me natyrën e procedurave gjyqësore dhe atyre të tjera. Direktiva 2014, për shembull, parashikon që konfiskimi i zgjeruar duhet të jetë i mundur kur një gjykatë bindet se pasuria në fjalë ka rrjedhur nga sjellja kriminale. Shtetet Anëtare të BE-së, për shembull, kanë presupozimin që është substancialisht më e mundshme që pasuria në fjalë është përftuar nga sjellja kriminale sesa nga aktivitete të tjera, duke vënë kështu barrën mbi të pandehurin që ta kundërshtojë këtë presupozim.

Konventa e Varshavës është më pak e pavendosur. Ajo i detyron Shtetet palë të marrin masa në lidhje me veprat e rënda (siç përkufizohet nga e drejta vendase) duke kërkuar që kryesi të demonstrojë origjinën e pasurisë që mund të jetë objekt konfiskimi, megjithëse një Shtet palë mund të mos e aplikojë këtë dispozitë të Konventës së Varshavës përmes një deklarate në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose hyrjes.<sup>[41]</sup>

GjEDNj ka gjetur sisteme specifike për përmbysjen e barrës së provës brenda kufijve për të qenë në përputhje me KEDNj-në.<sup>[42]</sup> Për konfiskimet jo të bazuara në

[40] Në UNCAC referenca është ndaj “parimeve themelore”; në UNTOC referenca është thjesht ndaj “parimeve”.

[41] Shih Nenin 53(4).

[42] Për shembull, *Grayson dhe Barnham k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 23 shtatorit 2008, nr.

dënim (marrja civile), përmbysja e barrës së provës mund të lejohet për sa kohë që ajo nuk rezulton me një “çekuilibër të papranueshëm mes palëve”.<sup>[43]</sup> Për procedurat e konfiskimit të bazuara në dënim, presupozimet kundër të pandehurit janë të lejueshme për sa kohë që Shtetet i kufizojnë këto presupozime “brenda kufijve të arsyeshëm të cilët marrin parasysh rëndësinë e asaj çka rrezikohet dhe mbështesin të drejtat e mbrojtjes”.<sup>[44]</sup> Gjatë përcaktimit të këtyre kufijve të arsyeshëm, mund të merren parasysh faktorët e mëposhtëm:

- › Nëse konfiskimi është përgjithësisht i supozuar apo rikthyes.<sup>[45]</sup>
- › Efektet e urdhrimit të konfiskimit mbi të pandehurin.<sup>[46]</sup>
- › Nëse presupozimi është në përputhje me prezumimin e pafajësisë në mënyrë që të ekzistojë mundësia e kundërshtimit edhe nëqoftëse kundërshtimi kërkon që i akuzuari ta mbrojë veten.<sup>[47]</sup>
- › Nëse përmbysja e barrës së provës do të kërkonte vetinkriminim.<sup>[48]</sup>

### 1.3.8 Konfiskimi i palës së tretë

Një kryes mund të tentojë t'i shmanget masave të konfiskimit duke transferuar asetet që përfaqësojnë të ardhurat e krimit tek palë të treta, siç janë të afërmit ose personat mbi të cilët kryesi ka kontroll. Konfiskimi i palës së tretë i referohet konfiskimit të aseteve në duart e palëve të tilla të treta. Konventat e OKB-së dhe

19955/05 dhe 15085/06 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[43] *G. k. Francës*, vendim i 5 tetorit 1988, Nr. 11941/86; Rikthimi i barrës së provës në konfiskimin e të ardhurave të krimit: Sondazh mbi Praktikat më të Mira të Këshillit të Evropës (Best Practice Survey Nr. 2) PC-S-CO (2000) 8 Rek.

[44] *Salabiaku k. Francës*, vendimi i 7 tetorit 1988, Nr. 10519/83 at §28 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[45] Rikthimi i barrës së provës në konfiskimin e të ardhurave të krimit: Sondazh mbi Praktikat më të Mira të Këshillit të Evropës (Best Practice Survey Nr. 2) PC-S-CO (2000) 9 Rek.

[46] Rikthimi i barrës së provës në konfiskimin e të ardhurave të krimit: Sondazh mbi Praktikat më të Mira të Këshillit të Evropës (Best Practice Survey Nr. 2) PC-S-CO (2000) 9 Rek.

[47] *Pham Hoang k. Francës*, vendimi i 25 shtatorit 1992, Nr. 13191/87; *Salabiaku k. Francës*, vendimi i 7 tetorit 1988, Nr. 10519/83 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[48] Rikthimi i barrës së provës në konfiskimin e të ardhurave të krimit: Sondazh mbi Praktikat më të Mira të Këshillit të Evropës (Best Practice Survey Nr. 2) PC-S-CO (2000) 9 Rek.

Këshillit të Evropës nuk përmbajnë rregulla të veçanta në lidhje me konfiskimin e palës së tretë, vetëm dispozitat e tyre të përgjithshme përkatëse për konfiskim, përfshirë përkufizimet e “të ardhurave të krimit” dhe mbrojtje të qarta për të drejtat e palëve të treta të pafajshme, lejojnë konfiskimin e palës së tretë.<sup>[49]</sup>

Megjithatë, Direktiva 2014 përmban dispozita të zhvilluara në lidhje me konfiskimin e palës së tretë. Ajo kërkon shprehimisht futjen e masave që mundësojnë konfiskimin e palës së tretë kur pala e tretë i ka përfutur të ardhurat, ose pasuri të tjera vlera e të cilave korrespondon me të ardhurat, nga një person i dyshuar ose i akuzuar nëqoftëse pala e tretë e ka ditur, ose duhet ta kishte ditur nga faktet dhe rrethanat, që qëllimi i transferimit ose blerjes ka qenë shmangia e konfiskimit. Fakti që pasuria është transferuar pa pagesë ose në këmbim të një shume shumë më të ulët sesa vlera në treg përmendet si tregues i mundshëm i kësaj njohurie të atribuuar.

Të drejtat e procesit të rregullt dhe zgjidhjes efektive u aplikohen palëve të treta nga të cilat propozohet të konfiskohet pasuria. Kjo përfshin paraqitjen si palë në procedurat e konfiskimit ku persona të tillë pretendojnë se kanë të drejta pronësore mbi pasurinë që kërkohet të konfiskohet. Kështu u vendos nga GjDBE-ja në Çështjet e Bashkuara C-845/19 dhe C-863/19 – *Procedurat penale kundër DR dhe TS*, ku u pretendua se shumat e marra gjatë hetimeve u përkisnin anëtarëve të familjes dhe nuk kishin qenë kurrë në posedim të të pandehurve, e aq më pak të përziera në kriminalitet.<sup>[50]</sup> Në këtë çështje, GjDBE vendosi që ligjet kombëtare në Bullgari që përjashtonin palët e treta nga paraqitja në procedura ishin në kundërshtim me Direktivën 2014.

Të drejtat e palëve të treta të mirëbesuara (d.m.th. ato palë njohuria e të cilave nuk mund të dëshkohet apo të kundërshtohet) nuk duhet të paragjykojnë. Kjo është e parashikuar në mënyrë eksplicite në UNTOC, UNCAC, në Rekomandimet e FATF-së dhe në Direktivën 2014. Konventa e Varshavës në mënyrë të veçantë mandaton që secili Shtet palë duhet të miratojë dispozita legislative për të siguruar që ato që preken nga ngrirja, sekuestrimi, konfiskimi apo çdo masë tjetër mbi pasurinë të ketë në dispozicion zgjidhje ligjore efektive në mënyrë që të ruajnë të drejtat e tyre. Masa të tilla mbrojtëse u aplikohen të dy palëve të treta që janë të emërtuar si pronarë të

[49] Besohet se përkufizimi i “të ardhurave” në këto konventa është aq i gjerë sa të përfshijë të ardhurat në duart e palëve të treta. Prandaj, konfiskimi i këtyre të ardhurave nënkupton konfiskimin nga palët e treta.

[50] Çështjet e Bashkuara C-845/19 dhe C-863/19 – *Procedurat penale kundër DR dhe TS*, vendimi i 21 tetorit 2021 (të përfshira si përmbledhje në këtë publikim).

pasurisë së kontestuar dhe atyre që e posedojnë këtë pasuri. Konventa e Strasburgut e vitit 1999 është e heshtur në lidhje me të drejtat e palëve të treta të mirëbesuara.

Ndërkohë që jurisprudenca e GjEDNj-së historikisht ka ofruar mbrojtje të kufizuara për palët e treta të mirëbesuara,<sup>[51]</sup> në Varvara k. Italisë, GjEDNj sugjeroi që mbrojtja e palëve të treta të mirëbesuara është normë zakonore e të drejtës ndërkombëtare e cila nuk duhet të paragjyket në konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave të krimit.<sup>[52]</sup> Nëqoftëse mbrojtja e palëve të treta të mirëbesuara vërtet është normë zakonore e të drejtës ndërkombëtare në lidhje me konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave kriminale përgjithësisht, kjo e drejtë aplikohet pavarësisht nga konventat ndërkombëtare që përcaktojnë forma të veçanta të procedurave të konfiskimit në fjalë (për shembull, Konventa e Strasburgut e vitit 1999 në lidhje me veprat e mitmarrjes, ose UNTOC në lidhje me krimin e organizuar). Prandaj, kur angazhohet e drejta ndërkombëtare gjykatat kombëtare duhet të kujdesen që të peshojnë çdo paragjykim ndaj palëve të treta të mirëbesuara kundrejt konfiskimit që kërkohet dhe, aty ku duhet, të lehtësojnë të drejtën e palëve të tilla të treta për t'u dëgjuar gjatë procedurave.

### 1.3.9 Konfiskimi jo i bazuar në dënim

Ka disa situata të caktuara në të cilat konfiskimi i bazuar në dënim mund të mos jetë i mundur. Për shembull, një i pandehur mund të jetë i panjohur, i vdekur, i arratisur ose ka imunitet nga ndjekja penale, ose vjetërsimi i lëndës mund të pengojë që ndaj tyre të fillojë procedura penale. Në situata të tilla, nuk ka dënim penal, por megjithatë mund të konsiderohet i dëshirueshëm mundësimi i procedurave të konfiskimit, bashkë me mbrojtjet e duhura. Disa Shtete i kanë të parashikuara procedurat e konfiskimit, sipas disa kushteve të caktuara, në mungesë të dënimit penal. Kjo njihet si konfiskim pa dënim, ose marrje civile.

Instrumentet ndërkombëtare të referuara në këtë publikim nuk përmbajnë dispozita të detajuara në lidhje me marrjen civile. UNTOC, UNCAC, Konventa e Strasburgut e vitit 1990, Konventa e Strasburgut e vitit 1999, dhe Konventa e Varshavës nuk e bëjnë dënimin penal parakusht për konfiskim, por përkufizimet e tyre për "të ardhurat" dhe instrumentalitetet sugjerojnë që fokusi është i përqendruar tek konfiskimet e bazuara në dënim. Kjo mund të jetë për shkak të rreptësisë së

[51] Në AGOSI k. Mbretërisë së Bashkuar, vendimi i 24 tetorit 1986, Nr. 9118/80, ku u mbështet urdhri i sekuestrimit kundër një "pronari të pafajshëm".

[52] Varvara k. Italisë, vendimi i 29 tetorit 2013, Nr. 17475/09.

konfiskimit (si privim përfundimtar i pasurisë) dhe rrezikut të keqpërdorimit të këtyre fuqive, përfshirë privimin arbitrar të pasurisë në kundërshtim me të drejtat themelore të personit, në mungesë të një dënimi sipas standardit penal të provës.

Megjithatë, ka pasur disa zhvillime në standardet ndërkombëtare në këtë fushë. UNCAC parashikon që, për qëllime të ndihmës së ndërsjellë, palët duhet “të marrin në konsideratë” marrjen e masave për të lejuar konfiskimin e pasurisë me origjinë të huaj sipas një urdhri të gjykatës pa dënim penal në rastet kur kryesi nuk mund të ndiqet penalisht për shkak të vdekjes, arratisjes, mungesës, ose në raste të tjera të përshtatshme.<sup>[53]</sup> Rekomandimet e FATF gjithashtu theksojnë se vendet duhet “të marrin në konsideratë miratimin” e masave të tilla.<sup>[54]</sup> Për më tepër, Konventa e Varshavës deklaroi, në kontekstin e bashkëpunimit me Shtetet kërkuese, që masat e ekzekutimit mund të kërkohen “në shkallën më të gjerë të mundshme sipas të drejtës së tyre vendase” kur një gjë e tillë kërkohet “në lidhje me një veprë penale” [theksi i shtuar], dhe jo domosdoshmërisht si sanksion penal pas dënimit.<sup>[55]</sup>

Brenda BE-së, standardet e njohjes së konfiskimit civil janë duke u zhvilluar. Vendimi Kornizë i vitit 2005 përcaktoi, në lidhje me veprat e taksave, që Shtetet Anëtare mund të përdorin procedura të tjera jo penale për të privuar një kryes nga të ardhurat e veprës. Në vitin 2008, Komisioni Evropian sugjeroi që Shtetet Anëtare të marrin në konsideratë futjen e masave të konfiskimit civil.<sup>[56]</sup>

Direktiva e vitit 2014 solli dispozita specifike për konfiskimin jo të bazuar në dënim, sado që vetëm në rrethana të kufizuara kur procedura penale ka filluar por sëmundja ose arratisja e të dyshuarit apo të akuzuarit e ka bërë të pamundur vijimin e dënimit penal, dhe me kusht që personi pasuria e të cilit preket të jetë i përfaqësuar nga një avokat. Testi i pragut që përcaktohet në Nenin 4(2) të Direktivës së vitit 2014 është që procedurat penale “mund” të kishin çuar tek dënim i penal sikur i akuzuari të kishte pasur mundësi të gjykohej. Sipas memorandumit shpjegues të Komisionit Evropian, kjo u lejoi Shteteve Anëtare të zgjedhin nëse konfiskimi duhet të vendoset nga gjykatat penale dhe/ose gjykatat civile/administrative.<sup>[57]</sup>

[53] Shih Nenin 54(1)(C) UNCAC.

[54] Rekomandimi 4 i Rekomandimeve të FATF-së.

[55] Neni 23(5) i Konventës së Varshavës.

[56] Komunikata nga Komisioni drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit, “Të ardhurat e krimit të organizuar: Të sigurohet që 'krimi nuk ia vlen'”, COM (2008) 766 final, prg. 3.3.1.

[57] Propozimi për një Direktivë të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për Ngrirjen dhe Konfiskimin e të Ardhurave të Krimit në Bashkimin Evropian, COM (2012) 85 final, fq. 11.



Draft Direktiva e BE-së për Rimarrjen e Aseteve shton vdekjen, imunitetin nga ndjekja penale, dispozitën e amnestisë dhe vjetërsimin e lëndës sipas të drejtës vendase në listën e rrethanave në të cilat, me kusht që procedura penale të ketë filluar, mund të kërkohet konfiskimi jo i bazuar në dënim.<sup>[58]</sup> Draft teksti e bën të shtrënguar testin e aplikueshmërisë, duke kërkuar që gjykata kombëtare të jetë “e bindur që të gjitha elementet e veprës janë prezente”.

GjEDNj gjithashtu e ka marrë në konsideratë konfiskimin jo të bazuar në dënim. Praktika gjyqësore e kohëve të fundit konfirmon që, në parim, një sistem i tillë për konfiskimin jo të bazuar në dënim mund të hyjë në përdorim, sado që në një mënyrë që është në përputhje me të drejtat e Konventës.<sup>[59]</sup> Kjo do të thotë që:

- › Procedurat për konfiskimin jo të bazuar në dënim duhet të zhvillohen në praninë e të dy palëve dhe duke respektuar të drejtat e mbrojtjes,<sup>[60]</sup> megjithëse të drejtat sipas titullit penal të Nenit 6 KEDNj me gjasë nuk aplikohen.<sup>[61]</sup>
- › Gjykatat në procedura të tilla duhet të japin arsyetim të plotë për vendimin e tyre përfundimtar.<sup>[62]</sup>
- › Duhet të ekzistojë e drejta për apel.<sup>[63]</sup>
- › Mund të jetë e lejueshme përmbysja e barrës së provës për një konfiskim jo të bazuar në dënim.<sup>[64]</sup>

[58] Neni 15 i Propozimit për Direktivën e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për Rimarrjen dhe Konfiskimin e Aseteve, COM/2022/245 final.

[59] *Arcuri k. Italisë*, vendimi i 5 korrikut 2001, Nr. 52024/99 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[60] *Arcuri k. Italy*, vendimi i 5 korrikut 2001, Nr. 52024/99 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[61] *Butler k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi për pranueshmërinë i 27 qershorit 2022, Nr. 41661/98 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[62] *Butler k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi për pranueshmërinë i 27 qershorit 2022, Nr. 41661/98 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[63] *Butler k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi për pranueshmërinë i 27 qershorit 2022, Nr. 41661/98 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[64] *Gogitidze k. Gjeorgjisë*, vendimi i 12 majit 2015, Nr. 36862/05 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

### 1.3.10 Bashkëpunimi ndërkombëtar

UNTOC, UNCAC, Konventa e Strasburgut e vitit 1990, Konventa e Strasburgut e vitit 1999 dhe Konventa e Varshavës e njohin rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në lidhje me konfiskimin dhe përfshijnë dispozita të detajuara në këtë aspekt.<sup>[65]</sup> Për shembull, Konventa e Strasburgut e 1990-ës njih në mënyrë eksplicite ekzistencën e konventave të tjera ndërkombëtare dhe lejon që konventat e tjera ndërkombëtare të jenë përmby dispoziat e asaj konvente nëqoftëse kjo fasilton bashkëpunimin ndërkombëtar.<sup>[66]</sup>

Ngritja e EPPO-s dhe propozimet për zyrat kombëtare të rimarrjes së aseteve brenda BE-së gjithashtu është tregues i rëndësisë së harmonizimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar kur veprat në fjalë me gjasë kanë elemente ndërkufitare.

### 1.3.11 Mbrojtjet

Duke pasur parasysh ashpërsinë e konfiskimit si mekanizëm zbatues dhe ndëshkues, duhet të ketë mbrojtje për të pandehurit, viktimat, dhe palët e treta. Si UNCAC ashtu edhe UNTOC i detyrojnë Shtetet palë të marrin masat e duhura për të mbrojtur dëshmitarët, ekspertet, dhe viktimat që japin dëshmi në lidhje me veprat e konstatuara në përputhje me ato Konventa, pa paragjykuar të drejtat e të pandehurit, përfshirë të drejtën për proces të rregullt. Më tej, ato deklarojnë se të drejtat e palëve të treta *bona fide* nuk duhet të paragjykohen.

Ndërkohë që Konventat e Strasburgut të viteve 1990 dhe 1999 nuk i detajojnë mbrojtjet specifike, Raporti Shpjegues i Konventës së Strasburgut të 1999 e njih potencialin intruziv të teknikave hetimore speciale. Raporti Shpjegues konfirmon që Shtetet palë janë të lirë të vendosin që disa prej këtyre teknikave nuk do të pranohen në sistemin e tyre ligjor ose që ta rrethojnë përdorimin e tyre “*me sa më shumë mbrojtje dhe garanci që është e nevojshme nga imperativi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore*”.<sup>[67]</sup>

[65] Shih Doracakun e UNDOC për bashkëpunimin ndërkombëtar për qëllime të konfiskimit të të ardhurave të krimit: <https://t.ly/XNbl4>

[66] Neni 39 i Konventës së Strasburgut të vitit 1990.

[67] Raporti Shpjegues i Konventës Penale për Korrupsionin, prg. 114.

Konventa të tjera ndërkombëtare si Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme<sup>[68]</sup> dhe Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit<sup>[69]</sup> mund të aplikohen kur bëhet fjalë për të ardhurat e krimeve në lidhje me vepra të caktuara si terrorizmi dhe trafikimi me qenie njerëzore. Këto kategori veprash janë jashtë fushëveprimit të këtij publikimi.

### 1.3.12 Administrimi i pasurisë së konfiskuar

Konventat ndërkombëtare kryesore<sup>[70]</sup> e adresojnë administrimin e pasurisë së konfiskuar. UNCAC përcakton që pasuria e konfiskuar do të administrohet, përfshirë kthimin tek pronarët legjitimë të mëparshëm, në përputhje me të drejtën e UNCAC dhe të drejtën vendase. Shteteve po ashtu u kërkohet të miratojnë masa legislative për të mundësuar që autoritetet e tyre t'i kthejnë pasuritë e konfiskuara me kërkesë të një Shteti tjetër firmëtar. Neni 57 përfshin kërkesën që një palë që kërkon kthimin e pasurisë së konfiskuar duhet të konstatojë pronësinë e mëparshme të pasurisë dhe të marrë një vendim gjyqor përfundimtar; ku Shteti kërkues mund të heqë dorë nga kjo kërkesa e fundit.<sup>[71]</sup>

UNTOC deklaron që pasuria e konfiskuar duhet të administrohet në përputhje me ligjet vendase. Ajo orienton që konsideratat parësore duhet t'u jepen kthimit të pasurisë së konfiskuar nga të ardhurat e krimit një Shteti palë kërkues në mënyrë që ai t'ia shpërndajë kompensimin viktimave të krimit ose t'ua kthejë pronarëve legjitimë. Neni 14(3) ofron një mekanizëm me të cilin Shtetet efektivisht mund të dhurojnë vlerën e çdo pasurie të rrjedhur nga shitja e pasurisë kriminale në një fond të administruar nga OKB-ja për të ndihmuar vendet në zhvillim që të vënë në zbatim UNTOC.<sup>[72]</sup>

Neni 10 i Direktivës së vitit 2014 sjell shembuj të llojit të masave që palët mund të marrin për të menaxhuar pasurinë e ngrirë dhe të konfiskuar. Këto përfshijnë ngritjen e zyrave të centralizuara, zyra të specializuara për menaxhimin e pasurive të ngrira me qëllim të konfiskimit të mundshëm. Direktiva e vitit 2014 thekson se duhet të ketë

[68] 1983, ETS Nr. 116.

[69] 2005, CETS Nr. 196.

[70] UNCAC, UNTOC, Direktiva 2014/42/EU për Ngrirjen dhe Konfiskimin e Instrumentaliteteve dhe të Ardhurave të Krimit në Bashkimin Evropian, Konventa e Strasburgut e vitit 1990, dhe Konventa e Varshavës.

[71] Neni 57 UNCAC.

[72] Neni 14 UNTOC.

dispozita për shitjen ose transferimin e pasurisë kur është e nevojshme, dhe Shtetet mund të marrin në konsideratë masa që lejojnë që pasuria e konfiskuar të përdoret për interesa publike ose qëllime sociale.<sup>[73]</sup>

Konventa e Strasburgut e vitit 1990 dhe Konventa e Varshavës gjithashtu u japin fuqi palëve që të miratojnë masat e tyre legjislative për të menaxhuar pasurinë e konfiskuar.<sup>[74]</sup>

---

[73] Neni 10 i Direktivës 2014/42/EU për Ngrirjen dhe Konfiskimin e Instrumentaliteteve dhe të Ardhurave të Krimit në Bashkimin Evropian.

[74] Neni 15 i Konventës së Strasburgut të vitit 1990 dhe Neni 6 i Konventës së Varshavës.

## ▶ 1.4 APLIKIMI I KONVENTËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Qëllimi i këtij seksioni është të shpjegojë, duke iu referuar praktikës gjyqësore relevante, se si funksionojnë Nenet përkatëse të KEDNj-së në rastet e konfiskimit, sekuestrimit dhe marrjes së të ardhurave të krimit. Do të merret në shqyrtim përmbajtja e neneve, dhe parimet kyçe të zhvilluara nga GjEDNj, e ndjekur nga përmbledhjet e praktikave gjyqësore relevante për konfiskimin e asetëve. Qëllimi i tërësishëm është që lexuesit t'i kuptojnë më thellësisht kontekstet e ndryshme në të cilat mund të angazhohen këto të drejta të KEDNj-së, dhe kur mund të shkelen ato.<sup>[75]</sup>

Siç deklarohet në hyrje të këtij publikimi, ka disa të drejta të KEDNj-së të cilat gjithmonë duhen balancuar në kontekstin e procedurave të konfiskimit. Një prej të drejtave kryesore mund të gjendet në Nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së, i cili përcakton të drejtën e individëve për gëzimin paqësor të pasurive të tyre. E drejta për proces të rregullt (Neni 6 KEDNj), parimi i mospasjes së krimit as dënimit pa bazë ligjore (Neni 7 KEDNj), dhe e drejta për respekt të jetës private dhe familjare (Neni 8 KEDNj) janë po ashtu relevante, dhe kanë qenë objekt i çështjeve të GjEDNj-së në lidhje me konfiskimin.

[75] Përveç praktikës gjyqësore të diskutuar në këtë seksion, lexuesit orientohen drejt Platformës për Ndarjen e Njohurive rreth KEDNj-së (ang. ECHR-KS). Ky burim i shkëlqyer mirëmbahet nga Kancelaria e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, përditësohet rregullisht, dhe mund të lexohet në vegzën <https://ks.echr.coe.int/en/web/echr-ks/>. Në mënyrë të veçantë, Tema Kyçe Neni 1 i Protokollit Nr. 1 për Konfiskimin/Marrjen e Asetëve është shumë interesante për lexuesit, dhe mund të gjendet në vegzën <https://ks.echr.coe.int/documents/d/echr-ks/confiscation-seizure-of-assets>.

## 1.4.1 E drejta për gëzimin paqësor të pasurive: Neni 1 i Protokollit Nr. 1 KEDNJ

### 1.4.1.1 Shikim i përgjithshëm

Parimi i të drejtës për gëzimin paqësor të pasurisë është i përcaktuar në Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

Neni 1 i Protokollit Nr. 1 thotë:

- 1) *Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.*
- 2) *Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.*

Neni 1 i Protokollit Nr. 1 garanton të drejtën e pasurisë dhe mbron individët ose personat ligjorë nga ndërhyrja arbitrare e Shtetit tek posedimet e tyre.<sup>[76]</sup> Neni 1 i Protokollit Nr. 1 cakton detyrimin negativ dhe pozitiv të Shteteve për të mbrojtur gëzimin e posedimeve.<sup>[77]</sup> Megjithatë, GjEDNJ njih të drejtën e Shtetit për të konfiskuar pasurinë e individëve ose personave ligjorë brenda kushteve të përcaktuara në Nenin 1 të Protokollit Nr. 1. Në mënyrë të veçantë, çdo ndërhyrje duhet të jetë në vijim të interesit publik, e zhvilluar në mënyrë të atillë që është në përputhje me shtetin e së drejtës dhe proporcionale me qëllimin e saj.

GjEDNJ ka vendosur një proces me tri faza për të përcaktuar nëse ka pasur shkelje të kësaj dispozite.

[76] *Marckx k. Belgjikës*, vendim i 13 qershorit 1979, Nr. 6833/74.

[77] *Öneryildiz k. Turqisë*, vendim i 30 nëntorit 2004, Nr. 48939/99.

## 1. Angazhimi i Nenit 1 të Protokollit Nr. 1: “Posedimi” i “pasurisë”

Për të hyrë në fushëveprimin e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, individit duhet ta “posedojë” pasurinë e tij. Termi “posedim” ka kuptim autonom brenda KEDNJ-së,<sup>[78]</sup> përfshirë sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Ai ka të bëjë me pretendimin dhe/ose të drejtën e një individit për pasuri. Në thelb, ky pretendim dhe/ose e drejtë duhet të ketë bazë në të drejtën vendase, dhe duhet që kërkuesi të pretendojë shkëlqen e të drejtës para GjEDNJ-së për të përcaktuar natyrën e saktë të asaj që i takon atij në të drejtën vendase. Për shembull, në *Novikov k. Ruisë*,<sup>[79]</sup> GjEDNJ theksoi se kërkuesit i takonte nafta që ishte sekuestruar nga policia ruse si objekt i krimit për shkak se ai ishte përfitues i një marrëveshjeje lidhur me naftën që ishte e zbatueshme sipas të drejtës ruse.

Pretendimet dhe/ose të drejtat mbi pronën mund të njihen gjithashtu edhe si “posedime” nëqoftëse hyjnë brenda fushëveprimit të një pretendimi ose pritshmërie legjitime mbi atë pronë. Një pritshmëri legjitime duhet të jetë e zbatueshme sipas të drejtës vendase dhe duhet të shihet si aset për qëllimet e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. *Denisova dhe Moiseyeva k. Ruisë*<sup>[80]</sup> kishte të bënte me një burrë i cili ishte dënua për tradhëti dhe i ishte konfiskuar pasuria nga autoritetet. Gruaja dhe vajza e burrit më pas pretenduan se ato ishin pjesërisht pronare të pasurisë që ishte konfiskuar. Gjatë shqyrtimit të pretendimit të gruas, GjEDNJ gjeti që e drejta vendase parashikonte pronësinë e përbashkët të pasurisë së fituar nga bashkëshortët gjatë martesës dhe që prandaj gruaja kishte pritshmërinë legjitime ndaj një pjese të pasurisë familjare të barabartë me burrin e saj. *Pine Valley Developments Ltd dhe të Tjerë k. Irlandës* e konsideron pritshmërinë legjitime në kontekst komercial, edhe pse jo në kontekstin e konfiskimit. Në këtë çështje, pritshmëritë legjitime dolën në pah pasi ishte dhënë leja për planifikimin fillestar, mbi bazën e së cilës kompanitë kërkuese e kishin blerë tokën për ta zhvilluar. Leja e planifikimit u vlerësua si pjesë e pasurisë, dhe kompanitë kishin pritshmërinë legjitime të lejes së plotë të dhënë për planifikim.<sup>[81]</sup>

Interesat mund të konsiderohen “posedime” brenda Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 edhe nëqoftëse ligjet vendase të një Shteti nuk e njohin një interes të caktuar si “e drejtë pronësore”. Kjo u demonstrua tek *Depalle k. Francës* ku, megjithëse e drejta e kërkuesit për të mbajtur një pronë publike ishte e revokueshme dhe e pabazuar (dhe

[78] *Gasus Dossier und Föedertechnik GmbH k. Hollandës*, vendim i 23 shkurtit 1995, Nr. 15375/89.

[79] *Novikov k. Ruisë*, vendim i 11 korrikut 2013, Nr. 7087/04.

[80] *Denisova dhe Moiseyeva k. Ruisë*, vendim i 1 prillit 2010, Nr. 16903/03.

[81] *Pine Valley Developments Ltd dhe të Tjerë k. Irlandës*, vendim i 29 nëntorit 1991, Nr. 12742/87.

jo objekt i një të drejte pronësore sipas të drejtës vendase), kjo përbëri posedim për qëllimet e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 sepse ishte “mjaftueshëm e vërtetuar dhe me peshë aq sa të përbënte posedim”<sup>[82]</sup>, edhe kur e drejta vendase nuk njuh që koha e mbajtjes i atribuohet një interesi pronësor. Termi “pronë” është i konceptuar gjerësisht dhe nuk është i kufizuar me mallra fizike.<sup>[83]</sup> Ai përfshin si vijon:

- › Pasuri të prekshme, të lëvizshme dhe të palëvizshme, si mallra, ndërtesa, toka.
- › Pasuri të paprekshme, përfshirë fonde monetare, aksione, pronë intelektuale, pensione, sigurime shoqërore, klientelë profesionale, licenca biznesi.
- › Akte ligjore si vendimet detyruese të gjykatave dhe tribunaleve, detyrime borxhi.

Në kontekstin e sekuestrimit, konfiskimit, ose heqjes dorë nga asetet, posedimet kanë përfshirë aeroplanë,<sup>[84]</sup> pasuri të sekuestruara gjatë procedurave penale,<sup>[85]</sup> si dhe asete të sekuestruara në një vend të huaj.<sup>[86]</sup>

## 2. Ndërhyrja tek Neni 1 i Protokollit Nr. 1 – Tri Rregullat

Meqenëse posedimi i pasurisë nga kërkuesi ishte konstatuar, dhe prandaj aplikohet Neni 1 i Protokollit Nr. 1, GjEDNj do të përcaktojë nëse ka (ose ka pasur, ose do të ketë) ndërhyrje tek gëzimi i një posedimi. Kjo përfshin shqyrtimin e akteve ose mos-veprimeve relevante për të parë nëse ato prekin gëzimin e posedimeve në fjalë. GjEDNj ndërmerr një qasje me “tri rregulla” ndaj kësaj çështjeje, ku e para është e drejta e përgjithshme, dhe e dyta dhe e treta janë dy format e kualifikimit për atë të drejtë të përmbajtur në Nenin 1 të Protokollit Nr. 1. Vendimi i GjEDNj-së varet nga një shqyrtim që nxjerr se cila prej tri rregullave aplikohen në situatën aktuale.<sup>[87]</sup>

[82] *Depalle k. Francës*, vendim i Dhomës së Madhe i 29 marsit 2010, Nr. 34044/02.

[83] Shih Udhërrëfyesin e GjEDNj-së për Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNj-së, në vegzën: <https://t.ly/Pdxy>, së fundi i përditësuar më 31 gusht 2022.

[84] *Bosphorus Airways k. Irlandës*, vendim i Dhomës së Madhe i 30 qershorit 2005, Nr. 45036/98 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[85] *Tendam k. Spanjës*, vendim i 13 korrikut 2010 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[86] *Saccoccia k. Austrisë*, vendim i 18 dhjetorit 2008, Nr. 69917/01 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[87] *Gogitidze k. Gjeorgjisë*, vendim i 12 majit 2015, Nr. 36862/05 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).



## Rregulla e parë

Rregulla e parë përcakton parimin e tërësishëm që individët kanë të drejtën e gëzimit paqësor të pasurive të tyre (formulë gjithëpërfshirëse). Rregulla e dytë dhe e tretë duhet të konceptohen nën dritën e këtij parimi të përgjithshëm.

## Rregulla e dytë

Rregulla e dytë ka të bëjë me privimin e pasurisë, pra me shuarjen e të drejtave të individit për pronësi. Për të përcaktuar nëse ka pasur ose nëse do të ketë “privim”, gjyqtari shqyrton nëse individit ka (ose do të ketë) mundësi ta përdorë, shesë ose dhurojë pronën, ose të ushtrojë të drejtat e tij mbi posedimin në fjalë.

Privimi mund të jetë *de facto* ose *de jure*. Në përgjithësi, privimi *de facto* ndodh kur autoritetet relevante (d.m.th. një organ shtetëror) ndërhyjnë tek gëzimi i pasurisë pa ia hequr zyrtarisht titullin pronarit. Duhet të theksohet se GjEDNj nuk është e prirur të njohë privimet *de facto* të pronës për qëllimet e Nenit 1(2) të Protokollit Nr. 1 nëqoftëse të drejtat e pronarit janë shuar zyrtarisht. Në *Hentrich k. Francës*<sup>[88]</sup> GjEDNj deklaroi që marrja paraprake nga autoriteti tatimor i pronës së kërkuesit, pasi ajo pronë i ishte shitur kërkuesit me çmim tepër të ulët, përbëri shpronësim *de facto* të pronës meqenëse marrja paraprake përbëri privim të posedimeve të kërkuesit ashtu siç përkufizohet nga Neni 1 i Protokollit Nr. 1.

Privimet e posedimeve mund të ndodhin edhe në rastet kur nuk është marrë vendim zyrtar për shuarjen e të drejtave individuale por impakti i posedimeve është kaq i thellë sa që përbën shpronësim. GjEDNj shkon përtej aparençave dhe heton realitetet e situatës.<sup>[89]</sup> Në *Sarica dhe Dilaver k. Turqisë*, toka ishte inkorporuar në një zonë ushtarake, gjë që i lejoi autoritetet turke ta zinin atë tokë dhe të ndryshonin përdorimin e saj në mënyrë të pakthyeshme, kështu që ajo u konsiderua pronë shtetërore, edhe pse nuk ishte bërë asnjë deklaratë zyrtare.<sup>[90]</sup> Nëqoftëse GjEDNj vlerëson se një masë përbën shpronësim, atëherë ekziston detyrimi i Shtetit për t'i ofruar kompensim pronarit të prekur.<sup>[91]</sup>

[88] *Hentrich k. Francës*, vendim i 22 shtatorit 1994, Nr. 13616/88.

[89] *Apap Bologna k. Maltës*, vendim i 9 dhjetorit 2021, Nr. 47505/19.

[90] *Sarica dhe Dilaver k. Turqisë*, vendim i 27 majit 2010, Nr. 11765/05.

[91] Udhërrëfytyesi i GjEDNj-së për Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNj-së, në vegzën: <https://t.ly/XEIX>, përditësuar më 31 gusht 2022, fq. 23.

Jo të gjitha veprimet që kufizojnë të drejtat e pronarit konsiderohen privime sipas rregullës së dytë, dhe mund të hyjnë tek rregulla e tretë. Megjithatë, duke qenë se konfiskimi është privim përfundimtar i pronës, kur zbatohet urdhri i konfiskimit ai përgjithësisht hyn tek rregulla e dytë.

### Rregulla e tretë

Rregulla e tretë ka të bëjë me kontrollin e përdorimit të pasurisë në përputhje me interesin e përgjithshëm. Kontrolli i përdorimit të pasurisë ndodh kur një organ relevant përcakton rregullat në interesin e përgjithshëm të cilat kufizojnë gëzimin e pasurisë nga pronari por nuk përbëjnë privim të posedimit. Shtetet kanë hapësirë të gjerë, por jo të pakufishme, vlerësimi në fuqinë e tyre për të kontrolluar pasuritë. Kontrolli i pasurisë duhet të zbatohet në linjë me një rregullë të përgjithshme dhe nuk mund të jetë arbitrar.<sup>[92]</sup> GjEDNj citon shpesh urdhrat e marrjes dhe konfiskimit si shembuj të kontrollit të pasurisë sipas rregullës së tretë.

Kontrolli nga Shteti i pasurisë mund të ketë fushëveprim shumë më të gjerë sesa privimi i pronës. Shteti mund të ushtrojë “kontroll” duke zbatuar rregulla që kërkojnë veprime pozitive nga një individ, ose rregulla që caktojnë kufizime mbi aktivitetet e tyre, siç është ngrirja e asetëve, urdhrat e konfiskimit ose marrjes, kontrollet planifikuese, urdhrat mjedisore, ndryshimet e kriterëve të licencimit dhe shkatërrimi i objekteve të ndërtuara ilegalisht.

GjEDNj thekson se tri rregullat nuk janë të ndara dhe të palidhura. Dy të fundit janë shembuj të ndërhyrjeve tek gëzimi paqësor i pasurisë dhe si të tilla ato duhen kuptuar nën dritën parimit të përgjithshëm të përcaktuar në rregullën e parë.<sup>[93]</sup> Nëqoftëse ndërhyrja tek të drejtat pronësore nuk mund të klasifikohet sipas rregullës së dytë ose të tretë, atëherë zbatohet rregulla e parë.

### 3. Justifikimi për ndërhyrjen

Hapi përfundimtar që GjEDNj duhet të ndërmarrë për të vlerësuar nëse ka pasur shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 është përcaktimi nëse ndërhyrja tek të drejtat pasurore të kërkuesit ka qenë e justifikuar. Për të qenë e justifikuar kjo ndërhyrje, veprimet e Shtetit duhet të kalojnë tre teste: ato duhet të jenë të ligjshme, t’i shërbejnë

[92] *Pine Valley Developments Ltd k. Irlandës (Neni 50)*, vendim i 9 shkurtit 1993, Nr. 12742/87.

[93] *James k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 21 shkurtit 1986, Nr. 8793/79.

një qëllimi legjitim, dhe të kenë arritur një ekuilibër të drejtë dhe proporcional mes të drejtave të individit dhe qëllimit legjitim të synuar.

## Ligjshmëria

Së pari, ndërhyrja e Shtetit tek pasuria e kërkuesit duhet të ketë qenë e ligjshme, që do të thotë se ndërhyrja ka pasur edhe bazë në të drejtën vendase edhe i është përmbajtur parimeve të shtetit të së drejtës (përfshirë qartësinë, parashikueshmërinë, dhe saktësinë). Në mënyrë të veçantë, ligji duhet t'u mundësojë atyre që qeveris që të parashikojnë, në masë të arsyeshme brenda rrethanave, pasojat e veprimeve të tyre.<sup>[94]</sup> Më tej, ligjshmëria nuk kërkon vetëm që Shteti të respektojë të drejtën e tij vendase, por edhe që ai të ndjekë procedura të rregullta dhe të duhura – masa në fjalë duhet të dalë nga dhe të ekzekutohet prej autoritetit përkatës dhe nuk duhet të jetë arbitrare.<sup>[95]</sup> Çdo ndërhyrje duhet të shoqërohet me garanci procedurale që i ofrojnë individit ose entitetit të prekur mundësi të arsyeshme për të paraqitur argumentet e tij para autoriteteve përgjegjëse për t'i kontestuar masat.<sup>[96]</sup>

Pra, në mënyrë që ndërhyrja të jetë e ligjshme ajo duhet të jetë e bazuar në të drejtën kombëtare,<sup>[97]</sup> të jetë e qartë, e parashikueshme për palët e përfshira, dhe e saktë.<sup>[98]</sup> Përveç kësaj, GjEDNj ka theksuar se çdo ndëshkim i përcaktuar në fazën parajyqësore do të pengonte seriozisht aftësinë e personit për të paraqitur argumentet e tij në mënyrë efektive para gjykatës.<sup>[99]</sup>

## Qëllimi legjitim

Së dyti, ndërhyrja e Shtetit tek e drejta për gëzimin paqësor të pasurisë duhet t'i shërbejë një qëllimi legjitim që është në interesin publik ose i interesit të

[94] *Baklanov k. Rosisë*, vendim i 9 qershorit 2005, Nr. 68443/01 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[95] *Winterwerp k. Hollandës*, vendim i 24 tetorit 1979, Nr. 6301/73.

[96] *Shorazova k. Maltës*, vendim i 3 marsit 2022, Nr. 51853/19 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[97] *Bosphorus Airways k. Irlandës*, vendim i Dhomës së Madhe i 30 qershorit 2005, Nr. 45036/98 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[98] *Carbonara dhe Ventura k. Italisë*, vendim i 30 majit 2000, Nr. 24638/94; *Beyeler k. Italisë*, vendim i 5 janarit 2000, Nr.33202/96.

[99] *Markus k. Letonisë*, vendim i 11 qershorit 2020, Nr. 17483/10 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

përgjithshëm.<sup>[100]</sup> Për shkak të gamës së gjerë e të shumëllojshme të politikave të zhvilluara nga Shtetet të cilat mund të ndikojnë tek pasuria në çfarëdo mënyre apo forme, GjEDNJ njih faktin se Shtetet kanë hapësirë të gjerë vlerësimi kur përcaktojnë se çfarë është ose nuk është në interesin publik ose në interesin e përgjithshëm.<sup>[101]</sup> Kur ndërhyrja e Shtetit përfshin politika sociale dhe ekonomike të zbatuara përmes legjislativës, GjEDNJ respekton vendimin e legjislaturës për sa i përket asaj që është “në interesin publik nëqoftëse ai vendim është dukshëm pa bazë të arsyeshme”.<sup>[102]</sup>

GjEDNJ ka gjetur se qëllimet e mëposhtme bëjnë pjesë në interesin publik:

- › Parandalimi i evazionit tatimor.
- › Masat për luftimin e trafikimit të drogës dhe kontrabandës.
- › Konfiskimi i parave të fituara ilegalisht.
- › Parandalimi i praktikave korruptive dhe mbrojtja e kuletës publike.
- › Mbarëvajtja e sistemit të drejtësisë.

Në çështjen *Riela dhe të Tjerë k. Italisë*, pasuria e kërkuesve u konfiskua nga autoritetet italiane mbi bazën se ajo pronë ishte përftuar, ose kishte qenë e përftuar, me anë të të ardhurave të krimit. Kishte prova domethënëse që dy kërkuesit e parë ishin anëtarë të një organizate kriminale të llojit mafioz, dhe që prona e konfiskuar ishte përftuar me anë të aktiviteteve të tyre në atë organizatë. Kërkuesit u ankuan sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 se masa e konfiskimit shkeli të drejtën e tyre për respekt ndaj pasurisë. GjEDNJ në *Riela* deklaroi se, ndërkohë që masa e konfiskimit pa dyshim kishte shkelur të drejtat e kërkuesve sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, qëllimi legjitim i luftimit të organizatave të tipit mafioz në Itali ishte kaq e rëndësishme saqë ndërhyrja tek KEDNJ nuk ishte joproporcionale me atë qëllim. Prandaj, nuk pati shkelje të KEDNJ-së dhe kërkesa që dukshëm e pabazuar.<sup>[103]</sup>

[100] *James k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 21 shkurtit 1986, Nr. 8793/79.

[101] *James k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 21 shkurtit 1986, Nr. 8793/79.

[102] *James k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 21 shkurtit 1986, Nr. 8793/79.

[103] *Riela dhe të Tjerë k. Italisë*, vendimi për pranueshmërinë i 4 shtatorit 2001, Nr. 52439/99.

## Ndërhyrja proporcionale

Për fund, ndërhyrja e Shtetit tek pasuria duhet të jetë proporcionale. Duhet vendosur një ekuilibër i drejtë mes të drejtave të kërkuesit për gëzimin paqësor të pasurisë dhe kriterit të interesit publik. Çdo pasiguri, qoftë legjislative, administrative, apo rezultat i praktikave të autoriteteve, është faktor që merret në konsideratë nga GjEDNj-ja kur vlerëson sjelljen e një Shteti.<sup>[104]</sup>

GjEDNj ka pranuar se masat e konfiskimit janë proporcionale edhe kur nuk ka dënim që konstaton fajësinë e kërkuesve, për sa kohë që asetet relevante gjendet se vijnë nga të ardhurat e krimit.<sup>[105]</sup>

Në *AGOSI k. Mbretërisë së Bashkuar*, kërkuesi kishte shitur 1,500 monedha ari Kruegerrand dy burrave të cilët u arrestuan teksa përpiqeshin t'i kontrabandonin monedhat për në Mbretërinë e Bashkuar. Monedhat u konfiskuan si objekte kontrabande. Kontrata e shitjes së monedhave specifikonte se titulli i monedhave nuk do të transferohej deri sa të realizohej pagesa nga kompania. Meqenëse çeku që iu paraqit AGOSI-t për pagesë nuk u shlye, kompania argumentoi gjatë procedurës në Mbretërinë e Bashkuar që, meqenëse ajo ende vazhdonte të mbante titullin e pronësisë, monedhat duhet t'i ktheheshin. Kërkuesit u ankuan para GjEDNj-së se konfiskimi i monedhave shkeli Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 sepse ata ishin të pafajshëm e jo keqbërës. Gjatë vlerësimit të proporcionalitetit, GjEDNj në AGOSI deklaroi:

*“Shtetet gëzojnë hapësirë të gjerë vlerësimi sa i përket zgjedhjes së mënyrave zbatuese dhe të siguruarit nëse pasojat e zbatimit janë të justifikuar në interesin e përgjithshëm të qëllimit për arritjen e synimit të ligjit në fjalë”.*

[104] *Broniowski k. Polonisë*, vendim i 24 qershorit 2004, Nr. 31443/96.

[105] *Balsamo k. San Marinos*, vendim i 8 tetorit 2019, Nr. 20319/17 dhe 21414/17 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

GjEDNJ ka njohur se vendosja e ekuilibrit të drejtë varet nga shumë faktorë të ndryshëm, përfshirë:

- › Sjellja e pronarit (në lidhje me aktin për të cilin Shteti ngre padi, si p.sh. vepër penale).<sup>[106]</sup>
- › Shkalla e fajësisë ose kujdesit që tregon pronari në sjelljen e tij dhe nëse procedurat e aplikueshme i lejojnë Shtetit të marrë parasysh shkallën e fajësisë ose kujdesit të kërkuesit.<sup>[107]</sup>
- › Nëse personit të prekur i është dhënë mundësi të arsyeshme për të paraqitur argumentet e tij para autoriteteve përgjegjëse në mënyrë efektive.<sup>[108]</sup>
- › Qëllimet dhe objektivat e politikës/legjislacionit në fjalë. Në mënyrë të veçantë, legjislatura duhet ta ketë mundësinë të marrë masa për t'i dhënë efekt qëllimit të politikës së miratuar.<sup>[109]</sup>
- › Nëse Shteti e ka tejkaluar hapësirën e tij të vlerësimit.<sup>[110]</sup>
- › Nëse kanë ekzistuar masa më pak ndërhyrëse që mund të ishin ndërmarrë.<sup>[111]</sup>
- › Konsiderata të tjera përfshijnë: kohshmërinë,<sup>[112]</sup> sigurinë tek ushtrimi i fuqisë së Shtetit,<sup>[113]</sup> impakti i ndërhyrjes tek individit,<sup>[114]</sup> mbrojtjet procedurale,<sup>[115]</sup> dhe pagimi i kompensimit.<sup>[116]</sup>

[106] AGOSI k. Mbretërisë së Bashkuar, vendim i 24 tetorit 1986, Nr. 9118/80.

[107] AGOSI k. Mbretërisë së Bashkuar, vendim i 24 tetorit 1986, Nr. 9118/80.

[108] G.I.E.M. S.R.L dhe të Tjerë k. Italisë, vendim i Dhomës së Madhe i 28 qershorit 2018, Nr. 1828/06, 34163/07 dhe 19029/11 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[109] Mellacher k. Austrisë, vendim i 19 dhjetorit 1989, Nr. 10522/83, 11011/84, 11070/84.

[110] Pressos Compania Naviera SA k. Belgjikës, vendim i 20 nëntorit 1995, Nr. 17849/91.

[111] OAO Neftyanaya Kompaniya Yukos k. Ruisë, vendim i 31 korrikut 2014, Nr. 14902/04.

[112] Erkner dhe Hofauer k. Austrisë, vendim i 23 prillit 1987, Nr. 9616/81.

[113] Hentrich k. Francës, vendim i 22 shtatorit 1994, Nr. 13616/88.

[114] Erkner dhe Hofauer k. Austrisë, vendim i 23 prillit 1987, Nr. 9616/81.

[115] Hentrich k. Francës, vendim i 22 shtatorit 1994, Nr. 13616/88.

[116] Lithgow dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar, vendim i 8 korrikut 1986, Nr. 9006/80, 9262/81, 9263/81, 9265/81, 9266/81, 9313/81 dhe 9405/81.

Një shembull i hapësirës së gjerë të vlerësimit që ka Shteti në luftën kundër korrupsionit shihet në çështjen *Gogitidze k. Gjeorgjisë*. GjEDNJ konsideroi se ishte e justifikueshme që barra e provës t'i vihej kërkuesit, dhe konsideroi legjitime që asetet e kërkuesit u konfiskuan para përcaktimit të fajësisë penale (dhe përfundimisht pa dënim për ndonjë krim) meqenëse kishte jashtëzakonisht shumë prova rrethore që sugjerorin se të ardhurat e ligjshme të kërkuesit nuk mund të kishin mjaftuar për të blerë asetet në fjalë.<sup>[117]</sup>

Ndërkohë që autoritetet vendase duhet ta kenë mundësinë për t'i dhënë efekt qëllimit të politikave të tyre të miratuara, ato masa njëkohësisht duhet të jenë proporcionale.

Kërkuesi në *Gabric k. Kroacisë* u ndalua nga policia teksa po kalonte kufirin mes Bosnje dhe Hercegovinës dhe Kroacisë. Nga makina e saj u sekuestruan 20,000 marka gjermane dhe 61 steka cigare. Kërkuesja u shpall fajtoare për shmangie nga dogana, dhe iu caktua dënim me kusht për 6 muaj, dhe cigaret e saj u konfiskuan. Ajo gjithashtu u dënua për vepër kundërvajtjeje në lidhje me 20,000 markat gjermane, për të cilën ajo u gjobit dhe paratë iu konfiskuan. Kërkuesja argumentoi që këto masa qenë të tepërta dhe shkelën të drejtat e saj sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. GjEDNJ njohu se konfiskimet e autoriteteve ishin të ligjshme dhe përbënin kontrollim të përdorimit të pasurisë. Megjithatë, meqenëse kërkuesja tashmë ishte gjobitur në lidhje me mos-deklarimin e parave, nuk kishte marrë dënim penal në lidhje me paratë, dhe i kishte fituar ato ligjërisht, GjEDNJ vendosi që Qeveria nuk kishte vërtetuar bindshëm se gjoba fillestare nuk kishte qenë pengesë dhe dënim i mjaftueshëm. Prandaj, konfiskimi qe joproporcional dhe përbëri shkelje të KEDNJ-së.<sup>[118]</sup>

Qasja ndaj proporcionalitetit në *Gabric* shihet në çështjen e GjDBE-së *Chmielewski k. Nemzeti Adó- és Vámhivatal Dél-alföldi Regionális Vám- és Pénzügyőri Főigazgatósága*. GjDBE gjeti se, ndërkohë që Shtetet Anëtare kanë hapësirë diskrecioni kur vendosin se si të sigurojnë respektimin e detyrimeve të tyre për zbatimin e të drejtës së BE-së, sanksionet sipas masave të zgjedhura duhet të jenë proporcionale dhe të nevojshme për të arritur objektivat e synuara nga legjislacioni përkatës.<sup>[119]</sup>

[117] *Gogitidze k. Gjeorgjisë*, vendim i 12 majit 2015, Nr. 36862/05 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[118] *Gabric k. Kroacisë*, vendim i 5 shkurtit 2009, Nr. 9702/04.

[119] *Chmielewski k. Nemzeti Adó- és Vámhivatal Dél-alföldi Regionális Vám- és Pénzügyőri Főigazgatósága*, CJEU vendim i 16 korrikut 2015 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim)

Shembuj të rasteve ku GjEDNj ka vendosur se veprimi i Shtetit ka qenë joproporcional mund të gjenden në çështjet e mëposhtme:

- › **Grifhorst k. Francës:**<sup>[120]</sup> Konfiskimi i parave kesh të kërkuesit shkeli Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 sepse nuk u gjetën prova që paratë kesh ishin të lidhura me ndonjë aktivitet kriminal dhe urdhri i konfiskimit qe tejet më i rreptë sesa dënimi i zakonshëm në rrethana të tilla.
- › **Tendam k. Spanjës:**<sup>[121]</sup> GjEDNj vendosi që, në rast se pronari i pasurisë shpallet i pafajshëm për akuzat kundër tij, duhet të merren masa të arsyeshme për ruajtjen e pasurisë së sekuestruar.
- › **Gladysheva k. Ruisë:**<sup>[122]</sup> Shpronësimi i një blerëseje të vërtetë nga apartamenti i saj, pa kompensim, në rrethana ku nuk kishte përplasje interesash private, dhe pa justifikim të mjaftueshëm që kjo ishte në interesin publik, përbëri ndërhyrje joproporcionale.

Praktika gjyqësore e GjEDNj-së kohët e fundit tregon që Shtetet firmëtare kanë diskrecion të konsiderueshëm në procedurat e rimarrjes së aseteve. Për shembull, në *Ulemek k. Serbisë*, kërkuesi u dënua për një numër të madh krimesh të rënda dhe iu kërkua të hiqte dorë nga shtëpia e tij, e blerë me fonde ilegale në vitin 1998. GjEDNj gjeti se nuk ishte arbitrare që konfiskimi i aseteve të shtrihej në mënyrë retroaktive tek pronat që kërkuesi kishte blerë para ligjit vendas të vitit 2008.<sup>[123]</sup> Tek *Phillips k. Mbretërisë së Bashkuar*, GjEDNj qe e mendimit se procedurat e urdhrimit të konfiskimit penguan dhe privuan një person nga të ardhurat e fituara nga trafiku i drogës si në këtë rast. U vlerësua se ky qëllim i rëndësishëm e justifikonte ndërhyrjen e pësuar nga kërkuesi në gëzimin paqësor të pasurisë.<sup>[124]</sup>

[120] *Grifhorst k. Francës*, vendim i 26 shkurtit 2009, Nr. 28336/02 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[121] *Tendam k. Spanjës*, vendim i 13 korrikut 2010 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[122] *Gladysheva k. Ruisë*, vendim i 6 dhjetorit 2011, Nr. 7097/10 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[123] *Ulemek k. Serbisë*, vendimi për pranueshmërinë i 2 shkurtit 2021, Nr. 41680/13 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[124] *Phillips k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 5 korrikut 2001, Nr. 41087/98 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).



### 1.4.1.2 Palët e treta të mirëbesuara (bona fide)

Një çështje që vlen të përmendet lind kur një palë e tretë, duke vepruar në mirëbesim, pëson pasojat e sekuestrimit ose konfiskimit të asetëve. GjEDNj ka shprehur keqardhjen për kërkues të tillë në të kaluarën, duke pranuar se palë të treta kanë vuajtur pasoja të rënda për shkak të urdhrave të sekuestrimit dhe konfiskimit. Siç u përmend më lart, mbrojtja e palëve të treta të mirëbesuara gjithashtu parashikohet në mënyrë eksplicite në disa instrumente ndërkombëtare, ku parashtrohet baza për zbatimin në nivel vendi të legjislacionit të konfiskimit; dhe GjDBE ka gjetur se ligjet vendase që ia ndalojnë palës së tretë pjesëmarrjen në procedura janë në kundërshtim me Direktivën e vitit 2014.<sup>[125]</sup>

Gjatë marrjes së vendimit në lidhje me pretendimet e palëve të treta në lidhje me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, GjEDNj merr parasysh dy faktorë kryesorë. Së pari, GjEDNj shqyrton nëse pala e tretë e prekur ka pasur mundësi të ngrejë efektivisht pretendimet e saj ndaj pronës, dhe nëse ato pretendime janë shqyrtuar, gjatë procedurës së zbatimit. Së dyti, GjEDNj merr parasysh sjelljen e kërkuesit dhe shkallën e fajit, dhe nëse këto faktorë janë marrë parasysh mjaftueshëm nga gjykatat vendase.<sup>[126]</sup>

Çështje të rëndësishme lidhur me palët e treta kanë qenë *AGOSI k. Mbretërisë së Bashkuar* (lart) dhe *Air Canada k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>[127]</sup> ku u pranua se një palë e tretë kishte pësuar dëme të mëdha për shkak të urdhrave të sekuestrimit dhe konfiskimit por nuk pati shkelje të së drejtës për pronën sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

Në çështjen *Air Canada k. Mbretërisë së Bashkuar*, Dogana dhe Akciza e Mbretërisë së Bashkuar sekuestroi një avion që i përkiste Air Canada, pasi në avion u gjetën sasi të mëdha droge. Sekuestrimi ndodhi pas një historie të gjatë incidentesh me trafikim drogash që përfshinin Air Canada dhe aeroportet britanike, si dhe kërkesa të shumta nga autoritetet britanike që Air Canada të shtrëngonte procedurat e sigurisë në Aeroportin Heathrow, kur ndodhi

[125] Çështjet e Bashkuara C-845/19 dhe C-863/19 – *Procedurat penale kundër DR dhe TS*, vendim i 21 tetorit 2021 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[126] *AGOSI k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 tetorit 1986, Nr. 9118/80.

[127] *Air Canada k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 5 majit 1995, Nr. 18465/91.

sequestrimi. Avioni u mbajt për orë të tëra në Aeroportin Heathrow, ku ndodhi sequestrimi. Avioni u mbajt për disa orë dhe u lëshua vetëm pasi kompania kërkuese pagoi 60,000 Euro për kthimin e tij. Kompania kërkuese u ankua para GjEDNj-së se sequestrimi i avionit, dhe kushtet e vëna për kthimin e tij, kishin shkelur të drejtat e saj sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 dhe Nenin 6.

Tek *Air Canada*, ashtu si tek AGOSI, nuk u gjet shkelje e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Në këtë çështje historia e kërkuesit me trafik droge dhe dështimi për shtrëngimin e procedurave të sigurisë qenë faktorë në vendimin e Komisionerit të Doganës dhe Akcizës për të sequestruar asetin e tyre. Më tej, GjEDNj theksoi se vendimi për konfiskimin e pasurisë i ishte nënshtruar një sfide ligjore dhe kërkuesi kishte pasur mundësinë që të argumentonte efektivisht çështjen e vet si dhe të jepte prova për të mbështetur argumentet e tij. Kërkuesi gjithashtu pati mundësinë të kërkonte shqyrtimin gjyqësor të vendimit, por nuk e bëri një gjë të tillë. Kështu që nuk pati shkelje.

Kërkuesi tek *Air Canada* dallon nga ai tek *Gladysheva k. Ruisë*.<sup>[128]</sup> Tek ky i fundit, kërkuesi kishte ndërmarrë të gjitha hapat e duhur dhe kishte paraqitur të gjithë dokumentacionin përkatës (tek autoritetet relevante) për t'u bërë pronari i ligjshëm i pronës; ndërkaq mashtrimi kishte ndodhur gjatë vazhdës së procedurës së zhvilluar nga autoritetet shtetërore. Ngjashëm, tek *Denisova dhe Moiseyeva k. Ruisë*,<sup>[129]</sup> urdhrat e konfiskimit mund të përfshinin vetëm pjesën e pasurisë martesore të bashkëshortit fajtor në një situatë ku pasuria është fituar në mënyrë kriminale dhe më pas e regjistruar në emrin e bashkëshortit të pafajshëm me qëllim që të parandalohet konfiskimi i saj.

Qasja e GjEDNj-së kur shqyrton nëse pala e tretë e prekur ka pasur mundësi efektive për të ngritur pretendimet e saj ndaj pronës mund të shihet në çështjen *Andonoski k. Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*.<sup>[130]</sup> Aty u gjet shkelje e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 sepse, mes të tjerash, e drejta vendase përcaktonte konfiskimin e çdo automjeti të përdorur për kontrabandimin e njerëzve pa përjashtim, duke e privuar kështu kërkuesin nga çdo mundësi për të diskutuar çështjen e tij ose për të kërkuar kompensim.

[128] *Gladysheva k. Ruisë*, vendim i 6 dhjetorit 2011, Nr. 7097/10 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[129] *Denisova dhe Moiseyeva k. Ruisë*, vendim i 1 prillit 2010, Nr. 16903/03.

[130] *Andonoski k. Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, vendim i 17 shtatorit 2015, Nr. 16225/08 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

Në disa raste GjEDNj-ja merr në konsideratë faktorë të tjerë që gjenden vetëm në rastet e palëve të treta për të përcaktuar nëse ka pasur shkelje. Tek *B.K.M. Lojistik Tasimacilik Ticaret Limited Sirketi k. Sllovenisë*,<sup>[131]</sup> GjEDNj gjeti që privimi i një pale të tretë nga pasuria mund të ishte i justifikuar vetëm nëqoftëse interesi i palës së tretë për rikthimin e pronës të kjo palë peshonte më pak sesa rreziku që kthimi i pronës do të dëmtonte qëllimet legjitime të autoriteteve. Në këtë çështje, meqenëse kamioni nuk u adaptua për qëllime kontrabande, nuk ishte përdorur për kontrabandë në të kaluarën, dhe shoferi i tij nuk ishte shpallur fajtor dhe as dënua me burg, nuk kishte arsye të arrihej në përfundimin se kamioni do të përdorej për kontrabandë në të ardhmen.

Ndërkohë që konsideratat e palës së tretë janë të rëndësishme për GjEDNj-në. Ato nuk janë vendimtare për gjetjen e një shkeljeje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Vendimi përfundimisht është çështje ekuilibri të varur nga faktet.

Megjithatë, kur bëhet fjalë për konfiskim, GjEDNj ka pranuar se autoritetet mund të zbatojnë masa konfiskimi jo vetëm mbi personat e akuzuar direkt por edhe tek familjarët e tyre ose kushërinjtë e afërt të përfshirë.<sup>[132]</sup> Tek *Balsamo k. San Marinos*, ndaj kërkuesve u mor urdhër konfiskimi për shkak të historikut të mëparshëm kriminal të babait të tyre.<sup>[133]</sup>

#### 1.4.1.3 Bashkëpunimi me një Shtet të huaj

Të gjitha instrumentet ndërkombëtare të përmendura në pjesën e parë të këtij publikimi përfshijnë detyrimin e Shteteve për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin. *Saccoccia k. Austrisë*<sup>[134]</sup> tregon se si bashkëpunimi ndërshtetëror me qëllim të sekuestrimit të aseteve mund të jetë në përputhje me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, për sa kohë që e drejta vendase e Shtetit ekzekutues garanton respektimin e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Në këtë rast, GjEDNj gjeti se ishte vënë ekuilibër i drejtë mes të drejtave të kërkuesit dhe qëllimit legjitim të forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar

[131] *B.K.M. Lojistik Tasimacilik Ticaret Limited Sirketi k. Sllovenisë*, vendim i 17 janarit 2017, Nr. 42079/12 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[132] *Raimondo k. Italisë*, vendim i 22 shkurtit 1994, Nr. 12954/87 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[133] *Balsamo k. San Marinos*, vendim i 8 tetorit 2019, Nr. 20319/17 dhe 21414/17 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[134] *Saccoccia k. Austrisë*, vendim i 18 dhjetorit 2008, Nr. 69917/01 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

për të siguruar që paratë e ardhura nga droga të merreshin dhe të sekuestroheshin, në mënyrë të atillë që të mos kishte shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 dhe Nenit 6, kur autoritetet austriake ekzekutuan një urdhër dorëheqjeje të bërë në Shtetet e Bashkuara.

#### 1.4.1.4 Kërkesat për shqyrtim gjyqësor

Pavarësisht nga mungesa e kritereve procedurale eksplicite në paragrafin e dytë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, GjEDNj-ja ka deklaruar se procedurat në tërësi duhet t'i japin kërkuarit mundësi të arsyeshme për të paraqitur argumentet e tij para autoriteteve me qëllim që të mundësohet gjetja e ekuilibrit të drejtë mes interesave konkurruese të çështjes në fjalë. Kështu, gjykatat vendase kanë për detyrim të ushtrojnë fuqinë e tyre të shqyrtimit të mëtejshëm sipas kërkesave, veçanërisht për të përcaktuar nëse ekuilibri është ruajtur ekuilibri i duhur mes gëzimit paqësor të pasurisë nga ana e kërkuarit dhe qëllimeve legjitime të autoriteteve. Tek *Paulet k. Mbretërisë së Bashkuar*, një çështje në lidhje me konfiskimin e fitimeve nga puna ilegale, u gjet se fushëveprimi i një gjykate apeli ishte tepër i ngushtë për të plotësuar kriterin e kërkitimit të ekuilibrit të drejtë të ngërthyer në Nenin 1 të Protokollit Nr. 1.<sup>[135]</sup>

#### 1.4.1.5 Pika kyçe

Në përmbledhje, gjatë përcaktimit nëse ka pasur shkelje të së drejtës së pasurisë, GjEDNj merr në konsideratë pyetjet e mëposhtme:

- › A ekziston e drejta për pasuri ose posedim brenda fushëveprimit të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1?
- › A ka pasur ndërhyrje tek ai posedim?
- › Tek cila prej tri rregullave hyn ndërhyrja?
- › A është ndërhyrja në përputhje me parimet e ligjshmërisë?
- › A i shërben ndërhyrja një qëllimi legjitim në interesin publik ose në interes të përgjithshëm?

[135] *Paulet k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 13 majit 2014, Nr. 6219/08 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

- › A është ndërhyrja proporcionale – a është gjetur ekuilibri mes kritereve të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe nevojës për të mbrojtur të drejtat themelore të individit?

Në kontekstin e procedurave të konfiskimit, tri pyetjet e para më lart me gjasë janë mjaft të drejtpërdrejta. Vështirësia qëndron tek zbatimi i testeve të ligshmërisë, qëllimeve legjitime dhe proporcionalitetit. Megjithatë, praktika gjyqësore është e qartë që format e ndryshme të konfiskimit, përfshirë marrjen civile dhe konfiskimin nga palët e treta, mund të ndërmerren pa shkelur Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, për sa kohë që mbrojtjet procedurale ekzistojnë dhe respektohen. Ndërkohë që fushëveprimi i këtij Neni është i gjerë, ai ofron një hapësirë të arsyeshme vlerësimi për të mundësuar që Shtetet të rimarrin të ardhurat nga veprimtaria kriminale.

Përmbledhjet e çështjeve në Pjesën 2 të këtij publikimi ofrojnë një shikim të tërësishëm të çështjeve më të rëndësishme ku kërkuesit kanë pretenduar shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 në kontekstin e sekuestrimit dhe konfiskimit të asetëve dhe të ardhurave të aktivitetit kriminale.

## 1.4.2 E drejta për proces të rregullt: Neni 6 KEDNJ

### 1.4.2.1 Shikim i përgjithshëm

E drejta për proces të rregullt parashikohet nga Neni 6 i KEDNJ-së. Neni 6 thotë:

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

- c) Çdo i akuzuar për një veprë penale ka të drejtat minimale të mëposhtme: a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;
- d) T'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;
- e) Të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;
- f) Të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
- g) Të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

Neni 6 është i aplikueshëm në procedurat që kanë të bëjnë me “të drejtat dhe detyrimet civile” dhe me “akuza penale”. Këto terma janë interpretuar në mënyrë autonome dhe mund të kenë kuptim të ndryshëm në KEDNJ dhe në të drejtën vendase.

Shkurtimisht, “përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve civile” përfshin çështje gjyqësore të natyrës së vërtetë dhe serioze që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet e personave privatë, p.sh. në kuadër të së drejtës kontraktore, së drejtës tregtare, së drejtës familjare, së drejtës pronësore dhe së drejtës së punësimit. Kërkuesi duhet të ketë mundësi të pretendojë, mbi baza argumentuese, një të drejtë që tashmë është e njohur në të drejtën vendase meqenëse Neni 6 nuk ndihmon të krijohen të drejta të reja. Neni 6 aplikohet vetëm për të drejtat civile që janë qenësore për procedurat në fjalë. “Të drejtat dhe detyrimet civile”, për shembull, mund të preken nga çështje gjyqësore në lidhje me pasurinë në kontekstin e shpronësimit dhe konfiskimit civil.

Në kontekstin penal, Neni 6 mund të aplikohet edhe kur akuzat nuk janë të klasifikuara si “penale” por, për shembull, si “administrative” në të drejtën vendase. Natyra e veprës dhe qëllimi, natyra dhe rreptësia e dënimit mund të merren parasysh kur përcaktohet nëse Neni 6 është i aplikueshëm. Termi “akuzuar” po ashtu ka kuptim autonom, përfshirë njoftimin zyrtar që i jepet një individit për t'i treguar që ai është i dyshuar për kryerjen e një veprë penale, dhe një situatë në të cilën i dyshuari është prekur në shkallë të konsiderueshme për shkak të atij dyshimi.

Është me rëndësi të theksohet se Neni 6(2) kërkon prezumimin e pafajësisë; që do të thotë se anëtarët e një trupi gjykues nuk duhet të ushqejnë nocione të parakconceptuara që i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet. Megjithatë, po aq rëndësi ka që heqja dorë nga pasuria si pasojë e një urdhri të dalë nga procedurat civile në vetvete nuk ngre çështje nga Neni 6(2).<sup>[136]</sup>

#### 1.4.2.2 Neni 6 – Konfiskimi i aseteve

Neni 6 angazhohet më shpesh në kontekstin e procedurave të anti-korrupsionit dhe konfiskimit mbi bazën se konfiskimi i aseteve të kërkuesit është ndërmarrë në mungesë të procedurave të përputhshme me Nenin 6(1),<sup>[137]</sup> urdhrat e konfiskimit janë të bazuara në akuza për të cilat kërkuesi është shpallur i pafajshëm,<sup>[138]</sup> ose kërkuesi beson se gjykata që ka marrë vendimin në lidhje me akuzën penale dhe urdhrin e konfiskimit kundër tij nuk ka qenë kompetente.<sup>[139]</sup>

GjEDNJ ka vendosur parimet bazë që aplikohen në procedurat e konfiskimit dhe Nenin 6 tek *Phillips k. Mbretërisë së Bashkuar*.<sup>[140]</sup> Ajo vendosi që Neni 6(2) nuk do të angazhohej nëqoftëse prezumimet statutorë në procedurat e konfiskimit nuk përbënin akuza të reja brenda kuptimit autonom të KEDNJ-së. Nga ana tjetër, Neni 6(1) u aplikohet në tërësi procedurave për akuza penale, përfshirë procedurën e dënimit. GjEDNJ gjeti se procedurat e konfiskimit janë të ngjashme ose analoge me procedurat e dënimit. Të drejtat e kërkuesit kanë mbrojtje të mjaftueshme kur kërkuesi ka mundësi ta kontestojë prezumimin se pasuria e tij është përftuar me anë të mënyrave jo legjitime.

Kjo gjetje tek *Phillips* në lidhje me Nenin 6(2) mund të krahasohet me *Geerings k. Hollandës*,<sup>[141]</sup> në të cilën pala e akuzës paraqiti kërkesë për urdhër konfiskimi në lidhje

[136] *Gogitidze k. Gjeorgjisë*, vendim i 12 majit 2015, Nr. 36862/05 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[137] *Al-Dulimi dhe Montana Management Inc k. Zvicrës*, vendim i Dhomës së Madhe i 21 qershorit 2016, Nr. 5809/08 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[138] *Geerings k. Hollandës*, vendim i 1 marsit 2007, Nr. 30810/03 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[139] *Iliya Stefanov k. Bullgarisë*, vendim i 22 majit 2008, Nr. 65755/01 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[140] *Phillips k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 5 korrikut 2001, Nr. 41087/98 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[141] *Geerings k. Hollandës*, vendim i 1 marsit 2007, Nr. 30810/03 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

me shumë vepra, pavarësisht se kërkuesi ishte shpallur i pafajshëm për shumicën e tyre. GjEDNJ gjeti shkelje të Nenit 6(2) sepse, për çfarëdo arsye, kërkuesi ishte trajtuar si fajtor pa qenë gjetur fajtor sipas ligjit.

Gjetjet në *Phillips* në lidhje me Nenin 6(1) shtellohen më tej në vendimin përfundimtar të çështjes *Grayson dhe Barnham k. Mbretërisë së Bashkuar*.<sup>[142]</sup> GjEDNJ deklaroi se, në kontekstin e vërtetuar të marrjes së kërkuesit me drogë, nuk ishte e paarsyeshme të pritej që ai të arrinte të shpjegonte legjitimitetin e parave të tij. Prandaj, nuk pati shkelje të Nenit 6(1) kur barra e provës u zhvendos tek kërkuesi gjatë procedurës së konfiskimit.

Kjo gjetje mund të krahasohet me çështjen e *Al-Dulimi and Montana Management Inc k. Zvicrës*.<sup>[143]</sup> Ngrirja e aseteve sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nuk qe në përputhje me Nenin 6 sepse kërkuesit nuk kishin pasur mundësinë e shqyrtimit gjyqësor para një gjykate të pavarur për të dy urdhrat dhe për zbatimin e tyre.

Duke u bazuar tek ky parim, *Ravon k. Francës* tregon se nuk mjafton që e drejta vendase thjesht të ofrojë mundësinë e kontestimit të bazës ligjore të një urdhri konfiskimi. Parregullsitë në zbatimin e urdhrave gjithashtu duhet të jenë të hapura për kontestim, dhe çdo mbrojtje ekzistuese në këtë kontekst duhet të jetë reale dhe efektive, e jo thjesht teorike.<sup>[144]</sup>

### 1.4.2.3 Pikat kyçe

- › Neni 6(2) nuk u aplikohet vetëm urdhrave të konfiskimit lidhur me procedurat penale nëqoftëse urdhri nuk sjell ngritjen e një “akuze” të re, por Neni 6(1) dhe (3) mund të vazhdojnë të jenë të aplikueshme.
- › Urdhrrat e konfiskimit nuk mund të zbatohen në lidhje me krimet për të cilat individi është shpallur i pafajshëm kur një urdhër i tillë do të nënkuptonte

publikim).

[142] *Grayson dhe Barnham k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 23 shtatorit 2008, Nr. 19955/05 dhe 15085/06 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[143] *Al-Dulimi dhe Montana Management Inc k. Zvicrës*, vendim i Dhomës së Madhe i 21 qershorit 2016, Nr. 5809/08 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[144] *Ravon k. Francës*, vendim i 21 shkurtit 2008, Nr. 18497/03 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).



përgjegjësinë penale të personit e rrjedhimisht do të shkelte prezumimin e pajfësisë. Konfiskimi jo i bazuar në dënim është i lejueshëm kur nuk krijon një nënkuptim të tillë të fajësisë.

- › Duhet të ekzistojnë mbrojtje për të siguruar që kërkuesit mund të kontestojnë çdo presupozim që asetet e tyre janë përfutur me anë të parave ilegale.
- › Kërkuesit kanë të drejtë që pretendimet e tyre të shqyrtohen nga gjykatat vendase, pra kur ata dëshirojnë ta kontestojnë urdhrin e konfiskimit.

### 1.4.3 Nuk ka dënim pa ligj: Neni 7 KEDNJ

#### 1.4.3.1 Shikim i përgjithshëm

Neni 7 thotë që nuk duhet të ketë dënim pa ligj, në kontekstin e së drejtës penale: *nullem crimen, nulla poena sine lege*.<sup>[145]</sup> Ai mishëron një element thelbësor të shtetit të së drejtës dhe është e drejtë absolute. Neni 7 përcakton:

1. *Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.*
2. *Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara.*

Qëllimi themelor i Nenit 7 është të sigurojë mbrojtje efektive kundër persekutimit, dënimit dhe ndëshkimit arbitrar.<sup>[146]</sup> Ky Nen ngërthen parimin e përgjithshëm që veprat duhet të jenë të bazuara në ligj, dhe që individ duhet të ketë mundësinë për të kuptuar nga formulimi i dispozitave përkatëse, nëse ka nevojë me ndihmën e përkthyesit gjyqësor, se cilat veprime dhe mosveprime e bëjnë atë individ penalisht përgjegjës. Prandaj ligji duhet të jetë lehtësisht në dispozicion dhe i parashikueshëm. Nuk kërkohet siguri absolute: mjafton standardi i “parashikueshmërisë së arsyeshme”.

[145] *Kafkaris k. Qipros*, vendim i Dhomës së Madhe i 12 shkurtit 2008, Nr. 21906/04.

[146] *Streletz, Kessler dhe Krenz k. Gjermanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 22 marsit 2001, Nr. 35532/97, 34044/96 dhe 44801/98.

Gjithashtu, vlen të theksohet se fjalia e dytë e Nenit 7, ndalimi i vënies së dënimit më të rëndë sesa ai që ka qenë i aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës, është zgjeruar duke përfshirë të drejtën e të pandehurit për të përfituar nga dënimi më i lehtë në rastet kur ai hyn në fuqi pas kryerjes së veprës.

### 1.4.3.2 Ndërveprimi mes Nenit 7 dhe konfiskimit

Pretendimet për shkelje të Nenit 7 kanë dalë në pah më shpesh në rastet kur kërkuesi ka tentuar të kontestojë dënimin që i është dhënë atij nga gjykatat vendase. Rrjedhimisht, zbatueshmëria e Nenit 7 në masat e konfiskimit varet nga fakti nëse GjEDNJ përcakton që masa në fjalë është dënim, brenda kuptimit autonom të fjalës në Konventë, ose është masë tjetër.<sup>[147]</sup>

Në çështjen *Welch k. Mbretërisë së Bashkuar*, kërkuesi u gjet fajtor për importimin e sasive të mëdha të kanabisit dhe u dënua me 22 vjet burgim. Gjyqtari gjithashtu solli urdhrë konfiskimi në shumën 75,000 €, mbi bazën e Ligjit për Veprat e Trafikimit të Drogës (“Ligji i vitit 1986”). Urdhri i konfiskimit ishte bërë përpara se të hynte në fuqi Ligji i vitit 1986, dhe kërkuesi u ankuu që urdhri i konfiskimit përbënte dhënien e një dënimi penal retrospektiv, në kundërshtim me Nenin 7. Duke theksuar natyrën autonome të përkufizimit të dënimit sipas Nenit 7m GjEDNJ vendosi që, për të siguruar që Neni 7 të mbetej efektiv, ajo duhet të përcaktonte nëse konfiskimi përbëri dënim në thelb. Për këtë qëllim, GjEDNJ shqyrtoi nëse masa ishte marrë pas kryerjes së një vepre penale; dhe analizoi natyrën dhe qëllimin e masës, karakterizimin e saj sipas të drejtës vendase, procedurat e përfshira në marrjen dhe zbatimin e masës, si dhe shkallën e rreptësisë së urdhrin të konfiskimit. Të bazuarit tek Ligji i vitit 1986 varej nga ekzistenca e një dënimi penal, dhe GjEDNJ nuk konsideroi se aspektet parandaluese dhe riparuese të konfiskimit i përjashtonin aspektet ndëshkuese të tij. Në fakt, GjEDNJ theksoi se parandalimi dhe riparimi mund të shihen si elemente përbërëse të ndëshkimit. Ndërkohë që shkalla e rreptësisë së masës nuk u vlerësua e rëndësishme, procedurat që kishin të bënin me marrjen e masës, përfshirë mundësinë e burgimit në rast mospajtueshmërie, tregonin fuqimisht se masa përbënte dënim. Prandaj, duke pasur parasysh thelbin e masës, Neni 7 i KEDNJ-së aplikohet në urdhrin e konfiskimit dhe ai ishte shkelur.

[147] Këshilli i Evropës, *Udhërrëfyes për Nenin 7 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut*, 31 gusht 2022, [https://t.ly/c\\_5\\_](https://t.ly/c_5_).

Një vendim gjykate që urdhri i konfiskimit përbën dënim është i rëndësishëm por jo gjithmonë vendimtar. Në *G.I.E.M. dhe të Tjerë k. Italisë*,<sup>[148]</sup> GjEDNj gjeti që masa e konfiskimit përbëri dënim. Megjithatë, Neni 7 u shkel vetëm në lidhje me kërkuesit që nuk janë palë në procedurat penale që çuan tek urdhrat e konfiskimit; nuk pati shkelje në lidhje me një kërkues përgjegjësia e të cilit është përcaktuar në procedura penale.

Vendimet në *Welch dhe G.I.E.M.* janë në kontrast me vendimin në *M. k. Italisë*.<sup>[149]</sup>

Në *M. k. Italisë* kërkuesi u dënua, mes akuzave të tjera, për “anëtarësi në një organizatë kriminale” dhe u dënua me periudha të shumta burgimi. U kërkuan masa parandaluese, përfshirë sekuestrimin e pasurisë së kërkuesit. Më pas u mor një urdhër konfiskimi kundër tij mbi bazën se e vetmja mënyrë se si ai mund të kishte akumuluar pasurinë e tij të madhe ishte përmes aktiviteteve ilegale. Kërkuesi diskutoi që gjykatat vendase italiane e kishin privuar atë nga pasuria e tij me anë të dispozitave të zbatuara në mënyrë retroaktive, ku pasuria ishte blerë nga ai para hyrjes në fuqi të ligjit përkatës vendas. Në këtë rast, GjEDNj vendosi që masat parandaluese të konfiskimit ndoqën qëllimin legjitim të “goditjes së organizatave të llojit mafioz” dhe burimeve të tyre. Në të drejtën italiane masa të tilla parandaluese nuk kishin karakter penal dhe nuk përbënë dënim për një vepër penale. Kështu, GjEDNj doli në përfundimin se masa nuk përfshiu gjetjen e fajësisë pas ngritjes së akuzës penale kështu që nuk përbëri dënim.

Ky parim shtjellohet më tej në *Yildirim k. Italisë*.<sup>[150]</sup>

Në *Yildirim k. Italisë* kërkuesi ishte pronar i një autobusi të cilin e kishte dhënë me qira. Gjatë kohës që autobusi ishte i dhënë me qira, ai u gjet se mbante imigrantë ilegalë. Pas kësaj, shoferët u arrestuan dhe morën dënime me paraburgim, dhe autobusi u sekuestrua. Kërkuesi nisi procedurat për rimarrjen

[148] *G.I.E.M. S.R.L dhe të Tjerë k. Italisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 28 qershorit 2018, Nr. 1828/06, 34163/07 dhe 19029/11 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[149] *M. k. Italisë*, vendimi për pranueshmërinë e 15 prillit 1991, Nr. 12386/86.

[150] *Yildirim k. Italisë*, vendimi për pranueshmërinë i 10 prillit 2003, 38602/02.

e autobusit. Duke u mbështetur tek Neni 1 i Protokollit Nr. 1 dhe Neni 7, kërkuesi e kontestoi refuzimin e kërkesës së tij për rimarrjen e autobusit dhe refuzimin për kthimin e automjetit të tij. Në lidhje me Nenin 7, GjEDNj theksoi se kundër kërkuesit nuk ishte ngritur akuzë penale, procedurat e konfiskimit nuk kishin pasur të bënin me akuza penale kundër kërkuesit, dhe kështu që konfiskimi nuk mund të kishte përfshirë gjetjen e fajësisë pas akuzës penale. Prandaj, konfiskimi nuk mund të ishte dënim sipas Nenit 7.

#### 1.4.3.3 Pika kyçe

Ndërveprimi mes Nenit 7 dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 shpeshherë është shumë i imët, ku vendimi i GjEDNj-së nëse konfiskimi përbën dënim apo jo (e rrjedhimisht nëse Neni 7 është i aplikueshëm) varet nga dallimet margjinale në fakte. Thelbësore për arsyetimin e GjEDNj-së është nëse masat e konfiskimit janë pasojë e akuzave penale, dhe nëse masa të tilla në vetvete janë të karakterizuara si dënime penale në kuadër të së drejtës vendase. Motive të tjera si parandalimi dhe riparimi nuk e përjashtojnë masën e konfiskimit nga të qenit “dënim” dhe kështu brenda fushëveprimit të Nenit 7.

Ndërkohë që Neni 7 i aplikohet masës së konfiskimit, gjykatat vendase duhet të sigurohen që të shqyrtojnë me kujdes kohën e ngritjes së ndonjë vepre (ose veprave) ekzistuese dhe dënimeve të aplikueshme si në atë kohë ashtu edhe në kohën e hyrjes në fuqi të dënimeve më të lehta.

## 1.4.4 E drejta për respekt ndaj jetës private dhe familjare: Neni 8 KEDNj

### 1.4.4.1 Shikim i përgjithshëm

Neni 8 parashikon respektin për jetën private dhe familjare, e cila gjithashtu përfshin të drejtën për respekt ndaj shtëpisë dhe korrespondencës. Është e drejtë e kualifikuar.

Neni 8 thotë:

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. *Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.*

Koncepti i jetës private u aplikohet personave natyrorë dhe ligjorë dhe përfshin identitetin personal, autonominë, të dhënat personale, seksualitetin, zhvillimin e vetes, marrëdhëniet me individë të tjerë, reputacionin, si dhe integritetin fizik dhe moral (pra mirëqenia fizike dhe psikologjike). Jeta familjare përfshin njësinë familjare biologjike, ligjore dhe sociale, për shembull marrëdhëniet brenda një familjeje tradicionale mes çifteve të martuara, prindërit dhe fëmijët, gjyshërit dhe nipat e mbesat, vëllezërit dhe motrat. Ajo gjithashtu përfshin çiftet e fejuara, çiftet që bashkëjetojnë, prindërit e ndarë të fëmijëve, çiftet homoseksuale, prindërit dhe fëmijët e adoptuar, dhe fëmijët dhe prindërit kujdestarë. Në fund, konceptit të shtëpisë i është dhënë përkufizim i gjerë nga organet e Konventës, dhe ai i aplikohet shtëpive de jure dhe *de facto*, si dhe personave natyrorë dhe ligjorë, ku përkufizimi i tij është i lidhur më shumë me punën sesa me ndonjë bazë ligjore. Meqenëse “shtëpia” dhe “jeta private” mund të jenë të ndërthurura me biznesin dhe aktivitetin profesional, mbrojtja e Nenit 8 është gjetur se shtrihet edhe tek zyrat personale dhe, në rastin e kompanive, edhe në ambientet e punës së kompanisë.

Në kuadër të Nenit 8, Shteti ka detyrimin negativ që të mos ndërhyjë tek jeta private e individit, tek jeta familjare, shtëpia dhe korrespondenca e tij. Kur Shteti fut masa që i prekin këto të drejta, kjo është shkelje nëqoftëse ndërhyrja nuk është “në përputhje me ligjin”, nëse nuk ndjek një qëllim legjitim, dhe nëse nuk plotëson kriterin e proporcionalitetit. Neni 8(2) rendit disa prej këtyre qëllimeve legjitime, përfshirë sigurinë kombëtare, parandalimin e trazirave ose krimit, dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Në disa rrethana Shteti ka detyrimin pozitiv të marrë hapa për të siguruar respektimin efektiv të Nenit 8. Kjo përfshin marrëdhëniet jo vetëm mes Shtetit dhe individit, por edhe mes individit dhe organeve private, dhe gjithashtu mes individëve privatë.

#### **1.4.4.2 Ndërveprimi mes Nenit 8 dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1**

Nuk është e pazakontë që kërkuesit të pretendojnë shkelje të së drejtës së tyre për respekt ndaj shtëpisë sipas Nenit 8 dhe gjithashtu të mbështeten tek Neni 1 i Protokollit Nr. 1 – posaçërisht kur objekti i procedurës së konfiskimit është një shtëpi e cila është vendbanimi i kërkuesit. Hyrja e policisë në një vendbanim ose vend pune, me qëllim të sekuestrimit të sendeve, është përdorur për të argumentuar

shkeljet sipas Nenit 8 dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, siç ilustron tek *Niemietz k. Gjermanisë*.<sup>[151]</sup>

*Niemietz k. Gjermanisë* kishte të bënte me një hetim tatimor që çoi tek akuzat penale për shpifje. U lëshua urdhër-kontrolli për bastisjen e zyrës ligjore të kërkuesit për të zbuluar identitetin e autorit të letrës. Gjatë kërkimit, u kontrolluan sirtarët e dosjeve me të dhëna konfidenciale të klientëve, të cilat nuk kishin qenë objekt i urdhër-kontrollit. Kërkuesi u ankua sipas Nenit 8(1) dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 që bastisja shkeli të drejtën e tij për respekt të shtëpisë dhe korrespondencës, që bastisja ishte joproporcionale dhe kishte anashkalluar ligjet e konfidencialitetit. GjEDNj theksoi se urdhri ishte në terma të gjera dhe se ai urdhëroi kontrollin për dhe sekuestrimin e “dokumenteve”, pa kufizime. Prandaj ishte joproporcional dhe jo i nevojshëm në një shoqëri demokratike, në shkelje të Nenit 8. Ankesa e kërkuesit sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 që urdhri i bastisjes prishi reputacionin e tij si avokat tashmë ishte shqyrtuar në kontekstin e Nenit 8, kështu që u vlerësua se shqyrtimi i mëtejshëm sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 nuk ishte i nevojshëm.

Megjithatë, në rastet lidhur me urdhrat e konfiskimit GjEDNj ka qenë e prirur të gjejë shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 dhe të Nenit 8. Në *Gladysheva k. Ruisë*,<sup>[152]</sup> GjEDNj gjeti shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 meqenëse Shteti kishte konfiskuar apartamentin e kërkueses mbi bazën se ai ishte përfutur në mënyrë mashtruese nga pronari i mëparshëm, pa i ofruar asaj akomodim alternativ.

#### 1.4.4.3 Neni 8 dhe bastisjet e pronës

Të gjitha konventat dhe standardet ndërkombëtare të përmendura në pjesën e parë të këtij publikimi përcaktojnë ose inkurajojnë, në terma të përgjithshme, ushtrimin e fuqive hetimore dhe kontrolluese në mënyrë që zbatimi i ligjit të implementohet në mënyrë efektive. Prandaj, Neni 8 mund të aplikohet përpara sekuestrimit të aseteve, për shembull gjatë hetimit të akuzave për korrupsion. Kur autoritetet vendase duhet të bastisin shtëpinë ose ambientet e biznesit të një kërkuesi, Neni 8 parashikon që një bastisje e tillë duhet të jetë “në përputhje me ligjin”. Kjo kërkon që bastisja jo vetëm të

[151] *Niemietz k. Gjermanisë*, vendim i 16 dhjetorit 1992, Nr. 13710/88.

[152] *Gladysheva k. Ruisë*, vendim i 6 dhjetorit 2011, Nr. 7097/10 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

jetë e bazuar në ligje të qarta dhe të parashikueshme, por edhe që këto ligje të ofrojnë garanci të mjaftueshme kundër arbitraritetit. Kështu, në përgjithësi, bastisjet duhet të zhvillohen me urdhër gjyqësor.

Kur nuk ka urdhër gjyqësor, bastisja mund të legjitimohet post facto përmes këqyrjes gjyqësore të ligjshmërisë së bastisjes dhe mundësisë për zgjidhje gjyqësore nëqoftëse bastisja ka qenë e paligjshme. Në *Gutsanovi k. Bullgarisë*,<sup>[153]</sup> GjEDNj gjeti se nuk mjaftonte që gjyqtari vendas thjesht të firmoste dhe të vuloste procesverbalin e bastisjes me fjalët “aprovuar”, pa dhënë arsye për aprovimin e tij; kjo nuk përbënte mbrojtje të mjaftueshme kundër abuzimit. Për më tepër, fushëveprimi i çdo urdhri gjyqësor për bastisje është relevant në kuadër të “nevojshmërisë” së tij. Për shembull, në *Ilija Stefanov k. Bullgarisë*,<sup>[154]</sup> GjEDNj gjeti se shtrirja më e gjerë sesa duhet e termave të urdhrit të bastisjes, e reflektuar në mënyrën e ekzekutimit të tij, nuk mund të konsiderohej e nevojshme dhe proporcionale në linjë me kriteret e Neni 8.

#### 1.4.4.4 Pika kyçe

Neni 8 dhe Neni 1 i Protokollit Nr. 1 mund të angazhohen dhe mund të ndërveprojnë në një sërë mënyrash. Ka rëndësi të theksohet se Shteti duhet të ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të siguruar që sekuestrimi i asetëve të mos shkojë përtej kufijve të nevojshëm, që do të thotë se urdhrat e bastisjes dhe sekuestrimit nuk duhet të jenë të papengueshëm. Masa të tilla, siç shpjegohet më lart, janë gjetur se shkelin edhe Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 edhe Nenin 8.

[153] *Gutsanovi k. Bullgarisë*, vendim i 15 tetorit 2013, Nr. 34529/10 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[154] *Ilija Stefanov k. Bullgarisë*, vendim i 22 majit 2008, Nr. 65755/01 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

## ▶ Pjesa 2 – Përmbledhjet e çështjeve

*Mos-lejimi i personave dhe entiteteve që janë pjesë e regjimit të sanksioneve nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, përfshirë ngrirjen dhe konfiskimin e aseteve, që të kërkojnë shqyrtimin nga gjykatat kombëtare të masave të marra sipas atij regjimi shkeli Nenin 6*

### VENDIM I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN **AL-DULIMI DHE MONTANA MANAGEMENT INC. K. ZVICRËS**

(Kërkesa Nr. 5809/08)

**21 qershor 2016**

#### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi i parë, Khalaf M. Al-Dulimi, ishte shtetas irakian që jetonte në Jordani. Sipas Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (OKB), ai ishte shefi i financave në shërbimet sekrete të Irakut gjatë regjimit të Sadam Huseinit. Kërkuesi i dytë ishte një kompani e inkuorporuar sipas ligjeve të Panamasë, Montana Management Inc., me zyra të regjistruara në Panama. Kërkuesi i parë ishte gjithashtu drejtori menaxhues i Montana Management Inc.

Pasi Iraku pushtoi Kuvajtin në gusht të vitit 1990, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi dy Rezoluta të reja ku ftohej OKB-ja dhe Shtetet jo-anëtare të OKB-së që të vinin një embargo të përgjithshme ndaj Irakut. Në përgjigje të kësaj, Këshilli Federal Zviceran lëshoi "urdhrin e Irakut" më 7 gusht 1990, i cili mori masa ekonomike kundër Irakut dhe bëri thirrje për ngrirjen e aseteve dhe burimeve ekonomike që i përkisnin Qeverisë irakiane, zyrtarëve të lartë, dhe kompanive ose organeve nën kontrollin ose menaxhimin e asaj Qeverie ose zyrtarëve të saj. Ky urdhër çoi në ngrirjen e aseteve të kërkuesve. Në maj 2004 kërkuesit u përfshinë në një listë të hartuar nga OKB-ja me persona dhe grupe që ishin në shënjestër të sanksioneve të rinovuara kundër Irakut. Në përgjigje saj kësaj, autoritetet zvicerane lëshuan një urdhër për konfiskimin e aseteve irakiane të ngrira më parë të cilat kishin qenë të përfshira në listë dhe për transferimin e tyre në Fondin Zhvillimor për Irakun.



Kërkuesi i parë deshi të paraqiste pranë Komisionit të OKB-së për Sanksionet një kërkesë për heqjen e asetëve të tij nga lista, dhe i kërkoi Departamentit Federal Zviceran për Çështje Ekonomike që të suspendonte procedurat e konfiskimit kundër pronave të tij deri sa ai ta bënte këtë, kërkesë të cilën autoritetet e pranuan. Negociatat mes kërkuesit dhe OKB-së në lidhje me përfshirjen e tij në listë ngecën në vitin 2005, pasi nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim në përgjigje të kërkesës së tij për të dhënë dëshmi me gojë para Komisionit të Sanksioneve. Autoritetet zvicerane sërish urdhëruan që asetet të konfiskoheshin, duke theksuar se Zvicra ishte nën obligimin e detyrimeve të saj ndaj të drejtës ndërkombëtare dhe se ajo mund të hiqte një emër nga lista vetëm kur vetë Komisioni i Sanksioneve e bënte një gjë të tillë.

Kërkuesit bënë tre apele pranë Gjykatës Federale të Zvicrës dhe të tre u rrëzuan deri në janar 2008, dhe gjykatat vendase i kufizuan vendimet e tyre me riafirmimin e detyrimeve të autoriteteve zvicerane për zbatimin e të drejtës ndërkombëtare dhe me prezencën e kërkuesve në listën e shënjestrave të Komisionit të Sanksioneve. Në korrik 2008, kërkuesit paraqitën një kërkesë për heqje nga lista pranë Komisionit të Sanksioneve në përputhje me procedurën e OKB-së, e cila u refuzua në janar 2009.

## 2. Vendimet e Gjykatës

Kërkuesit argumentuan duke u bazuar në Nenin 6 § 1 (e drejta për proces të rregullt) se konfiskimi i asetëve të tyre ishte urdhëruar në mungesë të procedurave të pajtueshme me Konventën.

### Neni 6 § 1

E drejta për proces të rregullt duhet të interpretohet nën dritën e shtetit të së drejtës, ku kërkohej që të gjitha palët në procedurë të merrnin zgjidhje juridike efektive që u mundësonte realizimin e të drejtave të tyre civile. Megjithatë, e drejta për qasje në gjykatë nuk është absolute, por u nënshtrohet kufizimeve, për sa kohë që këto kufizime nuk ngushtojnë qasjen e individit në mënyrë të atillë ose në masë të atillë që dëmtohet vetë thelbi i së drejtës.

Në vendimet e saj të janarit 2008, Gjykata Federale e Zvicrës dha arsye të detajuara se përse ajo konsideroi se kishte për detyrë vetëm të verifikonte që emrat e kërkuesve faktikisht ndodheshin në listat e Komisionit të Sanksioneve dhe se asetet në fjalë u përkisnin atyre. Gjykata Federale u bazua në supremacinë absolute të detyrimeve të dala nga Karta e OKB-së dhe vendimeve të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, duke thënë se obligimet e vëna nga Rezoluta 1483 (2003) nuk u linin Shteteve diskrecion.

Në këto rrethana, Gjykata qe e mendimit se qasja e kërkuesve në gjykatë kishte qenë qartazi e kufizuar dhe se mbetej të shqyrtohej nëse ai kufizim kishte qenë i justifikuar.

Qëllimi i masave ishte stabilizimi dhe zhvillimi i Irakut, dhe asetet do të transferoheshin në Fondin Zhvillimor për Irakun. Prandaj, vendimi i kontestuar u mor për të implementuar një objektivë që ishte në përputhje me Konventën dhe synonte një qëllim legjitim, pra ruajtjen e paqes dhe sigurisë. Qeveria kishte argumentuar që Zvicra ishte përballur me një konflikt mes detyrimeve të saj ndaj Kartës së OKB-së dhe detyrimeve ndaj Konventës, konflikt i cili nuk mund të zgjidhej sepse Zvicra nuk kishte vend për manovrimet gjatë zbatimit të Rezolutës së OKB-së. Gjykata iu referua qëllimeve për të cilat u krijuan Kombet e Bashkuara: përveç ruajtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, Neni 1 i Kartës parashikon që Kombet e Bashkuara janë krijuar për të "arritur bashkëpunimin ndërkombëtar... duke promovuar dhe inkurajuar respektin për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore...". Rrjedhimisht, duhet të kishte një prezumim që Këshilli i Sigurimit nuk kishte për qëllim t'u vinte Shteteve detyrimeve të cilat mund të shkelnin parimet themelore të të drejtave të njeriut.

Gjykata gjeti që asnjë nga dispozitat e Rezolutës 1483 (2003) nuk i ndalonte shprehimisht gjykatat zvicerane që të verifikonin, me qëllim të respektimit të të drejtave të njeriut, masat e marra në nivel vendi drejt zbatimit të vendimeve të Këshillit të Sigurimit. Përfshirja e individëve dhe entiteteve në listat e personave që u nënshtrohen sanksioneve të OKB-së ngërthente ndërhyrje praktike të cilat mund të ishin tejet të rënda për të drejtat e Konventës të personave në fjalë, dhe duhet të kalonin në shqyrtim.

Gjykata gjeti se kur një rezolutë e Këshillit të Sigurimit nuk përmban formulime të qarta ose eksplicite që përjashtojnë mundësinë e shqyrtimit gjyqësor të masave të marra për zbatimin e saj, ajo gjithmonë duhet të kuptohet si e tillë që autorizon gjykatat e Shtetit të paditur për të ushtruar këqyrje të mjaftueshme në mënyrë që të shmanget arbitrariteti. Duke kufizuar atë këqyrje ndaj arbitraritetit, Gjykata vendosi një ekuilibër të drejtë mes nevojës për të garantuar respektimin e të drejtave të njeriut dhe imperativës për mbrojtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Prandaj Zvicra në këtë rast nuk ishte përballur me një konflikt real të detyrimeve të saj, i atillë që të angazhohej rregulla e supremacisë së Kartës së OKB-së. Kjo gjetje e bëri të panevojshme që Gjykata të përcaktonte çështjen e hierarkisë mes detyrimeve të Shteteve Palë të Konventës sipas atij instrumenti, nga njëra anë, dhe atyre që dalin nga Karta e OKB-së, nga ana tjetër.

Sa i përket substancës së sanksioneve – ngrirja e asetëve dhe pronave të zyrtarëve të lartë të ish-regjimit të Irakut – Gjykata që e pikëpamjes se zgjedhja ishte e ngërthyer në brendinë e rolit eminent të Këshillit të Sigurimit të OKB-së si politikëbërësi përfundimtar në këtë fushë. Megjithatë, para se të merrnin masat e lartpërmendura, autoritetet zvicerane kishin për detyrim të siguroheshin që lista nuk ishte arbitrare. Gjykata Federale ishte kufizuar vetëm me verifikimin e faktit që emrat e kërkuesve ndodheshin në listën e Komisionit të Sanksioneve dhe që asetet në fjalë u përkisnin atyre, por kjo që e pamjaftueshme për të siguruar që kërkuesit nuk ishin futur në listë në mënyrë arbitrare. Kërkuesve duhet t'u ishte ofruar së paku një mundësi e sinqertë për të parashtruar prova të përshtatshme në një gjykatë, për shqyrtim të themeleve, me qëllimin për të treguar se përfshirja e tyre në listat e kontestuara kishte qenë arbitrare. Kështu ishte dëmtuar vetë thelbi i të drejtës së tyre për qasje në gjykatë.

Më tej, Gjykata theksoi se kërkuesit u ishin nënshtruar, dhe vazhdonin t'u nënshtroheshin, kufizimeve të mëdha. Fakti që kishte qenë tërë kohën krejtësisht e pamundur për ta që të kontestonin masën e konfiskimit për shumë vite me radhë ishte thujse i pakonceptueshëm në një shoqëri demokratike.

Në fund, Gjykata theksoi se sistemi i sanksioneve i OKB-së, dhe në mënyrë të veçantë procedura për futjen e individëve dhe entiteteve ligjore në listë dhe mënyra se si trajtoheshin kërkesat për heqje nga lista, kishte marrë kritika shumë serioze, të përsëritura, dhe të vazhdueshme nga shumë organe dhe gjykata ndërkombëtare dhe kombëtare. Prandaj qasja në atë procedurë nuk mund të zëvendësonte këqyrjen e duhur gjyqësore në nivel të Shtetit përgjegjës dhe nuk mund të kompensonte qoftë edhe pjesërisht mungesën e saj.

Prandaj, Gjykata gjeti që kishte pasur shkelje të Nenit 6 § 1.

#### Neni 41

Gjykata konsideroi që nuk kishte pasur lidhje shkakësore mes shkeljes së Nenit 6 § 1 dhe pretendimeve të kërkuesve për dëme materiale. Meqenëse kërkuesit nuk kishin kërkuar kompensim për dëme jomateriale ose rimbursim për kostot dhe shpenzimet e tyre, Gjykata nuk caktoi shpërblim sipas atyre titujve.

*Kriteri ligjor vendas për të konfiskuar automatikisht automjetin e përdorur në kontrabandimin e migrantëve përbëri shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1*

VENDIMI NË ÇËSHTJEN  
**ANDONOSKI K. ISH-REPUBLIKËS  
 JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË**

(Kërkesa Nr. 16225/08)  
**17 shtator 2015**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1968 dhe jetonte në Prilep. Më 25 korrik 2007, kërkuesi, i cili ishte shofer taksie, u ndalua nga policia ndërkohë që ishte duke dërguar tre shtetas shqiptarë nga Prilepi në Vitolishte, një fshat afër kufirit greko-maqedonas. Policia arrestoi kërkuesin dhe tre pasagjerët e tij sepse ata dështuan të paraqisnin dokumente udhëtimi. Policia gjithashtu konfiskoi makinën e kërkuesit dhe i lëshoi atij një fletëpranim për objekte përkohësisht të konfiskuara.

Më 26 korrik 2007, një gjyqtar hetues hapi hetimet kundër kërkuesit dhe njërit prej pasagjerëve mbi bazën e dyshimit të arsyeshëm për kontrabandë migrantësh. Më 8 gusht 2007, prokurori publik i tërhoqi të gjitha akuzat kundër kërkuesit, duke thënë se nuk kishte prova që ai e kishte ditur ose kishte arsye të besonte se kishte qenë duke transportuar migrantë ilegalë. U konstatua, dhe u vërtetua nga pasagjerët, që kërkuesi nuk ishte takuar kurrë dhe as nuk kishte pasur kontakte me ndonjërin nga pasagjerët. Më tej, i vetmi pasagjer me të cilin kërkuesi kishte folur, P.K., fliste maqedonisht rrjedhshëm.

Më 3 shtator 2007, trupi gjykues konstatoi që P.K. ishte paguar për të kontrabanduar dy pasagjerët e tjerë, migrantë ilegalë shqiptarë, përmes kufirit greko-maqedonas, dhe e dënoi atë për kontrabandë me migrantë. Trupi gjykues gjithashtu urdhëroi konfiskimin e përhershëm të makinës së kërkuesit, si mjeti me të cilin ishte kryer vepra penale ("urdhri i konfiskimit") siç kërkohej nga Kodi Penal.

Kërkuesi apeloj kundër urdhrin të konfiskimit, me argumentin se ai nuk ishte i bazuar në fakte meqenëse të gjitha akuzat kundër tij ishin tërhequr. Gjykata e Apelit e rrëzoi apelin e tij mbi bazën se konfiskimi i automjeteve të përdorura për kontrabandë ishte i detyrueshëm sipas Kodit Penal.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi argumentoi se konfiskimi i taksisë së tij, të cilin ai e përdorte për të mbajtur veten dhe familjen e tij, nuk i shërbente ndonjë interesi publik, dhe as nuk mund të kishte pasur për qëllim parandalimin e kryerjes së veprave të mëtejshme, duke marrë parasysh se ai nuk ishte dënuar, dhe se përbënte shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

### Neni 1 i Protokollit Nr. 1

Mbrojtja e pasurisë, që përmbahet në Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, përfshin tri rregulla: e para, e përcaktuar në fjalinë e parë të paragrafit të parë, është e natyrës së përgjithshme dhe shqipton parimin e gëzimit paqësor të pasurisë; e dyta, e përcaktuar në fjalinë e dytë të paragrafit të parë, mbulon privimin nga pasuria dhe përcakton kushtet e tij; e treta, e përcaktuar në paragrafin e dytë, njeh që Shtetet kanë të drejtë, mes të tjerash, të kontrollojnë përdorimin e pasurisë në përputhje me interesin e përgjithshëm. Në rastin konkret, veprimet e Shtetit të paditur përbënë privim të përhershëm të pasurisë së kërkuesit. Konfiskimi i makinës së kërkuesit që masë permanente e cila përfshiu transferimin konkluziv të pronësisë. Shteti nuk argumentoi se ekzistonte mundësia që kërkuesi të kërkonte rikthimin e pronës së tij.

Gjykata iu referua praktikës së saj gjyqësore të vendosur që ndërhyrja e Shtetit tek të drejtat pronësore duhet të jetë e parashikuar me ligj dhe duhet të synojë një ose disa qëllime legjitime. Duhet vendosur një ekuilibër i drejtë mes kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe interesave të individëve të përfshirë. Ekuilibri i kërkuar nuk mund të vihet nëqoftëse personit ose personave të përfshirë u është dashur të bartin një barrë individuale dhe të tepërt. Në rastin konkret, konfiskimi i automjetit të kërkuesit ishte kërkesë e Kodit Penal dhe synonte qëllimin legjitim të parandalimit të imigrimit klandestin dhe trafikimit të qenieve njerëzore.

Për sa i përket vlerësimit të proporcionalitetit, Gjykata përsëriti se, kur konfiskohen posedimet e përdorura ilegalisht, një ekuilibër i tillë varet nga shumë faktorë, të cilët përfshijnë edhe sjelljen e pronarit. Në këtë rast, kërkuesi nuk kishte histori trafikimi, nuk kishte të kaluar kriminale, ndaj edhe prokurori publik e liroi nga akuza.

Gjykata vuri në dukje se dispozita përkatëse e Kodit Penal kërkonte konfiskimin automatik të mjeteve të transportit të përdorura për kontrabandimin e migrantëve, dhe nuk lejonte përjashtime. Kjo aplikohet pavarësisht nëse ato mjete ishin në pronësi të kryesit të veprës apo të një pale të tretë dhe, në këtë rast, pavarësisht nga sjellja

e palës së tretë ose lidhja me veprën. Në rastin e kërkuarit, një konfiskim i tillë automatik e privoi kërkuarin nga çdo mundësi për të paraqitur argumentet e tij dhe për të pasur perspektivë suksesi në procedurën e konfiskimit. Ngjashëm, gjykatat vendase, në rrethana të tilla, nuk patën diskrecion dhe nuk mundën ta shqyrtonin çështjen mbi bazën e asnjërit prej faktorëve të përshkruar lart. Për fund, Gjykata theksoi se Kodi Penal nuk parashikonte mundësinë e kërkuarit të kompensimit për pronën e konfiskuar në këtë mënyrë. Qeveria nuk ofroi ndonjë ilustrim të praktikave vendase që do të demonstronte se mundësia e kërkuarit për kompensim nga pronarët e pafajshëm palë të treta ishte në dispozicion, e jo më që të ishte efektive, në rrethana të tilla siç ishin ato në rastin e kërkuarit.

Duke pasur parasysh sjelljen e kërkuarit dhe konfiskimin e kërkuar, në dukje pa opsione zgjidhjeje sipas Kodit Penal, Gjykata gjeti se urdhri i konfiskimit vuri një barrë joproporcionale dhe të tepërt mbi kërkuarin duke përbërë shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuarit 3,000 € për dëme jomateriale, dhe urdhëroi Shtetin e paditur që ta kthente makinën e konfiskuar në gjendjen në të cilën ishte konfiskuar ose, në tërësi, t'i paguante kërkuarit 10,000 € në lidhje me dëme materiale.

*Bastisja e zyrave ligjore dhe konfiskimi i dokumenteve nga inspektorët tatimorë që kërkonin prova kundër njërit prej klientëve të firmës u vlerësuan shkëlqje të Nenit 6 dhe Nenit 8*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **ANDRÉ DHE NJË TJETËR K. FRANCËS**

(Kërkesa Nr.18603/03)

**24 korrik 2008**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit ishin një avokat dhe një firmë ligjore me seli në Marsejë. Kërkuesit përfaqësonin një kompani në një kontest me autoritetet në lidhje me dyshimet për evazion fiskal. Në qershor të vitit 2001, administrata tatimore franceze mori autorizimin, sipas Nenit L.16B të Kodit të Procedurës Tatimore, për të bërë bastisjen e zyrave të avokatëve me qëllim të zbulimit të provave kundër kompanisë kliente. Bastisja u zhvillua në praninë e kërkuesit të parë, kryetarit të Dhomës së Avokatisë të Marsejës dhe një polici.

Gjatë bastisjes u konfiskuan gjashtëdhjetegjashtë (66) dokumente, duke përfshirë shënime të shkruara me dorë dhe një dokument me një koment të shkruar me shkrimin e dorës së kërkuesit të parë. Kryetari i Dhomës së Avokatisë vuri në dukje se këto ishin dokumente personale të avokatit dhe nuk mund të konfiskoheshin, meqenëse ishin të mbrojtura nga rregulli i konfidencialitetit profesional absolut. Kërkuesi i parë gjithashtu protestoi ndaj mënyrës së si u zhvillua bastisja.

Kërkuesit apeluan, dhe argumentuan se bastisja dhe konfiskimi kishin qenë të paligjshme. Ata deklaruan në mënyrë të veçantë, duke u mbështetur në sekretin profesional dhe të drejtën e mbrojtjes, se dokumentet e dërguara nga një klient tek avokati i atij klienti si dhe korrespondenca mes tyre nuk mund të konfiskohej kur bastisja nuk kishte për qëllim të konstatonte prova që avokati në fjalë kishte qenë i përfshirë në vepër. Në dhjetor 2022, çështja u rrëzua nga Gjykata e Kasacionit.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesit u ankuan se procedura e bastisjes dhe konfiskimit në zyrat e tyre përbënte shkëlqje të të drejtave të tyre të mbrojtjes dhe shkëlqje të konfidencialitetit profesional. Më tej, ata u ankuan për mungesën e një zgjidhjeje efektive. Ata u mbështetën tek Nenet 6, 8 dhe 13.

## Neni 6

Kur aplikohet Neni 6 § 1, si në këtë rast, ai përbën *lex specialis* në lidhje me Nenin 13, prandaj Gjykata e gjeti me vend të shqyrtonte ankesën vetëm sipas Nenit 6 § 1. Gjatë vlerësimit nëse kërkuesit kishin pasur qasje në gjykatë në mënyrë që të kishin një vendim në lidhje me kontestin e tyre, Gjykata iu referua një çështjeje të mëparshme ku ajo kishte shqyrtuar zgjidhjet e ndryshme juridike në të drejtën franceze.<sup>[155]</sup> Në atë çështje, Gjykata deklaroi se procedura e parashikuar dhe e përkufizuar në Nenin L.16B të kodit të Procedurës Tatimore nuk i plotësonte kriteret e Nenit 6 § 1. Gjykata nuk pa arsye që ta ndryshonte atë gjetje, dhe deklaroi se kishte pasur shkelje të Nenit 6 § 1 për shkak të mungesës së shqyrtimit gjyqësor efektiv në çështjen në fjalë.

## Neni 8

Termi “shtëpi” që ndodhet në Nenin 8 mund të nënkuptojë zyrat e një anëtari të një profesioni, si për shembull të një avokati. Prandaj, bastisja e zyrave të kërkuesve dhe konfiskimet e kryera përbënin ndërhyrje tek ushtrimi i të drejtave të tyre sipas Nenit 8. Kjo ndërhyrje ishte “në përputhje me ligjin”, meqenëse Neni L.16B i Kodit të Procedurës Tatimore përmbante dispozita specifike për respektimin e sekretit profesional dhe të ambienteve profesionale ose shtëpisë private të një avokati. Ndërhyrja gjithashtu synonte një “qëllim legjitim”, parandalimin e prishjes së rendit publik dhe krimit.

Gjatë shqyrtimit nëse ndërhyrja ishte “e nevojshme”, Gjykata deklaroi se bastisjet dhe konfiskimet në ambientet e punës së një avokati pa dyshim që shkelnin sekretin profesional, që është baza e marrëdhënies së besimit që ekziston mes një avokati dhe klientit të tij.

Më tej, ruajtja e sekretit profesional është në mënyrë të veçantë pasojë e të drejtës së klientit të një avokati për të mos inkriminuar veten, çka presupozon që autoritetet kërkojnë të vërtetojnë argumentet e tyre pa marrë prova të përfuara me metoda të shtrëngimit ose shtypjes duke shpërfillur vullnetin e “personit të akuzuar”. Prandaj, është thelbësore që bastisje të tilla të shoqërohen me mbrojtje të veçanta. Avokatët kanë një pozicion jetik në administrimin e drejtësisë dhe, për shkak të rolit të tyre si ndërmjetës mes palëve dhe gjykatës, mund të përshkruhen si zyrtarë të ligjit.

---

[155] *Ravon dhe të Tjerë k. Francës*, vendimi i 21 shkurtit 2008, Kërkesa Nr.18497/03.



Në rastin konkret, Gjykata vuri në dukje se bastisja ishte shoqëruar nga mbrojtje procedurale speciale, meqenëse ajo ishte kryer në praninë e kryetarit të Dhomës së Avokatisë në të cilën kërkuesit ishin anëtarë. Megjithatë, gjyqtari që kishte autorizuar bastisjen nuk ishte i pranishëm, dhe prania e kryetarit të Dhomës së Avokatisë dhe kundërshtimet e tij qenë të pamjaftueshme për të ndaluar inspeksionin faktit të të gjitha dokumenteve në zyra dhe konfiskimin e tyre. Për sa i përket konfiskimit të shënimeve me shkrim dore të kërkuesit të parë, nuk u kontestua që ato ishin dokumente personale të avokatit dhe përbënin sekret profesional.

Më tej, urdhri i bastisjes ishte hartuar në terma të gjera, ku vendimi kufizohej me urdhërimin e bastisjes dhe konfiskimit të kërkuar për të zbuluar prova të sjelljes së pahijshme në vende të caktuara ku mund të gjendeshin dokumente dhe të dhëna në lidhje me mashtrimin e dyshuar, në mënyrë të veçantë në vendin e punës së avokatit. Rrjedhimisht, inspektorëve dhe policëve iu dha pushtet i gjerë.

Për fund, dhe më së rëndësishmi, qëllimi i bastisjes në fjalë ishte zbulimi në ambientet e kërkuesve, thjesht në cilësinë e tyre si avokatë të kompanisë së dyshuar për mashtrim, i dokumenteve që mund të konstatojnë ekzistencën e një mashtrimi të tillë nga ana e kompanisë dhe përdorimi i këtyre dokumenteve si prova kundër saj. Në asnjë moment kërkuesit nuk u akuzuan ose dyshuan që kishin kryer ndonjë vepër ose që ishin përfshirë në ndonjë mashtrim të kryer nga klienti i tyre.

Prandaj, në kontekstin e inspektimit tatimor në biznesin e një kompanie që ishte kliente e kërkuesve, autoritetet i shënjestruan kërkuesit vetëm për shkak të vështirësive të hasura gjatë zhvillimit të inspeksioneve të nevojshme tatimore dhe me gjetjen e “dokumenteve ligjore dhe të kontabilitetit të kompanisë” që konfirmonin dyshimin se kompania kliente ishte e përfshirë në mashtrim. Nën dritën e kësaj, bastisja dhe konfiskimet e bëra në ambientet e kërkuesve ishin disproporcionale me qëllimin e synuar, ndaj kishte pasur shkelje të Nenit 8.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuesit të parë 5,000 € për dëme jomateriale, dhe 10,000 € kërkuesve së bashku për kosto dhe shpenzime.

Ankesat në lidhje me konfiskimin e aseteve që dyshohej se ishin përftuar ilegalisht, por ku kërkuesit kishin arritur të angazhoheshin efektivisht në procesin e konfiskimit, u deklaruan të papranueshme si dukshëm të pabazuara sipas Nenit 1 të Protokollit 1 dhe Nenit 46

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **ARCURI DHE TË TJERË K. ITALISË**

(Kërkesa Nr. 52024/99)  
**5 korrik 2001**

### **1. Faktet kryesore**

Katër kërkuesit ishin shtetas italianë që jetonin në Torino. Dy kërkuesit e parë ishin prindërit e martuar të kërkuesit të tretë. Kërkuesja e katërt ishte vajza e kërkuesit të dytë.

Prokurori Publik i Torinos bëri kërkesë për masa parandaluese dhe për bastisjen e aseteve që i përkisnin kërkuesve për shkak të dyshimeve për anëtarësinë e kërkuesit të parë në organizata kriminale të përfshira, mes të tjerash, në trafikim droge, dhe për shkak të shpërputhjes mes aseteve të tyre dhe të ardhurave të tyre të ligjshme. Ndërkohë që pasuria në fjalë ishte blerë nga kërkuesi i parë, ai ua kishte transferuar disa prej aseteve të tij gruas dhe fëmijëve të tij.

Divizioni special i Gjykatës së Torinos me ekspertizë në masat parandaluese urdhëroi konfiskimin e aseteve të marra nga kërkuesit në përputhje me të drejtën vendase. Kjo u bazua mbi provat e autoriteteve që pasuria e kërkuesve ishte përftuar në mënyrë të paligjshme dhe mbi mungesën e provave nga kërkuesit në mbështetje të pretendimit të tyre se asetet ishin përftuar në mënyrë të ligjshme. Gjykata e Torinos konkludoi se asetet që i përkisnin kërkuesit të dytë, të tretë dhe të katërt ishin blerë nga kërkuesi i parë dhe më pas u ishin transferuar fëmijëve të çiftit, ku gruaja e tij ishte bërë partnere në biznes në përpjekje për të mbrojtur pasurinë e tij nga procedurat e shumta gjyqësore kundër tij.

Urdhri i konfiskimit u mbështet nga Gjykata e Apelit të Torinos, e cila konkludoi që pasuria e familjes ishte krijuar përmes mënyrave kriminale. Mungesa e dokumentacionit të saktë e kishte bërë të pamundur vlerësimin e të ardhurave të ligjshme të kërkuesit të parë, dhe kishte prova se bizneset e tij të ligjshme ishin financuar nga të hyrat prej veprave penale që ai kishte kryer.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan se konfiskimi kishte shkelur të drejtën e tyre për gëzimin paqësor të pasurisë sipas Nenit 1 të Protokollit 1 dhe të drejtën e tyre për gjyq të drejtë sipas Nenit 6 § 1 dhe Nenit 6 § 3.

### Neni 1 i Protokollit Nr. 1

Gjykata njohu se konfiskimi përbënte ndërhyrja tek e drejta për gëzimin paqësor të pasurisë. Megjithatë, në këtë rast konfiskimi kishte për qëllim parandalimin e kërkuesit të parë nga të përdorurit e asetëve kinëse të përfuara ilegalisht për përfitime të tij ose të organizatës kriminale së cilës dyshohej se i përkiste, në dëm të komunitetit. Rrjedhimisht, masa përbënte kontrollim të përdorimit të pasurisë për interes të përgjithshëm në përputhje me paragrafin e dytë të Nenit 1 të Protokollit 1.

Për të parandaluar shkeljen e Nenit 1 të Protokollit 1, ndërhyrja duhet të jetë proporcionale me qëllimin legjitim të synuar. Gjatë zbatimit të politikave për parandalimin e krimit, Shtetet kanë hapësirë të gjerë vlerësimi. Gjykata theksoi se në Itali problemi i krimit të organizuar kishte arritur nivele shqetësuese, deri në atë masë sa grupet e organizuara kriminale kishin një shkallë të tillë të pushtetit ekonomik që vinte në rrezik shtetin e së drejtës. Kështu, Gjykata konkludoi që masat e konfiskimit ishin pjesë esenciale e ndjekjes së suksesshme penale në betejën kundër krimit të organizuar.

Sidoqoftë, ndërkohë që mori parasysh këto rrethana specifike, Gjykata theksoi detyrën e saj për të siguruar që të drejtat e garantuara nga Konventa të respektohen në çdo çështje. Për këtë qëllim, Gjykata përsëriti nevojën për mbrojtje gjyqësore efektive, e në mënyrë të veçantë që procedurat në gjykatat vendase t'u ofronin kërkuesve mundësi të arsyeshme për të parashtruar argumentet e tyre para autoriteteve. Ajo theksoi se kërkuesit, me një avokat që e zgjodhën vetë, arritën të ngrinin kundërshtime dhe të nxirrnin prova që ata i konsideruan të nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre, prandaj e drejta e kërkuesve për t'u mbrojtur u respektua. Për më tepër, Gjykata vuri në dukje se nuk kishte asgjë që të sugjeronte se gjyqtarët vendas kishin vepruar në mënyrë arbitrare gjatë vlerësimit të provave.

Gjykata arriti në përfundimin se ndërhyrja tek e drejta e kërkuesve për gëzimin paqësor të pasurisë nuk ishte në disproporcion me qëllimin legjitim të synuar, dhe e refuzoi pretendimin sipas Nenit 1 të Protokollit 1 si dukshëm i pabazuar.

## Neni 6

Gjykata filloi duke theksuar se masat parandaluese, siç është konfiskimi, nuk presupozojnë ndonjë përcaktim të fajësisë, dhe prandaj procedurat që qeverisin zbatimin e tyre nuk ofrojnë të gjitha garancitë në dispozicion në procedura penale, dhe Neni 6 § 3 nuk ishte i aplikueshëm. Sidoqoftë, Gjykata theksoi se procedurat e konfiskimit ku përfshiheshin kërkuesit kishin të bënin me 'të drejtat dhe detyrimet e tyre civile' brenda kuptimit të paragrafit të parë të Nenit 6 dhe kështu Neni 6 § 1, sipas titullit të tij civil, ishte i aplikueshëm.

Duke pasur parasysh gjetjet e mëparshme sipas Nenit 1 të Protokollit 1, Gjykata e refuzoi ankesën sipas Nenit 6 si dukshëm të pabazuar, meqenëse procedurat e konfiskimit ishin zhvilluar në praninë e të dy palëve, e drejta e mbrojtjes ishte respektuar, dhe gjykatat vendase kishin dhënë arsye të plota për vendimet e tyre.

*Konfiskimi i detyrueshëm i një kamioni të përdorur për trafik droge shkeli Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës*

VENDIMI NË ÇËSHTJEN  
**B.K.M. LOJISTIK TASIMACILIK TICARET  
 LIMITED SIRKETI K. SLOVENISË**

(Kërkesa Nr. 42079/12)

**17th janar 2017**

### **1. Faktet kryesore**

Kompania kërkuese ishte biznes turk që vepronte nga një zyrë regjistrimi në Stamboll. Në nëntor të vitit 2008, zyrtarët doganorë sllovenë ndaluan dhe kontrolluan kamionin e kompanisë kërkuese. Aty gjetën paketa me përmbajtje të panjohur e cila, pas një testi paraprak, rezultoi se ishte heroinë. Të nesërmen, kamioni u inspektua nga policia, e cila gjeti 105 kilogramë heroinë. Shoferi u arrestua, dhe kamioni u konfiskua. Rimorkioja dhe mallrat e saj u bënë objekt i një procedure doganore.

Pak kohë më pas, kamioni iu kthye kompanisë kërkuese. Megjithatë, rimorkioja u konfiskua sipas Seksionit 186(5) të Kodit Penal të Sllovenisë, meqenëse ishte përdorur për të transportuar droga të paligjshme narkotike. Në dhjetor të vitit 2008, Gjykata e Rrethit Ptuj e gjeti shoferin fajtor për trafik droge dhe e dënoi me nëntë vite burgim. Ajo urdhëroi që kamioni t'i kthehej kompanisë kërkuese, meqenëse deklaroi se nuk ishin plotësuar kriteret për konfiskimin e pronës sipas Kodit Penal të Sllovenisë, sepse nuk kishte tregues që kompania kërkuese ishte në dijeni për transportin e materialeve ilegale.

Gjykata e Lartë në Maribor e përmbysi vendimin në maj 2009, dhe ky vendim u mbështet nga Gjykata Kushtetuese në shtator 2011. Gjykata Kushtetuese konfirmoi që Seksioni 186 i Kodit Penal të Sllovenisë parashikonte konfiskimin e detyrueshëm të automjeteve të përdorura për transportimin dhe depozitimin e drogave ose substancave ilegale në sport, pavarësisht nga pronësia. Sipas mendimit të Gjykatës, qëllimi i masës së kontestuar ishte të ndalohej kryerja e veprave penale të rënda në të ardhmen dhe mbrojtja e vlerave ligjore të rëndësishme për shoqërinë, siç janë shëndeti dhe jeta. Natyra e veprave penale në fjalë, mënyra se si ishin kryer dhe pasojat e tyre të gjitha justifikuan ndërhyrjen tek të drejtat pronësore të të gjithë pronarëve të mjeteve të transportit të përdorura për trafikun e drogës. Gjithashtu, u vu në dukje se pronari i dëmtuar kishte pasur mundësinë dhe të drejtën për të marrë kompensim nga personi përgjegjës për dëmin (në këtë rast, shoferi i kamionit).

Ndërkohë, Gjykata e Rrethit Ptuj e informoi kompaninë kërkuese që kamioni do të shitej në ankand publik. Qeveria pretendoi se kamioni iu shit kompanisë kërkuese në shumën 12,000 €, megjithatë kompania kërkuese e kontestoi atë deklaratë, duke pretenduar se kamionin e kishte blerë një kompani tjetër.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kompania kërkuese u ankua se konfiskimi i kamionit të saj përbëri ndërhyrje të paligjshme dhe joproporcionale tek pronat e saj sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Ajo diskutoi se, në gjykatat gjykatat vendase sllovene e zbatuan të drejtën vendase në mënyrë arbitrare, dhe konfiskimi nuk pati ndonjë interes publik.

### Neni 1 i Protokollit Nr. 1

Gjykata deklaroi se kishte shqyrtuar në disa raste çështje të dala nga masat konfiskuese të zbatuara në lidhje me posedime që ishin përdorur në mënyrë të paligjshme dhe kishin synuar parandalimin e përdorimit të mëtejshëm të paligjshëm të tyre. Në shumicën e rasteve ajo kishte gjetur se masa përbënte shembull të kontrollimit të përdorimit të pasurisë. Megjithatë, ajo theksoi se ato vendime kishin të bënin me kufizime të përkohshme mbi përdorimin e pasurisë dhe, në kontrast, në rastin konkret konfiskimi kishte të bënte me transferimin permanent të pronësisë dhe kompania kërkuese nuk kishte mundësi reale për rimarrjen e kamionit. Konfiskimi i një instrumenti të kryerjes së veprës penale nga një palë e tretë nuk përfshinte të njëjtën shkallë urgjence si konfiskimi i të ardhurave ose objekteve të një vepre penale, parë nga këndvështrimi i politikave në interes të përgjithshëm. Prandaj, në disa rrethana kjo mund të shqyrtohej sipas fjalisë së dytë në paragrafin e parë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 e cila mbulon privimin e pasurisë, dhe Gjykata konsideroi se kjo është qasja që duhet të ndërmerret në rastin konkret.

Më tej, Gjykata shqyrtoi nëse ndërhyrja tek të drejtat pronësore të kompanisë kërkuese ishte e justifikuar. Ajo theksoi se, në luftën kundër tregtisë ilegale të drogës, ajo ishte thellësisht e vetëdijshme për problemet që hasin Shtetet në përpjekjet e tyre për t'i bërë ballë dëmit të shkaktuar në shoqëritë e tyre nga furnizimi me drogë nga jashtë vendit, dhe pranoi se këtu mund të përfshihen edhe pasojat negative për pasuritë e personave të tretë.

Ndërkohë që palët nuk qenë dakord nëse masa ishte e parashikuar nga ligji, Gjykata vlerësoi se dispozitat e Seksionit 186(6) të Kodit Penal, lexuar në lidhje me Seksionin 73(3), e mbështeste konfiskimin. Gjykata po ashtu pranoi se ndërhyrja

synonte qëllimin legjitim të parandalimit të veprave lidhur me drogën, çka përbënte kërcënim real për shëndetin dhe jetën e individit – një qëllim i cili i shërbente interesit të përgjithshëm.

Më tej Gjykata shqyrtoi proporcionalitetin e masës. Kompania kërkuese kishte tentuar të rimerrte kamionin e saj, por gjykatat vendase e kishin interpretuar legjisllacionin përkatës vendas si të tillë që përcaktonte konfiskimin e detyrueshëm të çdo automjeti të përdorur për trafikimin e drogës, pavarësisht nga zelli dhe mirëbesimi i treguar nga pronari i tij. Kështu, megjithëse nuk kishte tregues se kompania kërkuese kishte qenë e përfshirë në kryerjen e veprës penale, ose që ajo kishte pasur dijeni për aktivitetet ilegale të shoferit të saj, ose që ajo kishte dështuar të kryente kontrollet e rregullta të automjetit, ajo nuk pati asnjë mundësi efektive për rikthimin e kamionit të saj.

Nuk kishte dyshim që mbrojtja e shëndetit dhe jetës njerëzore – bazat e cituara nga Qeveria si justifikim i masës – kërkonin veprim vendimtar nga ana e Shtetit për të reduktuar veprat penale të lidhura me drogë. Prandaj, konfiskimi i pronës së përdorur në kryerjen e veprave të tilla mund të vinte një barrë të konsiderueshme mbi palët e tretë të cilave u përkiste prona. Vënia e një barre të tillë mbi pronarin mund të justifikohet vetëm nëqoftëse interesi i tij në kthimin e pronës peshonte më pak sesa rreziku që kthimi i pronës do të mundësonte trafikun e drogës dhe të dëmtonte luftën kundër krimit të organizuar. Nuk dukej se kamioni ishte adaptuar për kontrabandimin e drogës, as nuk kishte ndonjë incident të mëparshëm të shkaktuar nga dështimi i kompanisë kërkuese për të parandaluar transportimin e dërgesave ilegale. Kjo, së bashku me faktin që shoferi i kamionit u shpall fajtor për trafikim droge dhe u dënua me nëntë vjet burgim, nuk lejoi të arrihej në përfundimin se kamioni mund të përdorej sërish për transportimin e substancave ilegale, dhe Gjykata nuk arriti të shihte se çfarë pasojash negative mund të rezultonin nga kthimi i kamionit tek pronari. Kjo ishte posaçërisht e vërtetë sikur, ashtu siç u diskutua nga Qeveria, kompania kërkuese të mund ta blinte kamionin në ankand publik.

Prandaj, pavarësisht nga hapësira e gjerë e vlerësimit, Gjykata nuk mundi të pranonte se natyra jodiskriminuese e masës në fjalë ishte e justifikuar nga rrethanat e çështjes aktuale. Për më tepër, mundësia për të marrë kompensim për dëme materiale duke ia kërkuar këto shoferit të dënuar për trafik droge, i cili ishte pala përgjegjëse për dëmin e pësuar nga kompania, përmbante edhe më shumë pasiguri sepse shoferi mund të ishte i falimentuar.

Kështu, konfiskimi i detyrueshëm i automjetit të kompanisë kërkuese, së bashku me mungesën e mundësisë reale për të marrë kompensim për humbjen, nuk i mori në

konsideratë sa duhej interesat e kompanisë kërkuese. Nuk u gjet ekuilibri i drejtë mes kritereve të interesit të përgjithshëm publik dhe të drejtës së kompanisë kërkuese për gëzimin paqësor të pasurisë, dhe barra që iu vu përsipër kompanisë kërkuese që e tepërt, në shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkueses 14,490 Euro në lidhje me dëme materiale dhe 7,000 Euro për kosto dhe shpenzime.



*Konfiskimi i pasurisë së kërkuesit, para të kaluara përmes një kufiri, nuk qe i bazuar në të drejtën vendase dhe prandaj përbëri shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **BAKLANOV k. RUSISË**

(Kërkesa Nr.68443/01)

**9 qershor 2005**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte shtetas letonez i lindur në vitin 1957, dhe jetonte në Riga. Në vitin 1997 ai vendosi të lëvizte nga Letonia në Rusi, dhe negocioi një marrëveshje për pronë të patundshme me një agjent në Moskë. Më 20 mars 1997, kërkuesi tërhoqi 250,000 \$ në para të thata dhe i kërkoi të njohurit të tij B. që t'i dorëzonte paratë në Moskë.

B. arriti në aeroport më vonë atë ditë. Meqenëse nuk i deklaroi paratë në pikën doganore, ai u akuzua për kontrabandë. Më 13 shtator 2000, Gjykata e Rrethit Golovinskiy e gjeti B. fajtor për kontrabandim sipas Nenit 188-1 të Kodit Penal të vitit 1996, dhe e dënoi me burgim me kusht për dy vjet. Paratë iu dorëzuan Thesarit si objekt i kontrabandës. Kërkuesi apeloj, duke argumentuar se nuk kishte asnjë ligj relevant që parashikonte konfiskimin e parave. Apeli u hodh poshtë.

Më 1 qershor 2002, një Zv/Kryetar i Gjykatës Supreme bëri një kërkesë për shqyrtim mbikqyrës të vendimeve. Ai pretendoi se paratë e kontrabanduara mund të konfiskohen vetëm nëqoftëse vërtetohet se janë përftuar në mënyrë kriminale. Gjykata e Qytetit në Moskë e refuzoi kërkesën mbi bazën se një Vendim i Gjykatës Supreme Plenare të Bashkimit Sovjetik i lëshuar në vitin 1978 e lejonte konfiskimin e mallrave të kontrabanduara.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi pretendoi se Gjykata e Rrethit Golovinskiy i kishte konfiskuar paratë e tij pa asnjë bazë ligjore, në shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

#### Neni 1 i Protokollit Nr.1

Gjykata theksoi se konfiskimi i parave të kërkuesit ishte ndërhyrje tek të drejtat e tij të pronës brenda kuptimit të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Çështja që duhet të

adresonte Gjykata ishte nëse ndërhyrja ishte e justifikuar në përputhje me kriteret e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

Gjykata vuri në dukje se Shtetet kishin të drejtë të kontrollonin përdorimin e pasurisë përmes zbatimit të ligjeve, por se kriteri i parë dhe më i rëndësishëm i Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 ishte se çdo ndërhyrje tek gëzimi paqësor i pasurisë nga një autoritet publik duhet të jete i ligjshëm – siç parashikohet në fjalinë e dytë të paragrafit të parë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

Për më tepër, Gjykata deklaroi se çështja nëse ishte vendosur një ekuilibër i drejtë mes interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe të drejtave individuale themelore bëhej relevante vetëm kur konstatohej se ndërhyrja në fjalë ishte e ligjshme dhe jo arbitrare. Gjykata theksoi se ligjshmëria kërkon që masat të jenë të bazuara në ligjet vendase, ku ato ligje duhet të jenë të sakta, të parashikueshme dhe në dispozicion të personave të përfshirë.

Në këtë rast, Gjykata theksoi se gjykatat kombëtare kishin dështuar që t'i referoheshin ndonjë dispozite ligjore si bazë për konfiskimin e një shume të rëndësishme parash. Megjithëse Kodi Penal i vitit 1960 qartazi parashikonte "konfiskimin e mallrave dhe sendeve të tjera të kaluara përmes kufirit", Kodi Penal i vitit 1996, i cili përbëri bazën për dënimin e B., nuk e parashikonte më një konfiskim të tillë. Për më tepër, Vendimi i Gjykatës Supreme tek i cili ishin mbështetur gjykatat vendase i ishte referuar legjislacionit të vitit 1960 dhe jo atij të vitit 1996. Kështu, Gjykata gjeti se ligji i aplikueshëm në fjalë nuk ishte hartuar me saktësi aq të mjaftueshme sa që t'i lejonte kërkuesit të parashikonte, me arsye brenda rrethanave, pasojat e veprimeve të tij.

Kështu, Gjykata gjeti se ndërhyrja tek pasuria e kërkuesit nuk kishte bazë në ligj, e rrjedhimisht përbënte shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

#### Neni 41

Kërkuesit iu caktuan 3,000 € për dëme jomateriale.

*Konfiskimi i asetëve të kërkuesve pas shfajësimit të tyre për pastrim parash nuk shkeli Nenin 1 të Protokollit Nr. 1*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **BALSAMO K. SAN MARINOS**

(Kërkesat Nr. 20319/17 dhe 21414/17)

**8 tetor 2019**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit ishin të lindur në vitet 1986 dhe 1985 respektivisht, dhe jetonin në Breshia të Italisë. Në një datë të paspecifikuar, kundër kërkuesve dhe babait të tyre filluan hetimet penale për pastrim parash. Sipas palës së akuzës, të akuzuarit kishin pastruar asete në vlerë 2,150,00 Euro.

Fillimisht, kërkuesit u gjetën fajtorë më 4 nëntor 2014. Gjykata vendase e shkallës së parë dënoi kërkuesin e parë me dy vjet e gjashtë muaj burgim dhe kërkuesin e dytë me një vit burgim. Të dy u gjositën me 5,000 Euro dhe u ndaluan për një vit e katër muaj nga mbajtja e posteve publike dhe ushtrimi i të drejtave politike. Gjyqtari, duke u mbështetur tek Neni 147 § 3 i Kodit Penal, konfiskoi shumat që ishin bastisur – 1,920,785.50 Euro. Përveç kësaj, gjyqtari autorizoi, për kërkuesin e parë, një konfiskim në barsvlerën 499,000 Euro, meqenëse para ekzekutimit të bastisjes ajo e kishte tërhequr këtë shumë nga llogaria e saj bankare.

Origjina kriminale e asetëve ishte dëshmuar nga një vendim i mëparshëm penal italian kundër babait të kërkuesve së bashku me elementet e tjera relevante. Në mënyrë të veçantë, gjyqtari citoi një pjesë të vendimit italian ku përshkruhej karriera kriminale e babait dhe dënimet e tij të mëparshme për zënka, shkaktim të lëndimeve personale, armëmbajtje, dhe, pas vitit 1975, për tregëti mallrash të vjedhura, vjedhje të shumëfishta, pronësi mbi asete të pajustificuara, dhe marrje me drogë.

Më 10 tetor 2016, Gjyqtari i Apeleve Penale (Giudice d'Appello Penale) i shpalli të dy kërkuesit të pafajshëm për mungesë provash që mund të demonstrojnë *mens rea*. Pavarësisht nga kjo, Gjykata e Apeleve Penale theksoi se shumata e depozituar në llogarinë bankare kishte origjinë kriminale në mungesë të shpjegimeve për origjinën e atyre parave. Gjyqtari e mbështeti konfiskimin e shumave që ishin konfiskuar.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan se konfiskimi kishte shkelur të drejtat e tyre sipas Nenit 7, Nenit 6 § 2, dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës. Më tej, ata u ankuan se nuk kishin pasur zgjidhje efektive siç kërkohet nga Neni 13.

### Neni 7

Gjykata së pari u desh të siguronte që Neni 7 ishte i aplikueshëm në rastin konkret. Ajo përsëriti se koncepti i “dënimit” në Nenin 7 ka kuptim autonom, dhe se Gjykata mund të shohë përtej aparenceve dhe të vlerësojë nëse një masë përbën dënim sipas Konventës. Pikënisja për këtë vlerësim përgjithësisht është nëse masa në fjalë është marrë në vijim të një vendimi që një person është fajtor për një veprë penale. Megjithatë, merren parasysh edhe faktorë të tjerë, si natyra dhe qëllimi i masës në fjalë; karakterizimi i saj sipas të drejtës kombëtare; procedurat e bërjes dhe implementimit të masës; dhe rreptësia e saj.

Konfiskimi në rastin konkret ndodhi pas liritimit të kërkuesve nga të gjitha akuzat penale. Megjithatë, mungesa e dënimit nuk mjafton për të hequr nga diskutimi zbatueshmërinë e Nenit 7.

Sa i përket natyrës dhe qëllimit të masës së konfiskimit, Gjykata konsideroi se masa nuk ishte ndëshkuese por parandaluese, meqenëse konfiskimi zbatohet edhe kur sendet nuk i përkasinin kryesit. E drejta vendase ishte dizajnuar për të parandaluar përdorimin e paligjshëm të fondeve publike dhe kryerjen e veprave të mëtejshme. Gjykata e Apeleve Penale kishte konstatuar se fondet kishin origjinë ilegale, dhe kërkuesit ishin në dijeni të kësaj. Rrjedhimisht kërkuesit mund të akuzoheshin për veprat e reja të pastrimit të parave nëqoftëse do t’i përdornin ose transferonin këto para. Prandaj nuk mund të thuhet se masa përfshinte qëllimin ndëshkues.

Fakti që konfiskimi ishte caktuar nga gjykata me juridiksion penal nuk ishte shkak për të arritur në përfundimin se ky dënim ishte tipar i zakonshëm i shumë juridiksioneve.

Në fund, sa i përket rreptësisë së masës, Gjykata përsëriti se ky faktor në vetvete nuk ishte vendimtar, meqenëse ka shumë masa jo-penale të natyrës preventive që mund të kenë impakt substancial mbi personin në fjalë. Konfiskimi nuk ishte masë që i takonte vetëm të drejtës penale sepse ai po ashtu përdorej në të drejtën administrative, dhe duhet të shihet në kontekst më të gjerë. Për shembull, Këshilli i Evropës ka lejuar

implementimin e masave serioze për parandalimin e pastrimit të parave, dhe në këto rrethana Gjykata konsideroi se masat preventive mund të jenë të nevojshme dhe të përshtatshme duke pasur parasysh interesat publike për të cilat bëhet fjalë.

Prandaj, masa në fjalë nuk qe “dënim” për qëllimet e Nenit 7, dhe Gjykata e gjeti ankesën të papranueshme.

#### Neni 6 § 2

Prezumimi i pafajësisë së kërkuesve nuk ishte shkelur nga thjesht dhënia e urdhrorit të konfiskimit, dhe ankesa u deklarua e papranueshme si dukshëm e pabazuar.

#### Neni 13

Gjykata vendosi që Neni 13 nuk ishte i aplikueshëm meqenëse ankesat nga Neni 7 dhe 6 § 2 nuk ishin gjetur të argumentueshme, dhe kjo ankesë u deklarua e papranueshme.

#### Neni 1 i Protokollit Nr . 1

Mbrojtja e pasurisë përmban tri rregulla: rregulla e parë, në fjalinë e parë të paragrafit të parë, është e natyrës së përgjithshme dhe thekson parimin e gëzimit paqësor të pasurisë; rregulla e dytë, në fjalinë e dytë të paragrafit të parë, mbulon privimin nga pasuria dhe cakton kushtet për këtë; rregulla e tretë, në paragrafin e dytë, njeh që Shtetet kanë të drejtë, mes të tjerash, që të kontrollojnë përdorimin e pasurisë në përputhje me interesin e përgjithshëm. Masa e konfiskimit në rastin konkret hynte brenda rregullës së tretë. Edhe pse konfiskimi nuk bazohej në dënimin penal, dhe as nuk ishte rezultat i procedurave të ndara “civile”, gjithsesi ai duhej parë si kontrollim i përdorimit të pasurisë.

Gjykatat kombëtare kanë detyrën të zgjidhin probleme të interpretimit dhe aplikimit të legjislacionit vendas, dhe Gjykata nuk gjeti asgjë arbitrare në faktin që gjykata vendase lexoi Nenin 147(2), i cili parashikonte konfiskimin, edhe në mungesë të dënimit, të çdo sendi që përbënte vepër. Nuk kishte dyshime në lidhje me qartësinë, precizionin ose parashikueshmërinë e asaj dispozite.

Gjykata mori në konsideratë praktikën gjyqësore më të vjetër në lidhje me procedurat për marrjen e pasurisë që ishte e lidhur me kryerjen e pretenduar të veprave të rënda. Në lidhje me pasurinë që presupozohet se është siguruar, qoftë

plotësisht apo pjesërisht, me të ardhurat nga veprat e drogës ose nga organizata penale të përfshira në trafik droge ose nga aktivitete të tjera ilegale të tipit mafioz, ajo pranoi se masat e konfiskimit ishin proporcionale, edhe në mungesë të një dënimi që konstatonte fajësinë e të akuzuarit.

Duke iu referuar standardit të provave që kërkohet nga gjykatat vendase për të marrë vendimin për konfiskim, Gjykata e gjeti legjitime që autoritetet relevante vendase i lëshuan urdhrat mbi bazën e mbizotërimit të provave, të cilat në rastin konkret sugjeronin se të ardhurat e ligjshme të kërkuesve nuk do të kishin mjaftuar që ata të siguronin pasurinë në fjalë. Kurdo që një urdhër konfiskimi ishte rezultat i procedurave civile të lidhura me të ardhurat nga krimet që ishin vepra të rënda, Gjykata nuk kërkonte prova “përtej dyshimit të arsyeshëm” për origjinën e tyre ilegale por prova të një ekuilibri të probabiliteteve ose një probabilitet të lartë të origjinës ilegale, kombinuar me pamundësinë e pronarit për të dëshmuar të kundërtën. Ishte e arsyeshme që kërkuesit duhet të shkarkonin pjesën e tyre të barrës së provës duke refuzuar dyshimet e vërtetuara të prokurorit për origjinat e gabueshme.

Më pas Gjykata mori shembuj të mekanizmave ligjore ndërkombëtare siç është Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit e vitit 2005, rekomandimet e Taskforcës së Aksionit Financiar dhe dy Konventat relevante të Këshillit të Evropës të viteve 1990 dhe 2005 në lidhje me konfiskimin e të ardhurave nga krimi në çështje të tjera. Më tej ajo vuri në dukje se ka disa standarde ligjore evropiane të përbashkëta e madje edhe universale të cilat inkurajojnë konfiskimin e pasurisë së lidhur me vepra penale të rënda pa ekzistencën e mëparshme të një dënimi penal. Barra e vërtetimit të origjinës së ligjshme të pasurisë së presupozuar si e përftuar në mënyra të gabueshme mund të zhvendoset në mënyrë legjitime për tek të paditurit në procedura të tilla jo-penale të konfiskimit, përfshirë edhe në procedura civile *in rem*. Fondet në fjalë, në rastin konkret, ishin gjetur nga gjykatat vendase se kishin origjinë ilegale, dhe gjatë procedurave, kërkuesve, të cilët kishin përfaqësues ligjor, u ishin ofruar mundësi të arsyeshme për të paraqitur argumentet e tyre para gjykatave vendase. Qëllimi i konfiskimit në rastin konkret ishte që këto fonde të eliminoreshin nga qarkullimi në ekonomi. Në këtë pikë, Gjykata përsëriti se Shtetet kanë hapësirë të gjerë vlerësimi në lidhje me atë se çka përbën mënyrë të përshtatshme të zbatimit të masave për kontrollimin e përdorimit të pasurisë, siç është konfiskimi i të gjitha llojeve të të ardhurave nga krimi.

Duke pasur parasysh hapësirën e gjerë të vlerësimit që kishin autoritetet dhe faktin që gjykatat vendase u dhanë kërkuesve mundësi të arsyeshme për të paraqitur argumentet e tyre, Gjykata doli në përfundimin se konfiskimi i asetëve të kërkuesve nuk përbëri shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

*Konfiskimi dhe marrja e avionit të kërkuesit sipas Rregullores së Bashkimit Evropian nuk përbëri shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1*

## VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN **BOSFOR AIRWAYS k. IRLANDËS**

(Kërkesa Nr. 45036/98)  
**30 qershor 2005**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte një kompani ajrore çarter e regjistruar në Turqi, Bosfor Airways. Në maj 1993, një avion i marrë me qira nga linja ajrore jugosllave Yugoslav Airlines (JAT) u kap nga autoritetet irlandeze gjatë kohës që ndodhej në Irlandë për mirëmbajtje, në përputhje me Rregulloren 990/93 të Këshillit të Komunitetit Evropian, e cila zbatonte regjimin e sanksioneve kundër Republikës Federale të Jugosllavisë.

Kërkuesi e kontestoi mbajtjen e avionit në qershor 1994 në Gjykatën e Lartë. Atje, u deklarua se rregullorja për marrjen e avionëve nuk ishte e aplikueshme. Megjithatë, Shteti apeloj dhe Gjykata Supreme bëri referim në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë (GjED)<sup>[156]</sup> në lidhje me çështjen nëse avioni ishte i mbuluar nga Rregullorja 990/93. GjED deklaroi se rregullorja në fakt e mbulonte avionin, e rrjedhimisht Gjykata Supreme aplikoi vendimin e GjED-së dhe apeli i Shtetit nuk qe i suksesshëm.

### 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi argumentoi se mënyra se si Irlanda e zbatoi regjimin e sanksioneve për të mbajtur avionin ishte ushtrim i shqyrtueshëm i diskrecionit brenda kuptimit të Nenit 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe shkelje e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

#### Neni 1

Nuk u vu në diskutim se akti për të cilin u ankua kompania kërkuese, mbajtja e avionit të dhënë me qira për një periudhë të caktuar kohore, u zbatua nga autoritetet e Shtetit të paditur në territorin e tij në vijim të një vendimi të marrë nga Ministri irlandez i Transportit. Në rrethana të tilla, kompania kërkuese, si e adresuara e aktit të

[156] Tani Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GjDBE)

kontestuar, hynte brenda “juridiksionit” të Shtetit irlandez, me pasojën që ankesa e saj rreth atij akti ishte në pajtueshmëri *ratione loci, personae* dhe *materiae* me dispozitat e Konventës.

### Neni 1 i Protokollit Nr.1

Gjykata gjeti se Rregullorja 990/93 e BE-së, me t’u miratuar, ishte përgjithësisht e aplikueshme dhe e detyrueshme në tërësinë e saj. Kështu, ajo u aplikohet të gjitha Shteteve Anëtare, ku asnjëri prej tyre nuk mund të distancohet ligjërisht nga cilado prej dispozitave të saj. Prandaj aplikueshmëria e saj e drejtpërdrejtë nuk mund të vihet në diskutim. Rregullorja u bë pjesë e të drejtës vendase irlandeze qysh nga 28 prilli 1993, kur u publikua në Gazetën Zyrtare, para datës së marrjes së avionit dhe pa nevojën e legjislacionit implementues.

Gjykata deklaroi se ishte e parashikueshme që Ministri për Transport do të implementonte fuqitë e mbajtjes të përmbajtura në Nenin 8 të Rregullores 990/93 të BE-së. Autoritetet irlandeze me të drejtë e konsideruan veten të obliguar që të mbajnë çdo avion që do të niset të cilit ato konsiderojnë se i aplikohet rregullorja. Vendimi i tyre që rregullorja ishte e aplikueshme u konfirmua më vonë nga GjED. Gjykata gjithashtu qe dakord me Qeverinë e Irlandës dhe me Komisionin Evropian që Gjykata Supreme e Irlandës nuk kishte diskrecion për të ushtruar. Kështu, ndërhyrja qe e ligjshme dhe përbëri veprim në pajtueshmëri nga ana e Shtetit irlandez në përputhje me detyrimet e tij ligjore që rridhnin nga e drejta KE-së<sup>[157]</sup>, dhe Rregullorja 990/93 e KE-së.

Gjatë shqyrtimit nëse mbajtja qe e justifikuar, Gjykata gjeti se mbrojtja e të drejtave themelore nga e drejta e KE-së do të mund të ishte konsideruar se ishte, dhe kishte qenë në kohën relevante, “e barasvlershme” me atë të sistemit të Konventës. Rrjedhimisht lindi prezumimi që Irlanda nuk ishte distancuar nga kriteret e Konventës kur kishte zbatuar detyrimet që rridhnin nga anëtarësia e saj në KE. Një prezumim i tillë mund të hidhej poshtë nëqoftëse, në një rast të veçantë, konsiderohej se mbrojtja e të drejtave të Konventës ishte dukshëm e mangët. Në raste të tilla, interesi i bashkëpunimit ndërkombëtar kishte më pak peshë sesa roli i Konventës si “instrument kushtetues i rendit publik evropian” në fushën e të drejtave të njeriut.

Më tej, Gjykata vuri në dukje natyrën e ndërhyrjes, interesin e përgjithshëm të synuar përmes mbajtjes së avionit, dhe regjimin e sanksioneve të konfirmuar nga

---

[157] Tani e drejta e Bashkimit Evropian (BE).



vendimi i GjED-së të cilin Gjykata Supreme që e detyruar ta ndiqte. Ajo konsideroi të qartë se nuk kishte keqfunksionim të mekanizmave të kontrollit në respektimin e të drejtave të Konventës. Prandaj, në rastin konkret nuk mund të thuhet se mbrojtja e të drejtave të Konventës për Bosfor Airways ishte dukshëm e mangët, dhe prezumimi i pajtueshmërisë me Konventën nuk ishte hedhur poshtë.

Veprimet e autoriteteve irlandeze nuk shkelën Nenin 1 të Protokollit Nr. 1.

*Konfiskimi i asetëve mbi bazën e presupozimit që ato ishin direkt apo indirekt të ardhura nga aktivitetet penale nuk qe shkelje e Nenet 1 të Protokollit Nr. 1 sepse kërkuesi e pati mundësinë që ta kontestonte atë presupozim, dhe Neni 6 § 2 nuk qe i aplikueshëm*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **BUTLER K. MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesa Nr. 41661/98)  
**27 qershor 2002**

### **1. Faktet kryesore**

Çështja kishte të bënte me konfiskimin nga bagazhi i një makine duke dalë nga Mbretëria e Bashkuar të 230,010 £ (afro 270,000 €) në para të thata mbi bazën e presupozimit që ishin direkt ose indirekt të ardhura nga trafikimi i drogës dhe/ose ishin të synuara për t'u përdorur për trafik droge. Sipas të drejtës relevante vendase, standardi i kërkuar i provës për marrjen e një urdhri për konfiskim ishte ekuilibri i probabiliteteve, dhe një urdhër i tillë mund të merrej pavarësisht nëse ndaj personit në fjalë ngriheshin apo jo akuza për një vepër të lidhur me paratë në fjalë.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi u ankua se ishte shkelur e drejta e tij për supozimin e pafajësisë sipas Nenet 6 § 2, meqenëse ai ishte detyruar të mbante barrën e provimit përtej dyshimit të arsyeshëm (standardi penal) se paratë në fjalë nuk kishin të bënin me trafik droge, dhe se prandaj procedura në fjalë ishte e natyrës 'penale' dhe duhet të ndërthente mbrojtjet e procesit penal. Më tej, kërkuesi u shpreh se urdhri e privoi atë nga gëzimi paqësor i pasurisë së tij sipas Nenet 1 të Protokollit 1.

#### Neni 6

Gjykata së pari vuri në dukje se akuza penale nuk ishin ngritur kundër kërkuesit, as kundër asnjë pale tjetër. Qe pohimi i kërkuesit se konfiskimi i parave të tij në realitet përfaqësonte një sanksion penal të rëndë, të bërë në mungesë të garancive procedurale që gëzonte ai sipas Nenet 6, në mënyrë të veçantë e drejta e tij për t'u supozuar i pafajshëm.

Megjithatë, sipas këndvështrimit të Gjykatës, urdhri i konfiskimit ishte masë preventive dhe nuk mund të krahasohej me sanksionet penale, meqenëse ishte i

dizajnuar për të nxjerrë jashtë qarkullimit paratë që presupozohej se ishin të lidhura me tregtinë ndërkombëtare të drogave të paligjshme. Kështu, procedurat që çuan deri te marrja e urdhrit nuk përfshinë “përcaktimin ... e një akuze penale”. Kërkuesi ishte mbështetur në vendimin e Gjykatës në çështjen *Phillips k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>[158]</sup>, megjithatë urdhri i konfiskimit i kontestuar në atë çështje vijoi pas ndjekjes penale, gjyqit dhe dënimit të kërkuesit për akuza të importit të një droge të paligjshme, dhe nuk i dha shkas përcaktimit të një akuze të re ose të ndarë kundër kërkuesit. Urdhri i konfiskimit në *Phillips* u gjet se ishte analog me një procedurë dënimi, për çka edhe tërhoqi aplikueshmërinë e Nenit 6, ndërkohë që rrethanat e çështjes aktuale ishin ndryshe.

Duke qenë se Neni 6 sipas titullit të tij penal nuk ishte i aplikueshëm, Gjykata e gjeti ankesën të papërputhshme *ratione materiae* me dispozitat e Konventës brenda kuptimit të Nenit 35 § 3, dhe ajo u deklarua e papranueshme.

#### Neni 1 i Protokollit Nr. 1

Gjykata vuri në dukje se marrja dhe konfiskimi i parave të kërkuesit qartazi përbënte ndërhyrje tek gëzimi paqësor i pasurisë së tij. Megjithatë, ndërkohë që theksoi se kërkuesi ishte privuar nga paratë e tij në mënyrë permanente përmes urdhrit të marrjes, ai urdhër ishte sjellë në përputhje me të drejtën vendase dhe në interes të përgjithshëm, në mënyrë të veçantë për të luftuar trafikun ndërkombëtar të drogës. Prandaj, konfiskimi përbëri kontroll të përdorimit të pasurisë në përputhje me interesin e përgjithshëm siç parashikon paragrafi i dytë i Nenit 1 të Protokollit 1.

Në mënyrë që ndërhyrja nga autoritetet tek të drejtat e kërkuesit të jetë e justifikuar, gjykatat vendase duhet që të kenë vendosur një ekuilibër të drejtë dhe proporcional mes interesave të përgjithshme të komunitetit për çrrënjosjen e trafikut të drogës dhe mbrojtjes së të drejtës themelore të një individi për gëzimin paqësor të pasurisë së tij. Gjykata theksoi se Shtetet gëzojnë hapësirë të gjerë vlerësimi në formulimin dhe implementimin e masave të politikave për luftimin e krimeve të rënda. Gjykata gjithashtu theksoi se kishte njohuri për vështirësitë e hasura nga Shtetet në përpjekjet e tyre për të luftuar dëmet e shkaktuara nga narkotikët e paligjshëm, dhe njohu se sanksionet e rrepta siç janë masat e konfiskimit ishin të justifikuar në lidhje me ato përpjekje. Më tej, Gjykata njohu se e drejta vendase u jepte fuqi të qarta dhe të definuara autoriteteve për të kapur dhe konfiskuar asetë. Për më tepër, çdo

[158] *Phillips k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 5 korrikut 2001, Nr. 41087/98 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

konfiskim i nënshtrohej këqyrjes gjyqësore, ku konkretisht një gjykatë vendase duhet të bindej se paratë e konfiskuara ishin të lidhura me trafikun e paligjshëm të drogës. Ajo po ashtu theksoi se kërkuesi, me ndihmën e avokatit, pati mundësi të kontestonte besueshmërinë e provave që mbështetën urdhrin në seancat dëgjimore, dhe në asnjë moment ai nuk u përball me presupozime kundërshtuese të fakteve apo ligjit.

Duke pasur parasysh këto konsiderata, Gjykata gjeti se urdhri i konfiskimit nuk përbëri ndërhyrje joproporcionale tek të drejtat pronësore të kërkuesit. Rrjedhimisht, ankesa ishte dukshëm e pabazuar, dhe u deklarua e papranueshme.

*Dënimi automatik i konfiskimit të pronave pa dënim penal pas mos-respektimit të rregulloreve rajonale për shfrytëzimin e tokës përbëri shkelje të Nenit 6 § 2, Nenit 7 dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1*

## VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN **G.I.E.M. S.R.L. DHE TË TJERË K. ITALISË**

(Kërkesat Nr. 1828/06, 34163/07 dhe 19029/11)

**28 qershor 2018**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesit ishin katër kompani me personalitet juridik dhe një drejtor i kompanisë së katërt (z. Gironda). Të gjitha kompanitë kërkuese kishin zyrat e tyre të regjistruara në Itali.

Autoritetet bashkiake miratuan planet për zhvillimin e zonës për prona komerciale në tokën në pronësi të katër kompanive në fjalë. Sipas ligjeve italiane të planifikimit, kur materializohet vepra e “zhvillimit të paligjshëm të zonës”, gjykata penale është e detyruar, pavarësisht nëse të pandehurit dënohen apo jo, që ta konfiskojë tokën e zhvilluar dhe të gjitha ndërtesat në të, edhe kur toka është në posedim të një pale të tretë (përveç rastit kur vërtetohet se është vepruar në mirëbesim). Ashtu siç ndodhi me kërkuesit aktualë, zhvilluesve dhe pronarëve mund t’u konfiskohet toka, edhe kur ata kanë marrë autorizimin e duhur për zhvillim nga bashkia përkatëse, në rast se plani zhvillimor është në konflikt me ligjet e rajonit të gjerë për shfrytëzimin e tokës.

### 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit parashtuan se konfiskimi ndëshkues i pronave të tyre pavarësisht nga mungesa e dënimit penal shkeli Nenin 7 të Konventës. Kërkuesit gjithashtu shtruan se konfiskimi nuk i shërbeu ndonjë interesi valid të Shtetit dhe ishte barrë e madhe joproporcionale, duke shkelur kështu Nenin 1 të Protokollit Nr. 1. Në fund, kërkuesit gjithashtu shtruan ankesa në bazë të Neneve 6 dhe 13.

#### Neni 7

Për të përcaktuar nëse pretendimi nga Neni 7 është i pranueshëm, Gjykata së pari duhet të përcaktojë nëse sjellja që i dha shkas ankesave përbëri “dënim” brenda kuptimit të përshkruar në Konventë. Gjykata përsëriti se “dënimi” ngërthen një

kuptim autonom – dënimi nuk është thjesht dënim sepse Shteti që e cakton kufizimin e përkufizon si të tillë, dhe Gjykata mbetet e lirë që ta vlerësojë vetë çështjen.

Pika fillestare në çdo vlerësim të ekzistencës së një “dënimi” është përcaktimi nëse masa në fjalë është caktuar në vijim të një vendimi që personi është fajtor për një vepër penale. Në rastin konkret, Gjykata ndoqi precedentin e analizës së vendosur në *Sud Fondi S.r.l. dhe Të Tjerë k. Italisë*<sup>[159]</sup> dhe pati qëndrimin që konfiskimi për zhvillimin e paligjshëm të zonës që iu vu kërkuesve mund të shihej si “dënim” brenda kuptimit të Nenit 7 të Konventës, pavarësisht nga fakti se nuk u shpall asnjë dënim penal ndaj kompanive kërkuese apo përfaqësuesve të tyre.

Natyra dhe qëllimi i konfiskimit ishte pengues dhe ndëshkues. Natyra penguese dhe ndëshkuese e konfiskimit u theksua nga Gjykata italiane e Kasacionit, e njohur për të paditurit gjatë procedurës dhe e provuar nga natyra e detyrueshme dhe automatike e konfiskimit, pavarësisht nga kërcënimi aktual që shkelja përbënte për ambientin, mbrojtja e të cilit ishte interesi i Shtetit të cilit qeveria pretendoi t’i shërbente duke përdorur konfiskimin. Më tej, Gjykata gjeti se karakterizimi kombëtar i konfiskimit tregonte se ai konsiderohej si dënim në nivel vendas. Seksioni i Kodit të Ndërtimit që qeveriste masën e konfiskimit në fjalë në rastin konkret titullohej “Sanksionet penale”. Përveç kësaj, konfiskimi i pronave të kërkuesve u autorizua proceduralisht nga gjykatat penale, jo nga ndonjë proces administrativ. Në fund, Gjykata theksoi se konfiskimi, i cili nuk iu aplikua vetëm tokës së zhvilluar por të gjitha pronave në tërësi, qe veçanërisht i rreptë dhe ndërhyrës.

Prandaj, masat e konfiskimit mund të shiheshin si “dënime” brenda kuptimit të Nenit 7 të Konventës, dhe pretendimi i kërkuesve sipas Nenit 7 ishte i papranueshëm.

Për të vlerësuar nëse Neni 7 është respektuar në rastin konkret, Gjykata shqyrtoi nëse masat e konfiskimit u kushtëzuan me ekzistencën e një elementi mendor, nëse masat mund të viheshin pa ndonjë dënim formal të mëparshëm dhe pa kompanitë si palë në procedurën në fjalë.

Gjykata përsëriti rëndësinë e parimit që veprat dhe dënimet duhet të jenë të parashikuara nga ligji dhe nga kriteret e parashikueshmërisë së efekteve të së drejtës penale. Kështu, një masë mund të shihet si dënim brenda kuptimit të Nenit 7 vetëm kur vërtetohen elemente të përgjegjësisë personale nga ana e kryesit. Gjykata gjeti se, në rastin konkret, Neni 7 kërkonte që masat e konfiskimit duhet të ishin

[159] Shih *Sud Fondi S.r.l. dhe Të tjerë k. Italisë*, vendim i 20 janarit 2009, Nr. 75909/01.

të parashikueshme për kërkuesit dhe përjashtonte çdo vendim për imponimin e atyre masave mbi kërkuesit në mungesë të një lidhjeje që tregonte ndonjë element përgjegjësie në sjelljen e tyre. Meqenëse rregullave që ishin shkelur u mungonte parashikueshmëria, i akuzuari kishte kryer një gabim të pashmangshëm dhe të falshëm, duke hequr nga diskutimi elementin mendor që duhej të konstatohej për realizimin e veprës, dhe shfajësimi i tyre ishte i justifikuar.

Gjatë analizës nëse masat mund të viheshin pa ndonjë dënim të mëparshëm, Gjykata interpretoi se Neni 7 kërkonte gjetjen e përgjegjësive nga një autoritet vendas para zbatimit të dënimit. Gjetja e përgjegjësive nuk duhet të vijë nga një gjykatë penale, ajo mund të bëhet nga një organ administrativ. Meqenëse kompanitë kërkuese nuk u ndoqën vetë penalisht, nuk kishte pasur një deklaram të mëparshëm të përgjegjësive së tyre. Megjithatë, kundër kërkuesit individual, z. Gironda, u hap procedurë dhe u konstatua akuza ndaj tij për zhvillim të paligjshëm të tokës. E vetmja arsye pse procedura u la mënjanë ishte për shkak të vjetërsimit të lëndës së tij.

Duke analizuar nëse masat mund të caktoheshin mbi kompanitë kërkuese, të cilat nuk ishin palë në procedura, Gjykata përsëriti se askush nuk mund të konsiderohet fajtor për një vepër penale apo një tjetër. Në rastin konkret, kompanitë, ku secila kishte personalitetin e vet ligjor, nuk ishin palë në asnjërën prej procedurave. Sipas ligjeve italiane, konfiskimi i pronave ishte sanksion i vendosur nga një gjykatë penale si pasojë automatike e gjetjes së veprës së zhvillimit të paligjshëm të një parcele të tokës. Megjithatë, nuk u bë asnjë dallim për situatën kur pronare e pronës ishte një kompani, e cila nuk mund të kryente vepër penale sipas ligjeve italiane. Kompanitë nuk ishin palë në procedura të asnjë lloji. Vetëm përfaqësuesit ligjorë dhe aksionerët e tri kompanive u akuzuan në cilësi personale. Kështu, autoritetet caktuan sanksione mbi kompanitë kërkuese për veprimet e palëve të treta, pra veprimet e përfaqësuesve të tyre ligjorë dhe/ose aksionerëve të tyre, përveç njërës prej kompanive.

Prandaj, Gjykata vendosi që kishte shkelje të Nenit 7 në lidhje me kompanitë kërkuese sepse ato nuk ishin palë në procedurat penale që rezultuan me urdhrat e konfiskimit. Megjithatë, nuk pati shkelje të Nenit 7 në lidhje me kërkuesin individual, z. Gironda, meqenëse gjetjet e gjykatave vendase në procedurën kundër tij mund të shiheshin, në thelb, si deklaram i përgjegjësive që plotësonin kriteret e këtij Neni, meqenëse procedura kundër tij përbëri vepër formale për zhvillim të paligjshëm të tokës dhe kjo procedurë u ndërpre vetëm sepse çështja e tij ishte vjetërsuar.

### Neni 1 i Protokollit Nr. 1

Gjykata konstatoi se paragrafi i dytë i Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 aplikohej në rastin konkret meqenëse ndërhyrja përbëri kontroll mbi shfrytëzimin e pronës. Një ndërhyrje e tillë tek të drejtat pronësore duhet të jetë e parashikuar me ligj dhe të synojë një qëllim legjitim. Duhet vendosur një ekuilibër i drejtë mes kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe interesit të individëve në fjalë. Shteti citoi mbrojtjen e mjedisit si qëllimin e tij parësor në konfiskimin e pronës së kërkuësve. Megjithatë, gjendja e pronave (të cilat kishin mbetur të riparuar, me pronarët që ende strehoheshin aty, etj.) bëri që Gjykata të vinte në pikëpyetje nëse konfiskimi i pronave faktikisht kishte kontribuar në mbrojtjen e mjedisit.

Më tej, Neni 1 i Protokollit Nr. 1 kërkon një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti mes mënyrave të përdorura dhe qëllimit të synuar; ekuilibri i drejtë prishet nëse personi i përfshirë duhet të bartë një barrë individuale dhe të tepërt. Faktorët në vijim mund të merren në konsideratë për të vlerësuar nëse konfiskimi ka qenë proporcional: mundësia e masave alternative më pak të shtrënguara si demolimi i ngrehinave që ishin në shpërputhje me rregulloret përkatëse, ose anulimi i planit zhvillimor; natyra e pakufishme e sanksionit, meqenëse ajo prekte si tokën e zhvilluar ashtu edhe tokën e pazhvilluar, e madje edhe zonat që i përkisnin palëve të treta; dhe shkalla e fajësisë ose neglizhencës nga ana e kërkuësve ose, më së paku, marrëdhënia mes sjelljes së tyre dhe veprës në fjalë. Përveç kësaj, megjithëse Neni 1 i Protokollit Nr. 1 nuk përmban kritere procedurale eksplicite, Gjykata ka njohur se procedurat gjyqësore në lidhje me të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së personit gjithashtu duhet t'u ofrojë individëve të prekur mundësi të arsyeshme për paraqitjen e argumenteve të tyre para autoriteteve kompetente me qëllim të kontestimit efektiv të masave që ndërhyjnë tek të drejtat e garantuara nga kjo dispozitë. Një mundësi e tillë nuk u vu në dispozicion të kërkuësve.

Në rastin konkret, Gjykata gjeti se konfiskimet kishin shkelur Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 për të gjithë kërkuësit për shkak të natyrës së tyre automatike dhe të barrës joproporcionale që kishin vënë mbi kërkuësit.

### Neni 6 § 1 dhe Neni 13

Nuk qe e nevojshme të shqyrtoheshin këto ankesa meqenëse ato u mbuluan nga ankesat tashmë të shqyrtuara sipas Nenit 7 të Konventës dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.



## Neni 6 § 2

Z. Gironda gjithashtu u ankua se parimi i prezumimit të pafajësisë ishte shkelur nga Gjykata e Kasacionit në vendimin e saj për urdhërimin e konfiskimit të tokës së tij edhe pse çështja kundër tij ishte ndërprerë për shkak të vjetërsimit të lëndës.

Një qëllim i përgjithshëm i parimit të prezumimit të pafajësisë është të mbrohen individët që janë shfajësuar nga një akuzë penale, ose në lidhje me të cilët procedura penale është ndërprerë, nga trajtimi prej zyrtarëve dhe autoriteteve publike si fajtorë për veprën e akuzuar. Në këtë rast, kërkuesi u shfajësua në apel dhe masa e konfiskimit u hoq pasi që plani zhvillimor u gjet se ishte në përputhje me planin për shfrytëzimin e tokës dhe rregulloret e planifikimit. Megjithatë, ai vendim më pas u prish nga Gjykata më e lartë e Kasacionit, e cila gjeti se përgjegjësia e kërkuesit ishte vërtetuar. Kështu, kërkuesi u deklarua fajtor, pavarësisht nga fakti se ndjekja e veprës në fjalë ishte vjetërsuar.

Gjykata vendosi që kjo seri veprimesh nga ana e Gjykatës së Kasacionit ishte shkelje e prezumimit të pafajësisë e rrjedhimisht shkelje e Neni 6 § 2.

## Neni 41

Aplikimi i Neni 41 të Konventës nuk qe gati për vendim meqenëse Shteti ende nuk e kishte adresuar kërkesën e palëve për shpërblim të drejtë. Kështu, Gjykata e rezervoi çështjen e shpërblimit të drejtë dhe ftoi palët të paraqisnin vërejtje me shkrim në lidhje me këtë pikë dhe ta informonin Gjykatën në lidhje me ndonjë marrëveshje që mund të arrijnë mes tyre.

*Urdhri i konfiskimit i zbatuar pavarësisht se subjekti i tij ishte shfajësuar nga krimi relevant shkeli prezumimin e pafajësisë të Nenit 6 § 2*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **GEERINGS K. HOLLANDËS**

(Kërkesa Nr. 30810/03)

**1 mars 2007**

### **1. Faktet kryesore**

Më 20 maj 1998, kërkuesi u dënua nga Gjykata Rajonale për akuza të shumta të vjedhjes, grabitjes, punës me mallra të vjedhura, dhe të qenit anëtar i një bande kriminale. Ai u dënua me pesë vjet burgim. Ky vendim më pas u rrëzua në apel, ku kërkuesi, në vend që të shpallej fajtor për disa vjedhje të ndryshme dhe të dënohej me 36 muaj burgim, u dënua me 12 muaj burgim me kusht për dy vjet. Në janar 1999, prokurori publik e ftoi kërkuesin që të paraqitej në Gjykatën Rajonale për t'u dëgjuar në lidhje me kërkesën e prokurorit që urdhri i konfiskimit të korrigohte avantazhin ilegal që ai kishte përfituar nga mallrat e vjedhura. Gjykata Rajonale lëshoi një urdhër konfiskimi në mars 1999, vendim i cili u apelua nga kërkuesi.

Në mars 2001, Gjykata e Apelit vendosi të lëshonte një urdhër konfiskimi në shumën 147,493 gulden holandeze (67,594 €) që do të zëvendësoheshin me 490 ditë paraburgim nëqoftëse nuk paguheshin. Urdhri i konfiskimit përfshinte përfitimet që kërkuesi do të kishte pasur për krimet për të cilat ishte akuzuar nga Gjykata Rajonale. Pavarësisht nga shfajësimi i tij për këto krime, Gjykata e Apelit e justifikoi vendimin e saj duke arritur në përfundimin se kishte tregues të fortë që ai në fakt i kishte kryer ato. Kërkuesit iu refuzua apeli nga Gjykata Supreme. Në vitin 2004 kërkuesi arriti një marrëveshje që i lejonte atij të paguante 10,000 € menjëherë dhe të shpagueante pjesën e mbetur në këste mujore në shumën 150 €.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi, duke u mbështetur në Nenin 6 § 2 të Konventës (prezumimi i pafajësisë), tha se urdhri i konfiskimit ishte i bazuar mbi akuzat për të cilat ai ishte shpallur i pafajshëm në procedurën penale, dhe prandaj kishte shkelur të drejtat e tij të Konventës.

## Neni 6 § 2

Gjykata theksoi se, ndërkohë që Neni 6 § 2 qeveris procedurat penale në tërësinë e tyre, e drejta për prezumim të pafajësisë lind vetëm në lidhje me veprën e caktuar për të cilën akuzohet një person. Kur personi vërtetohet fajtor për atë veprë, prezumimi i pafajësisë nuk i aplikohet më procesit të dënimit, përveç rastit kur procedurat e dënimit kanë të bëjnë me ngritjen e një akuze të re.

Çështja në fjalë ishte ndryshe nga çështjet e tjera që Gjykata kishte vendosur, në të cilat kërkuesit ishin dënuar për vepra dhe nuk kishin mundur të vërtetonin, brenda shkallës së probabiliteteve, financat në fjalë nuk ishin përftuar si rezultat i aktivitetit ilegal për të cilin ishin dënuar. Megjithëse kërkuesi ishte gjetur fajtor për disa vepra të caktuara, nuk ishte vërtetuar se ai kishte pasur në posedim ndonjërin prej pronave në fjalë. Gjykata e konsideroi konfiskimin e asetëve që nuk dihej ose nuk ishte vërtetuar të ishte në posedim të personit relevant si e papërshtatshme, sidomos nëqoftëse ai person nuk ishte gjetur fajtor. Nëqoftëse ishte përtej çdo dyshimi të arsyeshëm që personi relevant e kishte kryer në fakt krimin, dhe nëqoftëse nuk mund të vërtetohej se personi kishte përfituar avantazh nga aktiviteti ilegal, masa e konfiskimit mund të justifikohet vetëm me anë të një prezumimi të fajësisë, diçka që do të ndërhynte tek të drejtat e Konventës sipas Nenit 6 § 2.

Në rastin e kërkuesit, masa e konfiskimit ishte aplikuar pa u gjetur fajtor kërkuesi sipas ligjit. Prandaj, masa e konfiskimit përbëri përcaktim të fajësisë së kërkuesit në shkelje të Nenit 6 § 2.

## Neni 41

Gjykata e rezervoi çështjen e shpërblimit të drejtë, meqenëse nuk ishte e gatshme për vendim.

*Dështimi i autoritetit shtetëror për të vlerësuar proporcionalitetin gjatë përzënies së një blerëseje të mirëfilltë (bona fide) nga një apartament i përftuar përmes mashtrimit nga pronari i mëparshëm shkeli Nenin 1 të Protokollit Nr. 1*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **GLADYSHEVA K. RUSISË**

(Kërkesa Nr. 7097/10)

**6 dhjetor 2011**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesja ishte e lindur në vitin 1973. Më 28 shtator 2005, ajo bleu një apartament në Moskë dhe filloi të banonte aty me djalin e saj. Në kohën e vendimit përfundimtar të Gjykatës, ata të dy u përballën me përzënien e menjëhershme nga banesa. Apartamenti më parë kishte qenë në pronësi të Qytetit të Moskës, por ishte blerë nga Ye. – gruaja e supozuar e një pronari të vdekur, M., të cilit i ishte dhënë si banesë sociale – sipas një skeme privatizimi. Ye. më pas ia kishte shitur apartamentin një pale të tretë, V., e cila ia kishte shitur kërkueses.

Në vitin 2008, Departamenti Banesor i Moskës bëri padi kundër kërkueses dhe pronarit të mëparshëm të apartamentit, duke pretenduar se ai ishte përftuar në mënyrë mashtruese nga Ye., meqenëse ishte marrë vesh që Ye. në fakt nuk kishte qenë e martuar me M., dhe se pasaporta e saj, në të cilën ajo ishte mbështetur si provë identiteti, ishte deklaruar e humbur në vitin 1996.

Më 25 korrik 2008, Gjykata e Rrethit Cheryomushkinskiy të Moskës e rrëzoi pretendimin e autoriteteve dhe lejoi kundërpretendimin e kërkueses, duke e njohur këtë të fundit si pronarja legjitime e apartamentit. Gjykata deklaroi se kërkuesja e kishte blerë apartamentin në mirëbesim dhe kishte paguar çmimin e blerjes për të. Departamenti Banesor i Moskës e apeloj vendimin; rrjedhimisht, vendimi origjinal u prish dhe çështja iu rikthye Gjykatës së Rrethit.

Më 15 dhjetor 2008, filloi procedura penale kundër një kryesi të panjohur mbi bazën e mashtrimit në procesin e privatizimit të apartamentit. Më 9 korrik 2009, Gjykata e Rrethit gjeti se privatizimi i apartamentit nga Ye. kishte qenë mashtrues. U gjet se autoriteti i regjistrimit të akteve civile nuk kishte asnjë shënim për martesën mes M. dhe Ye., dhe se certifikata e martesës kishte qenë e rreme. Kështu, Ye. nuk kishte të drejtë të regjistrohej në adresën e M. e as ta privatizonte apartamentin

e tij. Në rastin e kërkuases, Gjykata e Rrethit gjeti se ajo ishte blerëse e mirëfilltë, megjithatë, meqenëse apartamenti ishte privatizuar në mënyrë mashtruese, Qyteti i Moskës ishte pronari i ligjshëm i apartamentit, dhe kishte hequr dorë nga interesi i tij në apartamentin pa e ditur. Gjykata e Rrethit urdhëroi përzënien e kërkuases pa kompensim ose ndonjë ofertë për strehim alternativ.

Më 14 dhjetor 2010, Zv/Prokurori i Përgjithshëm i kërkoi Gjykatës Supreme të shqyrtonte çështjen e kërkuases në procedurë rishikimi mbikqyrës. Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën, dhe refuzoi ta rikonsideronte çështjen. Ajo deklaroi se statusi i kërkuases si blerëse e mirëfilltë nuk ishte vënë në dyshim në asnjë moment, dhe se gjykatat më të ulëta kishin zbatuar ligjin duke pranuar pretendimet e ligjshme të paditësit. U theksua se kërkuësja ishte e lirë të bënte padi për dëmshpërblim. Urdhri i përzënies u azhornua dy herë, por ishte ende në fuqi në kohën e vendimit përfundimtar të Gjykatës.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuësja u ankua se ishte privuar nga posedimet e saj në shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Më tej, ajo diskutoi që përzënia nga banesa ishte shkelje e të drejtës së saj për respektimin e shtëpisë së saj në Nenin 8.

### Neni 1 i Protokollit Nr. 1

Në përgjigje të argumentit të Qeverisë që pretendimi ishte jashtë fushëveprimit të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, meqenëse kishte të bënte me një kontest të së drejtës private, Gjykata deklaroi se ishte e qartë nga procedurat vendase që pretendimi kundër kërkuases ishte ngritur nga Departamenti Banesor i Moskës – që ishte autoritet publik e jo palë private.

Gjykata përsëriti parimet e vendosura në strukturën e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 dhe mënyrën se si tri rregullat duhet të aplikohen. Për të qenë në pajtueshmëri me rregullën e përgjithshme të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, ndërhyrja duhet të jetë në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe të synojë një qëllim legjitim me mjete të arsyeshme proporcionale për qëllimin e synuar. Kështu, ndërhyrja tek gëzimi paqësor i pasurisë duhet të vendosë një ekuilibër të drejtë mes kritereve të interesit të përgjithshëm publik të komunitetit dhe kritereve të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit. Më tej, duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti mes mënyrave të përdorura dhe qëllimit të synuar nga çdo masë që privon personin nga posedimet e tij ose nga kontrollimi i përdorimit të tyre.

Për më tepër, Gjykata deklaroi se marrja e pronës pa pagesë të lidhur në masë të arsyeshme me vlerën e saj normalisht përbën ndërhyrje joproporcionale që nuk mund të justifikohet sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Megjithatë, kjo dispozitë nuk garanton të drejtën për kompensim të plotë në të gjitha rrethanat, meqenëse objektivat legjitime të interesit publik mund të kërkojnë rimbursim në shumë më të ulët sesa vlera e plotë e tregut.

Duke aplikuar këto parime në rastin konkret, Gjykata vuri në dukje e kërkuësja ishte njohur si pronarja e ligjshme e pronës nga Shteti (autoritetet e regjistrimit të pronave si dhe organet banesore dhe rezidenciale). Prandaj, kjo përbënte posedim për qëllimet e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

Për sa i përket çështjes së ekzistencës dhe natyrës së ndërhyrjes, Gjykata konfirmoi se çështja në fjalë hynte brenda rregullës së përgjithshme në fjalinë e parë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Gjykata përsëriti se ndërhyrja në pronë duhet të jetë e ligjshme dhe të synojë një qëllim legjitim, së bashku me përbushjen e kriterit të proporcionalitetit. Duhet të vihet një ekuilibër i drejtë mes kriterit të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kriterit të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit, dhe ky ekuilibër nuk mund të vendoset kur individit bart nja barrë të tepërt.

Gjykata deklaroi se i takonte Shtetit të definojë kushtet dhe procedurat sipas të cilave ai transferonte pronësinë e asetëve të tij personave që ai konsideronte kandidatë dhe të mbikqyrte plotësimin e atyre kushteve. Nuk ishte përgjegjësi e kërkuësës të merrte përsipër riskun e pronësisë së një prone të tërhequr për shkak të defekteve të cilat do të duhej të ishin zgjidhur gjatë procedurave specifike. Detyrimi për zgjidhjen e këtyre çështjeve bie mbi Shtetin, e jo në kurriz të individit. Kështu, shpronësimi i kërkuësës nga banesa e saj vendosi një barrë të tepërt individuale mbi të pa justifikim të mjaftueshëm që ishte në interes publik. Për më tepër, ishte e vështirë të shihej se si sugjerimi i Qeverisë që ajo ta përcillte këtë barrë të tepërt individuale tek V., një tjetër individ blerës i mirëfilltë, do të përmirësonte ekuilibrin mes interesit publik dhe nevojës për të mbrojtur të drejtat e individit. Nga ana tjetër, as nuk mund të pretendohet dëmshpërblim nga personat fajtorë për mashtrim meqenëse në procedurën penale nuk ishin identifikuar fajtorë, dhe shanset e identifikimit të tyre ishin thuajse joekzistente meqenëse dëshmitarët kryesorë, Ye. dhe bashkëshorti i saj i supozuar, kishin ndërruar jetë.

Duke pasur parasysh ato që u thanë më lart, Gjykata gjeti shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

## Neni 8

Gjykata përsëriti se kur lëshohet një urdhër përzierje ai përbën ndërhyrje tek e drejta për respektimin e shtëpisë, pavarësisht nëse ai urdhër është zbatuar ose jo. Konventa kërkon që ndërhyrja të jetë proporcionale me qëllimin legjitim të synuar, pra në këtë rast të drejtat e personave që jetonin me ndihma sociale, të cilëve mund t'u riallokohej apartamenti. Gjykata e pa me rëndësi të merrte parasysh se përfituesit e synuar të apartamentit në listën e rasteve sociale në pritje nuk mund të individualizoheshin mjaftueshëm në mënyrë që rrethanat e tyre personale balancoheshin kundrejt rrethanave të kërkuësës. Sidoqoftë, asnjë individ në listën e pritjes nuk do të kishte pasur të njëjtën lidhje ose interes të shtënë në atë apartament të veçantë – në krahasim me një apartament të ngjashëm – siç kishte kërkuësja. Ndërkaq, ajo nuk ishte as kandidatë për strehim zëvendësues, meqenëse Departamenti Banesor i Moskës nuk kishte treguar vullnetin për t'i ofruar asaj një zgjidhje banimi qoftë edhe të përkohshme, jo më permanente, kur të dilte nga banesa. Prandaj, Gjykata gjeti se autoritetet e kishin lënë komplet jashtë ekuacionit të drejtën e kërkuësës për respektimin e shtëpisë së saj gjatë ekuilibrit të kësaj me interesat e Qytetit të Moskës.

Bazuar mbi sa u tha më sipër, Gjykata gjeti shkelje të Nenit 8.

## Neni 41

Gjykata urdhëroi Rusinë që t'ia rikthente kërkuësës pronësinë e apartamentit të saj dhe të anulonte urdhrin e përzierjes së saj. Kërkuësës iu akorduan 9,000 € për dëme jomateriale dhe 11,254 € për kosto dhe shpenzime.

*Marrja e pasurisë së përftuar në mënyrë të gabuar e cila i përkiste një ish-ministri dhe familjarëve të tij të afërt si pjesë e masave vendase të anti-korrupsionit nuk që shkelje e Nenit 1 të Protokollit 1*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **GOGITIDZE DHE TË TJERË K. GJEOGJISË**

(Kërkesa Nr. 36862/05)

**12 maj 2015**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit ishin katër shtetas gjeorgjianë. Kërkuesi i dytë dhe i katërt ishin djemtë e kërkuesit të parë, dhe i treti ishte vëllai i tij.

Kërkuesi i parë ishte ish-ministër i qeverisë dhe mbante postin e Zëvendësministrit të Punëve të Brendshme të Adjarian dhe Kryetarit të Zyrës së Auditimit. Në vitin 2004, ai u akuzua për abuzim të autoritetit dhe për shtrëngim, dhe Prokuroria Publike nisi procedurën për konfiskimin e pasurisë së tij të përftuar në mënyrë të gabuar dhe të pashpjegueshme, siç lejohej me të drejtën vendase.

Prokuroria pretendoi se kishte baza të arsyeshme për të besuar se rroga që kërkuesi i parë kishte marrë për dy pozitat e mbajtura mes vitit 1994 dhe 2004 nuk kishin qenë të mjaftueshme për të financuar blerjen e pasurisë së përftuar gjatë kësaj periudhe. Prokuroria demonstroi se rrogat zyrtare të kërkuesit të parë kishin qenë 1,644 € dhe 6,023 € për dy pozitat, por pasuria e tij kishte vlerën 450,000 € - një shumë e vlerësuar nga dy auditorë të pavarur që bënë vlerësimin e pasurisë së kontestuar në vitin 2004.

Në shtator 2004, Gjykata Supreme e Adjarianit urdhëroi konfiskimin e gjashtë pronave që i përkisnin kërkuesve. Vetëm kërkuesi i dytë ishte paraqitur personalisht në gjykatë. Në janar të vitit 2005, pas një apeli të të gjithë kërkuesve, Gjykata Supreme e Gjeorgjisë ktheu njëzën pronë por i vazhdoi urdhrat e tjerë të konfiskimit.

Kërkuesi i parë bëri ankesë kushtetuese në dhjetor 2004. Ai u ankua që konfiskimi i pasurisë së tij dhe familjes së tij përbëri imponim të një dënimi penal pa konstatim përfundimtar të fajësisë, dhe që ai nuk duhet ta kishte bartur barrën e provës për vërtetimin e ligjshmërisë së pronave të kontestuara. Më tej, ai tha se ai dhe familja e tij i kishin blerë pronat në fjalë shumë kohë përpara amendamenteve në të drejtën



vendase të 13 shkurtit 204 që futën procedurën administrative të konfiskimit, dhe që aplikimi retroaktiv i atyre dispozitave në situatën e tij dhe të familjes së tij ishte jokushtetues.

Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se urdhri i konfiskimit i kishte shërbyer interesit publik të luftimit të korrupsionit, dhe se testi i proporcionalitetit ishte përmbushur gjatë procedurave të konfiskimit, të cilat ishin zhvilluar në mënyrë të drejtë para gjykatave vendase. Më tej, amendamenti i ri i ligjit nuk kishte futur ndonjë koncept të ri por thjesht kishte rregulluar në mënyrë më efektive masat ekzistuese që kishin për qëllim parandalimin dhe çrrënjosjen e korrupsionit në shërbimin publik. Kështu, ankesa e kërkuarit u deklarua e pabazuar dhe u rrëzua nga Gjykata Kushtetuese në korrik të vitit 2005.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuarit u ankuan se konfiskimi i pasurisë së tyre shkeli Nenin 1 të Protokollit 1, e drejta për gëzimin paqësor të pasurisë së tyre, në mënyrë të veçantë duke pasur parasysh se konfiskimi administrative kishte qenë arbitrar dhe se konfiskimi i pasurisë së tyre nuk kishte qenë masë provizore por akt i pakthyeshëm e rrjedhimisht i pajustificuar, dhe se procedurat vendase kishin shkelur të drejtën e tyre për gjyq të drejtë sipas Nenit 6 § 1 dhe 6 § 2.

### Neni 1 Protokollit 1

Gjykata filloi duke theksuar se konfiskimi i asetëve të tundshme dhe të patundshme të kërkuarëve kishte përbërë ndërhyrje tek e drejta e tyre për gëzimin paqësor të pasurive të tyre, brenda kuptimit të Nenit 1 të Protokollit 1. Më pas, Gjykata vazhdoi duke konfirmuar tri rregullat e Nenit 1 të Protokollit 1: parimi i gëzimit paqësor të pasurisë, kushtet për privimin e posedimeve, dhe të drejtën e Shteteve për të kontrolluar përdorimin e pasurisë në përputhje me interesin e përgjithshëm duke zbatuar ligjet që ato i vlerësojnë të nevojshme për atë qëllim. Kushtet esenciale që një ndërhyrje të vlerësohet në pajtueshmëri me Nenin 1 të Protokollit 1 ishin që ajo të jetë e ligjshme, t'i shërbejë një interesi legjitim publik ose të përgjithshëm, dhe të jetë proporcionale me qëllimin legjitim të synuar përmes vënies së ekuilibrit të drejtë mes interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe mbrojtjes së të drejtave individuale. Ekuilibri nuk do të gjendej nëqoftëse një individ ose disa individë do të bartnin barrë të tepërt.

U theksua nga Gjykata se marrja e pasurisë së kërkuarit ishte urdhëruar në përputhje me Kodin e aplikueshëm të Procedurës Penale dhe Kodin e Procedurës

Administrative. Më pas, Gjykata adresoi argumentin e kërkuarit që aplikimi retroaktiv i amendamentit legjislativ të 13 shkurtit 2004 ishte i paligjshëm, duke thënë se amendamenti rregullonte sërish disa pjesë të legjislacionit dhe standardeve ekzistuese për anti-korrupsion, dhe se ishte brenda aftësisë së Shteteve që të kontrollonin përdorimin e pasurisë në mënyrë retrospektive përmes dispozitave të reja që rregullonin situata faktike ose marrëdhënie ligjore në vazhdim e sipër. Kështu, marrja e pasurisë ishte në përputhje me kriterin e "ligjshmërisë" të përmbajtur në Nenin 1 të Protokollit 1.

Gjykata konsideroi që urdhri i konfiskimit ishte i justifikuar nga qëllimi legjitim i luftimit të korrupsionit dhe sigurimit që pasuria e përftuar nga kërkuari nuk i kishte mundësuar askujt ndonjë përfitim personal në dëm të komunitetit.

Më pas, Gjykata konsideroi nëse autoritetet kishin vënë ekuilibër të drejtë mes konfiskimit të aseteve të kërkuarve dhe të drejtës së tyre për pasuri. Gjykata theksoi se amendamenti i shkurtit 2004 i ndihmonte autoritetet në luftimin e korrupsionit, dhe ishte implementuar si reagim ndaj raporteve nga organet ndërkombëtare të cilat kishin nënvizuar nivelet e larta të korrupsionit në Gjeorgji. Shtetet gjithashtu kishin një hapësirë të gjerë vlerësimi në rastet e krimit dhe korrupsionit. Gjykatat vendase ndërmoren një shqyrtim të kujdesshëm të situatës financiare të kërkuarve e cila çoi në prova të një mospërputhjeje të konsiderueshme mes të ardhurave të tyre dhe pasurisë së tyre, duke çuar direkt në dhe duke justifikuar vendimin për konfiskim. Po ashtu, kërkuarit patën mundësinë që ta kontestonin në mënyrë efektive këtë vendim dhe të prezantonin prova për të mbështetur pretendimet e tyre. Prandaj nuk mund të thuhet se kërkuarve u ishin mohuar mundësitë e arsyeshme për të paraqitur argumentet e tyre ose që veprimet e gjykatave vendase kishin qenë arbitrare.

Kështu, Gjykata arriti në përfundimin se ishte vënë një ekuilibër i drejtë mes të drejtave të kërkuarve për pasuritë e tyre dhe interesit të përgjithshëm, dhe prandaj nuk kishte pasur shkelje të Nenit 1 të Protokollit 1.

## Neni 6

Gjykata i refuzoi ankesat e kërkuarve sipas Nenit 6 § 1 si dukshëm të pabazuara, meqenëse vetë kërkuarit kishin zgjedhur të hiqnin dorë nga e drejta e tyre për të marrë pjesë në procedura, dhe nuk ishte arbitrare të pritej që ata ta lëshonin barrën e tyre të provës duke kundërshtuar akuzat e prokurorit. Më tej, ankesa e kërkuarve sipas Nenit 6 § 2 nuk ishte e aplikueshme për konfiskimin e pasurisë që u urdhërua si rezultat i procedurave civile.

*Vënia e barrës së provës mbi të pandehurin për të kundërshtuar presupozimin që pasuria e tij ishte përftuar ilegalisht pasi ai ishte gjetur fajtor për trafik droge nuk shkeli Nenin 6*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **GRAYSON DHE BARNHAM k. MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesat Nr. 19955/05 dhe 15085/06)

**23 shtator 2008**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi i parë u dënua në janar 2002 për një vepër që përfshinte importimin e mbi 28 kg heroinë të pastër e cila kishte vlerën në shumicë 1.2 milionë £ (afro 1.4 milionë €). Ai u dënua me 22 vjet burgim. Në korrik 2002, pas shqyrtimit të parashtrimeve me shkrim dhe me gojë nga kërkuesi dhe prokuroria, gjyqtari mori një urdhër konfiskimi sipas Ligjit për Trafikimin e Drogës të vitit 1994. Gjatë marrjes së vendimit për shumën që do të konfiskohej, gjyqtari mori parasysh financat aktuale të kërkuesit, sipërmarrjet biznesore, dhe të gjitha rrethanat e çështjes. Gjyqtari që i bindur në supozimin se një dërgesë kaq e madhe nuk do të kishte qenë sipërmarrja e parë e kërkuesit në trafikun e drogës, dhe se ai e kishte financuar blerjen e kësaj dërgese me të ardhurat nga tregtia e mëparshme e drogës. Kërkuesi dështoi ta kundërshtonte këtë supozim. Gjyqtari po ashtu e konsideroi të drejtë të supozohej se paratë që kishte kërkuesi ishin të ardhura nga trafiku i drogës, dhe se kërkuesi kishte para edhe në vende të tjera të cilat nuk ishte i gatshëm t'i zbulonte. Gjyqtari arriti në përfundimin se kërkuesi kishte përfituar, dhe e caktoi urdhrin e konfiskimit në shumën 1,230,748 £ (afro 1,407,000 €), dhe caktoi një periudhë shtesë prej 10 vjet burgim nëqoftëse paratë nuk paguheshin brenda 12 muajve, duke gjetur se kërkuesi i parë kishte gënjyer në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë procedurës në lidhje me asetet e tij. Kërkuesi i parë e apeloj vendimin, por Gjykata e Apelit e rrëzoi apelin e tij duke deklaruar se provat shtesë të kontabilitetit që kërkuesi tentoi të paraqiste nuk i kundërshtuan argumentet e prokurorisë por në fakt i mbështetën në masë të madhe.

Kërkuesi i dytë u dënua për dy akuza të konspiracionit që përfshinin planet për të importuar dërgesa të mëdha të kanabisit në Mbretërinë e Bashkuar në korrik 2001. Megjithatë, asnjëri nga importet nuk qenë të suksesshme, ndërkohë që vendndodhja e drogës mbeti e panjohur. Gjatë gjyqit, kërkuesi u përshkrua si organizatori kryesor i një biznesi ndërkombëtar të trafikut të drogës, ku polici i fshehtë "Murray", i cili duke pozuar si pastrues parash kishte kontaktuar me kërkuesin, dha dëshmi. Murray deklaroi se kërkuesi kishte pritur të merrte një pagesë prej 12 milionë £ (afro 2.3

milionë €), dhe se pjesa e tij personale do të ishte 2 milionë £ (afro 2.3 milionë €). Kërkuesi u dënua me 11 vjet burgim.

Procedurat e konfiskimit filluan në janar 2002. Kërkuesi e pranoi që ai kishte përfituar nga trafikimi i drogës brenda kuptimit të Ligjit të vitit 1994. Gjyqtari i gjyqit vendosi që përfitimi total i kërkuesit shkonte deri në 1.5 milionë £ (afro 1.7 milionë €). Në prill 2002 gjyqtari rifilloi procedurën për vlerësimin e aseteve të realizueshme të kërkuesit. Kërkuesi dhe bashkëshortja e tij dhanë deklaratat ku dëshmuar se i vetmi aset i tyre ishte shtëpia e tyre në Spanjë, e cila ishte në pronësi të përbashkët. Gjyqtari gjeti se kërkuesi dhe bashkëshortja e tij kishin gënjyer në lidhje me aktivitetet e tyre dhe burimet e tyre të të ardhurave. Gjyqtari mori urdhër konfiskimi në shumën 1,525,615 £ (afro 1,744,000 €), me një dënim shtesë prej 5 vitesh burgim nëqoftëse kërkuesi nuk e paguante shumën brenda 18 muajve. Kërkuesi apeloj kundër vendimit, duke thënë se Neni 6 § 1 i Konventës i aplikohej vlerësimin të pronave të realizueshme, dhe se prokuroria nuk kishte dëshmuar se ai i posedonte asetet. Gjykata e Apelit gjeti që gjyqtari i gjyqit kishte bërë gabim në llogaritje, dhe e reduktoi urdhrin në shumën 1,460,615 £ (afro 1,669,000 €). Një apel drejtuar Dhomës së Lordëve u refuzua.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në Nenin 6 § 1 (e drejta për gjyq të drejtë) dhe në Nenin 1 të Protokollit 1 (mbrojtja e pronës), kërkuesit u ankuan se gjykatat vendase, gjatë marrjes së urdhrave të konfiskimit, kishte supozuar që ata kishin asete të fshehura përveç aseteve të cilat ishin konstatuar të ishin në pronësi të tyre.

### Neni 6

Kërkuesit deklaruan se barra e vënë mbi ta për të vërtetuar se prona e tyre e realizueshme ishte më pak sesa shuma e vlerësuar si përfitim i tyre nga trafiku i drogës kishte shkelur të drejtat e tyre për gjyq të drejtë sipas Neni 6 § 1. Duke iu referuar çështjes *Phillips k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>[160]</sup>, Gjykata përsëriti se marrja e një urdhri konfiskimi sipas Ligjit të vitit 1994 ishte analoge me një procedurë dënimi, dhe prandaj Neni 6 § 1 ishte i aplikueshëm.

Gjykata theksoi se, gjatë fazës së parë të procedurës sipas Ligjit të vitit 1994, ishte detyrë e prokurorisë që të konstatonte, brenda shkallës së probabilitetit, se paratë

[160] *Phillips k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 5 korrikut 2001, Nr. 41087/98 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

e shpenzuara ose të fituara gjatë gjashtë viteve përpara veprës ishin të ardhura nga trafikimi i drogës. Nëqoftëse kjo konstatohej, atëherë barra e provës i kalonte tek të pandehurit për të dëshmuar, përsëri brenda shkallës së probabilitetit, se paratë në fakt kishin ardhur nga burime legjitime.

Marrja e një urdhri konfiskimi sipas Ligjit të vitit 1994 ishte ndryshe nga caktimi i një dënimi pas shpalljes fajtor nga një gjykatë penale, sepse shkalla e rreptësisë së urdhrit varej nga gjetja e një benefiti nga sjellja e kaluar kriminale në lidhje me të cilin i pandehuri jo domosdoshmërisht ishte dënuar. Për këtë arsye, përveç se përmendet shprehimisht në Nenin 6 § 2, e drejta e një personi në një çështje penale për t'u prezumuar i pafajshëm dhe për të kërkuar që prokuroria të bartë barrën e dëshmimit të akuzave kundër tij formon një pjesë të nocionit të përgjithshëm të seancës së drejtë sipas Nenit 6 § 1. Megjithatë, e drejta për prezumimin e pafajësisë nuk është absolute, meqenëse prezumimet e faktit ose të ligjit operojnë në çdo sistem të drejtësisë penale.

Gjatë tërë procedurës së kërkuesit të parë dhe të dytë, të drejtat e mbrojtjes u mbrojtën përmes mbrojtjeve të ngërthyera brenda sistemit. Vlerësimi i shumës së përfituar nga kërkuesit gjatë trafikimit të drogës u zhvillua nga një gjykatë me një procedurë gjyqësore që përfshinte seancën dëgjimore publike, zbulimin paraprak të argumenteve të prokurorisë, dhe mundësinë që kërkuesit të paraqisnin prova gojore ose përmes dokumentacionit, dhe secili kërkues u përfaqësua nga një avokat i zgjedhur nga ai/ajo vetë. Gjykata nuk konsideroi se, në cilindo rast, ishte e papajtueshme me konceptin e gjyqit të drejtë sipas Nenit 6 që barra t'i vihej kërkuesit, pasi ai të ishte dënuar për një vepër të rëndë të trafikimit të drogës, për të konstatuar se burimi i parave ose asetëve që ai kishte treguar se posedonte gjatë viteve përpara se vepra të ishte legjitime. Duke pasur parasysh ekzistencën e mbrojtjeve gjatë procedurave, barra mbi të nuk e tejkaloi kufirin e arsyeshem.

Faza e dytë e procedurës kishte të bënte me llogaritjen e vlerës së asetëve të realizueshme momentalisht në dispozicion të kërkuesit. Në këtë fazë legjislativi nuk kërkonte që gjykata që shqipton dënimin të bënte ndonjë supozim në lidhje me aktivitetin kriminal në të kaluarën: përkundrazi, ajo u desh të bënte një vlerësim të mjeteve në dispozicion të kërkuesit në kohën e urdhrit, dhe në këtë pikë barra i ra kërkuesit që të konstatonte sipas standardit civil se shuma që mund të realizohej ishte më e vogël sesa shuma e vlerësuar si përfitim.

Të dy kërkuesit dhanë dëshmi me gojë në lidhje me asetet e realizueshme. Përsëri, ata e patën avantazhin e mbrojtjeve procedurale, patën përfaqësim ligjor, dhe u informuan saktësisht, përmes vendimeve të hollësishme të gjyqtarëve, se si ishte

llogaritur shuma e përfitimeve. Secili kërkues e pati mundësinë të shpjegonte situatën e vet financiare dhe të përshkruante se çfarë kishte ndodhur me asetet të cilat gjyqtari i kishte llogaritur për të vlerësuar shumën e përfitimeve. Në secilin rast, gjyqtari gjeti që provat e kërkuesit kishin qenë krejtësisht të pandershme dhe pa kredibilitet.

Gjykata gjeti se nuk ishte në papajtueshmëri me nocionin e seancës së drejtë në procedurë penale që secili kërkues të bartte barrën e dhënies së një dëshmie të besueshme për situatën e vet financiare. Në secilin rast, pasi që ishte vërtetuar përfshirja në trafikë të mëdha e marramendëse të drogës, nuk ishte e paarsyeshme të pritej që kërkuesit të shpjegonin se çfarë kishte ndodhur me të gjitha paratë që prokuroria kishte treguar se ata posedonin, po aq sa ishte e paarsyeshme që në fazën e parë të procedurës të pritej që ata të tregonin legjitimitetin e burimit të këtyre parave ose asetëve. Çështje të tilla hynin brenda njohurive specifike të kërkuesve, dhe barra mbi secilin prej tyre nuk do të kishte qenë e vështirë të përmbushej sikur deklarimet e tyre në lidhje me aspektet e tyre financiare do të kishin qenë të vërteta.

Prandaj, nuk kishte pasur shkelje të Nenit 6 § 1.

#### Neni 1 i Protokollit Nr. 1

Duke iu referuar përsëri gjetjeve të saj në çështjen *Phillips k. Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata nuk gjeti se kërkesa për të paguar para sipas urdhrit për konfiskim të marrë në përputhje me Nenin 6 § 1 përbëri ndërhyrje joproporcionale tek e drejta për gëzimin paqësor të pasurisë, e rrjedhimisht nuk kishte pasur shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

*Konfiskimi dhe gjoba e vënë ndaj kërkuesit për mos-deklarimin e një shume parash tek autoritetet doganore qe joproportional, në shkëlje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **GRIFHORST k. FRANCËS**

(Kërkesa Nr. 28336/02)

**26 shkurt 2009**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte shtetas i Holandës dhe jetonte në Andorra. Më 29 janar 1996, gjatë rrugës për në Francë nga Andorra, kërkuesi u ndalua nga oficerët e doganës franceze. Doganierët e pyetën dy herë nëse kishte para për të deklaruar, dhe kërkuesi u përgjigj se nuk kishte. Doganierët e kontrolluan kërkuesin dhe makinën e tij dhe gjetën 500,000 gulda holandeze në xhepat e tij, të barasvlershme me 233,056 euro. Ata ia konfiskuan komplet shumën. Kërkuesi më pas deklaroi se i kishte tërhequr paratë nga banka Krediti i Andorrës për të blerë një pronë në Amsterdam.

Autoritetet holandeze e informuan Departamentin Kombëtar të Shërbimeve Sekrete dhe Hetimeve Doganore se kërkuesi ishte i njohur për policinë holandeze për aktivitetet e tij që nga viti 1983 (për kërcënim, shtrëngim, rrëmbim dhe posedim të armës së zjarrit). Ata shtuan se aktiviteti i tij i vetëm i ditur momental kishte të bënte me prona të patundshme dhe se policia holandeze kishte dyshime se ai ishte duke e përdorur atë aktivitet si mbulesë për pastrim parash, por se nuk kishin arritur të gjendeshin prova konkrete. Në tetor 1998, Gjykata Penale e Perpignan e gjeti kërkuesin fajtor për mos-respektimin e detyrimit sipas Nenit 464 të Kodit Doganor për deklarimin e parave, letrave me vlerë ose sendeve të çmuara. Ai u dënua, sipas Nenit 465 të Kodit Doganor, me konfiskimin e shumës së plotë, plus me gjobë sa gjysma e shumës që ai dështoi të deklaronte (225,000 gulda holandeze, të barasvlershme me 116,828 euro). Vendimi u vërtetua në apel në mars 2001. Në janar 2002, Gjykata e Kasacionit e refuzoi apelin për shkak të pikave në ligj.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Duke u mbështetur në Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (mbrojtja e pronës), kërkuesi u ankuar se konfiskimi dhe gjoba përbënë dënim joproportional duke marrë parasysh natyrën e akuzës kundër tij.

### Neni 1 i Protokollit Nr.1

Mbrojtja e pronës, e përmbajtur në Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, përfshin tri rregulla: rregulla e parë, e përcaktuar në fjalinë e parë të paragrafit të parë, është e natyrës së përgjithshme dhe thekson parimin e gëzimit paqësor të pasurisë; rregulla e dytë, në fjalinë e dytë të paragrafit të parë, mbulon privimin e pasurisë dhe vendos kritere për këtë; rregulla e tretë, në paragrafin e dytë, njih faktin që Shtetet kanë të drejtë, mes të tjerash, të kontrollojnë përdorimin e pasurisë në përputhje me interesin e përgjithshëm. Qeveritë duhet të balancojnë të drejtën e tyre për të rregulluar pasurinë për interesin e përgjithshëm kundrejt të drejtës themelore të individit për respekt të pronës së tij.

Gjykata theksoi se në çështjen aktuale, gjoba prej 116828 Euro që iu vu kërkuesit hynte tek paragrafi i dytë i Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, kontrolli i pasurisë. Në lidhje me konfiskimin e parave që kërkuesi kishte me vete, në vlerë 233,056 Euro, Gjykata përsëriti qëndrimin e saj të përmendur në një çështje të mëparshme që, megjithëse çështja kishte të bënte me privimin e pasurisë, marrja e parave të kërkuesit sidoqoftë përbëri kontroll të pasurisë sipas rregullës së tretë, duke cituar çështje të lidhura me luftën kundër drogës, basteve, dhe organizatave të tipit mafioz.

Më tej, Gjykata konsideroi se ndërhyrja në fjalë ishte e parashikuar në ligjet franceze dhe ndiqte një qëllim legjitim në interesin publik, pra luftimin e pastrimit të të ardhurave nga trafiku i drogës. Ajo që e vetëdijshme për rëndësinë e kësaj çështjeje për Shtetet Kontraktuese, dhe theksoi që gjatë viteve një numër gjithnjë më i madh i instrumenteve ndërkombëtare, përfshirë konventat e OKB-së dhe të Këshillit të Evropës, i rekomandimeve të Taskforcës për Aksion Financiar dhe ligjeve të BE-së ishin konceptuar për marrjen e masave efektive për kontrollimin e rrjedhave ndërkufitare të kapitalit. Një prej këtyre masave ishte edhe kërkesa që njerëzit të deklaronin paratë kesh që kishin me vete gjatë kalimit të kufirit dhe dënimi i tyre kur nuk e bënin një gjë të tillë.

Sa i përket çështjes nëse autoritetet franceze kishin arritur ekuilibër të drejtë mes kritereve të interesit të përgjithshëm dhe kërkesës për mbrojtjen e të drejtave themelore të kërkuesit, Gjykata theksoi së pari se në dosje nuk kishte tregues që kërkuesi ishte gjykuar ose dënuar për pastrim parash. E vetmja vepër që dihej se kishte kryer ishte mos-deklarimi i qëllimshëm i parave që kishte me vete. Në parashtrimet e tyre para Gjykatës Penale, autoritetet doganore madje kishin pranuar që shuma që iu gjet atij kishte qenë në përputhje me pasurinë e tij personale.



Gjykata gjithashtu theksoi rreptësinë e dënimit që iu dha kërkuesit, pra konfiskimi i komplet shumës së parave që kishte pasur me vete dhe gjoba që ishte sa gjysma e asaj shume, që në total përbënë 349,584 Euro. Ajo vuri në dukje se në Shtete të tjera Anëtare të Këshillit të Evropës dënimi më i shpeshtë në raste të tilla ishte një gjobë dhe se lejohej vetëm konfiskimi i pjesës së shumës që e tejkalonte shumën e lejuar.

Më tej, Gjykata theksoi se autoritetet franceze e kishin ndryshuar Nenin 465 të Kodit Doganor në vitin 2004, i cili nuk parashikonte më konfiskimin automatik, ndaj gjoba ishte reduktuar në çerekun e shumës në fjalë. Po ashtu, ajo vuri në dukje se shumica e teksteve relevante ndërkombëtare ose të BE-së nënvizonin nevojën që dënimet e parashikuara nga Shtetet të ishin 'proporcionale'. Prandaj, Gjykata gjeti që dënimi i dhënë për kërkuesin kishte qenë joproporcional, në shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

#### Neni 41

Gjykata e rezervoi vendimin e saj në lidhje me dëmet materiale meqenëse nuk qe e gatshme për vendim.

*Mungesa e arsyeve në miratimin gjyqësor të bastisjes së shtëpisë së kërkuesve nuk i përmbushi kriteret e ligjshmërisë të ngërthyera në Nenin 8*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **GUTSANOV K. BULLGARISË**

(Kërkesa Nr. 34529/10)

**15 tetor 2013**

### **1. Faktet kryesore**

Katër kërkuesit ishin një politikan i njohur, gruaja e tij, dhe dy vajzat e tyre të mitura të lindura në vitin 2002 dhe vitin 2004. Autoritetet dyshuan se kërkuesi i parë ishte i përfshirë në një grup kriminal të akuzuar për abuzim me pushtetin dhe zhvatjen e fondeve publike. Para agimit, rreth orës 6:30 të mëngjesit, më 31 mars 2010, një skuadër speciale e cila përfshinte policë të armatosur dhe të maskuar, arriti në shtëpinë e kërkuesve. Një kujdestare u tregoi atyre që gruaja dhe vajzat ndodheshin në shtëpi. Pasi kërkuesi i parë nuk iu përgjigj urdhrin për të hapur derën, policët hynë me forcë. Shtëpia u kontrollua dhe aty u morën disa sende si prova. Sipas kërkuesve, policët e maskuar hynë në dhomën e gjumit ku prindërit i kishin futur fëmijët e tyre, dhe i kërcënuan ato me armë zjarri dhe drita të forta. Pasi i vunë prangat kërkuesit të parë, policët urdhëruan kërkuesen e dytë t'i mbulonte fëmijët me një mbulesë për të mos i lënë të bërtisnin dhe të qanin nga frika. Policët e kundërshtuan këtë deklaram, duke thënë se ata nuk hynë në dhomë për t'i vënë prangat kërkuesit të parë, nuk folën me kërkuesen e dytë, të tretë dhe të katërt, dhe hynë në dhomën e gjumit të armatosur vetëm me ngacmuesit elektrikë për të ndihmuar kërkuesin e parë që të vishej.

Kërkuesi i parë eventualisht u arrestua dhe u shoqërua nga shtëpia në ora 1:00 të natës, ku u filmua nga gazetarët dhe një ekip televizioni të cilët ishin mbledhur jashtë shtëpisë së tij. Në të njëjtën ditë u mbajt një konferencë shtypi gjatë së cilës prokurori shqiptoi akuzat që do të ngriheshin kundër individëve të arrestuar, përfshirë kërkuesin e parë, për veprimet e tyre si pjesë të një grupi kriminal. Në ora 10:55 një prokuror ngriti formalisht akuzën kundër kërkuesit të parë për vepra të ndryshme, dhe urdhëroi paraburgimin e tij për 72 orë për të siguruar praninë e tij në gjykatë. Më 1 prill, një gazetë publikoi fjalën e prokurorit së bashku me pjesë të shkëputura nga një intervistë me Ministrin e Brendshëm, gjatë së cilës ai iu referua afërsisë së kërkuesit të parë me një të dyshuar tjetër dhe përfshirjen e tyre në një "komplot". Më 3 prill 2010, një gjykatë e vendosi atë në paraburgim paragjyqësor mbi bazën e

rrezikut që ai mund të kryente vepra të tjera. Më 5 prill 2010, Kryeministri dha një intervistë të drejtpërdrejtë në lidhje me situatën aktuale, në fund të së cilës iu kërkua të komentonte rreth arrestimeve të fundit. ai përmendi afërsinë e kërkuesit me një të dyshuar tjetër si dhe “përfitimet materiale” të tyre.

Apeli i kërkuesit të parë kundër paraburgimit paragjyqësor të tij më 13 prill 2010 dhe një kërkesë e mëtejshme për lirim më 18 maj 2010 u refuzuan. Më 25 maj 2010, Gjykata e Apelit e vuri kërkuesin e parë në arrest shtëpiak, duke cekur se rreziku që ai të kryente vepra të tjera nuk ekzistonte më. Më 26 korrik 2010, gjykata vendosi ta lironte me dorëzani. Në kohën e vendimit të Gjykatës, kërkuesi i parë ishte ende nën akuzë penale.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan sipas Nenit 3 se ata i ishin nënshtruar trajtimit poshtërues gjatë operacionit policor në shtëpinë e tyre. Kërkuesi i parë më tej u ankua sipas Neneve 5 dhe 6 në lidhje me një sërë çështjesh, përfshirë faktin se ai nuk ishte sjellë menjëherë para një gjyqtari dhe se deklaratat e zyrtarëve publikë në shtyp kishin shkelur prezumimin e pafajësisë së tij. Sipas Nenit 8, kërkuesit deklaruan se bastisja e kryer në shtëpinë e tyre përbëri ndërhyrje të pajustificuar tek e drejta për respekt ndaj jetës shtëpiake dhe familjare të tyre, dhe sipas Nenit 13 ata nuk patën zgjidhje efektive.

### Neni 3

Operacioni i policisë u përcaktua nga Gjykata se kishte synuar qëllimin legjitim të zhvillimit të arrestimit dhe bastisjes në interesin e përgjithshëm të ndjekjes penale të veprave penale. Megjithatë, planifikimi dhe ekzekutimi i operacionit të policisë nuk mori parasysh disa faktorë të rëndësishëm, siç ishte natyra e veprave për të cilat akuzohej kërkuesi i parë, faktin që ai nuk kishte histori dhune, dhe prania e gruas dhe fëmijëve të tij të vegjël në shtëpi. Këto faktorë tregonin se përdorimi i agjentëve të armatosur dhe të maskuar dhe përdorimi i metodave si ardhja në shtëpi shumë herët në mëngjes ishin të tepërta e jo diçka që do të kishte qenë domosdoshmërisht e nevojshme për të kapur një të dyshuar dhe për të mbledhur prova. Katër kërkuesit i ishin nënshtruar një përvoje të hidhur psikologjike e cila kishte shkaktuar ndjenja frike, ankthi dhe pafuqie. Prandaj veprimet e policisë u vlerësuan nga Gjykata se kishin përbërë trajtim poshtërues për qëllimet e Nenit 3, dhe përbënë shkelje të atij Neni.

## Neni 5

### *Neni 5(3) – dalja para gjyqtarit*

Kërkuesi i parë u paraburgos pa gjyq për tri ditë dhe gjashtë orë, por atij nuk iu kërkua të merrte pjesë në ndonjë masë hetimore pas ditës së parë. Ai nuk u dyshua për përfshirje në ndonjë aktivitet të dhunshëm dhe ishte në gjendje psikologjike delikate gjatë fazave fillestare të paraburgimit, pas trajtimit poshtërues që kishte vuajtur gjatë operacionit të policisë, i cili ishte rënduar nga fama e tij e keqe publike. Pavarësisht nga kjo famë e keqe, ai gjithashtu u paraburgos në të njëjtin qytet ku ndodhej gjykata, dhe nuk pati ndonjë masë sigurie të jashtëzakonshme. Këto elemente bënë që Gjykata të gjente shkelje të kriterit të Nenit 5 për paraqitje të menjëhershme para një gjyqtari.

### *Neni 5(3) – kohëzgjatja e paraburgimit*

Kërkuesi i parë u paraburgos për një periudhë prej 118 ditësh (31 maj deri më 30 qershor 2010), prej të cilave dy muaj ishte në arrest shtëpiak. Vendimet e gjykatave vendase për ta mbajtur atë në paraburgim u bazuan në rrezikun që ai mund të kryente ndonjë vepër tjetër, në mënyrë të veçantë ndërhyrja tek provat. Megjithatë, më 25 maj 2010 Gjykata e Apelit vendosi që, pas dorëheqjes së kërkuesit nga posti i tij, ky rrezik kishte kaluar. Por prapë se prapë, në kundërshtim me detyrimet e saj sipas të drejtës vendase, e njëjta gjykatë e vuri kërkuesin në arrest shtëpiak pa dhënë ndonjë arsye të veçantë për ta justifikuar këtë vendim. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet kishin dështuar në detyrimin e tyre për të ofruar arsye konkrete dhe të mjaftueshme për paraburgimin e kërkuesit të parë pas 25 majit 2010, dhe prandaj kishin shkelur Nenin 5(3).

### *Neni 5(5) – kompensimi*

Ligji për Përgjegjësinë e Shtetit nuk i ofronte kërkuesit zgjidhje efektive për dëmet që ai kishte pësuar gjatë paraburgimit, meqenëse kjo kërkonte gjetje formale nga një gjykatë vendase që paraburgimi i tij kishte qenë i paligjshëm. Meqenëse procedura kundër kërkuesit ende vazhdonte, paraburgimi i tij vazhdoi të konsiderohej i ligjshëm nga gjykatat vendase, dhe prandaj Ligji për Përgjegjësinë e Shtetit nuk aplikohet. Duke qenë se nuk ekzistonte ndonjë dispozitë tjetër vendore për kompensim, Gjykata gjeti se kishte pasur shkelje të Nenit 5(5).

## Neni 6

Gjykata shqyrtoi pretendimet e kërkuesit të parë që zyrtarë të ndryshëm publikë kishin shkelur të drejtën e tij për prezumim të pafajësisë. Pas mos-gjetjes së shkeljes në lidhje me intervistën e Kryeministrit dhe deklaratën për shtyp të prokurorit, Gjykata vazhdoi me shqyrtimin e implikimeve të intervistës së Ministrit të Brendshëm, gjatë së cilës ai deklaroi se “ajo që kishin bërë [kërkuesi i parë dhe një i dyshuar tjetër] përfaqëson një komplot të ndërlikuar gjatë një periudhe disa-vjeçare”. Gjykata dalloi natyrën e intervistës, që kishte të bënte ekskluzivisht me operacionin policor, nga fjalët spontane të Kryeministrit disa ditë më vonë. Përveç kësaj, fakti që ky fjalim u publikua të nesërmen e arrestimit të kërkuesit të parë, dhe para paraqitjes së kërkuesit të parë në gjykatë, nga një zyrtar i lartë publik i cili në këto rrethana do të duhej të kishte qenë i kujdesshëm për të shmangur konfuzionin, ishte domethënëse. Fjalët e Ministrit të Brendshëm ishin më shumë sesa një komunikim i thjeshtë informacionesh, dhe ato sugjerorin se kërkuesi i parë ishte fajtor. Prandaj kishte pasur shkelje të Nenit 6(2). Në fund, gjyqtari që refuzoi kërkesën për lirim më 18 maj 2010 deklaroi se gjykata e tij “mban pikëpamjen se është kryer një vepër penale dhe se i akuzuari ka qenë i përfshirë”. Kjo frazë ishte më shumë se një përshkrim i thjeshtë i dyshimit, ajo ishte deklarim i fajësisë së kërkuesit përpara se të ishte marrë ndonjë vendim në lidhje me themelet e çështjes. Për pasojë, edhe kjo shkeli Nenin 6(2).

## Neni 8

Gjykata theksoi se bastisja në fjalë ishte e bazuar në dispozita legjislative që nuk përbënin problem në lidhje me qasshmërinë dhe parashikueshmërinë e tyre për qëllime të bastisjes si një veprim që është “në përputhje me ligjin”. Sa i përket kriterit të fundit cilësor që duhet përmbushur nga ligjet vendase, pra pajtueshmëria me shtetin e së drejtës, Gjykata kujtoi se në kontekstin e kontrolleve dhe bastisjeve kërkohej që e drejta vendase të ofronte garanci të përshtatshme kundër arbitraritetit. Në rastin konkret, bastisja e shtëpisë së kërkuesve u zhvillua pa autorizimin paraprak të një gjyqtari. Një bastisje e tillë u lejua me kusht që një gjykatë ta shqyrtonte bastisjen në mënyrë retroaktive për të siguruar se ajo i kishte plotësuar disa kushte të caktuara materiale dhe procedurale. Në këtë rast, gjyqtari në fjalë megjithatë nuk dha arsye për aprovimin e tij – ai thjesht e kishte firmosur dhe vulosur procesverbalin me fjalën “aprovuar”. Si rezultat, Gjykata konsideroi se ai nuk kishte treguar kontroll efektiv mbi ligjshmërinë dhe nevojshmërinë e bastisjes. Andaj, ndërhyrja tek e drejta për respektim të shtëpisë nuk qe “e parashikuar me ligj” dhe prandaj shkeli Nenin 8.

### Neni 13 në kombinim me Nenet 3 dhe 8

Në të drejtën vendase nuk ekzistonte asnjë zgjidhje efektive me të cilën kërkuesit mund të shfrytëzonin të drejtën e tyre për të mos iu nënshtruar trajtimit në kundërshtim me Nenin 3 dhe të drejtën për respektim të shtëpisë së tyre sipas Nenet 8. Prandaj u gjet shkelje e Nenet 13 në kombinim me këto dy Nene.

### Neni 41

Një shumë e përbashkët prej 40,000 € iu caktua kërkuesve si shpërblim i drejtë dhe 4,281 € për kosto dhe shpenzime.

*Mangësitë në procedurë treguan se bastisja dhe konfiskimi i kryer në zyrën e kërkuesit, avokat, shkelën Nenin 8*

VENDIMI NË ÇËSHTJEN  
**ILIYA STEFANOV K. BULLGARISË**

(Kërkesa Nr. 65755/01)

**22 maj 2008**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte avokat, dhe kishte qenë anëtar i dhomës së avokatisë në Sofje që nga viti 1994. Në nëntor të vitit 2000, një person z. R.S. bëri ankesë në policinë e Sofjes duke pretenduar se ishte rrëmbyer nga persona që punonin për ish-punëdhënësin e tij, MIG Group AD. Një punonjës i kompanisë, z. K.G., e kishte kërcënuar atë dhe familjen e tij me dhunë për shkak se ai nuk i kishte paguar paratë që ishin borxh i kompanisë. Rrëmbyesit më pas e kishin çuar atë në zyrën e kërkuesit, avokat i MIG Group AD, ku ai ishte detyruar me forcë të firmoste premtime me shkrim për të paguar para, si dhe një kontratë për të dorëzuar makinën e tij. Të gjitha këto dokumente u supozua se ishin hartuar nga kërkuesi.

Policia e Sofjes për rrjedhojë hapi hetimet penale në lidhje me pretendimet për shtrëngim dhe ftoi z. K.G. dhe dy individë të tjerë për t'i marrë në pyetje. Pasi u informua për arrestimin e z. K.G., kërkuesi shkoi në stacionin e policisë për të ofruar ndihmë rreth orës 2:00 të pasdites më 29 nëntor 2000. Policia e futi atë në një dhomë ku ai mund të shihte njerëzit e tjerë që silleshin aty për t'u marrë në pyetje, dhe, edhe pse nuk ishte lëshuar urdhër arrestimi për të, ai nuk u lejua të largohej. Policia vendosi të paraburgoste z. K.G. dhe dy individët e tjerë për 24 orë. Atë mbrëmje në ora 6:30, polici i autorizuar për hetimet e intervistoi kërkuesin si dëshmitar. Kërkuesi deklaroi se nuk e kishte parë z. R.S. në datën në fjalë dhe mohoi pretendimet se z. R.S. ishte detyruar me forcë të firmoste dokumente në zyrën e tij. Ai gjithashtu tha se z. K.G. ishte klient i tij, dhe se ai kishte një kompjuter në zyrën e tij. Atë natë, policia e mbylli me vulë derën e zyrës së kërkuesit. Kërkuesi pretendoi se pas kësaj celulari i tij u përgjua, ku Qeveria deklaroi se nuk kishte prova të dokumentuara që sugjeronin se kjo kishte ndodhur.

Të nesërmen, zyrtari përgjegjës për çështjen bëri kërkesë pranë Gjykatës së Rrethit të Sofjes për një urdhër bastisjeje për zyrën e kërkuesit. Gjyqtari e lëshoi urdhrin, duke deklaruar se kishte prova të mjaftueshme që në atë zyrë mund të kishte

prova relevante për çështjen. Atë mbrëmje policia mori kompjuterin e kërkuesit, monitorin, printerin dhe sende të tjera, si dokumente dhe disketa. Bastisja u krye në praninë e dy dëshmitarëve të cilët firmosën inventarin e bastisjes së policisë. Vetë kërkuesi arriti në zyrën e tij pasi kishte filluar bastisja dhe depozitoi një kundërshtim formal për ligjshmërinë e bastisjes.

Në dhjetor 2000, polici përgjegjës për hetimet u informua se gjatë bastisjes nuk ishin gjetur dosje në lidhje me çështjen. Pas kësaj kërkuesi kërkoi që t'i ktheheshin sendet. Në shkurt 2001, Prokuroria vendosi t'i pezullonte hetimet, duke deklaruar se nuk ishte përcaktuar identiteti i kryesit. Ajo gjithashtu urdhëroi që sendet e kërkuesit t'i ktheheshin atij. Kërkesa e kërkuesit për informacione në lidhje me përgjimin e telefonit të tij u la e pashqyrtuar.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua sipas Nenit 8 (e drejta për jetën private dhe familjare) që bastisja dhe konfiskimi në zyrën e tij kishin qenë të paligjshme dhe që policia kishte përgjuar telefonin e tij. Ai gjithashtu u ankua sipas Nenit 3 (ndalimi i torturës) dhe Nenit 5 (e drejta për liri dhe siguri) që bastisja e zyrës së tij përbëri trajtim poshtërues dhe se ai u privua paligjshëm nga liria e tij në stacionin e policisë. Më tej, ai u ankua sipas Nenit 6 (e drejta për proces të rregullt) se ai nuk pati qasje në gjykatë kompetente për të vendosur në lidhje me akuzat penale kundër tij, dhe sipas Nenit 13 se nuk pati qasje në zgjidhje.

### Neni 8

Bastisja dhe konfiskimi i sendeve nga zyra e kërkuesit përbëri ndërhyrje tek të drejtat e kërkuesit nga Neni 8. Kjo do t'i jepte shkas një shkeljeje nëqoftëse nuk mund të tregohet se veprimet e autoriteteve ishin zhvilluar në përputhje me ligjin, kishin synuar një qëllim legjitim, dhe kishin qenë të nevojshme në një shoqëri demokratike. Në rastin konkret, bastisja u zhvillua mbi bazën e një urdhri gjyqësor. Gjykata gjithashtu theksoi se policia e kërkoi urdhrin vetëm pasi mori deklaratat nga dëshmitarët dhe viktima në lidhje me veprën e pretenduar. Informacionet e mbledhura nga deklaratat i dhanë shkas besimit se shtrëngimi mund të kishte ndodhur në zyrën e kërkuesit. Megjithatë, vetë urdhri qe shumë i gjerë dhe nuk specifikoi se çfarë sendesh dhe dokumentesh pritej të gjendeshin në zyrën e kërkuesit. Urdhri gjithashtu nuk përmendte nëse prej aty duhet të merrreshin materiale të privileguara. Gjykata gjeti se urdhri u hartua në terma më të gjera se duhej, kështu që nuk arriti të minimizonte ndërhyrjen tek të drejtat e kërkuesit nga Neni 8 dhe tek sekretësia e tij profesionale. Gjykata po ashtu theksoi se gjerësia e tepërt e urdhrin u reflektua edhe



në mënyrën se si ai u ekzekutua, kur policia mori krejt kompjuterin e kërkuesit dhe sende të tjera që gjeti në zyrë. Kompjuteri u mbajt për më shumë se dy muaj, gjë që duhet të ketë pasur impakt negativ në punën e kërkuesit. Bastisja u krye në praninë e dy dëshmitarëve certifikues, megjithatë këto dëshmitarë ishin fqinjë dhe ligjërisht nuk ishin të kualifikuar. Kjo i zvogëloi shumë gjasat që ata të mund të identifikonin se cilat materiale mbuloheshin nga privilegji ligjor profesional, dhe kështu që nuk mund të kishin ofruar mbrojtje efektive kundër ndërhyrjes së tepërt nga ana e policisë. Gjykata gjithashtu nënvizoi se, sipas ligjeve bullgare, kërkuesi nuk pati mënyra për të kontestuar ligjshmërinë e urdhrat ose të ekzekutimit të tij. Për pasojë, Gjykata gjeti se bastisja dhe konfiskimi qenë joproporcionale dhe shkelën Nenin 8.

Në lidhje me përgjimin e telefonit, ankesa e kërkuesit iu referua masave të vëzhgimit që u pretendua se ishin zbatuar ndaj tij. Gjykata duhet të bindej se kishte gjasa të arsyeshme që këto masa ishin zbatuar. Në këtë rast, i vetmi element që mund të sugjeronte se kishte pasur përgjime ishte pretendimi i kërkuesit që mbrëmjen e 29 nëntorit 2000 kishte pasur çrregullime në linjën e tij telefonike. Megjithatë, çrregullimet nuk ishin domosdoshmërisht prova të përgjimit. Mohimi kategorik nga Qeveria për vëzhgime të fshehta dhe mungesa e dokumenteve lidhur me përgjime i sugjeruan Gjykatës se nuk ishte konstatuar që kishte pasur ndërhyrje tek të drejtat e kërkuesit nga Neni 8. Ankesa u refuzua si dukshëm e pabazuar.

### Neni 3

Për të pasur shkelje të Nenit 3, trajtimi i kërkuesit duhet të kishte arritur një shkallë minimale rreptësie; ku vuajtja dhe poshtërimi do të kishin shkuar përtej asaj që është e pashmangshme në trajtimin legjitim. Në këtë rast Gjykata gjeti se, ndërkohë që bastisja dhe konfiskimi mund të kenë cenuar reputacionin profesional të kërkuesit, ishte e qartë se ato ishin nën shkallën minimale të rreptësisë që kërkohet për shkeljen e Nenit 3. Ankesa u refuzua si dukshëm e pabazuar.

### Neni 5

Neni 5 mund të aplikohet për privim të lirisë që zgjat vetëm për një periudhë shumë të shkurtër. Megjithatë, Gjykata theksoi se në këtë rast ajo nuk kishte nevojë ta trajtonte këtë pikë, meqenëse ajo ishte bindur se privimi i lirisë që i justifikuar. Arrestimi dhe paraburgimi ishin të parashikuara me ligj, dhe Gjykata nuk konsideroi që autoritetet, duke mbajtur kërkuesin për një periudhë prej pesë orësh me qëllim të marrjes së deklaratës së tij, kishin shkelur ekuilibrin e arsyeshëm mes nevojës për ta marrë atë në pyetje dhe të drejtës së tij për liri. Ankesa u refuzua si dukshëm e pabazuar.

### Neni 6

Procedurat penale nuk e patën asnjëherë objekt kërkuesin, dhe ndaj tij nuk u ngrit asnjë akuzë penale. Ngjashëm, lëshimi i urdhrit të bastisjes nuk shkaktoi ngritjen e akuzave penale ndaj tij. Si rezultat, procedurat ku kërkuesi qe direkt i përfshirë nuk hynë brenda fushëveprimit të Nenit 6. Ankesa u refuzua dhe u deklarua e papranueshme.

### Neni 13

Duke u mbështetur tek Neni 13, kërkuesi u ankua se ai nuk kishte pasur zgjidhje efektive për ankesat e tij sipas Neneve 3, 5, 6 dhe 8. Ankesat e tij sipas tre neneve të para u refuzuan si dukshëm të pabazuara. Në lidhje me Nenin 8 Gjykata theksoi se e drejta bullgare nuk e lejonte kërkuesin të kontestonte ligjshmërinë e bastisjes dhe konfiskimit, e as të merrte zgjidhje sikur ato të kishin qenë të paligjshme. Prandaj, pati shkelje të Nenit 13 në lidhje me ankesën sipas Nenit 8.

### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuesit 1,000 Euro për dëme jomateriale.

*Konfiskimi i detyrueshëm i pronave si dënim penal përbëri shkelje të të drejtave pronësore të kërkuesit sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **MARKUS K. LETONISË**

(Kërkesa Nr.17483/10)

**11 qershor 2020**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte shtetas letonez i lindur në vitin 1953, që jetonte në Riga. Në vitin 2008 ai u dënua për kërkimin dhe tentimin e marrjes së rryshfetit në shumën 80,000 lata letoneze (afro 114,000 Euro), gjatë kohës që kryesonte një institucion arsimor, në kundërshtim me Seksionin 320(2) të Ligjit Penal të Letonisë. Ai u dënua me katër vjet burgim, me një dënim shtesë që ishte konfiskimi i pronës. Megjithatë, për shkak se sipas të drejtës vendase letoneze masa e shqiptuar i aplikohet tërësisë së pasurisë së një personi të dënuar, prona specifike për konfiskim nuk u specifikua.

Në vitin 2010, kërkuesi bëri disa ankesa kushtetuese duke kontestuar kushtetutshmërinë e Seksionit 320(2) të Ligjit Penal. Ai kontestoi natyrën joproporcionale të dënimit, duke argumentuar se urdhri i konfiskimit mund të prekte edhe djalin e tij të rritur, palë e tretë, meqenëse një prej pronave të konfiskuara ishte një shtëpi e regjistruar në emrin e kërkuesit por e përdorur nga djali i tij i rritur me familjen e tij. Përveç kësaj, kërkuesi argumentoi se konfiskimi i detyrueshëm i një prone ishte në kundërshtim me ndalimin e diskriminimit, të drejtën për gjyq të drejtë, dhe të drejtën e pronës, siç garantohen nga Kushtetuta e Letonisë.

Gjykata Kushtetuese filloi procedurën në lidhje me të drejtën e pronës, por refuzoi të fillonte procedurën në lidhje me ndalimin e diskriminimit ose të drejtën për gjyq të drejtë. Në janar 2011, Gjykata Kushtetuese i ndërpreu procedurat, duke tërhequr vëmendjen e Parlamentit ndaj faktit se kishte “mangësi serioze” në rregullativën ligjore për caktimin dhe ekzekutimin e konfiskimit të pronës si dënim, duke theksuar se ligji nuk specifikonte se cilat prona nuk mund të konfiskoheshin, dhe kështu masa mund të shkelte të drejtat e familjarëve të personit të dënuar. Megjithatë, sipas Nenit 105 të Kushtetutës, një mbrojtje e tillë për palët e treta nuk mbulonte pronat e përfuara ilegalisht.

Më tej, Gjykata Kushtetuese gjeti se dënimi me konfiskim nuk ishte shpronësim por ndërhyrje tek të drejtat e pronësisë. Kjo nënkuptonte se ndërhyrja ishte në përputhje me

ligjin, meqenëse Seksioni 320(2) i Ligjit Penal ishte miratuar duke përdorur procedurën korrekte dhe u shërbente qëllimeve legjitime të mbrojtjes së demokracisë, sigurisë publike dhe të drejtave të të tjerëve. Megjithëse Gjykata Kushtetuese vuri në dukje se një mënyrë alternative për t'i arritur ato qëllime do të ishte përmirësimi i legjislacionit në lidhje me konfiskimin e pasurisë së përfutur ilegalisht, thjesht ekzistenca e atyre masave alternative nuk nënkuptonte se legjislatura e kishte tejkaluar hapësirën e vlerësimit.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi argumentoi se, sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, dënimi penal me konfiskim të pronës i cili kishte çuar në marrjen e pronës së tij të përfutur në mënyrë të ligjshme, kishte qenë joproporcional. Më tej, ai theksoi se konfiskimi i pronës në shumicën e rasteve kishte efekt mbi jetën e personave të tjerë (në këtë rast tek djali i tij i rritur dhe prindërit e tij me aftësi të kufizuara), kështu që sanksioni ishte vënë jo vetëm mbi personin penalisht fajtor por edhe mbi palët e treta.

### Neni 1 i Protokollit Nr. 1

Gjykata së pari vuri në dukje se Neni 1 i Protokollit Nr. 1 përmban tri rregulla që saktësojnë parimin e gëzimit paqësor të pasurisë, rregullimin e privimit nga pasuria, dhe njohjen e të drejtës së Shtetit për të kontrolluar përdorimin e pasurisë. Në këtë rast, Gjykata theksoi se rregulla e tretë ishte e aplikueshme, meqenëse dënimi kishte të bënte me konfiskimin e përgjithshëm të pasurisë së tij që u vendos për kërkuesin. Megjithëse gjykatat vendase nuk identifikuan pronën specifike objekt të konfiskimit, në realitet dhjetë nga njëmbëdhjetë prona iu nënshtruan kufizimit të pronësisë gjatë procedurës paragjyqësore. Pronësia e tetë prej atyre pronave më pas iu transferua Shtetit. Gjykata më tej nënvizoi se nuk ishin paraqitur prova që sugjeronin se ato prona kishin ndonjë lidhje tjetër me krimin. Rrjedhimisht, dënimi penal me konfiskimin e pasurisë përbëri ndërhyrje tek e drejta e kërkuesit për pronën.

Në lidhje me argumentin e kërkuesit që konfiskimi i detyrueshëm penal kishte qenë joproporcional, Gjykata theksoi argumentin e Qeverisë që formulimi i të drejtës vendase dukej se lejonte që konfiskimi i pasurisë t'i drejtohej një pjese të pasurisë së personit të dënuar.

Sidoqoftë, Gjykata përmendi gjetjet e Gjykatës Kushtetuese, e cila doli në përfundimin se kishte pasiguri dhe praktikë gjyqësore kontradiktore në lidhje me aftësinë e trupit gjykues për të përcaktuar shkallën e konfiskimit të pasurisë. Trupat gjyqësorë shpesh konsideronin që kompetenca e tyre ishte e limituar me urdhërimin

e konfiskimit të pasurisë së personit në tërësi, dhe procedonin në këtë mënyrë edhe kur rezultati mund të ishte konsideruar joproporcional. Kështu, meqenëse rregullorja linte një pasiguri të tillë rreth fushëveprimit të kompetencës së trupit gjykues, Gjykata nuk mund të shqyrtonte masën e parashikueshme ose masën që mund të ofronte mbrojtje kundër arbitraritetit.

Në lidhje me natyrën detyruese të dënimit, në linjë me praktikën gjyqësore të mëparshme, Gjykata tha se konfiskimi i detyrueshëm i pasurisë e privoi kërkuesin nga çdo mundësi për të paraqitur argumentet e tij për secilën pronë dhe nga çdo perspektivë suksesi. Më tej, fushëveprimi i saktë i dënimit të përcaktuar në fazën paragyqësore të procedurës nuk mund të shihej si i tillë që i lejonte individit mundësi të arsyeshme për të paraqitur argumentet e tij para autoriteteve kompetente.

Duke pasur parasysh fushëveprimin e shqyrtimit të zhvilluar nga gjykatat vendase, Gjykata vuri në dukje se nuk kishte një vlerësim të individualizuar të dënimit me konfiskim të pasurisë të dhënë ndaj kërkuesit. Në vendimet e gjykatave vendase që dënuan kërkuesin, analiza e proporcionalitetit kishte të bënte vetëm me privimin e tij nga liria, dhe nuk adresoi dënimin shtesë me konfiskim të pasurisë. Gjykatat vendase nuk e kishin specifikuar në asnjë moment pasurinë e saktë që duhej konfiskuar, dhe prandaj shkalla e dënimit nuk u identifikua në vendimet vendase. Nga ana tjetër, gjykatat vendase nuk analizuan në asnjë moment as çështjen nëse shuma e pasurisë për konfiskim ishte në përputhje me peshën e veprës, ose nëse kjo impononte një barrë të tepërt mbi kërkuesin.

Kështu, Gjykata konsideroi që Seksioni 320(2) i Ligjit Penal e kufizonte fushëveprimin e shqyrtimit të zhvilluar nga gjykatat vendase deri në atë masë sa ishte tepër i ngushtë për të përmbushur kriterin e “ekuilibrit të drejtë” të ngërthyer në Nenin 1 të Protokollit Nr. 1. Ai nuk i lejoi kërkuesit mundësi të arsyeshme për të paraqitur argumentet e tij para autoriteteve kompetente.

Prandaj, Gjykata doli në përfundimin se rregullativës vendase i mungonte qartësia dhe parashikueshmëria, ajo nuk ofronte mbrojtjet e nevojshme procedurale, dhe nuk ofronte mbrojtje kundër arbitraritetit. Si rezultat, Gjykata vendosi që kishte pasur shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

#### Neni 41

Kërkuesi nuk bëri kërkesë për shpërblim të drejtë, andaj Gjykata nuk mori vendim për dëmshpërblim.

*Zyrtari kroat nuk u nxit për të kryer korrupsion, megjithatë të drejtat e tij të mbrojtjes sipas Nenit 6 qenë të kufizuara për shkak të mungesës së procedurës efektive për përcaktimin e zbulimit të provave të mbledhura nga vëzhgimi sekret*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **MATANOVIĆ K. KROACISË**

(Kërkesa Nr. 2742/12)

**4 prill 2017**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1949, dhe në kohën e vendimit të Gjykatës ishte duke vuajtur dënimin në burgun e Lepogravës në Kroaci. Ai kishte qenë zv/kryetar i Fondit Kroat të Privatizimit, një entitet ligjor i ngritur nga Shteti, dhe kishte pasur detyrën e privatizimit të pronave publike. Më 3 prill 2007, J.K., përfaqësues i një projekti investimesh, raportoi në Prokurorinë e Shtetit që kërkuesi kishte kërkuar mito për të siguruar realizimin e projektit të tij. Pas kësaj, Prokuroria e Shtetit i kërkoi Gjykatës Krahinore të Zagrebit që të autorizonte masa të veçanta hetimore në lidhje me kërkuesit, konkretisht përgjimin e telefonit të tij, vëzhgim të fshehtë, dhe përdorimin e J.K. si informator në një operacion blerjeje të simuluar. Kërkesa u autorizua në të njëjtën ditë, ku urdhri përfshinte frazën statutores "që hetimet nuk [mund të] zhvilloheshin me mënyra të tjera ose që do të ishte tejet e vështirë [të veprohej kështu]". Gjatë hetimeve, gjyqtari hetues lëshoi një sërë urdhrash të tjerë për këtë qëllim.

Mes kërkuesit dhe J.K. u zhvilluan takime të ndryshme, përfshirë një takim ku J.K. i dha kërkuesit 50,000 € në lidhje me projektin e tij të investimeve. Në qershor 2007, gjyqtari hetues urdhëroi përfundimin e masave të veçanta hetimore. Pas kësaj, kërkuesi u arrestua dhe u paraburgos. Akuza kundër tij u shpall në shkurt 2008.

Në maj 2009, Gjykata Krahinore e Zagrebit gjeti se kërkuesi, në cilësinë e tij si zyrtar publik, kishte marrë mito, kishte lehtësuar mitmarrjen, dhe kishte abuzuar pushtetin dhe autoritetin e tij në lidhje me disa projekte investimi dhe privatizimi. Ai u dënua me njëmbëdhjetë vjet burgim. Gjykata u mbështet gjerësisht mbi incizimet e vëzhgimeve të fshehta dhe në mënyrë të veçantë tek ato të takimit të parë të organizuar pasi J.K. kishte pranuar të ishte informator. Në atë takim, kërkuesi i kishte shpjeguar J.K. se sa ishte shuma e pritur e pagesës dhe se pagesa për lobim ishte praktikë e zakonshme.

Kërkuesi bëri apel në Gjykatën Supreme, e cila e vërtetoi dënimin për akuzat e mitmarrjes dhe abuzimit të pushtetit dhe autoritetit. Pas një ankese kushtetuese, Gjykata Kushtetuese gjeti në qershor 2011 shkelje të së drejtës së kërkuesit për prezumim të pafajësisë, por i rrëzoi ankesat e tjera të tij.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua që rekursi i autoriteteve vendase në vëzhgimin e fshehtë kishte qenë në shkelje të Nenit 8 (e drejta për respektim të jetës private dhe familjare). Më tej, ai pretendoi se ishte futur në kurth dhe se mos-zbulimi dhe përdorimi i provave të përftuara përmes masave të veçanta hetimore kundër tij kishin qenë në kundërshtim me Nenin 6 (e drejta për proces të rregullt). Kërkuesi gjithashtu u ankua që interpretimi nga gjykatat vendase i dispozitave relevante të Kodit Penal ishin në kundërshtim me kriteret e Nenit 7 (nuk ka dënim pa ligj).

### Neni 8

Gjykata iu referua praktikës së saj gjyqësore të mëparshme<sup>[161]</sup>, në të cilën kishte gjetur se Kodi Penal i Kroacisë, ashtu siç interpretohej dhe aplikohet nga gjykatat kompetente, nuk ofronte qartësi të mjaftueshme në lidhje me fushëveprimin dhe mënyrën e ushtrimit të diskrecionit nga autoritetet publike. Ngjashëm, në rastin konkret, procedura për urdhërimin dhe mbikëqyrjen e përgjimit të telefonit të kërkuesit nuk ofronte mbrojtje të përshtatshme kundër abuzimeve të mundshme. Në mënyrë të veçantë, urdhrat e gjyqtarit hetues nuk kishin ofruar arsyetim relevant për rrethanat e çështjes, sidomos rreth arsyes se përse hetimet nuk mund të ishin zhvilluar në ndonjë mënyrë tjetër, më pak të ndërthurur. Prandaj, kishte pasur shkelje të Nenit 8.

### Neni 6 § 1

Gjykata së pari mori në shqyrtim ankesën e kërkuesit në lidhje me futjen e mundshme në kurth. Ajo theksoi se autoritetet e prokurorisë vetëm e kishin udhëzuar J.K. të vepronte si informator pasi ai kishte raportuar korrupsionin e kërkuesit. Takimi i parë mes kërkuesit dhe J.K., në të cilin J.K. kishte vepruar me mbështetjen e autoriteteve të prokurorisë, u zhvillua më 3 prill 2007. Incizimi i kësaj bisede tregoi se kërkuesi kishte kontroll të plotë mbi korrupsionin në lidhje me projektin e investimeve në fjalë, duke i shpjeguar J.K.-së modalitetet e aktivitetit ilegal dhe duke insistuar në

[161] *Dragojević k. Kroacisë*, vendimi i 15 janarit 2015, Nr. 68955/11.

justifikimin e kërkesës së tij për mito. Për më tepër, asgjë nuk sugjeronte se ky diskutim ishte rezultat i nxitjes së mëparshme nga J.K. që kërkuesi të merrte mito. Prandaj, Gjykata pranoi se veprimet e autoriteteve prokuroriale kishin qëndruar brenda kufijve të punës në fshehtësi (undercover) dhe nuk kishin qenë elemente provokatore (*agents provocateurs*). Rrjedhimisht, nuk kishte shkelje të Nenit 6 § 1 në lidhje me këtë aspekt të ankesës së kërkuesit sipas Nenit 6 § 1.

Më pas, Gjykata mori në shqyrtim ankesën në lidhje me mos-zbulimin dhe përdorimin e provave të përfutuara përmes masave hetimore të veçanta. Ankesat e kërkuesit u fokusuan tek qasja e tij e kufizuar në tri kategori kryesore të provave që ishin përfutur përmes përdorimit të masave të vëzhgimit të fshehtë, dhe Gjykata e adresoi secilën kategori ndaras.

Kategoria e parë e provave ishin incizimet e vëzhgimeve, tek të cilat u mbështet dënimi i kërkuesit. Mbrojtja pati qasje në procesverbalet e zbardhura të atyre incizimeve, të cilat sipas të drejtës vendase ishin vetëm një instrument i ndihmës teknike anësore për palët, por mbrojtjes iu mohua mundësia e marrjes së kopjeve të vetë incizimeve. Gjykata theksoi se procesverbali i incizimeve ishte përgatitur nga një ekspert i pavarur dhe i paanshëm, dhe incizimet ishin luajtur në gjyq, dhe se kjo e kundërpeshonte pamundësinë e mbrojtjes për të marrë kopje të incizimeve. Më tej, procesverbalet e zbardhura ishin vënë në dispozicion të mbrojtjes menjëherë pas ngritjes së aktakuzës. Procesverbale të tjera u urdhëruan nga trupi gjykoës pasi mori parasysh argumentet e palëve, dhe ato u vunë në dispozicion të mbrojtjes sapo u bënë gati. Prandaj, nuk kishte asgjë që tregonte se kërkuesi ishte penguar që të përgatiste mbrojtjen e tij në mënyrë të mjaftueshme.

Kategoria e dytë e provave ishin incizimet e realizuara përmes vëzhgimit të fshehtë, të cilat ishin të përfshira në dosjen e lëndës por mbi të cilat nuk u mbështet dënimi i kërkuesit. Gjykata theksoi se kërkuesi pati qasje në raportet e bisedave të tij me palët e treta. Këto ishin detajuar mjaftueshëm për të lejuar që kërkuesi të formonte argumente specifike në lidhje me relevancën e aspekteve të caktuara në incizimet e çështjes së tij. Megjithatë, kërkuesi nuk i paraqiti këto argumente gjatë procedurës vendase. Pamundësia e pretenduar e kërkuesit për të pasur qasje në këto incizime nuk qe e mjaftueshme për të gjetur shkelje të Nenit 6.

Kategoria e tretë e provave ishin incizimet nga vëzhgimi i fshehtë por në lidhje me individë të tjerë ndaj të cilëve eventualisht nuk u ngrit aktakuzë gjatë procedurës. Këto incizime nuk shërbyen për dënimin e kërkuesit, por nuk u përfshinë në dosjen e lëndës, e as nuk iu zbuluan mbrojtjes. Kjo u justifikua mbi bazën se kërkuesi nuk kishte



të drejtë qasjeje në incizimet që kishin të bënin me jetën private të të tjerëve dhe të cilat ishin konsideruar që në fillim si jorelevante për çështjen. Në të njëjtën kohë, nuk kishte procedura që do t'i lejonin gjykatës kompetente të vlerësonte, me kërkesë të kërkuesit, relevancën e provave për çështjen. Më tej, as gjykata e shkallës së parë e as Gjykata Supreme nuk ndërmorën ushtrimin e ekuilibrit mes të drejtave nga Neni 8 të individëve që ishin incizuar dhe kufizimit të të drejtave të kërkuesit për mbrojtje. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata vendosi që procedurat kundër kërkuesit, të marra në tërësi, nuk i plotësuan kriteret e gjyqit të drejtë dhe shkelën Nenin 6 § 1.

### Neni 7

Kërkuesi u ankua se interpretimi nga gjykatat vendase i dispozitave relevante të Kodit penal ishin në kundërshtim me kriteret e Neni 7, dhe se gjykatat kishin proceduar gabim mbi supozimin se ai kishte statusin e “zyrtarit publik”. Megjithatë, Gjykata theksoi se Gjykata Supreme e kishte korrigjuar këtë keqklasifikim me gjykatën më të ulët duke gjetur se pozita e kërkuesit nuk kishte qenë pozitë e “zyrtarit publik” por pozitë e “personit përgjegjës” sipas Kodit Penal. Më pas Gjykata Supreme kishte deklaruar që gabimi i gjykatës së shkallës së parë në lidhje me pozitën e kërkuesit nuk e kishte bërë dënimin e tij të paligjshëm, meqenëse dispozitat e Kodit Penal sipas të cilit kërkuesi ishte dënuar parashikonin të njëjtat sanksione, pavarësisht nëse aktet korruptive ishin kryer nga një individ që vepronte në cilësinë e tij si “zyrtar publik” apo si “person përgjegjës”. Kërkuesi kishte pasur të gjitha mundësitë për të paraqitur argumentet e tij në lidhje me përkufizimin ligjor të pozitës së tij dhe të rrethanave të korrupsionit të ndëshkueshëm, dhe ato argumente ishin shqyrtuar siç duhej nga Gjykata Supreme. Në këto rrethana, Gjykata nuk pa arsye të dyshonte te këto gjetje të Gjykatës Supreme, as nuk gjeti që gabimi i bërë në shkallën e parë, i korrigjuar nga Gjykata Supreme, në vetvete ishte në kundërshtim me kriteret e Neni 7. Prandaj, Gjykata e refuzoi këtë ankesë si dukshëm e pabazuar.

### Neni 41

Kërkuesit iu caktuan 1,500 Euro për dëme jomateriale dhe 2,500 Euro për kosto dhe shpenzime.

*Dështimi i gjykatës vendase për të zhvilluar një shqyrtim të gjerë për të gjetur nëse ekuilibri i duhur ishte vendosur në mënyrë të përputhshme me të drejtën e kërkuarit për gëzimin paqësor të pasurisë përbëri shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **PAULET K. MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesa Nr. 6219/08)

**13 maj 2014**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuari ishte shtetas i Bregut të Fildishtë i lindur në vitin 1984, i cili kishte ardhur në Mbretërinë e Bashkuar më 26 janar 2001 dhe kishte qëndruar atje ilegalisht. Ai aplikoi për punë dhe gjeti punë tri herë duke përdorur një pasaportë franceze fallso. Të gjithë punëdhënësit theksuan se nuk do ta kishin marrë në punë sikur ta kishin ditur statusin e tij të vërtetë të imigracionit. Mes prillit 2003 dhe shkurtit 2007, kërkuari fitoi rrogë në shumën 73,293.17 £ nga punët e ndryshme që bëri. Kursimet e tij në total arritën 21,649.60 £.

Më pas kërkuari u kap nga policia pasi paraqiti dokumente fallso në Agjencinë e Licencimit të Automjeteve dhe Patentave, në përpjekje për të marrë një patentë shoferi të përkohshme. Në qershor 2007 kërkuari u deklarua fajtor për tri akuza pandershmërie me përfitim material përmes mashtrimit. Ai gjithashtu u deklarua fajtor për një akuzë të mbajtjes së një dokumenti identifikimi fallso me dashje, një akuzë e ngasjes së automjetit duke qenë i pakualifikuar, dhe një akuzë për ngasje të automjetit pa siguracion. Në gjyq, gjyqtari rekomandoi që kërkuari të deportohej.

Pas këtij rekomandimi, prokuroria kërkoi një urdhër konfiskimi sipas Seksionit 6 të Ligjit Penal për të Ardhurat të vitit 2002 në lidhje me paratë e fituara të kërkuarit. Gjyqtari pranoi se kërkuari i kishte paguar të gjitha taksat e kërkuara dhe siguracionin kombëtar për fitimin e tij dhe se paratë që kishte fituar nga punësimi ishin fituar me të vërtetë. Prej aseteve të mbetura që kishte kërkuari, 21,949.60 £, gjyqi mori një urdhër konfiskimi me një dënim të mëtejshëm me 12 muaj burgim për t'u vuajtur në vend të pagesës. Kjo efektivisht e privoi kërkuarin nga të gjitha kursimet që kishte akumuluar gjatë viteve të punës së tij.

Kërkuari kërkoi leje për të apeluar, duke argumentuar se fitimet e tij nuk duhej të kishin hyrë brenda kuptimit të Ligjit Penal për të Ardhurat të vitit 2002 dhe se

vendimi i prokurorit për të kërkuar urdhër konfiskimi ishte abuzim i procesit. Apelet e mëtejshme të kërkuarit u rrëzuan, dhe ndaj tij filloi procedura e zbatimit.

## 2. Vendim i Gjykatës

Kërkuar u ankua sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 se urdhri i konfiskimit ishte ndërhyrje joproporcionale tek e drejta e tij për gëzimin paqësor të pasurisë.

### Neni 1 i Protokollit Nr.1

Gjykata përsëriti se Neni 1 i Protokollit Nr. 1 përbëhet nga tri rregulla të dallueshme: parimi i gëzimit paqësor të pasurisë, kushtet për privimin nga pasuria, dhe të drejtën e Shteteve për të kontrolluar pasurinë në përputhje me interesin e përgjithshëm. Gjykata riafirmoi se rregulla e dytë dhe e tretë duhet të interpretohen nën prizmin e parimit të përgjithshëm në rregullën e parë.

Në rastin konkret, urdhri i konfiskimit qartazi përbëri ndërhyrje tek e drejta e kërkuarit për gëzimin paqësor të pasurive të tij. Më tej, urdhrat e konfiskimit hynin brenda të drejtës së Shteteve Kontraktuese për të kontrolluar përdorimin e pasurisë (rregulla e tretë), në këtë rast për të siguruar pagesën e dënimeve. Megjithatë, u theksua se duhet të ekzistojë një marrëdhënie proporcionale mes mënyrës së përdorur dhe qëllimit që synohet të arrihet. Një ndërhyrje do të ishte joproporcionale nëqoftëse pronarit të pasurisë përkatëse do t'i duhej të bartte një barrë individuale dhe të tepërt në vend të rezultatit të ekuilibrit të drejtë mes të drejtës së individit për pasuri dhe interesit të përgjithshëm. Një faktor i rëndësishëm në përcaktimin e këtij ekuilibri ishte nëse të ardhurat në tërësi i lejonin kërkuarit mundësi të arsyeshme për të paraqitur argumentet e tij para autoriteteve kompetente.

Në këtë rast, Gjykata vuri në dukje se në kohën që çështja e kërkuarit ishte para gjykatave angleze, ishte me vend që ai të ngriste çështjen e abuzimit të procesit dhe shtypjes. Megjithatë, Gjykata po ashtu gjeti se, ndërkohë që Gjykata e Apelit vlerësoi nëse urdhri i konfiskimit ishte abuzim i procesit dhe në interesin publik, ajo nuk përcaktoi nëse ekuilibri i kërkuarit ishte ruajtur në mënyrë të atillë që ishte në pajtueshmëri me të drejtën e kërkuarit për gëzim paqësor të pasurisë.

Kështu, mbi këtë bazë, Gjykata gjeti se në kohën kur kërkuar filloi procedurën vendase fushëveprimi i shqyrtimit të zhvilluar që tepër i ngushtë për të përmbushur kriterin e kërkuarit të ekuilibrit të drejtë të kërkuarit nga Neni 1 i Protokollit Nr. 1 dhe se prandaj kishte pasur shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

### Neni 41

Shkelja e gjetur në çështjen në fjalë ishte e bazuar mbi mungesën e shqyrtimit të urdhrimit të konfiskimit që mund të plotësonte kriteret e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Në mungesë të një lidhjeje të afërt shkakësore mes shkeljes procedurale të gjetur dhe humbjes financiare të pësuar nga kërkuesi, për shkak të urdhrimit të konfiskimit, Gjykata nuk mundi të jepte kompensim për dëme materiale. Megjithatë, Gjykata i caktoi 2,000 € për dëme jomateriale. Më tej, kërkuesit iu caktuan 10,000 € për kosto dhe shpenzime.

*Supozimi statutor që të gjitha pronat e përfutuara gjatë gjashtë viteve pararendëse nga një person i dënuar për një vepër lidhur me trafik droge ishin të paligjshme nuk shkeli prezumimin e pafajësisë ose të drejtën për proces të rregullt sipas Nenit 6*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **PHILLIPS K. MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesa Nr. 41087/98)

**5 korrik 2001**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte shtetas britanik i dënuar në vitin 1995 për përfshirje në një skemë importi të sasive të mëdha të rrëshirës së kanabisit për në Mbretërinë e Bashkuar. Megjithëse ai kishte pasur dënime të mëparshme, kjo ishte vepra e tij e parë penale që kishte të bënte me drogë. Ai u dënua me nëntë vjet burgim.

Sipas Seksionit 2 të Ligjit për Trafikimin e Drogës të vitit 1994, u zhvilluan hetime mbi mjetet monetare të kërkuesit. Në seancën e konfiskimit para Gjykatës së Kurorës, gjyqtari zbatoi Seksionin 4(3) të Ligjit të vitit 1994, kur i lejoi gjykatës të supozonte se të gjitha pasuritë e përfutuara gjatë gjashtë viteve të mëparshme nga kërkuesi, një person i dënuar për një vepër të trafikimit të drogës, ishin në fakt të ardhura nga trafiku i drogës. Kjo shumë shkante në 91,400 £ (afro 102,700 €), dhe për këtë shumë u lëshua një urdhër konfiskimi. Dështimi për të dorëzuar shumën tek autoritetet do të kishte rezultuar me dënim shtesë prej dy vitesh burg. Kërkuesit iu refuzua leja për të bërë apel kundër shpalljes fajtor dhe dënimit.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi u ankua se supozimi sipas Ligjit të vitit 1994 shkeli të drejtën e tij për t'u prezumuar i pafajshëm, e garantuar me Nenin 6 § 2, dhe se gjithashtu pati shkelje të Nenit 6 § 1. Më tej, ai u ankua se urdhri i konfiskimit kishte shkelur Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës.

#### Neni 6 § 2

Gjykata theksoi se urdhri i konfiskimit nuk kishte lidhje me përcaktimin e mëtejshëm të fajësisë penale për ndonjë vepër tjetër lidhur me drogë, dhe se në historinë penale të kërkuesit nuk ishte shtuar dënimi. Rrjedhimisht, supozimi sipas Ligjit të vitit 1994

nuk bëri që kërkuesi të “akuzohej për vepër penale”. Përkundrazi, Gjykata pranoi se qëllimi i supozimit ishte t’i mundësonte gjykatës vendase që të vlerësonte shumën e duhur për t’u konfiskuar, pra në thelb përcaktimin nga gjykata të shumës së një gjobe ose kohëzgjatjes së dënimit me burg që i jepet një vepërkryesi të dënuar. Meqenëse procedura e konfiskimit bëri një përcaktim të karakterit dhe sjelljes së të akuzuarit si pjesë e procesit të dënimit, Neni 6 § 2 nuk ishte i aplikueshëm sepse përcaktimi nuk çoi në ngritjen e një akuze të re brenda kuptimit autonom të Konventës.

### Neni 6 § 1

Gjykata konsideroi që e drejta e një personi në një çështje penale për t’u prezumuar i pafajshëm dhe për të kërkuar që prokuroria të bartë barrën e vërtetimit të pretendimeve kundër tij formonte një pjesë të nocionit të përgjithshëm të një seance të drejtë sipas Nenit 6 § 1. Gjykata riafirmoi se supozimi statutor sipas Ligjit të vitit 1994, nuk ishte përcaktim i fajësisë por një metodë për vlerësimin e shumës në të cilën duhej caktuar urdhri i konfiskimit, dhe megjithëse urdhri i konfiskimit ngërthente një shumë të konsiderueshme dhe krijonte mundësinë që kërkuesi të vuante një dënim më të gjatë me burgim, nuk bëhej fjalë për dënimin e tij për një vepër shtesë.

Për më tepër, Gjykata theksoi se ekzistonin mbrojtje vendase për të siguruar një sistem të drejtë: gjykata vendase mund të urdhëronte konfiskimin e një shume më të vogël nëqoftëse bindej, brenda shkallës së probabiliteteve, që vetëm një shumë më e vogël mund të paguhej, dhe supozimi i bërë sipas Ligjit të vitit 1994 mund të ishte hedhur poshtë sikur kërkuesi të kishte treguar, në shkallën e probabiliteteve, se ai e kishte përfutuar pasurinë e tij me mënyra të tjera e jo me trafik droge. Gjyqtari gjithashtu e kishte diskrecionin për të mos e aplikuar këtë supozim sikur të konsideronte se një gjë e tillë do të mund t’i jepte shkas një rreziku serioz për padrejtësi.

Në këtë rast, gjyqtari i gjyqit ishte bindur se kërkuesi kishte në pronësi ose tashmë e kishte hequr pasurinë në fjalë, dhe se konkluzioni i qartë ishte se pasuria e tij kishte ardhur nga burime të paligjshme. Nëqoftëse kërkuesi do të kishte pasur prova në të kundërt, do të kishte qenë e lehtë të hidhej poshtë supozimi statutor. Gjykata gjeti se aplikimi i Ligjit të vitit 1994 ishte i arsyeshëm dhe të drejtat e mbrojtjes u respektuan në plotësi. Prandaj, nuk u gjet shkelje e Nenit 6 § 1.

### Neni 1 i Protokollit Nr. 1

Kërkuesi pretendoi se pushteti i ushtruar nga gjykata vendase sipas Ligjit të vitit 1994 që i paarsyeshëm dhe shkeli Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, i cili thotë se çdo

person ka të drejtë për gëzimin paqësor të pasurisë së tij dhe se ai nuk privohet nga posedimet e tij përveç rastit kur është në interesin publik dhe është parashikuar me ligj. Siç u tha më lart, urdhri i konfiskimit përbëri dënim brenda kuptimit të Konventës, dhe prandaj ishte i mbuluar nga paragrafi i dytë i Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, i cili u lejon Shteteve Kontraktuese që të kontrollojnë përdorimin e pasurisë për të siguruar pagesën e dënimeve. Megjithatë, prapë duhet të kishte një marrëdhënie proporcionale mes mënyrave të përdorura dhe qëllimit të synuar. Në rastin konkret, qëllimi i urdhrimit të konfiskimit ishte që ai të shërbente si armë për gjykatat në luftën kundër trafikimit të drogës, duke penguar trafikantët dhe duke konfiskuar të ardhurat e tyre për të parandaluar përdorimin e tyre për aktivitete ilegale të mëtejshme. Gjykata theksoi se urdhri i konfiskimit ngërtheu shumë që kërkuesi kishte përfutur nga trafiku i drogës gjatë 6 viteve pararendëse dhe se kërkuesi e kishte mundësinë për ta realizuar shumë nga asetet që kishte në pronësi. Ndaj Gjykata nuk gjeti se urdhri i konfiskimit ndërhyre tek e drejta e kërkuesit për gëzimin paqësor të pasurisë së tij.

*Vazhdimi i mbajtjes preventive të aseteve të marra në lidhje me të ardhurat e krimeve të tipit mafioz për 4 vjet e 8 muaj pasi kërkuesi ishte shpallur i pafajshëm përbëri shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **RAIMONDO K. ITALISË**

(Kërkesa Nr. 12954/87)  
**22 shkurt 1994**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesi u arrestua në vitin 1984 dhe u akuzua për anëtarësinë e tij të dyshuar në një organizatë të tipit mafioz. Në lidhje me këtë akuzë Prokurori Publik kërkoi marrjen preventive të disa prej aseteve të kërkuesit përfshirë prona të patundshme dhe automjete, me qëllim të konfiskimit të tyre të mundshëm. Urdhri i konfiskimit u lëshua nga Gjykata e Rrethit në vitin 1985, megjithatë kërkuesi më pas u shpall i pafajshëm për akuzat kundër tij në janar 1986. Ky shfajësim më tej u vërtetua në janar 1987 nga Gjykata e Apelit. Në një vendim që u bë përfundimtar në dhjetor 1986, Gjykata e Apelit urdhëroi rikthimin e pasurisë së marrë dhe të konfiskuar. Megjithatë, për një pjesë të pasurisë, tërheqja e masës nuk u fut në regjistrat përkatës deri në gusht 1991.

### 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua se marrja dhe konfiskimi vijues i aseteve të tij shkeli të drejtat e tij sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (e drejta për gëzimin paqësor të pasurive). Ai gjithashtu u ankua sipas Nenit 6 § 1 (e drejta për proces të rregullt) se gjatësia e procedurave në lidhje me apelin e tij kundër konfiskimit dhe mbikëqyrjes speciale të aseteve të tij kishte shkelur Konventën.

#### Neni 1 i Protokollit 1

Gjykata vendosi të shqyrtonte situatën deri tek vendimi i Gjykatës së Apelit në dhjetor 1986 ndaras prej situatës së mëpasme që zgjati deri në përmbysjen e marrjes dhe konfiskimit të pasurisë.

Gjykata gjeti që marrja fillestare e aseteve të kërkuesit pati bazë në legjislacion dhe se autoritetet nuk e privuan kërkuesin nga posedimet e tij por vetëm kontrolluan



përdorimin e tyre nga ai. Në lidhje me proporcionalitetin e kësaj mase, duke pasur parasysh fazën e hershme të procedurave penale kur ajo u urdhërua, Gjykata gjeti se marrja qartazi që një masë provizore me qëllim të sigurimit që pasuria që dukej se ishte fryt i aktiviteteve të paligjshme, e zhvilluar në dëm të komunitetit, mund të konfiskohej më pas po të ishte e nevojshme. Prandaj masa që e justifikuar nga interesi i përgjithshëm dhe, duke ditur pushtetin tepër të rrezikshëm ekonomik të një organizate si Mafia, nuk mund të thuhet se marrja në një fazë të hershme të procedurave që proporcionale me qëllimin e synuar.

Në lidhje me konfiskimin e disa prej aseteve të kërkuesit që vijoi pas marrjes fillestare, Gjykata konfirmoi praktikën e saj gjyqësore të mëparshme që konfiskimi i pasurisë nuk hyn domosdoshmërisht brenda fushëveprimit të privimit nga pasuria sipas Nenit 1 të Protokollit 1. Gjykata theksoi se, sipas të drejtës italiane, konfiskimi i këtij lloji nuk mund të kishte efektin e transferimit të pronësisë tek Shteti deri sa të dilte një vendim përfundimtar. Në këtë rast nuk u mor një vendim i tillë përfundimtar, dhe prandaj Gjykata gjeti se nuk kishte pasur privim por vetëm kontroll të pasurisë.

Gjatë shqyrtimit të proporcionalitetit të veprimeve të autoriteteve italiane, Gjykata theksoi që, së pari, konfiskimi synoi qëllimin që ishte në interesin e përgjithshëm. Konkretisht, ajo mëtoi të siguronte që përdorimi i pasurisë në fjalë nuk do të shkonte në dobi të kërkuesit, ose organizatës kriminale në të cilën ai dyshohej se bënte pjesë, në dëm të komunitetit. Gjykata më tej theksoi vështirësitë që has Shteti italian në luftën kundër Mafias, dhe se kjo organizatë ishte e njohur se investonte të ardhurat e aktiviteteve të saj kriminale në prona të patundshme. Gjykata theksoi se konfiskimi i pasurisë është një armë efektive dhe e nevojshme kundër lëvizjeve të kapitalit të dyshimtë. Prandaj, konfiskimi i pasurisë së kërkuesit që proporcional me qëllimin e synuar. Në fund, Gjykata përsëriti se konfiskimi preventiv zakonisht është i justifikuar në zbatimin e tij të menjëhershëm pavarësisht nga apeli. Në përfundim, Gjykata gjeti se Italia kishte vepruar proporcionalisht. Rrjedhimisht, nuk pati shkelje të Nenit 1 të Protokollit 1 në periudhën deri në vendimin e Gjykatës së Apelit të dhjetorit 1986.

Megjithatë, pasuria nuk iu kthye menjëherë kërkuesit pas vendimit të Gjykatës së Apelit në dhjetor 1986. Në fakt, një pjesë e pasurisë iu kthye vetëm pas katër vjetësh e tetë muajsh. Gjykata vendosi që kjo ishte ndërhyrje tek të drejtat e kërkuesit sipas Konventës dhe që nuk ishte as 'e parashikuar me ligj' e as e nevojshme 'për të kontrolluar përdorimin e pasurisë në përputhje me interesin e përgjithshëm' brenda kuptimit të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të asaj dispozite.

### Neni 6

Gjykata tha se ngrirja preventive e asetëve nuk është e krahasueshme me sanksione penale sepse ajo ka për qëllim parandalimin e kryerjes së veprave. Prandaj, Neni 6 nuk aplikohet në këtë aspekt të çështjes.

Në lidhje me çështjen e konfiskimit, Gjykata theksoi se duke pasur parasysh faktin se çështja doli para dy gjykatave vendase, gjatësia totale e procedurave nuk mund të konsiderohej se kishte qenë e paarsyeshme. Rrjedhimisht, nuk kishte pasur shkelje të Nenit 6(1).

### Neni 50 (tani Neni 41)

Gjykata i caktoi kërkuesit dëmshpërblim jomaterial në shumën dhjetë milionë lira italiane, dhe pesë milionë lira italiane për kosto dhe shpenzime.

*Pamundësia e apelimit të zbatimit të një urdhri për bastisje dhe konfiskim mbi pika të faktit që shkelje e Nenit 6 § 1*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **RAVON DHE TË TJERË K. FRANCËS**

(Kërkesa Nr. 18497/03)

**21 shkurt 2008**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit në këtë çështje ishin z. Ravon dhe dy kompani të kontrolluara prej tij, ku ai kishte aksione ose ushtronte menaxhim statutor.

Më 3 korrik 2000, me dyshimin që kompanitë kërkuese ishin përfshirë në evazion fiskal, autoritetet tatimore franceze kërkuan autorizim nga autoritetet gjyqësore që të bastisnin disa adresa të caktuara dhe të konfiskonin prova të evazionit fiskal. Pasi u lëshuan urdhrat, u zhvilluan kontrole në ambientet e kompanive kërkuese dhe shtëpinë e kërkuesit, dhe u morën disa dokumente. Duke ditur parregullsitë që kishin ndodhur gjatë atyre bastisjeve dhe konfiskimeve, kërkuesit aplikuan në gjykata duke kërkuar anulimin e operacioneve. Kërkesa e tyre u rrëzua nga Gjykata e Shkallës së Parë e Parisit dhe nga divizioni penal i Gjykatës së Kasacionit, ku të dyja deklaruan se, sipas Nenit përkatës të Kodit të Procedurës Tatimore, urdhrat që autorizonin bastisjen e ambienteve rezidenciale mund të apeloeshin vetëm pas faktit mbi bazën e pikave të ligjit, dhe jo me qëllim të shqyrtimit të parregullsive procedurale. Meqenëse Kodi Tatimor nuk e kufizonte juridiksionin e gjykatave me afate kohore, Gjykata Supreme atëherë vendosi që ky lloj shqyrtimi procedural i autorizimit dhe zhvillimit të bastisjes dhe konfiskimit pas kryerjes së operacionit përbëri ushtrim të tepruar të pushtetit nga magjistrati, i cili do të kishte qenë në kontakt të vazhdueshëm me autoritetet policore dhe tatimore gjatë operacionit.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Duke u mbështetur tek Neni 6 § 1 (e drejta për proces të rregullt) dhe Neni 13 në lidhje me Nenin 8, kërkuesit u ankuan që nuk kishin pasur qasje në zgjidhje efektive për të kontestuar bastisjen dhe konfiskimet. Megjithatë, ankesa sipas Nenit 8 u refuzua mbi baza procedurale.

## Neni 6 § 1

Gjykata së pari vuri në dukje se Neni 6 § 1 ishte i aplikueshëm sipas titullit të tij civil. Megjithëse ishte e vërtetë që mosmarrëveshjet tatimore janë jashtë fushëveprimit të “të drejtave dhe detyrimeve civile”, thelbi i mosmarrëveshjes aktuale qëndronte tek bastisjet dhe konfiskimet në shtëpi të cilave u ishin nënshtruar kërkuesit. E drejta për respektim të shtëpisë së tyre ishte qartazi e natyrës “civile” dhe Gjykata më tej theksoi se kur aplikohet Neni 6 § 1, si në këtë rast, ai përbënte *lex specialis* në lidhje me Nenin 13. Prandaj ishte e udhës të shqyrtohej ankesa vetëm sipas Nenit 6 § 1 dhe të përcaktohej nëse kërkuesit kishin pasur qasje në “gjykatë” siç përkufizohet sipas atij Neni.

Termi “gjykatë” ishte i përkufizuar si një organ i cili plotëson disa kriteret të caktuara, përfshirë pavarësinë nga ekzekutivi dhe palët e përfshira, dhe i cili gëzon juridiksionin të plotë. Në mënyrë që një “gjykatë” e tillë të vendosë që të kontestojë të drejtat dhe detyrimet civile në përputhje me Nenin 6 § 1, ajo duhet të ketë juridiksionin për të trajtuar të gjitha çështjet relevante të faktit ose të ligjit që kanë të bëjnë me mosmarrëveshjen që ka përpara. Për më tepër, e drejta për qasje në gjykatë duhet të ishte praktike dhe efektive. Nga kjo rrjedh që, në kontekstin e bastisjes së shtëpisë, personat e përfshirë duhet të kishin pasur mundësi të kishin shqyrtim gjyqësor efektiv, si në aspektin e faktit ashtu edhe në aspektin e ligjit, të ligjshmërisë së vendimit për bastisjen dhe të masave të marra mbi bazën e tij. Zgjidhja në dispozicion, në rast gjetjeje të ndonjë parregullsie, duhej që ose të parandalonte ndodhjen e operacionit ose, në rast se ai tashmë kishte ndodhur, t’i ofronte personit zgjidhjen e duhur.

Gjykata theksoi se individëve që ishin objekt i bastisjes së shtëpisë së tyre iu dha rekurs për të apeluar vetëm mbi pika të ligjit, por jo për shqyrtimin e parregullsisë faktike gjatë procesit të bastisjes dhe konfiskimit. Kjo nuk plotësoi kriteret e Nenit 6 § 1, meqenëse një apel i tillë nuk lejoi shqyrtimin e bazës faktike të urdhrin të kontestuar. Ndërkohë që legjislacioni gjithashtu parashikonte që operacionet të zhvilloheshin nën shqyrtimin e vazhdueshëm të gjyqtarit që lëshonte urdhrin për to, Gjykata vendosi që kjo nuk përbëri shqyrtim të pavarur të rregullsisë së vetë urdhrin, dhe sidoqoftë praktika gjyqësore vendase tregoi se qasja tek ky gjyqtar nga ana e personave relevantë ishte më shumë teorike sesa efektive. Zyrtarët e ligjit që zhvilluan bastisjet nuk patën detyrimin ligjor për të informuar personat në fjalë në lidhje me të drejtat e tyre, urdhri i bastisjes nuk paraqiti detajet e gjyqtarit kompetent, nuk u kërkua prezenca e personave në fjalë (mjaftuan dy dëshmitarët e palës së tretë), dhe nuk pati mundësi që personat në fjalë të thërrisnin një avokat. Për më tepër, opsioni për ta referuar çështjen tek gjyqtari relevant mori fund pas përfundimit të bastisjes,

meqenëse u konsiderua gjyqtari se kishte qenë në dispozicion për të shqyrtuar çdo parregullsi dhe për të pezulluar ose ndaluar bastisjen gjatë procesit. Çdo kontestim i ligjshmërisë së procedurave të bastisjes ishte i mundur vetëm nëqoftëse dhe kur të fillonin procedura të mëtejshme kundër personave në fjalë, çka nuk ndodhi në rastin konkret.

Në këto rrethana, Gjykata doli në përfundimin që kërkuesit nuk kishin pasur qasje në “gjykatë”. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të Nenit 6 § 1.

#### Neni 41

Kërkuesit të parë iu caktua shuma 5,000 Euro për dëme jomateriale, megjithatë Gjykata konsideroi se gjetja e shkeljes qe e mjaftueshme për kompanitë kërkuese.

*Marrja dhe konfiskimi i asetëve të kërkuesit në Austri, pas një urdhri amerikan për konfiskim, nuk shkeli Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, dhe procedura që në përputhje me Nenin 6*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **SACCOCCIA K. AUSTRISE**

(Kërkesa Nr. 69917/01)  
**18 dhjetor 2008**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte shtetas amerikan që ishte duke vuajtur një dënim me burg në SHBA në kohën e bërjes së kërkesës së tij. Në vitin 1992, kundër tij nisi procedura penale për pastrim parash në shkallë të gjerë në Gjykatën e Rrethit të Rhode Island. Gjykatave austriake iu kërkua që të merrnin asetet e tij që mbaheshin në dy kasaforta në Vjenë të cilat ishin marrë me qira nga kërkuesi. Më 10 shkurt 1992, Gjykata Penale e Rrethit të Vjenës urdhëroi marrjen dhe vendosjen e asetëve (para të thata dhe letra me vlerë) në dispozicion të Gjykatës së Rrethit në Rhode Island për t'u përdorur si prova kundër kërkuesit.

Kërkuesi pretendoi se asetet rridhnin nga aktivitetet e ligjshme të biznesit të zhvilluara deri në vitin 1988, ndërsa qeveria e SHBA-së pretendoi se ato ishin rezultat i aktiviteteve të pastrimit të parave të zhvilluara nga viti 1990 deri në vitin 1991 dhe se ai i mbante ato në mirëbesim për një kartel droge për të cilin ai kishte punuar. Në shkurt 1993, Gjykata e Rrethit në Rhode Island e shpalli kërkuesin fajtor për pastrimin e mbi njëqind milionë dollarëve amerikanë, dhe e dënoi me 660 vite burgim. Më pas, më 30 gusht 1993, gjykata në SHBA lëshoi një urdhër paraprak për konfiskim. Apelet e kërkuesit kundër dënimit të tij dhe urdhrit të konfiskimit u rrëzuan.

Më 7 nëntor 1997, Gjykata e Rrethit në Rhode Island lëshoi një urdhër final konfiskimi që shkonte në shumën 136 milionë dollarë, përfshirë 9 milionë dollarë në lidhje me pronat e vetë të kërkuesit, që përbëheshin nga shuma parash të thata në franga zvicerane, dollarë amerikanë, shilinga austriake të bastisura në Vjenë në vitin 1992, një listë letrash me vlerë të lëshuara nga bankat austriake, dhe një llogari bankare në Vjenë. Departamenti amerikan i Drejtësisë ia përcolli kërkesën e konfiskimit autoriteteve austriake, dhe Ministria austriake e Drejtësisë i kërkoi Prokurorit të Lartë Publik të Vjenës që të niste procedurën për zbatimin e vendimit të gjykatës së huaj.

Më 12 mars 1998, Gjykata Penale Rajonale e Vjenës, si masë e përkohshme urdhëroi konfiskimin e asetëve të kërkuarit, 80,000,000 shilinga austriake (5,800,000 €). Kërkuari apeloj, duke argumentuar se vendimi i Gjykatës Rajonale përbënte ndërhyrje të paligjshme tek e drejta e tij për pasuri dhe se atij i mungonte baza ligjore. Më tej, ai shtoi se urdhri i zbatimit nga SHBA nuk ishte i pranueshëm në Austri, meqenëse seksioni 64(7) i Ligjit për Ekstradim dhe Ndhimë Ligjore (ang. ELAA) parashikonte që çdo gjobë ose aset i konfiskuar të përfutur me anë të ekzekutimit të një vendimi të huaj ishte në dorë të Republikës së Austrisë. Përveç kësaj, u argumentua se urdhri përfundimtar i konfiskimit përfshinte asete që nuk kishin lidhje me ose nuk rezultojn nga aktiviteti penal, dhe se procedura e konfiskimit nuk kishte qenë në përputhje me Nenin 6 të KEDNJ-së sepse ai nuk ishte dëgjuar. Apeli i tij u rrëzua më 12 tetor 1998.

Në ndërkohë, më 1 gusht 1998 hyri në fuqi një traktat mes SHBA-ve dhe Austrisë i quajtur Ndhimë Ligjore e Ndërsjellë në Çështje Penale (Traktati i vitit 1998). Më 25 gusht 1999, autoriteti qendror i Shteteve të Bashkuara, duke u mbështetur në Traktatin e vitit 1998, bëri një kërkesë të re për zbatimin e urdhrit përfundimtar të konfiskimit. Më 14 qershor 2000, Gjykata Penale Rajonale e Vjenës, pa mbajtur seancë dëgjimore, vendosi të merrte përsipër zbatimin e urdhrit përfundimtar të konfiskimit, dhe urdhëroi marrjen e asetëve të kërkuarit në emër të Shteteve të Bashkuara. Kërkuari dhe Prokuroria Publike apeluan dhe, më 7 tetor 2000, Gjykata vjeneze e Apelit, në një seancë *in camera*, e rrëzoi apelin e kërkuarit por ndryshoi vendimin e Gjykatës Rajonale dhe urdhëroi konfiskimin në emër të Republikës së Austrisë.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuari u ankua sipas Nenit 6 § 1 (e drejta për seancë dëgjimore të drejtë dhe publike) për mungesën e një seancë publike gjatë procedurës në Austri në lidhje me ekzekutimin e urdhrit të konfiskimit. Së dyti, kërkuari argumentoi se vendimet e gjykatave austriake shkelën Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (gëzimi paqësor i pasurisë).

### Neni 6

Argumenti i kërkuarit ishte se as Gjykata Penale Rajonale e Vjenës e as Gjykata e Apelit e Vjenës nuk kishin mbajtur seanca dëgjimore gjatë procedurave të konfiskimit kundër tij, dhe se ai do të duhej të ishte dëgjuar personalisht gjatë atyre procedurave në mënyrë që të tregonte se asetet e tij rridhnin nga aktivitete të ligjshme biznesi. Gjykata gjeti se procedurat duhet të shqyrtoheshin sipas titullit civil të Nenit 6 § 1, dhe përsëriti se seanca dëgjimore publike është parim themelor i kësaj dispozite,

dhe mbron palët ndërgjygjëse kundër administrimit sekret të drejtësisë pa këqyrje publike. Më tej, është mjet përmes të cilit mund të ruhet besimi publik tek gjykatat.

E drejta për seancë dëgjimore publike ngërthen të drejtën për “seancë orale” nëqoftëse nuk ekzistojnë rrethana që justifikojnë mos-mbajtjen e një seance të tillë. Në rastin konkret, asnjë seancë orale nuk u zhvillua para gjykatave austriake. Prandaj, Gjykata u desh të shqyrtonte nëse kishte pasur rrethana të një natyre të tillë që i kursenin gjykatat nga mbajtja e seancës dëgjimore. Seanca mund të mos jetë e nevojshme të mbahet kur nuk ka probleme me çështje të besueshmërisë ose fakte të kontestuara dhe gjykatat mund të vendosin drejt dhe me arsye në lidhje me çështjen mbi bazën e parashtrimeve me shkrim të palëve, megjithatë parimi i tërësishëm i drejtësisë i ngërthyer në Nenin 6 është konsideratë kyçe. Mosmarrëveshjet e natyrës teknike, dhe çështjet që ngrenë pika thjesht ligjore të një natyre të kufizuar, ishin situata që kishin më shumë gjasa të pajtueshmërisë me Nenin 6 nëqoftëse seanca orale nuk mbahej.

Në rastin konkret, gjykatat u desh të shqyrtonin nëse ishin plotësuar kushtet e parashtruara në dispozitat përkatëse të ELAA dhe të Traktatit e vitit 1998 për ekzekutimin e urdhrin të konfiskimit. Këtu përfshihej çështja e reciprocitetit, nëse aktet e kryera nga kërkuesi ishin të ndëshkueshme sipas të drejtës austriake në kohën e kryerjes, pajtueshmëria me afatet kohore statutore, dhe nëse procedurat në SHBA kishin qenë në përputhje me standardet e Nenit 6 të Konventës. Prandaj, procedura kishte të bënte më shumë me çështje teknike të bashkëpunimit ndërshtetëror në luftimin e pastrimit të parave me anë të zbatimit të një urdhri të huaj për konfiskim. Ato ngritën ekskluzivisht çështje të një natyre të kufizuar dhe nuk kërkuan dëgjimin e dëshmitarëve ose marrjen e dëshmive të tjera orale. Në këto rrethana, gjykatat në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme mund të vendosnin për çështjen mbi bazën e parashtrimeve me shkrim nga palët dhe materialeve të tjera të shkruara, dhe pra nuk kishte pasur shkelje të Nenit 6 § 1.

#### Neni 1 i Protokollit Nr.1

Kërkuesi argumentoi se ai ishte pronari i aseteve në fjalë dhe se vendimet e gjykatave austriake nuk kishin bazë në ligj. Kërkuesi pohoi se kriteri i reciprocitetit në ELAA nuk ishte plotësuar (d.m.th. kur ishte marrë urdhri përfundimtar i konfiskimit, Traktati i vitit 1998 nuk kishte qenë në fuqi dhe kushti i reciprocitetit i kërkuar nga seksioni 3(1) i ELAA nuk ishte plotësuar), urdhri përfundimtar i konfiskimit u vjetërsua për shkak të afateve kohore, dhe se Traktati i vitit 1998 lejonte vetëm konfiskimin e fryteve dhe mjeteve të kryerjes së një veprë – por jo konfiskimin e aseteve zëvendësuese.



Gjykata iu referua parimeve të ngulitura të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 dhe tri rregullave të dalluara të ngërthyera në atë dispozitë. Urdhri i konfiskimit hynte brenda rregullës së tretë, në lidhje me të drejtën e Shtetit për të zbatuar ligje të tilla ashtu siç ai e vlerëson të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronave në përputhje me interesin e përgjithshëm. Gjykata theksoi se ekzekutimi i urdhrimit të konfiskimit ishte i bazuar në të drejtën austriake, konkretisht në seksionin 64 të ELAA dhe Nenin 17 të Traktatit të vitit 1998. Gjykatat austriake ishin marrë në detaje me argumentet e kërkuarit dhe kishin dhënë arsyetime të gjera për gjetjet e tyre. Nuk kishte prova që aplikimi i ligjit ishte përtej kufijve të arsyeshem të interpretimit.

Për më tepër, Gjykata vuri në dukje se ekzekutimi i urdhrimit të konfiskimit kishte një qëllim legjitim, pra fuqizimin e marrëdhënieve ndërkombëtare për të siguruar që paratë e rrjedhura nga marrja me drogë të konfiskoheshin. U njoh fakti që Shtetet përballeshin me vështirësi në luftën kundër trafikimit të drogës, dhe masat parandaluese ishin të nevojshme për të luftuar praktika të tilla. Ishte vënë ekuilibër i drejtë mes kërkesave për interesin e përgjithshëm dhe interesit të kërkuarit në mbrojtjen e të drejtës së tij për gëzimin paqësor të pasurisë, dhe u theksua se Shtetet gëzojnë hapësirë të gjerë vlerësimi në raste të tilla.

Megjithëse Neni 1 i Protokollit Nr. 1 nuk përmbante kritere procedurale specifike, procedurat duhet t'i ofronin individit mundësi të arsyeshme për të paraqitur argumentet e tij para autoriteteve përkatëse me qëllim të kontestimit të masave që shkelnin të drejtat e tij. Gjykata theksoi se para gjykatave austriake ishin zhvilluar dy procedura. E para ishte në lidhje me konfiskimin paraprak të aseteve me qëllim që të sigurohej ekzekutimi i marrjes së tyre, dhe e dyta ishte në lidhje me ekzekutimin e urdhrimit përfundimtar të konfiskimit nga Gjykata e Rrethit e Rhode Island. Gjithashtu, u theksua se kërkuari kishte pasur përfaqësim gjatë të gjitha procedurave dhe kishte pasur mundësi të bollshme për të paraqitur argumente dhe për të kontestuar masat që ndërhyenin tek të drejtat e tij.

Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se ekzekutimi i urdhrimit të konfiskimit nuk paraqiti dështim në vënie e ekuilibrit të drejtë mes interesit të përgjithshëm dhe respektimit të të drejtave të kërkuarit sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Andaj, nuk pati ndërhyrje joproporcionale tek të drejtat pronësore të kërkuarit dhe nuk pati shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

*Aplikimi i ligjit doganor të Shtetit i dha kërkuesit mundësinë për mbrojtje dhe nuk mveshi supozimin e fajësisë në shkellje të Nenit 6 të Konventës*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **SALABIAKU K. FRANCËS**

(Kërkesa Nr. 10519/83)

**7 tetor 1988**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte shtetas i Zaïre (tani Republika Demokratike e Kongos) i cili kishte lindur në vitin 1951 dhe jetonte në Paris. Më 20 korrik 1978, kërkuesi shkoi në Aeroportin Roissy për të marrë një paketë që përmbante ushqime të ndryshme afrikane të cilat ishin dërguar në adresë të tij me një fluturim të Air Zaïre. Pasi nuk arriti ta gjente paketën, kërkuesi kërkoi ndihmë tek një punonjës i Air Zaïre i cili e drejtoi kërkuesin tek një sënduk i mbyllur me dry (që ende nuk e kishte marrë askush) i cili mbante etiketën e Air Zaïre por nuk kishte emër. Punonjësi e paralajmëroi kërkuesin që aty mund të kishte mallra të ndaluara. Megjithatë kërkuesi e mori në posedim sëndukun e kyçur dhe kaloi nëpër doganë, duke thënë se nuk kishte asgjë për të deklaruar. Zyrtarët doganorë e ndaluan kërkuesin jashtë zonës së doganës, kur ai po bëhej gati për të marrë një fluturim të Air France, e detyruan të hapte sëndukun dhe gjetën një kapak fallso në fund të tij ku ishin fshehur 10 kg kanabis. Kërkuesi mohoi të kishte dijeni për drogën, dhe pretendoi se e kishte marrë sëndukun gabimisht në vend të paketës së ushqimeve që priste. Të nesërmen, Air Zaïre tentoi të njoftonte kërkuesin, i cili ishte në paraburgim, se një paketë adresuar atij kishte arritur gabimisht në Bruksel. Hetuesit e hapën paketën dhe gjetën vetëm ushqimet e pritura.

Më 2 gusht 1979, kërkuesi u lirua dhe u akuzua për veprën penale të importimit të paligjshëm të narkotikëve dhe për veprën doganore të kontrabandimit të mallrave të ndaluara. Më 27 mars 1981, trupi gjykues e gjeti fajtor për të dy akuzat, gjë të cilën ai e apeloj më pas. Më 9 shkurt 1982, Gjykata e Apelit në Paris e hoqi akuzën për importimin e paligjshëm të narkotikëve por vërtetoi dënimin për veprën doganore të kontrabandimit të mallrave të ndaluara. Kërkuesi apeloj përsëri kundër dënimit për kontrabandë pranë Gjykatës së Kasacionit, duke cituar Nenin 6 § 1 dhe § 2 të Konventës. Gjykata e Kasacionit e rrëzoi apelin e tij mbi bazën se gjykata e apelit e kishte zbatuar të drejtën vendase në mënyrën e duhur.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi parashtroi se kodi doganor ishte aplikuar në rastin e tij në një mënyrë e cila ishte në mospërputhje me Nenin 6 § 1 dhe § 2, duke i vënë në barrë atij supozimin thuajse të pakundërshtueshëm të fajësisë.

### Neni 6

Dy paragrafët relevantë të Nenit 6 parashtrojnë që 1) gjatë përcaktimit të çdo akuze penale kundër një individ, ky i fundit ka të drejtën për proces të rregullt, dhe 2) një individ i akuzuar për veprë penale supozohet i pafajshëm deri sa të dëshmohet fajtor. Në rastin konkret, Shteti nuk e vuri në diskutim që kërkuesi ishte akuzuar për veprë penale. Dispozitat ndëshkuese të së drejtës doganore në Francë mund të konsideroheshin akuza penale për qëllimet e Nenit 6 sepse në nivel vendi ato shiheshin si e drejtë penale speciale meqenëse kërkonin caktimin e ndëshkimeve dhe gjobave pas dënimit. Megjithatë, Shteti debatoi që Kodi Doganor nuk përcaktonte supozimin e fajësisë – ai përcaktonte supozimin e përgjegjësisë. Duke pasur parasysh që nuk u vu në diskutim se kundër kërkuesit u ngritën akuza penale, çështja u përqendrua në përcaktimin nëse zbatimi i ligjeve doganore të Shtetit që në mospërputhje me prezumimin e pafajësisë, që është një aspekt i të drejtës për proces të rregullt.

Në praktikë, ligjet doganore të Shtetit nuk paraqisnin një prezumim të pakundërshtueshëm të fajësisë. Kërkuesi nuk u la krejtësisht pa asnjë mjet mbrojtjeje. Gjykata që bëri vlerësimin e dënimit për veprën doganore ishte e autorizuar të lejonte hapësirën për t'i besuar kërkuesit nën dritën e rrethanave lehtësuese dhe kishte për detyrë ta shpallte të pafajshëm nëqoftëse ai arrinte të dëshmonte një *force majeure* duke treguar se ai e kishte të pamundur të konstatohej përmbajtjen e paketës. Në këtë rast, gjykata e apelit që dakord se gjetjet faktike mbështetën vendimin e trupit gjykues për shpalljen fajtor për akuzën e veprës doganore të kontrabandimit të mallrave të importuara – kërkuesi që neglizhent në mënyrën se si e trajtoi sëndukun duke shpërfillur paralajmërimin e punonjësit të Air Zaïre, duke mos kontrolluar sëndukun për t'u siguruar se ai ishte vërtet paketa që përmbante gjërat që ai priste, dhe duke deklaruar në doganë se sënduku ishte pronë e tij dhe se ai nuk kishte asgjë për të deklaruar. Gjykata e apelit ia dha kërkuesit hapësirën për t'i besuar në lidhje me veprën penale të importit të paligjshëm të narkotikëve, duke theksuar se provat faktike nuk mbështesnin dënimin për një veprë të tillë, e cila kërkonte një barrë më të lartë të provës nga ana e prokurorisë.

Gjykata gjeti se gjykata e apelit u tregua e kujdesshme për të shmangur supozimet automatike të parashtruara në ligjet doganore të Shtetit. Gjykata e apelit iu përmbajt praktikës gjyqësore të mëparshme e cila mëtonte të zbatonte dënimet për vepra doganore në mënyrë të atillë që të moderonte natyrën e pakundërshtueshme të gjuhës së statuteve. Kështu, Gjykata vendosi që nuk kishte pasur shkelje të Nenit 6 § 1 dhe § 2.

*Urdhri për ngrirjen e asetëve pas kërkesës së autoriteteve kazake përbëri shkelle të drejtave pronësore të kërkuësës sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **SHORAZOVA K. MALTËS**

(Kërkesa Nr. 51853/19)

**3 mars 2022**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuësja ishte e lindur në vitin 1976 në Kazakistan dhe jetonte në Vjenë. Ajo ishte vejusha e Rakhat Aliyev (prej këtu RA). RA më parë kishte qenë i martuar me vajzën e presidentit të atëhershëm të Kazakistanit, Nursultan Nazarbayev (NN). RA kishte mbajtur disa pozita qeveritare në Kazakistan mes viteve 1991 dhe 2007. Megjithatë, mes RA dhe NN u krijuan tensione politike, dhe në vitin 2007 u lëshua një urdhërarrest për RA pas të cilit ai u arratis nga Kazakistani. Më pas, ai jetoi me kërkuësën në Maltë nga viti 2009 deri në vitin 2013.

Gjatë kësaj periudhe, autoritetet kazake zhvilluan hetime mbi akuzat për mashtrim dhe pastrim parash nga ana e kërkuësës dhe RA. Ato bënë kërkesa të shumta për ekstradim në Shtete Evropiane (si Austria, Gjermania dhe Lihtenshtajni). Në vitet 2008-2009, pasi Austria refuzoi të ekstradonte RA, në Kazakistan u mbajtën dy gjyqe *in absentia*, ku RA u shpall fajtor për vepra politike dhe u dënua për të dyja me 20 vjet burgim. Në vitin 2014, Kazakistani i kërkoi Maltës implementimin e një urdhri për ngrirjen e asetëve të kërkuësës dhe RA, me të cilin Malta u pajtua.

Në vitin 2014, kërkuësja dhe RA filluan procedurat për zgjidhje kushtetuese në lidhje me ngrirjen e asetëve të tyre, të cilat qenë pa sukses. RA vdiq në burg në Austri në vitin 2015, në pritje të gjyqit për akuza të vrasjes. Në vitin 2020, kërkuësja bëri kërkesë në Gjykatën Penale të Maltës, duke argumentuar se urdhri i ngrirjes kundër saj duhet të hiqej. Më 2 nëntor 2020, Gjykata Penale malteze u njoftua për kërkesën e kërkuësës pranë Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut. Në vitin 2021, Gjykata Penale e Maltës nuk gjeti baza për mbajtjen e urdhrit, meqenëse nuk kishte pasur asnjëherë procedura kundër kërkuësës nga autoritetet kazake. Kështu, urdhri i ngrirjes u hoq.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja u ankua që pajtueshmëria e Maltës me kërkesën për ndihmë dhe me urdhrin vijues për ngrirje shkelën të drejtat e saj sipas Nenit 6 § 1 dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës. Për më tepër, kërkuesja argumentoi se procedurat kushtetuese që ajo kishte nisur për t'u ankuar rreth shkeljes së të drejtave të saj kishin qenë tepër të gjata, katër vjet e dhjetë muaj, duke shkelur të drejtat e saj sipas Nenit 6 § 1.

### Neni 1 i Protokollit Nr. 1

Gjykata konsideroi se urdhri i ngrirjes përbëri ndërhyrje tek të drejtat pronësore të kërkueses që kishin të bënin me kontrollimin e përdorimit të pasurisë. Ndërkohë që masa u mor në përputhje me të drejtën vendase, ajo nuk qe në përputhje me ligjin *ab initio*, meqenëse, sipas Gjykatës Penale të Maltës, kërkuesja nuk kishte, e as nuk kishte pasur kurrë, statusin e personit të ngarkuar ose të akuzuar në Kazakistan, por vetëm statusin e personit të dyshuar, çka i mohonte asaj dhe burrit të saj pozicionin ligjor dhe të drejtat përkatëse që u takonin si të akuzuar në këto procedura. Gjykata e gjeti shqetësues faktin se, për gati tetë vjet, asnjë autoritet ose gjykatë vendase nuk kishte shqyrtuar në tërësi ligjshmërinë e situatës së kërkueses. Kjo, sipas pikëpamjes së Gjykatës, pasqyronte një problem serioz në nivel vendi.

Më tej, Gjykata vuri në pyetje nëse masa synonte një interes të përgjithshëm. Gjykata njohu se jurisprudenca e saj përgjithësisht respektonte gjykimet e autoriteteve shtetërore se çka përbën interes të përgjithshëm. Megjithatë, në këtë rast të veçantë, ishte e qartë nga materialet e paraqitura në Gjykatë dhe në gjykatat vendase që RA ishte kundërshtar politik i vendosur i regjimit kazak, kështu që mund të përballej me raprezalje nga ana e pushtetit. Prandaj, ndërkohë që urdhri i ngrirjes mund të ishte në interesin e përgjithshëm, rrethanat e veçanta të çështjes kërkonin një vlerësim të kujdesshëm nga gjykatat vendase.

Qeveria argumentoi se masa synonte luftimin e krimit dhe se ajo ishte marrë në linjë me detyrimet e Maltës ndaj Nenit 18 të Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Transkombëtar. Megjithatë, Gjykata theksoi se ndihma ligjore e ndërsjellë duhet të ishte në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Megjithëse kishte baza të mjaftueshme për të vënë në pyetje natyrën e mirëfilltë të veprimeve të ndërmarra nga Kazakistani, gjykatat malteze me kompetenca kushtetuese gjetën se masa automatikisht synonte një interes të përgjithshëm pa një vlerësim të detajuar të situatës në rastin konkret.

Sa i përket çështjes së proporcionalitetit, Gjykata konsideroi se ngrirja e të gjitha pasurive të kërkueses ishte, për nga natyra, një masë e rreptë dhe kufizuese sepse ajo kishte kapacitetin që të ndikonte tek të drejtat e një pronari deri në atë masë sa aktiviteti i tij i biznesit apo qoftë edhe kushtet e jetesës mund të viheshin në rrezik. Procedurat para Gjykatës Penale të Maltës, me anë të të cilave urdhri për ngrirje u lëshua dhe u vazhdua në mënyrë të përsëritur, e privuan kërkuesen nga mbrojtjet procedurale përkatëse kundër arbitraritetit ose ndërhyrjes joproporcionale. Gjykata deklaroi se juridiksionet kushtetuese dështuan në korrigjimin e atyre mosveprimeve, duke adresuar vetëm sa për sy e faqe kriteret përkatëse në vlerësimin prej tyre të masës së kontestuar, për të cilën kërkuesja kishte pretenduar se ishte në shkelje të të drejtave të saj sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Kështu, Gjykata deklaroi se të drejtat pronësore të kërkueses, si rezultat i kësaj, u bënë të pavlefshme. Këto konsiderata qenë të mjaftueshme për t'i mundësuar Gjykatës që të arrinte në përfundimin se kishte pasur shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës.

#### Neni 6 § 1

Duke pasur parasysh gjetjet e mësipërme sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, Gjykata konsideroi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtoheshin procedurat e zakonshme nën dritën e Nenit 6 § 1.

Në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave kushtetuese, Gjykata theksoi se, përveç gjashtë muajve, çka mund të shpjegohej me kompleksitetin e çështjes dhe me parashtrimet e reja, nuk kishte pasur ndonjë periudhë të veçantë mos-aktiviteti, dhe kërkuesja as nuk kishte treguar ndonjë sjellje tjetër të mangët nga ana e autoriteteve. Prandaj, ndërkohë që Gjykata konsideroi se katër vjet e dhjetë muaj ishte periudhë e gjatë për të përcaktuar një çështje në dy nivele të juridiksionit, kohëzgjatja nuk ishte e tepërt dhe nuk kishte pasur shkelje të Nenit 6 § 1 në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave për zgjidhje kushtetuese.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkueses 2000 euro për dëme jomateriale dhe 586 euro për kosto dhe shpenzime.

*Konfiskimi i pronës nga gruaja e një burri të përfshirë në kontrabandë, i cili kishte vdekur para finalizimit të procedurave penale, nuk qe shkelje e Konventës*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **SILICKIENË K. LITUANISË**

(Kërkesa Nr. 20496/02)

**10 korrik 2012**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesja ishte shtetase lituaneze e lindur në vitin 1971. Burri i saj ishte zyrtar policor i lartë tatimor, i ndjekur për një sërë veprash të rënda, mes të cilave përfshirje në grup kriminal për kontrabandimin e sasive të mëdha alkooli dhe cigaresh. Ai u paraburgos në gusht të vitit 2000.

Në vitin 2000, hetuesi ngriu disa pjesë pasurie që i përkisnin kërkueses, burrit të saj dhe nënës së tij. Në vitin 2002, si rezultat i një apeli nga vjehrra e kërkueses, gjykata e liroi një pjesë të pasurisë së saj. Vetë kërkuesja nuk apeloj kundër marrjes së pasurisë. Pas vdekjes së burrit të kërkueses në burg në vitin 2003, gjykata lituaneze vendosën t'i vazhdonin procedurat penale meqenëse ato kishin të bënin me aktivitetet e një shoqate kriminale. Gjykata shpalli fajtorë dhe dënoi tre anëtarë të grupit me disa vite burgim, dhe urdhëroi konfiskimin e disa pasurive të caktuara, meqenëse gjeti se ato ishin përftuar si rezultat i aktiviteteve të organizatës kriminale. Kërkuesja angazhoi një avokat për të apeluar në emër të të gjithë personave të prekur nga konfiskimi. Apeli u rrëzua, sepse gjykata vendase arsyetuan që individët e dënuar kishin vepruar si grup i organizuar, dhe që ata nuk kishin arritur të shpjegonin se si ishin përftuar pasuritë. Përveç kësaj, kërkuesja kishte qenë plotësisht në dijeni të aktiviteteve kriminale të burrit të saj.

Gjykata e apelit gjithashtu rrëzoi argumentin e avokatit se konfiskimi kishte qenë i paligjshëm për shkak se procedurat penale kundër burrit të kërkueses ishin ndërprerë. Ajo iu referua Nenit 72 të Kodit Penal, i cili i detyron gjykatat të konfiskojnë pasurinë e ardhur nga krimi, nëqoftëse personat të cilëve ajo pasuri u është transferuar e kanë ditur origjinën e paligjshme të saj. Një apel në kasacion i ngritur nga i njëjti avokat u rrëzua nga Gjykata Supreme. Në procedura të ndara penale, kërkuesja u shpall fajtorë për përvetësim të pasurisë dhe falsifikim të dokumenteve dhe u dënua me katër vjet burgim. Megjithatë, ajo u lirua në vijim të një ligji për amnesti.



## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja u ankua se ajo nuk kishte mundur të mbronte të drejtat e saj siç duhej sepse nuk kishte qenë palë e procedurave penale kundër burrit të saj të ndjerë, dhe se ajo ishte detyruar nga të tjerët që të merrte përsipër përgjegjësinë për krimet kinse të kryera nga burri i saj i cili nuk ishte dënuar. Ajo u mbështet në Nenin 6 § 1 dhe § 2 dhe Nenin 1 të Protokollit Nr.1.

### Neni 6 § 1

Ankesa e kërkueses hynte tek Neni 6 § 1, meqenëse kontesti në fjalë kishte të bënte me një të drejtë civile. Çështja para Gjykatës ishte nëse procedurat e konfiskimit kishin respektuar parimet bazë të gjyqit të drejtë, dhe kryesisht nëse kërkueses i ishin dhënë mundësi të mjaftueshme për të paraqitur argumentet e saj para gjykatave, në vend të shqyrtimit në terma abstrakte të përputhshmërisë së Konventës me të drejtën penale lituaneze, e cila i detyronte gjykatat të konfiskonin pasurinë e përfutur ilegalisht, përfshirë pasurinë e transferuar tek persona të tretë.

Megjithëse kërkuesja nuk kishte qenë palë në procedurat penale kundër organizatës kriminale, Gjykata gjeti se sistemi ekzistues i kishte siguruar mbrojtjet. Në mënyrë të veçantë, kërkuesja mund të kishte hapur procedura shqyrtimi gjyqësor për të kontestuar marrjen e pasurisë, gjë që ajo nuk e kishte bërë.

Përveç kësaj, gjatë apelit, duke përfaqësuar interesat e saj avokati i saj kishte ngritur në mënyrë specifike çështjen e pasurisë së konfiskuar në lidhje me secilën pikë dhe secilin objekt të konfiskimit. Sikur kërkuesja të kishte pasur prova që tregonin burimin legjitim të pasurisë së saj, ajo do të mund t'ia kishte dhënë avokatit gjatë procedurave të apelit. Rrjedhimisht, Gjykata doli në përfundimin se kërkueses i ishin dhënë mundësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme për të paraqitur argumentet e saj, dhe se prandaj nuk kishte pasur shkelje të Nenit 6 § 1.

### Neni 6 § 2

Kërkuesja diskutoi se ajo ishte detyruar të merrte përsipër përgjegjësinë për veprimet kriminale kinse të kryera nga burri i saj i ndjerë. Duke rikujtuar rregullën themelore të së drejtës penale që përgjegjësia penale nuk i mbijeton personit që e ka kryer veprën penale, Gjykata ripërmendi se, edhe pse procedura penale kundër burrit të kërkueses ishte ndërprerë, procedurat në tërësi nuk ishin përmbyllur sepse tre prej bashkëpunëtorëve të tij kishin dënuar për formimin e një organizate kriminale

bashkë me të. Gjykatat lituaneze kishin gjetur se pasuria e konfiskuar ishte përftuar nga të ardhurat ilegale të aktiviteteve penale të tërë organizatës kriminale, e jo vetëm përmes akteve të burrit të kërkueses.

Gjykata doli në përfundimin se kërkuesja nuk ishte ndëshkuar për veprat penale të kryera nga burri i saj i ndjerë, dhe kështu nuk e kishte “trashëguar” fajësinë e tij, dhe urdhri i konfiskimit nuk mund të shihej si i tillë që e gjente atë fajtores për ndonjë veprë. Rrjedhimisht, nuk kishte pasur shkelje të Nenit 6(2).

#### Neni 1 i Protokollit Nr. 1

Konfiskimi i pasurisë së kërkueses ishte urdhëruar në përputhje me Nenin 72 të Kodit Penal, kështu që kishte qenë i ligjshëm. Konfiskimi kishte prekur asetet të cilat ishin përftuar ilegalisht nga organizata kriminale e udhëhequr nga burri i ndjerë i kërkueses, dhe kishte synuar qëllimin legjitim të sigurimit që kërkuesja të mos përfitonte nga të ardhurat e krimit në dëm të komunitetit.

Gjykatat vendase kishin gjetur se kërkuesja kishte marrë pjesë personalisht në bërjen e pagesave për mallrat e kontrabanduara; prandaj ajo duhet të kishte qenë në dijeni se pasuria e konfiskuar do të mund të ishte përftuar vetëm me të ardhura nga aktivitetet e organizatës kriminale. Ajo gjithashtu ishte gjetur fajtores për përvetësim dhe falsifikim të dokumenteve në procedura të ndara. Përveç kësaj, konfiskimi ishte urdhëruar në procedura para tri gjykatave vendase të ndara, të cilat kishin gjetur se asetet e konfiskuara ishin blerë me të ardhurat e paligjshme të organizatës kriminale. Në fund, aktivitetet ilegale ishin zhvilluar në shkallë të madhe dhe kishin qenë sistematike. Rrjedhimisht, konfiskimi dukej të ishte një masë thelbësore në luftën kundër krimit të organizuar, dhe Gjykata doli në përfundimin se ai nuk shkelti të drejtën e kërkueses për gëzimin paqësor të pasurive të saj.

Prandaj, nuk kishte pasur shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

*Refuzimi i gjykatave për të caktuar kompensim për paraburgimin paragjyqësor dhe humbjen dhe dëmet në pasurinë e marrë gjatë procedurave penale pas lirimit nga akuzat përbëri shkelje të Nenit 6 dhe të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **TENDAM K. SPANJËS**

(Kërkesa Nr. 25720/05)

**13 korrik 2010**

### **1. Faktet kryesore**

Kundër kërkuesit u hapën dy procedura në vitin 1986, për vjedhje dhe për veprime me mallra të vjedhura. Si pjesë e procedurës së parë, ai u paraburgos në pritje të gjyqit për 135 ditë, u shpall fajtor nga gjykata e shkallës së parë më 12 prill 1993, por më pas u shpall i pafajshëm në apel më 9 shtator 1993. Si pjesë e procedurës së dytë, disa bastisje në shtëpinë dhe dyqanin e elektronikës së kërkuesit u autorizuan në mars 1986 gjatë kohës që ai ndodhej në paraburgim paragjyqësor, ku bastisjet u zhvilluan në prani të gruas së kërkuesit. Gjatë bastisjeve, disa pajisje, shumë prej tyre elektronike, u morën dhe u mbajtën nga Garda Civile në pritje të përmbylljes së procedurës. Ai u shpall i pafajshëm gjithashtu edhe për akuzën e dytë më 29 tetor 1993, dhe më 19 nëntor 1993 ai kërkoi rikthimin e posedimeve të marra prej tij gjatë hetimeve.

Sendet e marra u kthyen më 22 janar 1994. Megjithatë, disa prej tyre ishin zhdukur, pasi u ishin dhënë personave që pretendonin se ishin pronarë të cilët kishin raportuar vjedhjen e tyre përpara marrjes. Prej sendeve të kthyera kërkuesit, shumë prej tyre ishin të dëmtuara ose në gjendje të keqe, dhe shumë prej tyre ishin ndryshkur. Kërkuesi aplikoi në Ministrinë e Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme për kompensimin e dëmeve në lidhje me paraburgimin e tij të mëparshëm, për dështimin për t'i kthyer sendet e bastisura, dhe për dëmin e sendeve që ishin kthyer. Ankesa vendase e kërkuesit u rrëzua dhe apelet e tij të mëtejshme qenë të pasuksesshme. U vendos se kërkuesi nuk kishte vërtetuar që sendet e marra ishin zhdukur ose ishin dëmtuar.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi diskutoi se refuzimi për të caktuar kompensim për paraburgimin paragjyqësor për humbjet që rezultuan nga prishja e sendeve të marra gjatë procedurave penale përbëri shkelje të Nenit 6 § 2 dhe të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

## Neni 6

Gjykata konfirmoi se e drejta për prezumimin e pafajësisë shkelet nëqoftëse një vendim gjyqësor pasqyron idenë se i pandehuri është fajtor edhe kur fajësia e tij nuk është konstatuar (d.m.th. pas shfajësimit ose përpara konstatimit të fajësisë). Neni 6 § 2 shtrihet përtej procedurës penale fillestare, dhe përfshin procedurat gjyqësore pas shfajësimit kur çështjet e ngritura janë në vijimësi të atyre procedurave. Prandaj, pasi shpallja e pafajësisë bëhet përfundimtare, shprehjet gjyqësore të dyshimeve rreth pafajësisë së një të akuzuari nuk janë më të pranueshme. Kjo vlen për shpalljen e pafajësisë për mungesë provash po aq sa edhe për shpalljen e pafajësisë që rezulton nga gjetja e pafajësisë.

Gjykata theksoi se refuzimi nga ana e Ministrit të Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme për të dhënë kompensim për paraburgimin paragjyqësor të kërkuesit ishte bazuar mbi faktin se ai ishte shpallur i pafajshëm në apel për mungesë provash të mjaftueshme. Ky dallim mes shpalljes së pafajësisë për mungesë provash dhe shpalljes së pafajësisë mbi bazën e gjetjes se vepra e supozuar nuk ishte kryer hodhi dyshime mbi pafajësinë e kërkuesit. Për më tepër, gjykatat vendase e kishin mbështetur arsyetimin e Ministrisë pa e zgjidhur çështjen në fjalë. Rrjedhimisht, Gjykata gjeti shkelje të Nenit 6 § 2 të Konventës.

## Neni 1 i Protokollit Nr. 1

Gjykata theksoi se bastisja e ankimuar nuk kishte për qëllim privimin e tij nga posedimet e tij por kontrollin e përkohshëm mbi përdorimin e tyre prej tij. Për më tepër, nuk kishte asnjë tregues se bastisjes i mungonte baza ligjore. Megjithatë, Gjykata përsëriti se mënyrat e përdorura nga Shteti duhet të jenë proporcionale me qëllimin e synuar. Më tej, pavarësisht nga heshtja e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 në lidhje me kriteret procedurale, procedurat e aplikueshme gjithashtu duhet t'i ofrojnë personit në fjalë mundësi të përshtatshme për të paraqitur argumentet e tij para autoriteteve kompetente në mënyrë që të kontestojë masat që shkelin të drejtat e garantuara me atë dispozitë.

Gjykata përsëriti se një pronar që shpallet i pafajshëm për kontrabandë duhet, në parim, të ketë të drejtën për të rimarrë sendet e bastisura pas shfajësimit të tij. Neni 1 i Protokollit Nr. 1 nuk përcakton të drejtën e personit të shfajësuar për të marrë kompensim për ndonjë dëm që rezulton nga bastisja e posedimeve të tij gjatë hetimeve në procedura penale. Megjithatë, autoritetet që kryejnë bastisjet duhet të marrin masa të arsyeshme për ruajtjen e sendeve të bastisura, në mënyrë të veçantë

duke bërë një inventar të posedimeve në kohën e bastisjes, si dhe kur ato i kthehen pronarit pas shfajësimit. Për më tepër, legjislacioni vendos duhet të ofrojë rrugë për nisjen e procedurave kundër Shtetit për të marrë kompensim për dëmet në posedimet e konfiskuara që rezultojnë nga mos-mbajtja e tyre në kushte arsyeshëm të mira nga ana e Shtetit. Megjithatë, i takon Shteteve Kontraktuese që të përcaktojnë saktë kushtet në të cilat ekziston e drejta për kompensim në rrethana në tilla.

Në rastin konkret, Gjykata konsideroi se barra e provës në lidhje me sendet e munguara ose të dëmtuara binte mbi autoritetet gjyqësore, të cilat ishin përgjegjëse për ruajtjen e sendeve përgjatë tërë kohës së mbajtjes së tyre. Meqenëse autoritetet nuk kishin ofruar ndonjë justifikim për zhdukjen e disa sendeve dhe për dëmtimin e disa sendeve të tjera, ato ishin përgjegjëse për humbjet e shkaktuara si rezultat i bastisjes. U vendos që, duke refuzuar kërkesën për kompensim, Shteti i kishte vënë kërkuarit një barrë joproporcionale dhe të tepërt. Duke pasur parasysh këtë, u gjet shkelje e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

#### Neni 41

Gjykata e rezervoi çështjen e dëmeve materiale meqenëse nuk qe e gatshme për vendim, duke lejuar mundësinë e një marrëveshjeje mes kërkuarit dhe Shtetit, por i caktoi kërkuarit 15,600 euro për dëme jomateriale.

*Konfiskimi i asetëve të kërkuesit pas zbatimit të një ligji të ri për marrje  
nuk angazhoi Nenin 7 dhe as nuk shkeli Nenin 1 të Protokollit 1*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **ULEMEK K. SERBIË**

(Kërkesa Nr. 41680/13)

**2 shkurt 2021**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte shtetas serb i lindur në vitin 1968. Në kohën e vendimit të Gjykatës Evropiane ai ishte duke vuajtur dënimin me burg në Pozharevc. Mes viteve 2007 dhe 2009, kërkuesi u dënua si udhëheqës i një grupi të organizuar kriminal për disa krime të rënda të kryera mes viteve 1999 dhe 2003, dhe u dënua me 40 vjet burgim.

Më 29 mars 2010, Prokuroria e Krimit të Organizuar bëri një kërkesë për marrjen e asetëve të kërkuesit në përputhje me Ligjin për Bastisjen dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi (Ligji i vitit 2008). Objekt i kërkesës së Prokurorit ishte shtëpia e kërkuesit, e cila ishte blerë në vitin 1998 për 374,409 Marka Gjermane (afro 190,000 Euro).

Prokurori pretendoi që të ardhurat e ligjshme të kërkuesit të mbledhura bashkë nga viti 1996 deri në vitin 1998, kur ai e kishte blerë shtëpinë, kishin qenë vetëm 22,789 Marka Gjermane (afro 11,650 Euro), më pak se një e pesëmbëdhjeta e shumës që ai kishte paguar për atë pronë. Meqenëse kishte një mospërputhje të qartë mes të ardhurave të ligjshme të kërkuesit dhe vlerës së pronës së tij, dhe meqenëse ai kishte qenë i dënuar si anëtar i një grupi të organizuar kriminal, Prokurori kërkoi që t'i merrej shtëpia në fjalë.

Më 20 maj 2010, Gjykata e Lartë e Beogradit e pranoi kërkesën e Prokurorit dhe lëshoi një urdhër marrjeje. Gjykata arsyetoi se kishte mospërputhje të qarta mes të ardhurave të ligjshme të kërkuesit dhe vlerës së pronës së tij. Meqenëse kërkuesi kishte dështuar të ofronte prova të mundshme që e kishte blerë pronën e kontestuar me asete të fituara ligjërisht, dhe meqenëse ai kishte qenë i dënuar për krime të rënda me elemente të krimit të organizuar përmes të cilave ai kishte "fituar të ardhura jashtëzakonisht të mëdha", marrja qe e justifikuar. Gjykata e Lartë e Beogradit gjithashtu shpjegoi se kjo lloj marrjeje nuk kërkonte gjetjen e një lidhjeje të drejtpërdrejtë mes krimit për të cilin ishte dënuar kërkuesi dhe blerjes së

pronës. Prona e kërkuesit po merrej mbi bazën e një procedure speciale që kishte në shënjestër të ardhurat kriminale të personave të dënuar për krim të organizuar, çka ishte krejtësisht e ndryshme nga marrja e zakonshme kriminale.

Në apel, urdhri i marrjes u konfirmua nga gjykatat më të larta mbi të njëjtat baza. Kjo arriti kulmin me një vendim të Gjykatës Kushtetuese më 26 nëntor 2012 i cili i rrëzoi të gjitha ankesat e kërkuesit në lidhje me urdhrin e gjykatës më të ulët.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua sipas Nenit 7 § 1 që zbatimi i masës së marrjes në rastin e tij kishte shkelur parimin e mos-retroaktivitetit të së drejtës penale. Përveç kësaj, duke u mbështetur tek Neni 1 i Protokollit Nr. 1, kërkuesi u ankua që marrja e pronës së tij kishte shkelur të drejtën e tij për gëzimin paqësor të pasurisë.

### Neni 7

Për qëllimet e Konventës, nuk mund të ketë “dënim” deri sa të përcaktohet në përputhje me ligjin që është kryer një vepër - penale ose, nëse është me vend, disiplinore. Ngjashëm, nuk mund të ketë dënim nëqoftëse nuk përcaktohet përgjegjësia personale. Koncepti i “dënim” në Nenin 7 ka kuptim autonom. Për ta bërë efektive mbrojtjen e ofruar nga ky Nen, Gjykata duhet të jetë e lirë të shkojë përtej aparenave për ta vlerësuar vetë nëse një masë e caktuar përbën “dënim” në thelb. Pika fillestare në këtë vlerësim është nëse masa në fjalë është caktuar pas vendimit që personi është fajtor për një vepër penale. Megjithatë, ka faktorë të tjerë që mund të merren parasysh gjithashtu në lidhje me këtë, si natyra dhe qëllimi i masës në fjalë, karakterizimi i saj sipas të drejtës vendase, procedurat në marrjen dhe zbatimin e masës, dhe rreptësia e saj.

Në rastin konkret, Gjykata theksoi se marrja sipas Nenit 2 të Ligjit të vitit 2008 aplikohet vetëm nëqoftëse kishte një dënim për një prej veprave të rënda të cekura në atë dispozitë, përfshirë krimin e organizuar. Prandaj urdhrat e marrjes ishin të lidhur me dhe të varur nga kryerja e një veprë penale të një shkalle të mjaftueshme.

Sa i përket karakterizimit të masës sipas të drejtës vendase, gjykatat serbe qenë unanime në përfundimin e tyre që marrja e asetëve të fituara në mënyrë kriminale nuk përbënte dënim brenda kuptimit të Nenit 34 § 2 të Kushtetutës dhe Nenit 7 § 1 të Konventës. Gjykatat gjetën se marrja e asetëve nuk ishte dënim shtesë por pasojë e faktit që një kryes ose përfitues të tjerë kishin përfutuar asete të ardhura nga një

akt i paligjshëm. Gjykata theksoi se institucioni i marrjes së aseteve kriminale që u zbatua në rastin e kërkuesit nuk ishte i rregulluar me Kodin Penal të Serbisë por me një legjislacion krejtësisht tjetër, pra me Ligjin e vitit 2008. Prandaj, nuk kishte asgjë në legjislacionin përkatës që e klasifikonte masën qartë si dënim.

Gjatë vlerësimit të natyrës dhe qëllimit të urdhrave të marrjes, Gjykata vërejti se masat e përcaktuara në Ligjin e vitit 2008 ishin konceptuar për të qenë në pajtim me detyrimet sipas Konventës së Këshillit të Evropës për Pastrimin, Bastisjen, Marrjen dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi. Prandaj, urdhrat e marrjes qartazi ishin konceptuar për të siguruar që krimi nuk ia vlente dhe ishin të natyrës restorative jo penale.

Gjykata gjithashtu vërejti se disa karakteristika të sistemit serb të marrjes së aseteve kriminale sipas Ligjit të vitit 2008 ishin të krahasueshme me marrjen civile dhe jo me gjobën sipas të drejtës penale. Së pari, legjislacioni përkatës sugjeronte që sistemi ishte i drejtuar kah prona dhe jo kah personi, çka ishte e dukshme nga fakti se marrja mund të urdhërohej për prona që i përkisnin një personi të tretë nëqoftëse prona e kishte origjinën nga krimi dhe personi i tretë nuk kishte të drejta ligjore valide mbi të. Së dyti, Ligji i vitit 2008 njihte mundësinë e konfiskimit të pronës së një personi të vdekur i cili nuk ishte dënuar asnjëherë për krime, nëqoftëse prona ishte blerë me të ardhura nga krimet e një pale të tretë. Së treti, shkalla e fajësisë së kryesit nuk ishte relevante për caktimin e shumës së aseteve të deklaruara të marra. Së katërti, urdhrat e marrjes nuk mund të zbatoheshin përmes burgimit në vend të pagimit. Në fund, gjatë lëshimit të urdhrat të marrjes, gjykatat serbe gjithashtu mund të vendosnin që të caktonin disa ose të gjitha asetet e konfiskuara për të mirën e viktimës, çka ishte më shumë e krahasueshme me rikthimin sipas të drejtës civile sesa me gjobën sipas të drejtës penale.

Në lidhje me procedurat e urdhërimit dhe zbatimit të masës, urdhri i marrjes ishte sjellë nga një dhomë e veçantë e gjykatës penale në procedura të veçanta të marrjes, vlerësimi i të cilave kishte qenë objektiv dhe i bazuar në prova relevante, në mungesë të një kundërshtimi të suksesshëm, dhe pas dënimit përfundimtar të kërkuesit.

Në lidhje me shkallën e marrjeve, Gjykata rikujtoi që rreptësia e masës në fjalë në vetvete nuk është vendimtare meqenëse shumë masa jopenale mund të kenë impakt substancial mbi personin e përfshirë.

Pasi peshoi të gjithë faktorët me rëndësi, Gjykata arriti në përfundimin se urdhri i marrjes që ishte lëshuar kundër kërkuesit nuk përbëri "dënim" sipas Neni 7, dhe se Neni 7 nuk ishte i aplikueshëm.



### Neni 1 i Protokollit Nr. 1

Gjykata theksoi se urdhri i marrjes në çështjen në fjalë përbënte ndërhyrje tek e drejta e kërkuesit për gëzimin paqësor të pasurive të tij. Nuk kishte dyshime në lidhje me qartësinë, saktësinë, ose parashikueshmërinë e urdhrin të marrjes nga gjykata vendase mbi bazën e ligjeve për marrje. Duke pasur parasysh argumentin e kërkuesit se ishte arbitrare që fushëveprimi i mekanizmit të konfiskimit të shtrihet në mënyrë retrospektive për të përfshirë pasurinë që ai e kishte blerë përpara hyrjes në fuqi të Ligjit për Marrjen, Gjykata përsëriti se kriteri i “ligjshmërisë” i përmbajtur në Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 normalisht nuk kuptohet si i tillë që e pengon legjislatoren nga kontrollimi i përdorimit të pasurisë apo ndërhyrja tek të drejtat me anë të dispozitave të reja retrospektive që rregullojnë situatat e vazhdueshme faktike ose marrëdhëniet ligjore. Kështu, Gjykata konsideroi që marrja e pasurisë së kërkuesit ishte në përputhje të plotë me kriterin e “ligjshmërisë” në Nenin 1 të Protokollit Nr. 1.

Sa i përket ligjshmërisë së ligjit, masa ishte pjesë esenciale e një pakete më të madhe legjislative që kishte për qëllim intensifikimin e luftës kundër krimit të organizuar. Ajo kryesisht ishte dizajnuar për të privuar një person nga përfitimet e arritura nga përfshirja në aktivitete kriminale dhe, më së rëndësishmi, për të hequr vlerën e të ardhurave nga përdorimi i mundshëm në të ardhmen në aktivitete kriminale. Qëllimi i masës ishte, rrjedhimisht, jo vetëm të siguronte që krimet nuk ia vlejnin por gjithashtu edhe për të parandaluar qarkullimin e asetëve për vijimësinë e veprimtarisë kriminale. Përveç kësaj, masa qartazi kishte elemente rikthyese meqenëse gjykatat patën mundësinë t’ia kalonin pasurinë e konfiskuar viktimave të krimeve.

Më tej, Gjykata theksoi se kërkuesi e kufizoi ankesën e tij tek aplikimi “retroaktiv” i marrjes. Nuk kishte asgjë që sugjeronte se masa e marrjes ishte joproporcionale me qëllimet legjitime të synuara.

Prandaj, ankesa sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 u refuzua.

*Ankesat e kërkuetit në lidhje me mungesën e arsytimit në urdhrin e konfiskimit u deklaruan të papranueshme për shkak të mos-shterimit të zgjidhjeve vendase*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **WEBB k. MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesa Nr. 56054/00)  
**10 shkurt 2004**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi u ndalua në Molin Lindor në Dover nga një zyrtar doganor më 26 tetor 1994. Pasi u mor në pyetje, ai shpjegoi se kishte rreth 27,000 Paund (afro 44,000 Euro) në para të thata për investime jashtë vendit. Ai e korrigjoi këtë me shifrën 39,000 Paund (afro 63,000 Euro) pak çaste më vonë, dhe deklaroi se paratë ishin vetëm pjesërisht të tijat dhe se ai po udhëtonte që të blinte mobilje ose një makinë antikuariat. Ai refuzoi të jepte emrin e pronarit tjetër të pjesshëm të parave. Paratë iu bastisën sipas Ligjit të vitit 1990 për Drejtësinë Penale (Bashkëpunimi Ndërkombëtar) ('Ligji i vitit 1990'), më vonë i zëvendësuar nga Ligji për Trafikun e Drogës i vitit 1994 ('Ligji i vitit 1994'). Zyra e Doganës dhe Akcizës bëri kërkesë për konfiskimin e parave, me argumentimin se paratë e kapura përfaqësonin të ardhurat nga trafikimi i drogës dhe/ose ishin të dedikuara për përdorim në trafik droge.

Gjykata e Magjistratëve në Dover urdhëroi konfiskimin e parave pasi Zyra e Doganës dhe Akcizës paraqiti prova që kartmonedhat e kapura përmbanin gjurmë të drogave ilegale mbi to. Kërkuesi kishte qenë evaziv kur ishte ndaluar, dhe kishte pranuar se kishte qenë i dënuar për vepra të lidhura me drogë në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Gjermani. Kërkuesi u përfaqësua nga një avokat gjatë tërë procedurës, dhe u lejua të paraqiste prova për të mbështetur argumentet e tij. Gjykata e Magjistratëve urdhëroi konfiskimin e parave, por nuk dha arsye publikisht për vendimin e saj.

Gjykata vendase gabimisht regjistroi në procesverbal që urdhri i konfiskimit ishte marrë sipas Ligjit të vitit 1990, i cili, ndryshe nga Ligji i saktë i vitit 1994, nuk parashikonte ri-dëgjimin në apel nga një gjykatë më e lartë por lejonte vetëm kërkesën për shqyrtim gjyqësor të vendimit. Kërkuesi kërkoi shqyrtimin gjyqësor të vendimit të marrjes mbi bazën se gjykata vendase nuk kishte dhënë arsye për vendimin e saj. Gjatë kërkesës për shqyrtim gjyqësor, Zyra e Doganës dhe Akcizës parashtroi se në fakt kërkuesi e kishte të drejtën për apel para Gjykatës së Kurorës për ri-dëgjim sipas Ligjit të vitit 1994. Në përgjigje ndaj kësaj, kërkuesi i ndryshoi bazat e shqyrtimit të

tij gjyqësor duke argumentuar se urdhri i konfiskimit duhet të bëhej nul sepse gjykata vendase e kishte marrë vendimin e saj sipas Ligjit të vitit 1990 kur në fakt Ligji i vitit 1994 tashmë e kishte zëvendësuar atë.

Gjykata e rrëzoi këtë kërkesë mbi bazën se referenca e gjykatës vendase ndaj statutit të gabuar ishte thjesht formalitet dhe se procedura kishte zbatuar ligjin e saktë. Kërkuesi apeloj ndaj këtij vendimi duke argumentuar se referenca ndaj Ligjit të vitit 1990 e kishte paragjykuar atë duke e çorientuar atë dhe avokatët e tij dhe duke i bërë të besonin se e drejta për ri-dëgjim në apel nuk ekzistonte. Megjithatë, edhe ky apel u rrëzua po ashtu.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua sipas Nenit 6 § 1 (e drejta për proces të rregullt) që Gjykata e Magjistratëve nuk i kishte dhënë atij një vendim të arsyetuar në lidhje me urdhrin e konfiskimit. Ai gjithashtu u ankua që standardi i provës që kërkohet për të konfiskuar paratë kishte qenë i bazuar në shkallën e probabilitetit, ku standardi civil, pavarësisht se të ardhurat kishin karakter kriminal, ishte më i lartë, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Më tej, kërkuesi u ankua sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (mbrojtja e pasurisë) që konfiskimi i pasurisë së tij mbi bazën e standardit civil të provës kishte shkelur të drejtat e tij sipas Konventës.

### Neni 6

Gjykata filloi duke përsëritur se Neni 6 sipas titullit të tij civil nuk ishte i aplikueshëm në procedurat e marrjes meqenëse urdhri i konfiskimit nuk nënkuptonte përcaktim të fajësisë penale. Rrjedhimisht, aplikimi i standardit civil të provës ishte i saktë, dhe ankesa e kërkuesit ishte e papranueshme. Pasi shqyrtoi nëse procedura ishte e drejtë sipas titullit civil të Nenit 6, Gjykata konsideroi që çështje duhet të adresohet në kontekstin e ankesës së kërkuesit sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

### Neni 1 i Protokollit Nr. 1

Gjykata theksoi se thelbi i argumentit të kërkuesit ishte që ai ishte privuar nga pasuria e tij në mungesë të mbrojtjeve të mjaftueshme procedurale. Gjykata përcaktoi se urdhri i konfiskimit ishte bazuar mbi të drejtën vendase dhe kishte një qëllim legjitim, konkretisht luftën kundër trafikimit të drogës, dhe më pas vazhdoi me vlerësimin nëse ishte arritur ekuilibri i drejtë mes përmbushjes së atij qëllimi dhe të drejtave të kërkuesit. Procedura para Gjykatës së Magjistratëve kishte qenë e bazuar

në parimin e kontradiktorialitetit, ku kërkuesi kishte marrë pjesë efektivisht dhe ishte përfaqësuar nga avokati gjatë kësaj procedure. Barra e provës gjatë procedurës ishte vënë mbi Zyrën e Doganës dhe Akcizës, dhe fakti që procedura e konfiskimit ishte zhvilluar në përputhje me standardin civil të provës nuk e komprometoi drejtësinë e procedurës dhe as nuk mbështeti argumentin se urdhri i konfiskimit kishte qenë joproportional.

Gjykata e pranoi mundësinë që refuzimi nga gjykata vendase për ta bërë publik arsyetimin e saj për urdhrin e konfiskimit mund të kishte dëmtuar drejtësinë e procedurës, pavarësisht nga fakti që ndaj kërkuesit nuk u vendos asnjë sanksion penal. Ky përfundim u bazua mbi parimin që dhënia e arsyeve për vendimet e marra në procedura civile ishte gjithashtu pjesë e kriterit të drejtësisë që përmban Neni 6 § 1. Pavarësisht nga kjo, kërkuesi e pati të drejtën statutore për apel para Gjykatës së Kurorës si dhe mundësinë për shqyrtim gjyqësor, por nuk shfrytëzoi asnjërën prej tyre në lidhje me dështimin e gjykatës vendase për të publikuar arsyetimin e saj. Roli i përfaqësuesit ligjor është pikërisht të jetë i vëmendshëm ndaj defekteve në procedura të cilat mund të paragjykojnë interesat e klientit të tij dhe t'i sjellë ato defekte në vëmendje të gjykatës. Megjithatë, përfaqësuesit ligjorë të kërkuesit nuk kishin ngritur kundërshtime, por kishte qenë dakord që procedurat të zhvilloheshin sipas Ligjit të vitit 1990. Dështimi i avokatëve të kërkuesit për të vlerësuar rëndësinë e këtij momenti la të kuptohet se ata nuk e shfrytëzuan mundësinë për ri-dëgjim në apel dhe për sigurimin e zgjidhjes për ankesën e tyre për mungesën e arsyetimit nga gjykata vendase.

Sa i përket shqyrtimit gjyqësor të vendimit të magjistratëve, Gjykata theksoi se kërkuesi kishte zgjedhur të argumentonte se urdhri i konfiskimit duhet të prishej sepse ai ishte marrë sipas Ligjit të gabuar. Gjykata vuri në dukje se sikur kërkuesi ta kishte vazhduar kërkesën e tij për shqyrtimin gjyqësor të dështimit të Gjykatës së Magjistratëve në Dover që të jepte arsyet për vendimin e saj, Gjykata e Lartë mund t'u kishte kërkuar magjistratëve që të ofronin një deklaratë të fakteve dhe arsyetimin e tyre në mënyrë që të siguronin nëse ishte bërë gabim ligji. Kështu, Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesi e kishte privuar veten nga mundësia për t'i marrë ato arsye dhe një vendim nëse vendimi i magjistratëve ishte i saktë në ligj.

Ankesa e kërkuesit sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 kishte qenë e fokusuar tek mungesa e arsyeve në urdhrin për konfiskimin e parave të tij. Megjithatë, ai nuk i kishte ndjekur zgjidhjet vendase për këtë çështje të veçantë, përkundrazi, ankesa e tij për shqyrtim gjyqësor kishte qenë e fokusuar tek keqaplikimi i Ligjit të vitit 1990. Prandaj, kërkuesi u gjet se kishte dështuar të shteronte zgjidhjet vendase, dhe Gjykata e deklaroi kërkesën të papranueshme.

*Pezullimi i zgjatur i procedurës për vepër administrative që e pengoi kërkuesin nga rimarrja e parave përkohësisht të konfiskuara përbëri shkelje të Nenit 1 të Protokollit 1*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **ZAKLAN k. KROACISË**

(Kërkesa Nr. 57239/13)

**16 dhjetor 2021**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte shtetas kroat i lindur në vitin 1944 që jetonte në Pakrac.

Më 28 janar 1991, autoritetet doganore të ish-Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (shq. RSFJ) përkohësisht konfiskuan nga ai 4,350 marka gjermane dhe 100 dollarë amerikanë nga kërkuesi, teksa ai tentonte t'i kalonte këto para përmes kufirit shtetëror në kundërshtim me ligjin. Më 27 mars 1991, Departamenti i Zagrebit në Inspektoratin e Operacioneve Federale në Valuta të Huaja nisi procedurën për kundërvajtje administrative kundër kërkuesit. Më 8 tetor 1991, Kroacia shpalli pavarësinë dhe shkëputi të gjitha lidhjet me RSFJ-në. Një muaj më pas, qeveria e Kroacisë shpalli një dekret që pezullonte të gjitha procedurat për vepra administrative në Departamentin e Zagrebit deri në përfundim të procesit të vijimësisë. Marrëveshja për Çështjet e Vijimësisë mes shteteve që vijonin të shkëputeshin nga RSFJ, e cila qeveriste menaxhimin e asetëve financiare të RSFJ-së dhe të drejtat pronësore të qytetarëve të RSFJ-së, hyri në fuqi më 2 qershor 2004.

Ndërkohë që procesi i vijimësisë vazhdonte, akuzat për vepër administrative kundër kërkuesit u vjetërsua. Në vitin 2007, kërkuesi bëri kërkesë në Prokurorinë e Shtetit për kthimin e parave të konfiskuara. Në vitin 2008, Prokuroria e Shtetit e refuzoi kërkesën me shpjegimin se paratë e konfiskuara ishin depozituar (dhe mbeteshin) në llogarinë e Inspektoratit të Operacioneve në Valuta të Huaja në Beograd, Serbi. Kërkuesi bëri padi civile kundër Shtetit duke kërkuar kthimin e parave të tij, gjë që u refuzua sepse paratë e konfiskuara mund të ktheheshin vetëm kur procedura për vepër administrative përmbyllej, ndërkohë që kjo procedurë qëndronte e pezulluar në pritje të përfundimit të procesit të vijimësisë. Kërkuesi apeloi, por ky apel u rrëzua në vitin 2011.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, kërkuesi parashtroi se autoritetet kroate duhet ta kishin ndërprerë procedurën për veprë administrative kundër tij sepse vepra për të cilën ai ishte akuzuar para shumë kohësh ishte vjetërsuar. Sikur autoritetet kroate ta kishin ndërprerë si duhet procedurën, Shteti do të kishte qenë i detyruar t'i kthente paratë e tij të konfiskuara.

### Neni 1 i Protokollit Nr. 1

Pika e parë që shqyrtoi Gjykata ishte nëse shkelja e ankimuar mund t'i atribuohet Shtetit të paditur. Ajo gjeti se ishte kështu për një mori arsyesh. Së pari, autoritetet kroate i morën përsipër procedurat për vepra administrative kundër kërkuesit nga autoritetet federale të ish-RSFJ-së. Së dyti, autoritetet kroate kishin vazhduar të zhvillonin procedura në përputhje me ligjet kroate qysh nga marrja përsipër prej ish-RSFJ-së. Së treti, fondet e konfiskuara përkohësisht duhet të ktheheshin sapo vepra në fjalë të vjetërsohej sipas ligjeve kroate dhe atyre serbe. Në fund, pezullimi i vënë nga ligjet kroate i kishte penguar autoritetet përkatëse nga marrja e vendimit për ndërprerjen e procedurës së vjetërsuar për veprë administrative kundër kërkuesit.

Teksa gjeti se situata për të cilën u ankua kërkuesi ishte e atribueshme ndaj Shtetit të paditur, Gjykata më tej iu kthye çështjes nëse pezullimi i zgjatur i procedurës për veprë administrative kundër kërkuesit, dhe pamundësia rezultuese e tij për të rimarrë paratë e konfiskuara përkohësisht, ishin në përputhje me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1.

Palët nuk e diskutuan që konfiskimi i parave të kërkuesit ishte i natyrës së përkohshme dhe nuk përbënte privim nga pasuria. Si të tilla, paratë e konfiskuara mbeteshin pronë private e kërkuesit. Prandaj, Gjykata vendosi që pasuria e konfiskuar ishte “posedim” i kërkuesit brenda kuptimit të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Më tej, Gjykata përcaktoi se pamundësia e zgjatur e kërkuesit për të pasur dhe përdorur posedimet e tij të konfiskuara duhet të shqyrtohej nën dritën e parimit të përgjithshëm të parashtuar në rregullën e parë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Rregulla e parë, e cekur në fjalinë e parë të paragrafit të parë të nenit, thekson parimin e përgjithshëm të gëzimit paqësor të pasurisë.

Kur analizon një shkelje të mundshme të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse veprimet e Shtetit kanë qenë të ligjshme, nëse kanë ndjekur një qëllim që ishte në interesin e përgjithshëm, dhe nëse është vendosur një “ekuilibër i drejtë” mes interesit të përgjithshëm në fjalë dhe të drejtave pronësore të kërkuesit.

Në rastin konkret, Gjykata gjeti se pezullimi i procedurës për vepër administrative u bë në përputhje me legjislacionin vendas. Gjykata gjithashtu gjeti se, duke vonuar ripagimin e shumave përkohësisht të depozituara në llogari jashtë territorit të tij deri në përfundim të procesit të vijimësisë nga ish-RSFJ dhe shpërndarjen e asetëve të ish-federatës, Shteti kishte ndjekur qëllimet e mbrojtjes së kuletës publike dhe ekonomisë kombëtare, të cilat janë qëllime të interesit të përgjithshëm. Megjithatë, Gjykata gjeti se shkalla deri ku ishte zgjatur procedura për vepër administrative nuk vendosi një ekuilibër të drejtë mes interesit të përgjithshëm dhe të drejtës pronësore të kërkuesit, i cili u desh të bartte një barrë joproporcionale. Gjykata doli në këtë përfundim sepse: a) pezullimi i zgjatur e pengoi kërkuesin nga kërkimi i kthimit të parave të tij përkohësisht të konfiskuara nga autoritetet kroate dhe ato serbe; dhe b) Shtetet vijuese kishin marrë masa në nivel kombëtar për të ofruar zgjidhje për individët në disa rrethana që të rimerrnin paratë, por jo për një individ në situatën e kërkuesit (shih *Ališić dhe të Tjerë k. Bosnje dhe Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*).<sup>[162]</sup> Rrjedhimisht, Gjykata doli në përfundimin se kishte pasur shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuesit 1,327 euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 4,365 euro për kosto dhe shpenzime. Gjykata nuk caktoi shpërblim për dëme materiale meqenëse gjeti se nuk kishte lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore mes shkeljes faktike, që ishte pezullimi i zgjatur i procedurës nga autoritetet shtetërore, dhe pretendimit të kërkuesit për dëme materiale.

[162] *Ališić dhe të Tjerë k. Bosnje dhe Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 16 korrikut 2014, Nr. 60642/08.

*Caktimi i gjobës në masën 60% të shumës në para të thata të cilat nuk u deklaruan gjatë kalimit të kufirit nga jashtë BE-së brenda BE-së u gjet se ishte joproporcional, ku ligjet hungareze shkelën ligjet e BE-së*

VENDIMI I GJYKATËS (DHOMA E DYTË) – KËRKESË PËR VENDIM PARAPRAK  
NGA KECSKEMÉTI KÖZIGAZGATÁSI ÉS MUNKAÜGYI BÍRÓSÁG (GJYKATA  
ADMINISTRATIVE DHE E PUNËS, KECSKEMÉT, HUNGARI), NË ÇËSHTJEN  
**C-255/14 ROBERT MICHAL CHMIELEWSKI K. NEMZETI  
ADÓ- ÉS VÁMHIVATAL DÉL-ALFÖLDI REGIONÁLIS  
VÁM- ÉS PÉNZÜGYŐRI FŐIGAZGATÓSÁGA**

(Çështja C-255/14)

16 korrik 2015

### 1. Faktet kryesore

Më 9 gusht 2012, z. Chmielewski hyri në territorin e Hungarisë nga Serbia dhe nuk deklaroi shumën e parave që kishte me vete. Kjo shumë ishte 147,492 Euro, dhe përbëhej nga 249,150 Leva bullgare (BGN), 30,000 Lira turke (TRY) dhe 29,394 Lei rumune (RON). Për pasojë, z. Chmielewski u urdhërua të paguante një gjobë administrative prej 24,532,000 HUF (afro 78,000 Euro) me një vendim të datës 4 tetor 2013 nga Nemzeti Adó- és Vámhivatal Dél-alföldi Regionális Vám- és Pénzügyőri Főigazgatósága (drejtoria e përgjithshme e doganave dhe financave për rajonin Dél-Alföld të Zyrës Kombëtare të Tatimeve dhe Doganave). Gjoha u vu mbi bazën se ai kishte dështuar ta deklaronte atë shumë parash në kohën e hyrjes në territorin e BE-së, dhe rrjedhimisht nuk kishte vepruar në përputhje me detyrimet e Rregullores Nr. 1889/2005, krahas detyrimeve të Ligjit Nr. XLVIII of 2007 ('Ligji Nr. XLVIII').

Me qëllimin e parandalimit të lëvizjeve të paligjshme të parave të thata, Rregullorja Nr. 1889/2005 e BE-së përcakton që çdo person që kalon kufirin nga jashtë BE-së në brendësi të BE-së me të paktën 10,000 Euro para të thata duhet ta deklarojë atë shumë tek autoritetet relevante në momentin që kalon kufirin (citati 6 i preambulës së Rregullores). Në mungesë të harmonizimit në nivel të BE-së të dënimeve të aplikueshme kur kryhet një shkelje e tillë e detyrimit për deklarim, Shtetet Anëtare duhet të ofrojnë dënime efektive, proporcionale dhe zbindëse, sipas Nenit 9(1) të Rregullores. Ligji Nr. XLVIII e zbatonte Rregulloren Nr. 1889/2005 në të drejtën vendase. Në mënyrë të veçantë, paragrafi 5/A(1)(c) parashikon që çdokush që hyn në territorin e BE-së pa përmbushur plotësisht detyrimin për të deklaruar paratë që



mban me vete, ashtu siç parashikon Neni 3(1) i Rregullores, do të paguajë në vend një gjobë në masën 60% të parave që ka me vete, kur shumta është më shumë se 50,000 Euro.

Pas kësaj, z. Chmielewski ngriti padi kundër atij vendimi para gjykatës referuese, në të cilën ai pretendoi që, *inter alia*, dispozitat e Ligjit Nr. XLVIII nuk ishin në pajtueshmëri me të drejtën e BE-së.

## 2. Pyetjet e ngritura nga gjykatat kombëtare

Gjykata Administrative dhe e Punës, Kecskemét, iu referua dy pyetjeve të GjDBE-së për një vendim paraprak.

Në fillim, u ngrit pyetja nëse shumta e gjobës së vënë sipas Paragrafit 5/A të Ligjit Nr. XLVIII, në zbatim të Rregullores Nr. 1889/2005, ishte konform kërkesave të Nenit 9(1) të asaj Rregulloreje. Pra, a ishin dënimet e vëna me ligj efektive, zhbindëse dhe njëkohësisht proporcionale me shkeljen dhe objektivin e synuar?

Në fund, u ngrit pyetja nëse Paragrafi 5/A i Ligjit Nr. XLVIII nuk shkelte, si rezultat i shumës së gjobës së vënë, ndalimin e kufizimeve të maskuara të lëvizjes së lirë të kapitalit në Traktatin e [BE] dhe në Nenin 65(3) të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (ang. TFEU).

## 3. Vendimi i GjDBE-së

Gjykata theksoi se, në mungesë të harmonizimit të legjislacionit të BE-së që vendos dënime që duhen dhënë kur nuk përmbushen detyrimet për deklarim, Shtetet Anëtare kanë fuqinë të zgjedhin ato dënime që u duken më të përshtatshme. Megjithatë, ato duhet ta ushtrojnë atë fuqi në përputhje me të drejtën e BE-së dhe parimet e saj të përgjithshme, pra në rastin konkret parimin e proporcionalitetit. Rrjedhimisht, masat administrative ose ndëshkuese të parashikuara nga legjislacioni kombëtar nuk duhet të shkojnë më larg sesa është e nevojshme për të arritur qëllimet legjitime që synohen nga ai legjislacion. Rreptësia e dënimeve duhet të përputhet me seriozitetin e shkeljeve për të cilat jepen ato dënime, dhe duhet të jenë vërtet zhbindëse në efektet e tyre, duke respektuar njëkohësisht parimin e proporcionalitetit.

Duke marrë parasysh kriteret e Nenit 9(1) të Rregullores, Gjykata njohu se dënimet në fjalë duken më të përshtatshme për arritjen e objektivave të synuara nga Rregullorja 1889/2005, meqenëse kanë gjasa të zhbëjnë nga shkelja e detyrimit

për deklarim. Sa u përket kritereve të proporcionalitetit, u theksua se një sistem brenda të cilit shuma e dënimit të vënë ndryshonte varësisht nga shuma e parave të padeklaruara në vetvete nuk dukej joproporcional. Përveç kësaj, Gjykata sqaroi se kriteri për dënimet proporcionale, ashtu siç parashikohej nga Neni 9 i Rregullores 1889/2005, nuk nënkuptonte që autoritetet kompetente duhet të marrin parasysh rrethanat individuale të secilit rast, siç është qëllimi (intenca) ose prirja për përsëritje (recidivizmi).

Megjithatë, pavarësisht nga këto konsiderata, duke pasur parasysh detyrimin për deklarim, siç përcaktohet në Nenin 3 të Rregullores 1889/2005, një gjobë ekuivalente me 60% të shumës së parave të padeklaruara, kur shuma është më shumë se 50,000 Euro, nuk mund të thuhet se është proporcionale, duke shkuar përtej asaj që është e nevojshme për të siguruar pajtueshmërinë me atë detyrim dhe përmbushjen e objektivit që synon rregullorja. Gjykata nënvizoi që Neni 9 i Rregullores nuk kishte për qëllim të penalizonte aktivitetet mashtruese ose të paligjshme por shkeljen e detyrimit për të deklaruar.

Gjykata po ashtu theksoi se, për të lejuar që autoritetet kompetente të zhvillojnë kontrollet e nevojshme në lidhje me prejardhjen, përdorimin e synuar dhe destinacionin e parave të padeklaruara, Neni 4(2) i Rregullores 1889/2005 ofronte mundësinë e mbajtjes së parave të padeklaruara në përputhje me Nenin 3 të Rregullores pas një vendimi administrativ dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në të drejtën vendase. Rrjedhimisht, një dënim që përmban një gjobë në një shumë më të ulët, krahas masës së mbajtjes së parave të padeklaruara, ka kapacitetin për të arritur objektivat e synuara nga ajo rregullore pa tejkaluar kufirin e nevojshëm për atë qëllim. Në rastin konkret, ishte e qartë nga dosja e dorëzuar në Gjykatë se legjislacioni në fjalë nuk përmbante dispozita për një mundësi të tillë.

Rrjedhimisht, Gjykata arriti në përfundimin se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej pyetja e dytë. Neni 9(1) i Rregullores Nr. 1889/2005 në lidhje me kontrollin e parave që hyjnë ose dalin nga BE duhet të interpretohet si i tillë që e përjashton legjislacionin kombëtar, si në çështjen në fjalë, e cila imponon pagesën e një gjobe administrative për të penalizuar mos-respektimin e detyrimit për deklarim të parashikuar nga Neni 3 i asaj Rregulloreje, shuma me të cilën korrespondon masa 60% e shumës së parave të padeklaruara, kur shuma është më shumë se 50,000 Euro.

*Gjykata sqaroi interpretimin e fushëveprimit të Direktivës 2014/42/EU mbi ngrirjen dhe konfiskimin e instrumentaliteteve dhe të ardhurave të krimit në Bashkimin Evropian. Ajo konfirmoi zbatueshmërinë e Direktivës kur kryerja e të gjitha elementeve të veprës relevante ka ndodhur në territorin e një Shteti të vetëm Anëtar. Për më tepër, ajo sqaroi fushëveprimin juridiksional të gjykatave vendase në lidhje me konfiskimin e përfitimeve ekonomike të rrjedhura nga kryerja e një vepre penale për të cilën kryesi është ndjekur penalisht, dhe të drejtat e palëve të treta për të marrë pjesë në procedurat e konfiskimit kur pretendohet se pasuria në fjalë i përket jo kryesit por vetë atyre.*

VENDIMI I GJYKATËS (DHOMA E TRETË) – KËRKESA PËR  
VENDIM PARAPRAK NGA APELATIVEN SAD – VARNA  
(GJYKATA E APELIT, VARNA, BULLGARI) NË ÇËSHTJET  
**E BASHKUARA TË PROCEDURAVE PENALE  
KUNDËR DR (C-845/19) DHE TS (C-863/19)**

(Çështjet Nr. C-845/19 dhe Nr. C-863/19)

**21 tetor 2021**

### **1. Faktet kryesore**

Këto dy çështje ishin referime paraprake të dala nga Apelativen sad ('Gjykata e Apelit') në Varna të Bullgarisë, në lidhje me interpretimin e Direktivës 2014/42/EU të 3 prillit 2014 për ngrirjen dhe konfiskimin e instrumentaliteteve dhe të ardhurave të krimit në Bashkimin Evropian, dhe të Nenit 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian ('Karta'). Kërkesat u bënë në kontekstin e procedurave penale pas dënimit të DR dhe TS ('personat e dënuar') dhe kishte të bënte me kërkesat për konfiskimin e shumave të parave për posedimin e narkotikëve me qëllim të shpërndarjes së tyre, shuma të cilat personat në fjalë pretenduan se u përkisnin palëve të treta.

Në mënyrë të veçantë, vendimi kishte të bënte me interpretimin e Nenit 5 të Direktivës, titulluar 'Konfiskimi i zgjeruar', i cili përcakton, inter alia, që Shtetet Anëtare duhet të miratojnë masat e nevojshme për të mundësuar konfiskimin e pasurisë që i përket një personi të dënuar për një vepër penale që mund t'i japë shkas përfitimit ekonomik, direkt apo indirekt, kur gjykata është e bindur se pasuria në fjalë ka rrjedhur nga sjellja kriminale pas ekzaminimit të fakteve specifike të secilës çështje. Dispozita relevante e të drejtës vendase, nën dritën e së cilës Direktiva u interpretua në rastin konkret, ishte Neni 53 i Nakazatelen kodeks (Kodi Penal; 'NK'), në lidhje me klasifikimin e veçantë të 'të ardhurave direkte' dhe 'të ardhurave indirekte' të një vepre penale për qëllime konfiskimi.

Më 21 shkurt 2019, DR dhe TS u gjetën, në Varna, se posedonin narkotikë tepër të rrezikshëm pa autorizim, me qëllim të shpërndarjes së tyre. Pas kësaj, ata u dënuan për atë vepër. Gjatë procedurave paragjyqësore, u zhvillua bastisja e vendbanimit të DR dhe makinës së tij nga autoritetet kompetente. Në kohën materiale, ai ishte duke jetuar me nënën dhe gjyshërit e tij. Aty u mor një shumë parash prej 4,447.06 BGN (afro 2,200 Euro). Bastisja paragjyqësore në ambientet ku jetonte TR me nënën e tij bëri që autoritetet të zbulonin një shumë parash prej 9,324.25 BGN (afro 4,800 Euro).

Pas dënimit penal të personave në fjalë, Okrazhna prokuratora – Varna (Prokuroria Publike Rajonale në Varna) bëri kërkesë pranë Okrazhen sad Varna (Gjykata Rajonale e Varnas) për konfiskimin e atyre shumave të parave në favor të Shtetit, në përputhje me dispozitat relevante të së drejtës vendase. Gjykata Rajonale shqyrtoi kërkesën në një seancë publike në të cilën morën pjesë personat në fjalë. Gjatë procedurës, DR deklaroi se shuma e zbuluar e parave i përkiste gjyshes së tij e cila e kishte marrë si hua në bankë, duke nxjerrë prova që tregonin se, në dhjetor 2018, gjyshja e tij kishte tërhequr shumën 7,00.06 BGN (afro 3,500 Euro) nga llogaria e saj bankare. Gjyshja e DR nuk pati mundësi të merrte pjesë në procedurë, meqenëse e drejta bullgare nuk e lejonte të ishte aty si palë tjetër nga kryesi i veprës, dhe ajo nuk u dëgjua as si dëshmitare. Më tej, TS pretendoi se shuma e parave në fjalë i përkiste nënës dhe motrës së tij, duke parashtruar prova me shkrim që tregonin se, në mars 2018, nëna e tij kishte marrë një hua konsumatori në shumën 17,000 BGN (afro 8,500 Euro). Megjithëse nëna e TS po ashtu nuk kishte mundësi të merrte pjesë në procedurë, ajo u dëgjua si dëshmitare në lidhje me këtë pikë.

Gjykata Rajonale e Varnas refuzoi të autorizonte konfiskimin e shumave të parave në fjalë, duke gjetur se vepra penale e posedimit të narkotikëve me qëllim të shpërndarjes së tyre, për çka personat në fjalë ishin dënuar, nuk ishte e tillë që gjeneronte përfitime ekonomike. Megjithëse u nxorën prova që ata kishin qenë duke shitur narkotikë, kriteret për konfiskimin në favor të Shtetit të cekura në dispozitën relevante sipas Nenit 53(2) të NK nuk u plotësuan, sepse Prokuroria Publike nuk i kishte akuzuar personat në fjalë për shitje të narkotikëve, dhe dënimet penale nuk kishin konfirmuar trafikimin e narkotikëve.

Prokuroria Publike e apeloj këtë vendim përpara se gjykata referuese, Gjykata e Apelit në Varna, të parashtronte se Gjykata Rajonale nuk e kishte aplikuar dispozitën nën dritën e Direktivës 2014/42. Nga ana tjetër, personat në fjalë parashtruan që e vetmja pasuri materiale direkt e rrjedhur nga vepra për të cilët ata ishin dënuar mund të konfiskohej.

## 2. Pyetjet e shtruara nga gjykatat kombëtare

Gjykata e Apelit në Varna i pezulloi procedurat për të referuar pyetjet vijuese tek GjDBE për vendim paraprak:

Së pari, u pyet nëse Direktiva 2014/42/EU dhe Karta ishin të aplikueshme në lidhje me një vepër penale që ka të bëjë me posedimin e narkotikëve dhe për qëllime të shpërndarjes së tyre, kryer nga një shtetas bullgar në territorin e Bullgarisë, ku të ardhurat ekonomike potenciale realizohen dhe janë të vendosura në Bullgari.

Më tej, nëqoftëse ato dispozita të së drejtës së BE-së aplikohen në rastin konkret, GjDBE u pyet se si duhet të kuptohet koncepti i “avantazhit ekonomik të rrjedhur... indirekt nga një vepër penale” në Nenin 2(1) të Direktivës përkatëse, dhe nëse një shumë parash e gjetur dhe e konfiskuar nga shtëpia e një personi të dënuar dhe familjes së tij, ose nga makina e tij, mund të përbëjë një avantazh të tillë.

Së treti, Gjykata u pyet nëse Neni 2 i Direktivës duhet të interpretohej si i tillë që e përjashton një dispozitë vendase si Neni 53(2) i NK, e cila nuk parashikon konfiskimin e një avantazhi ekonomik të rrjedhur indirekt nga një vepër penale.

Në fund, nëqoftëse Neni 47 i Kartës do duhej të interpretohej si i tillë që e përjashton një dispozitë vendase si Neni 306(1)(1) i Nakazatelnoprotsesualen kodeks (Kodi i Procedurës Penale, ‘NPK’), e cila lejon konfiskimin në dobi të Shtetit të një shume parash që pretendohet se i përket një personi që nuk është kryesi i veprës penale, ku ajo palë e tretë nuk ka mundësi të marrë pjesë në ato procedura me të drejtën e vet dhe duke pasur qasje të drejtpërdrejtë në gjykatat vendase.

## 3. Vendimi i GjDBE-së

Në përgjigje ndaj pyetjes së parë, GjDBE deklaroi se Direktiva 2014/42/EU për ngrirjen dhe konfiskimin e instrumentaliteteve dhe të ardhurave të krimit në Bashkimin Evropian duhet të interpretohet si e tillë që nënkupton se posedimi i narkotikëve me qëllim të shpërndarjes së tyre hyn brenda fushëveprimit material të saj, edhe kur të gjitha elementet e kryerjes së asaj vepre janë të kufizuara brenda një Shteti të vetëm Anëtar. Gjykata theksoi se Direktiva ishte e bazuar, *inter alia*, mbi Nenin 83(1) të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (ang. TFEU), i cili i mundëson Bashkimit Evropian të përcaktojë rregulla minimale harmonizimi në lidhje me përkufizimin e veprave penale dhe sanksioneve për krime veçanërisht të rënda të

dimensioneve ndërkufitare, qoftë për shkak të natyrës apo impaktit të veprave të tilla, ose për shkak të nevojshmërisë së një baze të përbashkët për t'i goditur ato, brenda së cilës hynte 'trafikimi i paligjshëm i drogës'.

Në përgjigje ndaj pyetjes së dytë dhe të tretë, në lidhje me interpretimin e konceptit të avantazhit ekonomik të rrjedhur indirekt nga një vepër penale, nën dritën e Nenit 2(1) të Direktivës 2014/42, Gjykata theksoi se, megjithëse personat në fjalë ishin dënuar për posedim të narkotikëve të rrezikshëm me qëllim të shpërndarjes së tyre, ajo vepër penale në vetvete nuk krijonte avantazh ekonomik. Prandaj, shumat e parave konfiskimi i të cilave kërkohej nuk mund të kishin ardhur nga ajo vepër penale. Më tej, megjithëse kishte prova që personat në fjalë kishin qenë duke shitur narkotikë, ata as nuk u ndoqën penalisht e as nuk u dënuan për një vepër të tillë penale. Në rastin konkret, GjDBE nënvizoi se u takonte gjykatave referuese të vlerësonin nëse vepra në fjalë në procedurën kryesore kishte gjasë t'i jepte shkas, direkt apo indirekt, përfitimeve ekonomike, duke marrë parasysh rrethanat e kryerjes së veprës.

GjDBE vendosi që Direktiva duhet të interpretohet si e tillë që nënkupton se ajo parashikon vetëm konfiskimin e pasurisë që përbën përfitim ekonomik të rrjedhur nga vepra penale për të cilën kryesi është dënuar, por ajo gjithashtu parashikon konfiskimin e pasurisë që i përket një kryesi kur gjykata vendase që e shqyrton çështjen bindet se pasuria ka rrjedhur nga sjellje të tjera penale. Megjithatë, mbrojtjet e ofruara nga Neni 8 i Direktivës duhet të respektohen, dhe vepra për të cilën kryesi është dënuar duhet të renditet në Nenin 5(2) dhe të jetë e tillë që mund t'i japë shkas, direkt apo indirekt, përfitimit ekonomik brenda kuptimit të përcaktuar nga Direktiva.

Në lidhje me pyetjen e katërt, GjDBE vendosi që Neni 8(1), (7) dhe (9) i Direktivës 2014/42, i lexuar së bashku me Nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, duhet të interpretohet si i tillë që e përjashton legjislacionin vendas i cili lejon konfiskimin, në favor të Shtetit, të pasurisë e cila pretendohet se i përket një personi që nuk është kryesi i veprës penale, ku ai person nuk ka të drejtë të paraqitet si palë në procedurat e konfiskimit. Në mënyrë të veçantë, ishte thelbësore për Direktivën që të njihet fakti se kjo prek thelbësisht të drejtat e personave, jo vetëm të të akuzuarve por edhe të drejtat e palëve të treta që pretendojnë se janë pronare të pasurisë në fjalë. Neni 8 i Direktivës ngërthen mbrojtjet për ato palë të treta. Nën dritën e këtyre dispozitave të Nenit 8, cituar lart, një palë e tretë në kontekstin e procedurave të konfiskimit, e cila pretendon, ose në lidhje me të cilën pretendohet, se është pronare e pasurisë që është objekt i konfiskimit, duhet të informohet rreth të drejtës së saj për t'u paraqitur si palë në procedura dhe rreth të drejtës për t'u dëgjuar. Ajo palë duhet të vihet në një pozitë ku mund t'i ushtrojë ato të drejta dhe

të pretendojë pronësinë përpara se të merret urdhri i konfiskimit. Në rastin konkret, Gjykata vendosi që këto kritere të Nenit 8 të Direktivës nuk janë përmbushur në rrethanat në të cilat, sipas të drejtës vendase, pala e tretë nuk mund të paraqitet si palë në procedurat aktuale të konfiskimit dhe për këtë arsye duhet ta ngrëjë padinë e saj para një gjykate civile.







Përgatitja e këtij publikimi është mbështetur nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar.  
Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim nuk reflektojnë domosdoshmërisht  
qëndrimin zyrtar të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.